

Bashkia Shkodër
Biblioteka "Marin Barleti"

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

*14 - 2021
Vjeti VI i botimit,
Shkodër*

Gegnia
E përkohshme kulturore-artistike

14-2021
Vjeti VI i botimit,
Shkodër

Redaksia:
Maxhid Cungu, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër
dhe Bibliotekës "Marin Barleti"**

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka "Marin Barleti", Shkodër
E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al
info@bibliotekashkoder.com

Shënim: *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

Përmbajtja

• Editoriali •

Mario de ANDRADE

Qeska e karamelve

• Vjete përkujtimorë •

Ernest KOLIQI

Dante e ne shqiptarët

Arben PRENDI

Çfarë kuptimi ka vepra letrare e Dantes në kohën tonë?

At Pjetër MËSHKALLA

Kritikë ndërtuese

• Albanologji. Qytetërim •

Ernest MARKU

Fishta: historia e të parëve dhe pema gjenealogjike

Engjëll ÇEKA

Historia e familjes ÇEKA (SUMMA) (pj.I)

• Trashëgimi kulturor •

Gjush SHELDIJA

Dasma në Dukagjin

• Histori •

Gëzim H. JUKA

Përfaqësuesit e pushtetit qëndror në nivelin vendor

në Shkodër 1912-2020

• Letërsi •

Stefan ÇAPALIKU

Kolë Ashta letrar

Klodiana MARTICAMAJ, Ermira ALIJA

Elemente letrare në periodikun e Shkodrës, në vitet 1910-1920

Salvator GJEÇI

Cikël poetik

• **Filateli** •

Luigj SHABANI

Historia përsëritet

• **Bibliofili** •

Valbona BËRDICA

Refleksion për revistën e parë në Shkodër (pj.2)

Fatmira LEKIQI

"Gjurmë të Ai' Gjergj Fishtës në Bibliotekën Publike

"Marin Barleti"

• **Kronikë** •

Dante Alighieri: profet i shpresës dhe poet i dëshirës njerëzore

• **In memoriam** •

Zenepe DIBRA

Artan Hamid Boriçi (1965-2021) shkencëtari i shquar shkodran

Artan HAXHI; Tefë TOPALLI

Ndahet nga jeta, Prof. Njazi Kazazi

Zija VUKA

In memoriam. Skënder Temali

Pjerin MIRDITA


In memoriam. Eduart Grizhaj

Në vend të editorialit

Mario de ANDRADE (1893-1945)

QESKA E KARAMELEVE¹

Përktheu: Aurel Plasari



Numërova vitet e mia dhe zbulova që kam më pak kohë për të jetuar tash e mbrapa në krahasim me sa kam jetuar deri më tani.

Ndihem si ai fëmija, të cilit i dhurojnë një qeskë me karamele: të parat i ha gjithë ngut e gëzim, por, kur e vë re se i kanë mbetur pak, fillon t'i shijojë ashtu siç duhet.

¹ <https://www.radiandradi.com>

Nuk kam kohë për mbledhje pa fund, në të cilat diskutohen statute, ligje, procedura dhe rregullore të brendshme, duke e ditur që në fund të fundit nuk do të përfundohet gjë.

Nuk kam kohë për të duruar persona absurdë, që të mos jenë rritur në asnjë kuptim tjetër përpos se nga mosha në regjistrin e gjendjes civile.

Nuk kam kohë për të humbur me budallallëqe.

Nuk dua të marr pjesë në veprimtari ku parakalojnë "EGO" të fryra.

Tani nuk i duroj dot më manipulorët, arrivistët, interesaxhinjtë.

Më bezdisin ziliqarët, që rreken të çkreditojnë më të aftët, për të përfituar nga talenti i tyre dhe rezultatet e tyre.

I urrej, nëse jam dëshmitar, efektet që shkakton lufta për një post të rëndësishëm.

Nuk i duroj dot personat që nuk diskutojnë për përmbajtjet, por për titujt.

Kam pak kohë për të biseduar për të mira materiale ose pozicione sociale.

Dua thelbësoren, sepse shpirti im tani ka ngut.

Dhe me kaq pak karamеле në qeskë...

Tani, kaq i vetëm, dua të jetoj mes qenieve njerëzore shumë të ndjeshme.

Njerëz që të dinë të dashurojnë e të mos tallen me të patëkeqtë e me gabimet e tyre.

Njerëz shumë të sigurt në vetvete, që të mos mburren për luksin e

vet dhe për pasuritë e veta.

Njerëz që të mos e mbajnë veten "të zgjedhur" parakohe.

Njerëz që të mos u ikin përgjegjësi të veta.

Njerëz sa më të sinqertë që të mbrojnë dinjitetin njerëzor.

Njerëz me të cilët dëshiron vetëm të jetosh me ndershmëri e drejtësi.

Sepse vetëm thelbësorja është ajo që e bën jetën t'ia vlejë të jetohet.

Dua të rrethohem nga njerëz që të dinë të mbërrijnë në zemrën e njerëzve.

Njerëz të cilëve goditjet e rënda të jetës t'u kenë mësuar të rriten me përkëdhelje të ëmbla në shpirt.

Po... kam ngut... për të jetuar me intensitetin që asgjë më shumë se pjekuria mund të na e japë.

Nuk kam ndër mend të humb as edhe një karamelë të vetme nga ato që tani më kanë mbetur në qeskë.

Jam i sigurt që këto karamelë do të jenë më të shijshme se ato që kam ngrënë deri më tani.

Synimi im, fundja më në fund, është të iki i kënaqur dhe në paqe me të dashurit e mi dhe me ndërgjegjen time.

Të uroj që edhe synimi yt të jetë i njëjti, sepse, në njëfarë mënyre, edhe ti për të ikur ke...

• Vjete përkujtimorë •**Ernest KOLIQI****DANTE E NE SHQIPTARËT**

Tue u besue kujtimeve t'mia të largëta të kohës kur isha mësues i letërsisë shqipe në Gjymnazin Shtetnor të Shkodrës (prej tete klasësh: unë jepja letërsi shqipe në tre klasat e fundit nga 1930 deri më 1933), mund të pohoj se poezia e Dantes u interesonte gjallnisht nxanësve të mi. Asokohe mësimi i letërsisë e zhvillohej mbrenda hullive të gjinisë letrare, e tekstet¹, redaktue simbas rregullave shkollore të kohës,

¹ Teksti që përdorej në shkollat shtetnore A.Xhuvani e K.Cjpo- Fillime të Stilistikës e të Letërsisë së Përgjithshme -Tiranë, 1930, përveç - nocioneve t'zakonshme stilistike përmban edhe përmbledhje të gjana mbi veprat kryesore t'letërsive të mëdha. Në pjesën e parë jepeshin udhëzime mbi artin e t'shkruemit nëpënnjet shumë shembujsh të metaforave e tropeve,të stilit, të metrikës klasike e moderne, gjithë tue iu referue në mënyrë t'vçantë shqipes.Në pjesën e dytë,tue ndjekë ndamjen simbas gjinive letrare jepeshin te dhana mbi autorët e mëdhejtë t'gjith aletërsive.Mbi Danten dhe Komedinë e tij flitet në faqen 144 e n'vijim të tekstit.Kurse në Gjymnazin e Françeskanëve në Shkodër, përdorej teksti i Justin Rrotës-Letërsytira Shqipe,Shkodër,1934, i paësun me gjansima t'madhe referimesh për sa i perket autorëve e veprave sis hqiptare është dhe të hueja. Më 1925, Rrota, kishte realizue botimin e parë të kësaj vepre të tij.Në botimin e dytë"Letteratyra"e tij shfaqet krejtësisht e ripunueme me kritore letrare ma t'lira e ma t'gjana.Në Gjymnazin e Etënve Jezui të përdorej manuali i Patër Antonio Zanoni: Prësinclá më të letërsytës,Shkodër,1912e1920,i përpunuem me shtoj ca të mprehta e t'gjalla nga Patër

prezantonin së pari veprat e autorve shqiptarë tue u zgjanue mandej në t'dhanunit e informacionit mbi kryeveprat e shkëlqyeme t'letrësisë së huej.

Në tri klasat e fundit të gjimnazit, nxanësit ishin në gjendje me lexue mjaft mirë vepra në gjubën përkatëse, veçanërisht n'italisht e frëngjisht. Natyrisht, për një nivel përvetsimi ma t'mirë parapëlqeheshin veprat e përkthyme në shqip, kur ato egzistonin. Në mungesë të tyne, mësuesi (që thuejse në t'gjitha rastet kishte krye studimet jashtë shteti) ushtrohej në përkthimin e fragmenteve ma t'randsishëm, tue përdorë maksimumin e mundsive të veta.

Mbi gjithçka, ishte jeta e Dantes ajo që u linte mbresa nxanësve shqiptarë, jeta e mbushun me situata dramatike t'shkaktueme nga kundërshti të dhunshme e urrejtje t'pamshirshme qytetare. Disa pasazhe t'kronikave të Dino Compagni e Giovanni Villani, shfaqen si përshkrim i gjallë i ngjarjeve bashkohore vendore. Portreti i Corso Donati-t, me pak përpunim, u përshtatej saktësisht personaliteteve t'njoftun nga të gjithë. Ngjarjet fiorentine t'epokës së Dantes shfaqeshin shumë të ngjashme me ato që patën tronditë Shqipërinë mbas luftës së parë botnore, pasojat e t'cilave randojnë mbi të gjithë ende sot. Mentaliteti i Dantes përkon në përgjithsi me shpirtin shqiptar. Ndamjet në klane, shkapetjet e vrullshme t'ambicjeve, ndërhyrjet e jashtëme, intrigat mes familjeve të mëdha t'vume ne garë për me shti n'dorë qeverisjen e qytetit, përndjekjet dhe debimet, pra tanë lamshi i pasioneve që përbajnë sfondin e jetës dhe veprës së Fiorentinit të Madh, qenë shumë të kuptueme prej shqiptarve. Çuditësha edhe se me sa lehtësi e kapnin konceptin politik dantesk. Kalimi në vazhdën e shekujve, nga perandoria romake n'atë bizantine e së fundi të gjindunit nën juridiksionin perandorak osman, ka lanë gjurmë të thella në kujtesën kolektive të popullit tonë. Edhe në perandorinë e paanë të Sulltanëve, që shtrihej në tre kontinente, nuk mungonin nismat e zotnijve të fuqishëm vendas për me prishë rendin eprovincavet'gjana. Askush nuk kundërvihet autoritetit nominal të Padishahut (të Sulltanit) në personin e t'cilit ishin përqëndruet të gjitha pushtetet civile, ushtarake e fetare: ai ishte Perandori e Kalifi, Mëkambsi i Profetit mbi tokë. Nshanësit e mi i kuptonin shumë mirë përpjekjet e dëshpërueme t'fiorentinëve për me ruejtë autonominë absolute t'ligjeve të tyne shtetnore, gjithnji tue veprue në emën t'imperatorit e tue mos ia dishrue tepër praninë e vazhdueshme: nga ana

tjetër orientoheshin me vështirsi në mosmarrveshjen mes Perandorisë dhe Papatit. Nuk gjenin raste luftimesh mes pushtetit perandorak e klerit në tanë historinë osmane, madje as në pashallëqet e ndryshme ku këto pushtete qenë të ndamengaana administrative. Nxitun nga kjo arsye e rrjedhimisht nga ndryshueshmënia tansore e edukatave religjioze, mes kantikëve të Komedisë Hyjnore, vëreja se Ferri e deri-diku dhe Purgatori, kuptoheshin dhe shijoheshin nga nxanësit; Parajsa mjaft ma pak, për t' mos thanë aspak nëse përrjashtojme kangët e Cacciaguida-s ku lavdohet jeta tradicionale dhe mërgimi ilajmëruem i Poetit. Plasticiteti i artit danteski cili shpaloset në figurat e t' mallkuemve të mëdhej, (Skota e Umbertit, Uliksit, Kontit Ugolino etj.) zgjonte emociione të forta tek t'rijtë. U pëlqente edhe pasazhi i Purgatorit në të cilin muzikanti *Casella*, tue qenë i ftuem prej Dantes, këndon dhe kanga e tij përhapë ambëlsi të pashprehshme në shpirtin e t' pranishmëve. Nuk kam ndërmend me bā këtu ndonji disertacion mbi efektet psikologjike që poezia danteske prodhon te shqiptarët: due thjesht që, tue u bazue në përvojën time prej mësuesi, me nënvizue faktin se burrnia dhe karakteri i Poetit- ai qëndrim i tij përçmues dhe krenar përballë kundërshtarve politik, individëve vulgarë përsa i takon nivelit t'ulët shpirtnor, apo kundërt atij që i shmangej ligjeve të nderit,- i shkundnin nxanësit e mi. E i entuziazmontelāvdi i guximit, ivirtyeteve të forta tradicionale, pika mashkullore e vështrimit dantesk në vlersimin e veseve dhe virtyeteve njerzore.

Aty nga viti 1938, Pater Gjergj Fishtës i kceu damari me iu përveshë përkthimit në shqip të disa soneteve t' Petrarkës. Por mbas do përpjekjesh t'mundimshme më pohoi vështirsitë e paprituna që po i dilnin gjithnji përpara. Tha: *"Ësht e çuditshme: për me bā një variant t'një kange të Dantes në shqip, do kisha gjetë menjherë fjalë e fraza t'qillueme; nuk kuptoj se pse u dashka me mundue kaq fort për me përkthye Petrarkën..."*

Po mandej e kuptoi e dha një spjegim në mënyrën e tij: "Thelbi mashkullor i poezis e së Dantes përputhet me karakterin e fuqishëm dhe konceptimin heroiko-patriarkal që ka jeta shqiptare, veçanërisht ajo e maleve. Gjuha jonë mashkullore, e nënshtrueshme ndaj lakoniznit sintetik, përdoret në mënyrë të shkëlqyeme për me i mbartë shprehjet e fuqishme danteske. Nga ana tjetër, modulimet valzuese t'vargjeve të Petrarkës, t'bame komplekse nga mundimi i tij i dashunisë, i përpunuem e delikat, që mugullon herë n'turbullime sensuale e herë n'vrulle shpirtnore, jo vetëm që i gjen me vështirësi termat e përshtatshme

ekspresive në trashëgiminë tonë leksikore, por shfaqet në kundërshti të hapun me çdo manifestim të natyrës sonë, e privueme nga lloji i ndjenjave dritëhijore”.

Kështu u shpreh Orakulli ynë e, në të vërtetë përktheu vetëm disa sonete të Petrarkës (që i botova në revistën time “Shkëndija”² e nuk iu nënshtrua ma mundimeve të përkthimit i cili, - pamvarsisht nga njohja e pakrahasueshme që ai zotnonte në të gjitha nivelet e gjuhës shqipe - i dukej i vështirë.

Fatkeqsisht nuk mujta me e binde që t’na jepte versionin shqip të ndonji kange të Komedisë. Ai ishte i vetmi mes nesh që i kishte të gjitha dhuntitë për me e pasunue trashëgiminë tonë letrare me egzemplarë të përkthimit dantesk.

Sidoqoftë, egzistojnë edhe në shqip prova serioze e t’zellshme, qoftë të versioneve të “Vita Nuova”, qoftë të “Rima”-ve e qoftë të “Komedisë Hyjnore”.

Të parën sprovë në kronologji kohore - botue në Antologjinë Shqiptare të Jeronim De Radës - ia detyrojmë italo-shqiptarit Luigi Lorecchio, vëllait të Anselmo-s, themeluesit dhe drejtuesit të periodikut “La Nazione Albanese”³

Është një përkthim besnik dhe i kujdesshëm në vargje t’lira të tij. Autori, në vitet e para të “Nazione Albanese” ka botue shpesh lirika shumë të rrjedhshme e plot pathos, tue përdorë të folmen e Pallagorio-s (Provincë e Catanzaro-s), t’pasunueme plot kujdes e hijeshi me fjalë toske (nga dialekti i Shqipnisë Jugore).

Në të njejtin periodik, më 1900, gjejmë një version të kangës V të Ferrit realizue nga Sokol Baci, i cili padyshim është Kola, i biri i t’famshmit Bajraktar t’Maleve të Mbishkodrës Sokol Bacit. Kolë Baci ishte diplomue në Romë dhe shumë nga poezite e tij patriotike, shkrua në fillim të këtij shekulli e botue në “Nazione Albanese”, lexohen ende me interes. Në provën e tij të përkthimit dantesk, Baci jep provat e një mjeshtri në përdorimin e vargut njimbëdhjetërokësh (i panjohun për poezinë popullore të Shqipnisë dhe i përdorun vetëm nga italo-shqiptarët në vjerrsha, pra ndër serenatat e improvizueme tipike nokturne të dashunisë) e në lirshmëninë e dukshme t’ përdorimit të tercines së lidhun, aq e vështirë në shqip për rimen e saj të trefishtë.

Gjuha që përdor është gegnishtja e Shkodrës, e gjallë dhe e fuqizuese

2 Shlf. Revista “Shkëndija” Tiranë, Viti I Nr. 3 (Gusht 1940), fq.10-11.

3 Shlf. Jeronim De Rada-Antologjia Albanese -Napoli, 1896-fq.66-70.

nga përdorimi i shprehjeve idiomatike. Tue pasë parasysh kohën e dhanë në të cilën u shfaq, kjo përpjekje meriton vemendje.

Më 1924, i ndjeri Vinçens Prennushi⁴, vdekun tragjikisht mbas luftës së dytë botnore, me penën e naltë që kapërcente shkathësisht çdo pengesë ndër ushtrimet ma t'zjarra poetike, botoi në vëllimin e tij me lirika një përkthim t'admirueshëm të Kangës së Shën Françeskut (kanga XI e "Parajsës"), ku ritmi e rima jo vetëm që e ndjekin besnikërisht origjinalin por dhe mbartin në shqip valëzimet e veçanta muzikale dhe theksimet e ngjyrës.

Më 1932, nga shtypshkronja e botuesit Nikaj të Tiranës, doli vëllimi i parë i "Poetët e Mëdhej t'Italis"⁵ t'autorit të këtij shkrimi, që përmblihte versionin e disa fragmenteve danteske. Poeti kombtar Gjergj Fishta, në një parathanie mjeshtrorë të librit, lëvdonte (e të gjithë e dimë se sa i përmbajtun ishte ai në lëvdime!) ato përkthime që i pëlqyen edhe një tjetri poeti tonë t'madh, Dom Ndrë Mjedës (që lëvdonte edhe me ma vështirsi se Fishta) i cili foli fjalë shumë të mira në një reçension tek revista "Leka". I vlersoi mirë edhe Prof. Carlo Tagliavini në parathanien e vëllimit të dytë, botue me 1936.

Në të sipërpërmendunën revistën "Leka"⁶, i palodhshmi Kristo Floqi na dhuroi më 1937 përkthimin e episodit të Kontit Ugolino, (Kanga XXXIII e Ferrit). Nxitun nga nevoja e papërballueshme e të shkruemit, Floqi, autor veprash të shumta që në hapsinën e gjanë prodhuese përfshijnë studime juridike, esse mbi administrimin shtetnor, e një gamë t'larmishme shkrimesh në të cilat figurojnë tana llojet letrare, që nga lirika dhe epika deri tek dramatika e artet rrëfimorë, fatkeqsisht nuk i kushtoi vemendje mënyrës së të shprehurit dhe pena e tij, me tepër kollajlllek hidhet nga proza në poezi, pa i dhanë tharm stilit që shfaqet njilloj i rrafshët si në përkthimet prej greqishtes antike, ashtu edhe në letërsinë moderne. Ky version me vargje njimbëdhjetrokëshe çaluëse,

4 Shfl.A.Vinçens Prennushi – Gjethe Lule - Shkodër,1924.

5 Shfl.Ernest Koliqi - Poetët e Mëdhej t'Italis - Vëll.I (Dante, Petrarca, Ariosto, Tasso)-me parathanien e At Gjergj Fishtës -Tiranë, 1932;

Vëll.II (Parini, Monti, Foscolo, Manzoni)-me parathanie të Prof.Carlo Tagliavini - Tiranë 1936. Lirikat e Leopardi-t, Carducci-t, Pascoli-t, D'Annunzio-s, që duhej të shfaqeshin në vëllimin III,qenë botue ndër gazeta e periodikë letrarë nga viti 1937 e n'vijim. Dom Ndrë Mjedja flet për përkthimin e "Sepolci" të Foscolo-s në "Leka" - Viti VII (1935) Nr. I në numrat 1 dhe 2 revista "Leka" botoi lirikën e Foscolo-s të përkthyerme në shqip,që mandej gjeti vend në vëllimin II të veprës së sipërpërmendun.

6 Shfl. Kristo Floqi-Kont Ugolini- përkthye në "Leka"Shkodër , Viti IX. Nr.4. (prill 1937) Fq.162-165

me fraza të përgjithshme, me strofa katërshe e rimë t'alternueme, shpesh arbitrare, përta i takon interpretimit të tekstit original, damton mbi gjithçka tonin: Floqi e transformon ngjarjen tragjike në një ndodhi të kronikës së zezë dhe e shtjellon me ritmin e një ballade popullore.

Dy episode t'përkthyme në tosknisht (Kanga X e Ferrit e Skatës se Umbertëve e edhe ajo e Kontit Ugolino) gjenden në tekstin shkollor "Letërsi e Huaj" të Mahir Domit⁷ e Sterio Spasses, por meqë në lidhje me çështjen në fjalë na mungojnë treguesit, nuk dijmë nëse përkthimi është vepër e tyre a e të tjerë; gjithsesi nuk na duket përkthim kushediseçfarë.

Ma në fund, mbas shumë përpjekjesh të pjesshme, pak a shumë të mbërrituna, ja tek shfaqet përkthyesi i shumëpritun i tanë Komedisë Hyjnore. Tashma janë përkthye "Ferri" e "Purgatori". "Parajsa" thuhet se është në botim e sipër. Së shpejti pra, krahas versioneve nga greqishtja e latinishtja të Naim Frashërit, Gjergj Fishtës e Etem Haxhiademit, Frano Alkajt dhe t'atyne anglezë e gjermane nga Fan S. Noli, Vinçens Prenushi e Lazer Shantoja, do t'kemi edhe poemëne Dantes përkthye në shqip nga Pashko Gjeçi⁸. Ai është diplomue për letërsi e Filozofi n'Universitetin e Romës më 1941 e ka botue vjersha dhe esse kritike shumë të çmueme ndër periodikë letrare. Që prej ma se pesëmbëdhjetë vitesh, i është përkushtue me tana energjitë e veta përkthimit në shqip të kryeveprave danteske.

Në shkrimet e tij, Gjeçi jep një provë mikluese përta i takon njohjes së leksikut e frazeologjisë shqiptare. Ai e ka studiue thëllsisht shqipen, kështuqë zotnon përgatitjen e nevojshme për t'u përballë me ndërmarrjen e naltë të përkthimit të Dantes, nëpërmjet një gjuhe që ka veç një shekull që është ngritë në nivelin e sprovave letrare. Me një formim t'rreptë klasik, tue e përsosë shijen edhe mbi autorët e mëdhej t'letërsive të mëdha perëndimore, Gjeçi ka fitue dhuntinë e zgjedhjes së fjalëve e lokucioneve pa të cilat, çdolloj përkthimi prej një gjuhe në tjetrën rrezikon me u katandisë në parodi. Besnikëria e përkthimit nuk qëndron në rrejtimin e saktësisë së kuptimit të fjalëve, jo në mbartjen prej një gjuhe në tjetrën të një koncepti, t'mbushun me ndjenjë të veçantë e vezullues në tisin e një imazhi origjinal, por në zgjidhjen e qëllueme të një shprehjeje mundësisht të ngjyeme në idioma, qe japin, - përveç domethanies - do t'hoja tonin, tingullin dhe koloritin e origjinalit.

7 Shfl. Mahir Domi - Sterio Spasse - Letërsi e Huaj - Tiranë, 1960. Fq. 41-53.

8 Dante Aligieri - Komedia Hyjnore - përkthye prej origjinalit nga Pashko Gjeçi - Redaktue nga Llazar Siliqi. Ferri, Tirane 1960 - Purgatori, Tirane 1962.

Gjeçi, lexues i vazhdueshëm i poemës danteske, prej së cilës njeh me siguri shumë pjesë përmendësh, lëshohet mbas ritmit të njimbëdhjetërrokshit e lojnavë të shumta t'rimës së tretë, do t'hoja me epsh. Shfaqet e përkryeme teknika e tij prej vargëzuesi në mbrojtjen e njimbëdhjetërrokshit teksa përpiqet, dhe në të shumtën e rasteve ia del mbanë, me mbetë i pranishëm në harmoninë e mbrendshme të tekstit. Edhe n'ato pasazhe ku nuk arrin me e kapë veçantinë e koloritit dhe skalitjen e artit tëgjanë dantesk me mijra e mijra forma e sfumatura, përkthyesi ynë ruen gjithnji një nivel të naltë mjeshtrie stilistike. Vështirsia e pakapërcyeshme e përkthimit të Dantes në çfardolloj gjuhe, qëndron në variacionet e përhershme dhe t'pafundme të thurjes ekspresive, që ndjek gjith' tue ndryshue tonin, ngjarjete njimbasnjishme t'udhtimit të tij përtejtoksor e në gërshetimin e shpejtë të ndjesive e mbresave nga kanga në kangë. Kalohet nga stili i naltë bibliknë stilin e vrullshëm popullor florentin, ngabisedatoborrtare në ato familjare e n'ato vulgare e banale. E pasazhe të tilla tonesh, që Dante kapërcen me natyrshmëni të mrekullueshme, bajnë me iu dridhë damarët e pulset edhe përkthyesit ma të sprovuem. Mund të pranojmë se Gjeçi, i cili ia ka dalë mbanë me aftësi dinjitoze edhe ndër pikat ku kërkesave tiranike të rimave u shtohet vështirsia e ruajtjes së timbrit të veçantë dhe riprodhimi i atmosferës së veçantë t'originalit. Episodet e Ferrit, të Françeskës nga Rimini, Skotës së Umbertëve, Uliksit, janë realizue me t'vërtëtë gjallnisht në përkthimin e Gjeçit. Në përgjithsi, kantiku i parë, *scultorea*, e ka ma të lehtë me e gjetë në leksikun shqiptar mjetet ekspresive për një përkthim të suksesshëm, falë karakterit plastik e konkret të materies poetike që trajtohet. Purgatori, piktoresk, kërkon tansinë e një lloji fjalësh e frazash me të cilat shqipja nuk është edhe aq e begatë. Nivelin ma t'naltë të mjeshtrisë së tij, përkthyesi ynë do t'na e japë nëse do arrijë me i kapërcye vështirsitë që paraqet përkthimi i Parajsës muzikale.

"Shejzat" nr. 9-10/1965 Nga ital. Sh. Kelmendi

Arben PRENDI

ÇFARË KUPTIMI KA VEPRA LETRARE E DANTES NË KOHËN TONË?

Shkrimtarët e mëdhenj i kapërcejnë kohën në të cilën kanë krijuar e jetuar. Homeri, Eskili, Sofokliu, Euripidi, Virgjili, Dante, Shekspiri, Servantes, Gëte etj. bëjnë pjesë tashmë në traditën e letërsisë botërore dhe njëkohësisht janë bashkëkohorë. Eugenio Montale, poeti i madh italian, në esenë e tij "Dante dje dhe sot" pyet me të drejtë se çfarë kuptimi ka për një poet të sotëm vepra e Dantes?! Pyetje së cilës mund t'i shtojmë edhe pyetjen se çfarë kuptimi ka kjo vepër për të gjithë në kohën tonë, në kohën e posmodernitetit, ku imagjinata njerëzore ka marrë trajtën e realitetit virtual të krijuar në rrjetet 4G dhe 5G dhe ku Komedia duket si një projektion artistik i hershëm i kësaj teknike disa dimensionale?! Çka ndodhur me njerëzimin e kohës së internetit dhe teknologjisë që ende e gjen dramën e qenies së tij tek një vepër artistike shkruar afro 700 vjet më parë si Komedia?! Ka ndodhur ajo që ndodh me veprat e mëdha letrare të cilat bëhen universale sepse kanë rrokur thelbin e dramës së qenies njerëzore në jetë të jetëve, shpirti i së cilës është përjetësisht i mbushur me të njëjtat pikëpyetje, mëkate, dhimbje e vuajtje por edhe me virtyte e dritë të pambarim. Jehona e veprës së Dante Alighierit vijon edhe përgjatë shekullit të XXI këtë e tregojnë edhe vlerësimet e disa prej shkrimtarëve të rëndësishëm bashkëkohorë evropianë si: Saint-John Perse, Ezra Pound, T.S. Eliot,

Osip Mandelshtam, Jorge Luis Borges, Eugenio Montale etj. Të gjithë i referohen Dantes si mjeshër, duke vënë në pah përmes shkrimeve të tyre, universalitetin e veprës, rolin e saj në konsolidimin e gjuhës italiane, cilësitë komplekse poetike, filozofike, fetare të veprës Komedia Hyjnore.

1. Saint-John Perse: Vepër artistike që paraqet njeriun dhe botën njerëzore me gjendjet e saj



1.1. Komedia Hyjnore vepër që komunikon me të gjitha kohët

Shkrimtari nobelist (1960) Saint-John Perse në ligjëratën me titull "Për Danten" mbajtur në përurimin e Kongresit Ndërkombëtar me rastin e shtatëqind -vjetorit të Dantes (Firence, 20 prill 1965)¹e vlerëson Danten për frymën universale të veprës *Komedia Hyjnore*, si një vepër që komunikon dhe përshtatet me të gjitha kohët, pavarësisht nga karakteri i saj kompleks ku ndërthuren elemente fetare, filozofike dhe artistike: "Që një vepër poetike e një dëshire dhe një botëkuptimi kaq të lartë, e mbingarkuar të vdesë nga intelektualiteti, nga dogmatizmi racional dhe skolastika e kulluar, që një vepër doktorale e që mëton para së gjithash të jetë vepër moralizuese, që i përgjigjet me terma alegorike kërkesave shkollore më të kundërta në të gjitha pikëpamjet tona për poetikën moderne, të mund të mbartë, pa rraskapitje, si vepër e gjallë gjer tek ne, një të tillë barrë përshtatësie dhe ngarkesash kontraktuale-

¹Eliot, Pound, Mandelshtam etj. Kuvendim për Danten. Aleph 2005, f.45-54.

përbën edhe mrekullinë e saj të vërtetë!²

1.2. *Krijesë dhe krijuese e gjuhës italiane*

S-J. Perse vlerëson rolin e veprës në konsolidimin e gjuhës italiane, si një vepër që është njëkohësisht edhe “krijesë edhe krijuese”³ e kësaj gjuhe. “Fati i mrekullueshëm, për një poet, krijues i gjuhës së tij, të jetë në të njëjtën kohë njësuasi i një gjuhe kombëtare, shumë kohë përpara bashkimit politik që ajo paralajmëron. Nëpërmjet tij, ligjërimi që i kthehet një bashkësie të gjallë bëhet historia e jetuar e mbarë një populli në kërkim të së vërtetës së vet”⁴. Para së gjithashtu Saint-John Perse e sheh veprën *Komedia Hyjnore* si vepër poetike, si “narracion i kulluar” para se vepër filozofike apo tjetër fare: “Por ngaqë aventura shpirtërore e heroit ishte fillimisht ajo e poetit, vepra e jetuar e toskanit të madh mbetet besnike e vetë jetës, dhe duke trajtuar e gjallë, absoluten pa shkretuar perandorinë e reales, duke ruajtur rrënjët te konkretja, dhe te njerëzorja, dhe gjer tek e përditshmja, ajo i shpëton, -duke qenë rrëfim- gabimeve më të këqija të abstraksionit. Tregim i një udhëtimi në botë imagjinare, kjo vepër mbetet për ne narracion i mrekulluar”⁵. Për Saint-John Perse, të marrësh frymë me botën mbetet funksioni tipik dhe ndërmjetësues i poetit⁶ dhe se Dante në veprën e tij kërkon te njeriu “më shumë se njeriu”⁷.

Mbi të gjitha Saint-John Perse, pavarësisht rrafshëve të leximit të veprës çmon udhëtimin shpirtëror të poetit tek *Komedia Hyjnore*, udhëtim që e cilëson të huaj për misticizmin: “Mbi katër planet e evolucionit të përcaktuar nga Dante në *Convivion* e tij: literali, alegoriku, morali dhe anagogjiku, vepra autoritare e *Commedias* pëson heroikisht ngjitjen e saj melodike, si ajo e vetë heroit, pelegrin i dashurisë dhe absolute. Ajo ngrihet, rreth pas rrethi, gjer në atë abstraksion përfundimtar të një vërshimi lavdie në gjë të hyjnore: vërshim ende plot intelekt, sepse udhëtimi shpirtëror i poetit është, për nga natyra e tij, i huaj për udhët e misticizmit të mirëfilltë”⁸. Pra shihet se S-J. Perse ka konsideratë të lartë në radhë të parë për Danten si poet dhe veprën *Komedia Hyjnore*

² Eliot, Paund, Mandelshtam etj. *Kuvendim për Danten*. Aleph 2005, f. 46.

³ Po aty, f. 47.

⁴ Po aty, f. 47.

⁵ Po aty, f. 46.

⁶ Po aty, f. 50.

⁷ Po aty, f. 50.

⁸ Po aty, f.46.

si vepër artistike që paraqet njeriun dhe botën njerëzore me gjendjet e saj. Ai çmon me këtë rast rolin e saj në letërsinë evropiane dhe në konsolidimin e gjuhës italiane.

2. Ezra Pound: *Komedia...udhëtimi i intelektit të Dantes...*



2.1. *Krëfimi për Dashurinë zbuluese...*

Ezra Pound në studimin e tij *Dante*⁹ vlerëson se vepra *Jeta e re* dëshmon për talentin e poetit që në moshën 20 vjeçare. Në këtë vepër, në sonetin e dytë dhe të katërt ai “fillon rrëfimin e Dashurisë zbuluese, të Dashurisë portë dhe rrugë drejt intelektit, të Dashurisë së pafundme “che move il sole e l’altre stelle” (që lëviz diellin dhe yjet e tjerë). [...] *O voi, che per la via d’Amor passate/ O ju që nëpër udhën e Dashurisë kaloni*”¹⁰

Tek *Vita Nuova, Jeta e re*, Pound vë në dukje se Dante ka bërë idealizimin e një gruaje të vërtetë, Beatriçe Portinari, dhe sonetet kushtuar asaj janë një hyrje në udhën e Dashurisë të cilën do ta vijoje edhe tek *Komedia* sipas fjalëve të Dantes këtu, se: “shpresoj të them për të atë që nuk u tha kurrë për asnjë tjetër”¹¹.

2.2. *Kuptimet themelore të Komedisë*

Duke iu referuar Dantes, në analizën që Pound i bën *Ferrit*, risjell në vëmendje kuptimet themelore të veprës: kuptimin letrar, alegorik, anagogjik dhe etik, interpretimet matematike dhe gjeometrike të

⁹ Eliot, Pound, Mandelstam etj. *Kuvendim për Danten*. Aleph 2005, f. 55-120.

¹⁰ Po aty, f. 57.

¹¹ Po aty f. 63.

strukturës së *Komedisë Hyjnore*. Ndërsa në tërësi na jep një interpretim kuptimor mbi veprën në këtë sintezë: "*Komedia*, në kuptimin literal, është përshkrimi i vizionit që Dante pati për një udhëtim në mbretëritë e banuara nga shpirtrat e njerëzve mbas vdekjes; në një kuptim më të thellë është udhëtimi i intelektit të Dantes nëpër ato gjendje shpirtërore ku njerëzit, të çdo lloji dhe prejardhje, qëndrojnë para vdekjes së tyre; gjithashtu, Dante, ose intelektit i Dantes, mund të nënkuptojë "Çdokënd", pra "Njerëzimin", prandaj udhëtimi i tij bëhet simbol i luftës së njerëzimit në ngjytjen përtej padijes, drejt dritës së qashtë të filozofisë. Në një kuptim të dytë, udhëtimi është zhvillimi mendor dhe shpirtëror i Dantes. Në një kuptim të tretë *Komedia* është shprehje e ligjeve të gjyqimit të përjetshëm, "të dënimit sipas fajit" siç e quan Bertrando, ose të ligjit të Karmës (nëse duam të përdorim një term oriental)"¹².

2.3. *Ferri, Purgatori dhe Parajsja si "gjendje"*

Dante, sipas Ezra Paund, i koncepton *Ferrin, Purgatorin* dhe *Parajsën* si "gjendje dhe jo si vende" dhe se duke lexuar *Komedinë* ia vlen më mirë t'i shohësh përshkrimet danteske të veprimeve dhe gjendjeve të hijeve, si përshkrime të gjendjeve mendore kur ishin njerëzit në jetë e në të cilat janë të destinuara të mbeten mbas vdekjes; çka do të thotë që personalitetet shpirtërore janë të dukshme para syve të intelektit të Dantes udhëhequr nga një personifikim i kulturës klasike, i teologjisë mistike dhe i fuqive mirëbërëse¹³. Për *Ferrin*, Paund do të shprehet gjatë analizës së kësaj pjese se: "është gjendja e njeriut të zotëruar nga pasionet e tij, i cili ka humbur "fillin e arsyes"¹⁴, për të shtuar se: "Përgjatë gjithë *Ferrit* gjen një satirë therëse kundër dihatjes së kotë, të shqetësuar, të furishme të njerëzimit: nis me vorbullën e erës që tërheq Paolon dhe Françeskën, vazhdon me paraqitjen e bataçinjtve të shtyrë me fshikullima prej djajve, dhe përfundon vetëm në fundin më të fundmë të *Ferrit* në akullin e përjetshëm të ligësisë së tradhëtarëve"¹⁵. Përveç elementit tragjik Paund vë re humorin e zyrtë dhe sarkazmën e fortë të pranishme tek *Ferri*. Ndërsa për *Purgatorin* shprehet se: "Mundet që figurat e *Purgatorit* të jenë më pak të fuqishme se ato të *Ferrit*, dhe që Dante, në këtë mbretëri të mesme, i lejon vetes luksin të

¹² Eliot, Paund, Mandelshtam etj. Kuvendim për Danten, Aleph 2005, f.65.

¹³ Po aty, f.66.

¹⁴ Po aty, f. 66.

¹⁵ Po aty, f. 71.

shpjegojë shumë. Por për atë që e do poezinë, gjashtë këngët e fundit që përshkruajnë Parajsën Tokësore bëjnë që libri i dytë të mos jetë aspak i fundit i të treve¹⁶.

Për *Parajsën*, Paund thekson, se "Bukuria e *Parajsës* vuan që ka përfunduar në copëza, siç u përpoqa të bëj unë: ajo i përket atij lloji të poezisë për të cilën Coleridge thotë se nuk duhen vlerësuar pjesë të veçanta por rryma e nëndheshme e vazhduar. Në *Parajsë* gjejmë imazhe mjaft të bukura, por mrekullia më e madhe nuk qëndron te zbukurimi por në vargje si këto: Unë shoh qartë se si tashma ndriçon/ në mendjen tande drita e amëshueme,/ që veç tue e pa përpjetë dashni të zgjon;/ e n'qoftë se gjana tjera të dëshrueme/ janë fort prej jush, kjo rrjedh se ato kanë/ gjurma prej asaj dritë, keq të kuptueme"¹⁷. Duke analizuar fragmente nga *Parajsa* Paund vlerëson veçmas vargjet që i kushtohen Beatrices në momentin kur ajo është kthyer tek Trëndafilu qiellor: "O zonjë që je për mue mbështetja e shpresa/që për shpëtimin tim ti ke pranue/ gjurmët me lanë ku e ferrit asht fillesa,/ për kaq gjana, që munda me shikue,/ia di unë fuqisë sate e mirësisë,/ nga hiri dhe virtyti yt diktue./ Nga skllav më nxore n'rrugën e lirisë/tue ndjekë të gjitha shtigjet çka kryekreje/ varej prej mundësisë sate dhe fuqisë"¹⁸. Këto vargje shprehet studiuesi, të shkëputura nga konteksti janë poezia më fisnike e dashurisë në të gjithë botën, veç po t'i vihet përballë *Mangnificat*-i. Për Marinë: Pashë tue buzqeshë një Bukuri të madhe/ për lodra e kangë, e një hare pa prehje/ ndër sy u ndizte t'shenjtave aradhe"¹⁹.

2.4. Pranëvëniet Dante-Miltoni-Shekspiri

Lavdërimi më i hijshëm për *Komedinë*, thotë Paund, do të ishte heshtja, ndërkohë ka mendimin se: "Komedia Hyjnore" nuk duhet çmuar si një poemë epike: duke e krahasuar me poemat epike në të vërtetë nuk ka asnjë epërsi. Por ndërkohë në një farë mënyre është lirika, lirika e hatashme e Dantes subjektiv, por klasifikimi më i pjekur është ai i vetë Dantes: komedi përsa "ndryshon nga tragjedia në përmbajtje, pasi tragjedia në fillim është e admirueshme dhe e qetë dhe në fund e tmerrshme dhe e llahtarshme... aty ku komedia fillon me disa vështirësi por e çon intrigën e saj në fund të gëzueshëm. *Komedia* e Dantes, në fakt është një paraqitje e shenjtë, apo më mirë, një cikël i tërë paraqitjesh të

¹⁶ Po aty, f. 79

¹⁷ Po aty, f. 90.

¹⁸ Po aty, f.106

¹⁹ Po aty, f. 106

shenjta²⁰. Vlen për t'u sjellë në vëmendje këtu krahasimi që Paund bën ndërmjet *Komedia Hyjnore* e Dantes dhe *Parajsa e humbur* e Miltonit: "Zoti i Dantes është hyjni e parrëfyeshme, Zoti i Miltonit është një plak pedant me ato zbatimet e veta. Dante është metafizik aty ku Miltoni është thjesht sektar. *Parajsa e humbur* është melodramë e rëndomtë dhe kritikët modernë kanë përcaktuar se protagonistin është djalli, gjë që nuk i jep poemës asnjë kuptim. Satanai i Dantes është në mënyrë të pamohueshme dhe të parrëfyeshme një e keqe; nuk ka "vullnet të lirë", është një keqdashje budallaqë. Milton nuk e kap mbinjeriun, ëngjëjt e tij janë njerëz me fuqi madhore shto edhe krahët; ëngjëjt e Dantes e kapërcejnë natyrën njerëzore dhe ndryshojnë, lëvizin në mënyrë të pashpjegueshme në hapësirat e tyre të larta"²¹.

Sipas Paund, Dante mund të krahasohet vetëm me Shekspirin nga letërsia angleze megjithëse i ndajnë afro tre shekuj. Duke u marrë me çështje të ndikimit të veprës së Dantes mbi veprën e Shekspirit, ai vlerëson se: "Nëse gjuha e Shekspirit është më tepër magjepsëse, ajo e Dantes e jep më bukur saktësinë; të dy janë zotër të të gjithë mjeshtërisë. Shekspiri mbase shkëlqen më tepër në përdorimin e epitetëve të cilësive vetjake; por nga ana tjetër Dante është më i mirë në "krahasim"²² duke nënkuptuar me "krahasim" metaforën, similitudën, shprehjen eliptike të perceptimit metaforik. Për Ezra Paund, vepra e Dantes është e atij lloj arti që është çelës për një inteligjencë të thellë të natyrës dhe bukurisë së botës dhe shpirtit.

²⁰ Po aty, f. 109

²¹ Po aty, f. 111

²² Po aty, f.113.

3. Thomas Stern Eliot: Dante para së gjithash poet evropian



3.1. Dante, poeti më universal i gjuhëve moderne

Thomas Stern Eliot (Nobel 1948) në studimin që mban titullin “Ferri” vë në dukje se nga njëra anë kuptimi i skemës, filozofisë, kuptimeve të fshehura të vargut të Dantes është themelor për vlerësimin e tij; nga ana tjetër mund të thuhet se këto veçori qenë të pavend sepse poetika në vargjet e tij është unike dhe mund të shijohet në vetvete pa studiuar strukturën që i ka shërbyer autorit për të krijuar poezinë, por që lexuesit nuk i jep ndonjë kënaqësi²³. Një prej gjërave që të befason në poezinë e Dantes, shprehet Elioti, është lehtësia e të lexuarit të saj që përbën një provë se poezia e vërtetë mund të komunikojë para se të kuptohet. Sigurisht ai e ka fjalën jo për faktin se gjuha që përdor apo përmbajtja e veprës është e thjeshtë, por atë se Dante është më universal i poetëve të gjuhëve moderne. Kjo nuk do të thotë se ai është më i madhi apo më i gjithanshmi por universaliteti i tij nuk është vetëm çështje vetjake. Universalitetin e Dantes, Eliot e sheh të lidhur me latinishten mesjetare, si gjuhë përbashkuese e kulturës për Evropën ndaj edhe e cilëson Danten para së gjithash si poet evropian²⁴ pa pushuar së qeni poet italian. Kultura e Dantes është kulturë evropiane para së gjithash dhe se Europa e kohës së Dantes me gjithë ndasitë dhe ndytësitë e saj mendërisht që më e unifikuar nga ç’ mund ta mendojmë ne.

²³ “Ferri” në Eliot, Pound, Mandelstam etj. *Kuvendim për Danten*. Aleph 2005, f.121-122.

²⁴ Po aty, f.123.

3.2. *Komedia*, vepër që mund të shijohet pjesë-pjesë, por që e fiton tërësinë kuptimore nga leximi i plotë

Në vlerësimet për stilin e veprës, Eliot dallon se, stili i Dantes ka një qartësi të veçantë-një poetikë të dallueshme nga një kthjelltësi intelektuale. Mendimi mund të jetë i errët porse fjala është e kthjelltë, e tejdashme. Eliot vë në dukje se Dante përkthehet më lehtë se Shekspiri në gjuhët e tjera ndërsa e krahason Danten me Shekspirin, Molierin dhe Sofokliun. Pra thjeshtësia e Dantes lidhet me mënyrën e të menduarit që e bashkon me kulturën evropiane si dhe me gjuhën alegorike të përdorur në vepër, gjuhë e cila ishte e pranishme në letërsinë evropiane të kësaj periudhe dhe shërbente për ta bërë në fakt më të kuptueshme veprën letrare. Falë alegorisë lexuesi edhe nëse nuk është një italianist i aftë mund ta shijojë veprën e Dantes. Për Eliotin alegori do të thotë imazhe të qarta pamore²⁵ dhe këto imazhe fitojnë edhe më tepër dendësi kur përmbajnë domethënie kuptimore. Imagjinatën e Dantes e cilëson në këtë kuptim si imagjinatë pamore dhe vizionare. Për Eliotin, përpjekja e Dantes është të na bëjë ne të shohim atë që pa vetë prandaj përdori një gjuhë të thjeshtë dhe me pak metafora, sepse alegoria me metaforën nuk shkojnë fort mirë me njëra-tjetrën. Edhe Elioti ndalet tek natyra e krahasimeve që përdor Dante në veprën *Komedia Hyjnore*. Këto krahasime kanë natyrë shpjeguese për ta ndihmuar lexuesin të shohë më qartë, të kuptojë më mirë. Ai është i mendimit se vepra mund të shijohet e të lexohet pjesë-pjesë, por domethënien e saj të plotë mund ta rrokim vetëm mbasi ta njohim të gjithën. Atëherë mund të kuptojmë "se me sa zgjuarsia dhe sa bindshëm ka mundur Dante që t'i bëjë njerëz realë bashkëkohësit e tij, miqtë dhe armiqtë, personazhet e afërta historike, figurat legjendare dhe ato biblike apo të letërsisë antike"²⁶.

3.3. Gjykime kritike për *Ferrin*, *Purgatorin* dhe *Parajsën*

Në veçanti për bukurinë e tyre poetike vlerëson nga *Ferri* episodin e Bruneto Latinit (kanga XV), Uliksi (kanga XXVI), Bertrand de Born (kanga XXVIII), Adamo di Brescia (kanga XXX) dhe Ugolini (Kanga XXXIII).

Për Eliotin *Ferri* nuk është vend por gjendje, gjendje e atillë që mund ta mendosh apo përjetosh vetëm nëpërmjet projeksionit të imazheve ndjesorë. Këngën e fundit të *Parajsës* ai e cilëson si majën më të lartë

²⁵ Po aty, f. 126.

²⁶ Po aty, f. 131.

të poezisë që është arritur apo mund të arrihet ndonjëherë në letërsinë botërore. Nga *Ferri*, thotë ai, patëm mësuar se poezia më e lartë mund të shkruhet me ekonominë më të madhe të fjalëve dhe me përkorjen më të madhe në përdorimin e metaforës, krahasimit, hijeshisë verbale dhe elegancës. Ndërsa nga *Purgatori* mëson se një qëndrim i paepur filozofik mund të shndërrohet në një poezi të madhe; prej *Parajsës* që një përkryerje dhe thellim i gjendjeve të bukurisë mund të jenë lëndë për poezinë e madhe. Për poetin dhe studiuesin Tomas Stern Eliot *Purgatori* është më i vështiri i tri pjesëve. Me të nuk mund të kënaqesh si me *Ferrin* as nuk mund t'i gëzohesh si vijim i tij. Kjo kërkon po ashtu vlerësimin e *Parajsës* dhe vetëm kur të përfundohet leximi i *Parajsës* dhe rileximi i *Ferrit* do të shfaqet bukuria e plotë e *Purgatorit*. Siç shprehet autori "Dënimi dhe madje bekimi janë më eksitues sesa shëlbimi"²⁷.

3.4. Arti poetik i Dantes një model për t'u ndjekur

Sipas Eliotit është gabim të mendohet që ka pasazhe në *Komedinë Hyjnore* që janë vetëm për katolikët dhe studiuesit e Mesjetës sepse ka dallim mes besimit filozofik dhe pëlqimit poetik. Ndërsa lexoni Danten ju hyni në botën e katolicizmit të shekullit të trembëdhjetë, që nuk është bota e katolicizmit modern, sikundër bota e tij e fizikës nuk është bota e fizikës moderne. As nuk ju kërkohet të besoni atë që besoi Dante, pasi besimi juaj nuk do t'ju japë ndonjë kuptim dhe vlerësim më të mirë. Në qoftë se ju e lexoni poezinë si poezi do të besoni në teologjinë e Dantes po aq sa besoni në realitetin fizik të udhëtimit të tij²⁸. Edhe tek Elioti gjejmë një mendim të ngulitur se *Komedia Hyjnore* mund të krahasohet vetëm me veprën dramatike të Shekspirit, këta autorë ndajnë mes tyre botën moderne, nuk ka të tretë. Shekspiri jep gjerësinë më të madhe të pasionit, Dante lartësinë më të madhe dhe thellësitë më të mëdha.

Për Eliotin, poezia e Dantes është e vetmja shkollë universale stili e shkrimit të poezisë në cilëndo gjuhë; - nuk ka asnjë poet në asnjë gjuhë – as latinisht dhe greqisht- që të jetë model kaq i qëndrueshëm për të gjithë poetët; edhe për shkrimtarët ai ofron një përvojë poetike për t'u ndjekur; metoda alegorike e poezisë së Dantes ka përparësi të mëdha në krijimin e poezisë; shijimi i poezisë si krijim letrar na ndihmon të gjejmë domethëniet e kësaj poezie; *Komedia Hyjnore* është një skelë

²⁷ Po. aty, f. 136.

²⁸ Po. aty, f. 141.

e plotë e thellësive dhe lartësive të emocionit njerëzor; *Purgatori* dhe *Parajsa* duhen lexuar si zgjerime të hapësirës rreptësisht të kufizuar njerëzore²⁹.

4. Osip Mandelshtam: Bashkëkohësia e Dantes është e pashtrrshme, e pafundme, e pacoptueshme



4.1. Uniteti i dritës, tingullit dhe materies në poetikën e Dantes

Osip Mandelshtam në esenë “Kuvendim me Danten” (1933) e quan Danten mjeshtrë instrumental të poezisë, strateg i shndërrimeve dhe kryqëzimeve, poet “paneuropean”³⁰. Sipas tij vepra e Dantes është para së gjithash mësymje e italishtes në arenën ndërkombëtare të bashkëkohësisë së tij. Poezia e Dantes i ka të gjitha llojet e energjisë që njih shkenca bashkëkohore. Uniteti i dritës, tingullit dhe materies përbën natyrën e saj të brendshme.

4.2. Bashkudhëtimi i filozofisë me poezinë

Sipas Mandelshtam *Ferri* dhe në veçanti *Purgatori* përlëvdon ecjen njerëzore, përmasat dhe ritmin e hapave, tabanin dhe formën e tij. Hapin të harmonizuar me frymëmarrjen dhe të nginjur me mendim Dantja e merr si zanafillë të prozodisë. Në veprën e Dantes, për Mandelshtamin, filozofia dhe poezia ecin gjithnjë krahu njëra-tjetrës. Aligieri ndërtoi në hapësirën e fjalës një organo pafundësisht të fuqishme dhe kënaqej tashmë me të gjitha regjistrat e mendimit, u frynte shakujve, ulërinte dhe u binte të gjitha trumpetave³¹. Vargjet e Dantes janë formuar dhe

²⁹ Po aty, f. 152.

³⁰ “Kuvendim me Danten” në Eliot, Paund, Mandelshtam etj. *Kuvendim për Danten*. Aleph 2005, f.153-198.

³¹ Po aty, f. 162.

ngjyrosur gjeologjikisht. Struktura e tyre materiale është shumë më e rëndësishme se skulpturaliteti i famshëm. Përfytyroni një monument prej graniti ose mermeri i cili në tendencën e tij simbolike është përqendruar jo në paraqitjen e kalit apo kalorësit, porse në shpalimin e strukturës së brendshme të vetë mermerit apo granitit, kështu do të merrni një kuptim mjaft të qartë se në çfarë raportesh qëndrojnë tek Dantja forma dhe përmbajtja.

4.3. Komedia si një strofë e vetme apo si një prizëm njëmijë faqesh

Mandelshtami gjykon se poema paraqet në vetvete një strofë të vetme, një figurë kristalografike. Poemën, gjykon ai, e përshkon graviteti i pandalshëm trajtëformues. Trajtëformimi i poemës i kapërcen nocionet tona mbi krijimtarinë dhe kompozicionin, thotë Mandelshtam, duke vijuar se, shumë më korrekte është të pranosh si fillesë të saj paraprirëse-instinktin. Përkufizimet e parashtruara si shembuj më së paku kanë parasysh trillin metaforik. Këtu ngjet luftë për përfaqësimin e së tërës, për demonstrimin e së rrokshmes nga mendja. Vetëm në sajë të metaforës ka gjasa të gjesh një shenjë konkrete për trajtëformimin e instinktit, me të cilin Dante mbliidhte dhe farkëtonte tercinat. Duhet përfytyruar dhe në këtë mënyrë, sikur mbi krijimin e kristalit trembëdhjetë mijë faqesh të kishin punuar bletët, me dhuntinë gjeniale të dëgjimit stereometrik, duke joshur gjithnjë e më shumë bletë të tjera.³² Mandelshtami e quan të padobishëm mistifikimin e veprës së Dantes nga vetë studiuesit dhe poetët e mëvonshëm, sikurse edhe qasjet historike, politike apo teologjike. Vërtet kjo vepër ishte e vështirë për bashkëkohësit por në fund ajo i shpërblente ata me dije. Sipas Mandelshtamit e ardhmja e komentarit dantesk i takon shkencave natyrore, kur këto shkenca të jenë përimtuar dhe ta kenë përsosur meditimim figurativ³³.

4.4. Këngët e Komedisë instrumente për të kapur të ardhmen...

Meditimi figurativ tek Dantja, thotë më tej Mandelshtami, sikundërse në çdo poezi të njëmendët, realizohet me ndihmën e cilësisë së pëlhurës poetike, të cilën jua ofroj ta quani adresati ose adresim. Shtjellimi i imazhit mund të quhet shtjellim vetëm se me kusht. Është e paimagjinueshme, vëren autori, t'i lexosh këngët e Dantes pa iu kthyer

³² Po aty, f. 165.

³³ Po aty, f. 167.

bashkëkohësisë. Ato për të janë krijuar. Ato janë pajisje për të kapur të ardhmen. Bashkëkohësia e tij është e pashterrshme, e pafundme, e pacoptueshme.³⁴ Mandelshtami e vështron poemën si vepër e përsosur “muzikale” në të cilën janë të përdorur të gjitha instrumentet e mundshme madje si një opera dramatike³⁵ apo balet kinetik.³⁶ Duke përbashkuar të pabashkueshmen, Dantja ndryshoi strukturën e kohës, a ndoshta bëri të kundërtën: që i shtrënguar të shkojë në glosologjinë e fakteve, në sinkronizimin e ngjarjeve, emrave dhe legjendave të ndërprera nga shekujt, pikërisht sepse kishte ndjerë ambalazhimin e kohërave³⁷. Në një rast tjetër duke studiuar natyrën e metaforës danteske Mandelshtami shprehet se ajo ka domethënien e ndërtimit të kohës. Rrënjët e saj nuk gjenden në fjalëzën “si” por në fjalën “kur”.³⁸

4.5. Antikommentari mbi veprën e Dantes

Në studimin e tij Mandelshtami është kundër trajtimit shkollaresk të veprës së Dantes, madje ai propozon një “antikomentar autentik” si kundërvënie ndaj punës së mbrapshtë të një radhë brezash skolastësh, filologësh dhe pseudobiografësh. Ky trajtim sipas Mandelshtam ka ardhur nga mungesa e nderimit për lëndën poetike të Dantes, që ai e cilëson si zoti madhështor dhe administratori i kësaj materie poetike, dirigjenti i madh i artit evropian³⁹.

5. Jorge Luis Borges: *Komedia* një ëndërr e ëndërruar nga Dantja



³⁴ Po aty, f.174.

³⁵ Po aty, f. 181.

³⁶ Po aty, f.188.

³⁷ Po aty, f.193.

³⁸ Po aty, f.194.

³⁹ Po aty, f.195.

5.1. *Komedia*, paneli i një biblioteke që prek skajet e universit

Jorge Luis Borges, fitues i disa çmimeve të rëndësishme letrare ndërkombëtare, në esenë "Nëntë netë me Danten" e krahason poemën e Dantes me panelin e një biblioteke të pikturuar në shekuj. Ky panel, thotë ai, është poema e Dantes, skajet e së cilës përkufizojnë universin. Siç është e pritshme prej shkrimtarit të vizioneve fantastike, ai është i prirur të vlerësojë nga *Komedia Hyjnore* jo universalitetin e saj, por zgjedhjen me shije të veçorive të larmishme⁴⁰ që bien në sy menjëherë. Te Dante, Borges, vlerëson saktësinë me të cilën operon në vepër ku nuk gjen asnjë fjalë të pajustificuar. Sipas Borges, universi i Dantes është përshkruar edhe nga astronomia Ptolemeane edhe nga teologjia Kristiane. Për Borges është e qartë se Dante nuk kishte qëllim të ndërtonte një reliev të vërtetë apo real të botës tjetër. Ai e deklaroi vetë se subjekti i *Komedisë* është gjendja e shpirtit pas vdekjes dhe alegorikisht njeriut, vlerat apo fajet e të cilit e bëjnë atë të meritojë ndëshkimin apo shpërblimin hyjnor.

5.2. Dante, secili prej nesh

Dante është çdonjëri nga njerëzit në botën fiktive, çdo frymëmarrje, çdo detaj ndaj edhe një nga detyrat më të vështira për poetin është të fshehë kudo gjendjen e tij, në mënyrë që lexuesi të mos e kuptonte se dora e së Drejtës që jepte dënimet ishte ai vetë.⁴¹ Për Borges *Komedia* mund të jetë shumëçka por është e qartë se ajo është një ëndërr e ëndërruar nga Dantja, ku edhe ai vetë është subjekt i kësaj ëndërre. Borges përmend këtu vargun që thotë se ai vetë nuk e di qysh përfundoi në pyllin e errët të mbushur me tinguj që janë metaforë e hutimit të shpirtit mëkatar por edhe sugjerojnë fillimin e mjegullt të aktit të të ëndërruarit.

5.3. Episodet ekuivoqe

Borges i kushton vëmendje në esenë e tij episodit me Ugolinin në këngën e parafundit të *Ferrit*, në të cilën del sikur Ugolini han fëmijët e tij nga uria. Për Borgesin strofa që paraqet këtë moment është lënë qëllimisht misterioze dhe ai e shtron problemin nga një vështrim tjetër përmes pyetjes: "A deshi Dante që ne të besonim se Ugolino (Ugolino i *Ferrit*, jo Ugolinua i historisë) hëngri mishin e fëmijëve të tij?"⁴².

⁴⁰ „Nëntë netë me Danten“. Eliot, Pound, Mandelshtam etj. *Kuvendim për Danten*. Aleph 2005, f. 199.

⁴¹ Po aty, f.203.

⁴² Po aty, f. 209.

Sipas Borges, Dante nuk donte që ne ta besonim por të dyshonim, të dyshonim me paqartësi dhe tmerr si për një rën ashtu edhe për tjetrën zgjedhje. Vëmendjen e Borgesit e ka tërhequr edhe kënga e XXVI nga *Ferri* ku përshkruhet rrëfimi i Uliksit mbi udhëtimin dhe fundin tragjik të udhëtimit të tij. Udhëtimi i Dantes është i ngjashëm me atë të Uliksit i cili u thotë shokëve të tij se ata nuk kishin lindur të jetonin si egërsira, por të kërkonin virtytin dhe diturinë, udhëtimi i Dantes nuk është udhëtimi i tij por kompozicioni i librit. Dante ishte teolog dhe shkrimin e *Komedisë* duhet ta ketë parë si një sipërmarrje po aq të lodhshme e të guximshme e fatale sa edhe lundrimi i Uliksit. Ai guxoi të bënte mrekullira që nuk i parashikonte as Shpirti i Shenjtë, guxoi të vendoste Beatrice Portinarin në të njëjtin nivel me Virgjëreshën dhe Jezusin⁴³. Vëmendjes së Borgesit nuk i shpëton as episodi me Françeskën në *Ferr*. Ai shprehet se Dante ëndërroi dhimbjen e Françeskës dhe dhembshurinë e tij, pra ndien keqardhje për gjërat që i ka shpikur vetë. Dantja e ktheu drejtësinë në tiparin kryesor të Zotit në Ferr, por Françeskën e vuri mes shpirtave të humbur dhe ndjeu keqardhje për të. Siç thotë B. Kroçe "*Si teolog, besimtar, si njeri etik, Dantja i mallkon mëkatarët, por me shpirt as mallkon as fajëson*".

5.4. Kryevepra letrare për të rikthyer Beatricën

Një libër i madh si "Komedia Hyjnore" nuk është izolimi apo kapriçoja e zakonshme e një individi, thotë Borges, shumë njerëz dhe breza vunë nga një tullë deri sa ajo u ndërta. Të hetosh për të gjetur paralajmëruesit e saj nuk do të thotë t'i futesh punës lodhëse të juristit apo dedektivit, ajo është ekzaminim i lëvizjeve, probabiliteteve, aventurave, vezullimeve dhe parandjenjave të shpirtit njerëzor.⁴⁴

Borges beson se Dante e krijoi arkitekturën e trefishtë të poemës me qëllim që të fuste në të takimin me Beatricën dhe ajo çfarë ndodhi me të është ajo çka ndodh zakonisht në ëndrra. Me Beatricën përgjithmonë të mohuar ai ëndërroi për të, por ëndërroi me një ashpërsi të tmerrshme, e ëndërroi të paarritshme, e ëndërroi në një koçi të tërhequr nga një luan që ishte zog ose ishte tërësisht luan apo tërësisht zog ndërsa e prisnin sytë e Beatricës.

Dhe në një rast tjetër Borges shprehet se Dante e krijoi librin më të mirë që letërsia ka arritur të ketë me qëllim të rikthente në të Beatricën


⁴³ Po aty, f.212.

⁴⁴ Po aty, f. 221.

e pakthyeshme.

Beatricja për Danten ekzistoi pafundësisht. Ndërsa Dantja për Beatricën shumë pak ose hiç fare. Prej keqardhjes dhe prej respektit, shprehet Borges, të gjithë ne e harrojmë këtë mospërputhje të madhe e cila për Danten ishte e paharrueshme. Për Borgesin, episodi i takimit të Paolos me Françeskën është projektimi i takimit që Dante nuk e gëzoi kurrë. Në fund të esesë, Borges vë në dukje ngarkesën e pikëllimit që mbart kënga XXXI e *Parajsës* tek episodi i takimit me Beatricën dhe pastaj me zhdukjen e saj me një buzëqeshje enigmatike nga larg.

6. Eugenio Montale: Për një lexim kompleks të veprës duke lexuar jetën, kulturën, formimin dhe epokën e Dantes



6.1 Dante poet që mbërrin tek të gjithë, por jo poet modern

Eugenio Montale në esenë "Dante dje dhe sot" thekson që në fillim se Dante është trashigimi universale dhe zëri i tij mund të mbërrijë tek të gjithë ashtu siç nuk ka ndodhur kurrë në kohë të tjera e siç ndoshta nuk do të jetë e mundur në të ardhmen, kështu që mesazhi i tij mund të prekë profanin po aq sa fillestarin dhe mundësisht në një mënyrë krejt të re.⁴⁵ Montale tërheq vëmendjen, se Dante nuk është një poet modern

⁴⁵ *Dante dje dhe sot*, ligjëratë e mbajtur në Kongresin Përkujtimor të 700 vjetorit të lindjes së Dantes në Firence më 24 prill 1965, botuar më pas në *Atti del Congresso Internazionale di studi danteschi* vëllimi II, f. 315-333, Sansoni, Firenze 1966. f. 233. Cituar me këtë rast sipas "Kuvendim me Danten" f. 233-250.

dhe se instrumentet e kulturës moderne nuk janë më të përshtatshme për ta kuptuar dhe interpretuar kompleksitetin e veprës së tij. Por fakti që nuk është poet modern, vëren ai, nuk na pengon për ta kuptuar të paktën pjesërisht dhe për ta ndier të afërt me ne këtë vepër. Ndoshta kjo ndodh, siç thotë Montale, sepse po jetojmë në një mesjetë të re tiparet e së cilës nuk mund t'i shquajmë ende. Montale është kundër tezës se poezia e Dantes duhet lexuar vetëm si tekst poetik, ahistorik dhe i shkëputur nga jeta e poetit. Një lexim i poemës duke anashkaluar krejtësisht jetën e Dantes, kulturën dhe formimin e tij nuk të shpie larg. Orvatja për ta lexuar siç lexohet një poet modern duke zgjedhur pjesët më të gjalla e duke eliminuar ato që quhen të huaja për poezinë, ka bërë që të lindin keqardhje të çuditshme. Për Montalen njohja e shkollës së "Il dolce stil nouvo" dhe e poetëve bashkëkohës apo paraardhës të Dantes ndihmon për të kuptuar më thellë veprën e tij. Nga ana tjetër njohja e veprave të mëparshme si "Jeta e re" dhe "Gostia" i shërben identifikimit të elementëve apo figurave që do të përdoren te *Komedia*.

6.2. Pasuria e leximeve dhe nevoja e hipotezave të reja për interpretimet e *Komedisë*

Për Montalen nuk ka asnjë dyshim se *Komedia* dhe struktura e saj nuk ishte e parafiksuar që nga vargu i parë e përkundrazi u modifikua dhe u pasurua gjatë përpunimit dhe rishikimit hipotetik të saj. Përkrah poetit të ditur, vëren autori, qëndron letrari që zbulon dhe shfrytëzon mundësinë e gjuhës së tij të re, njeriu që kthehet te vetvetja, që pasuron mendimin e tij, mërgimtari që shpreson të lejohet të kthehet në atdheun e tij e që më vonë i zhgënjyer thekson shprehjet e inatit të vet. Për *Komedinë*, Montale shprehet, se ajo ka një personazh hero dhe këndon historitë e tij me ndihmën e Muzave dhe Shkrimeve të Shenjta duke përdorur një stil jo gjithmonë tragjik pavarësisht një përzjerjeje të jashtëzakonshme stilesh dhe mënyrash që nuk janë përherë në përputhje me dinjitetin dhe uniformitetin e stilit epik.

Montale e lexon poemën si një rrëfim që shtjellohet në një plan të vetëm duke mos harruar domethëniet e udhëtimit në botën e përtejme dhe në nëntë qiejt, por as marrëdhëniet njerëzore, ndjenjat dhe meritë, paradoksin e një vizioni të dyfishtë që nga njëra anë shpalos peizashin e përjetësisë ndërsa nga ana tjetër shpalos jetën tokësore që zhvillohet në pak kohë dhe në një vend të papërcaktuar, jetën e florentinit të thjeshtë dhe ngjarjet e viteve të angazhimit civil të poeti dhe rolit që Dante pati

në këto ngjarje.

Sikurse studiuesit e tjerë edhe Montale vë në dukje sensin alegorik të poemës, i cili gjithsesi nuk i detyron lexuesit e shumtë të kënaqen vetëm me kuptimin e parë të veprës, pa u futur në pyjet e alegorive dhe analogjive në episodet e shumta të saj. Për Montalen, asnjë poemë tjetër nuk ka qenë ndonjëherë kaq e mbushur me figura, në sensin e drejtpërdrejtë ose në sensin simbolik apo profetik. Në asnjë poemë tjetër historia reale dhe historia e pakohë e mitit dhe teologjisë nuk janë shkruar si në poemën danteske. Dante realisht është fundi i botës ose pararendësi i tij, thotë Montale: historikisht profecia e tij nuk i përket kësaj bote dhe simboli i kryqit dhe shqiponjës kishte degraduar para se të ishte përfunduar *Komedia*. Për Montalen meqenëse aftësia jonë për të interpretuar veprën është në sosje Montale është i mendimit se duhen gjetur se cilat hipoteza të tjera leximi mund të japin një rezultat të kënaqshëm në interpretimin e veprës së Dantes, pasi aftësitë e studimeve dhe kritikës letrare moderne janë konsumuar përballë saj.

6.3. *Komedia* mrekullia e fundit e poezisë botërore

Montale synon të shtjellojë në këtë ese pyetje të tilla si: Çfarë kuptimi ka për një poet të sotshëm vepra e Dantes? A gjejmë në të një shembull apo një trashëgimi që duhet ta përvetësojmë?

Për Montalen, Dante është i papërsëritshëm. Qe shpallur thujse i pakuptueshëm dhe gjysmë barbar pak dekada pas vdekjes, ndërkohë që trillimi retorik dhe religjioz i poezisë si i diktuar nga dashuria u harrua shumë shpejt. Shembull i përkryer i objektivitetit dhe racionalizmit maksimal, shprehet Montale, ai është i huaj për kohën tonë, për qytetërimin tonë subjektivist dhe thellësisht irracional, sepse ai vendos domethëniet e tij tek faktet e jo tek idetë. Dhe është pikërisht arsyeja e fakteve ajo që nuk kuptohet në ditët tona. Si poet koncentrik, Dante nuk mund të jetë model për një botë që largohet në mënyrë progresive nga qendra duke synuar një ekspansion të pafund. Për këtë arsye *Komedia* është dhe mbetet mrekullia e fundit e poezisë botërore. Qe e tillë sepse ishte ende brenda mundësive të një njeriu të frymëzuar ose thënë ndryshe, për shkak të një kombinimi të veçantë të yjeve në qiellin e poezisë apo duhet ta konsiderojmë si një mrekulli, jashtë mundësive njerëzore?

Për Montalen mësimi më i madh që na ka lënë Dante është ky: që poezia e vërtetë ka patur përherë karakterin e një dhuntie dhe që për këtë

ajo nënkupton dinjitetin e atij që i dhurohet. Dhe nëse është e vërtetë se ai deshi të ishte poet dhe asgjë tjetër më shumë se poet, mbetet i pashpjegueshëm për verbërinë tonë moderne fakti që sa më shumë bota largohet nga ne, aq më shumë na shtohet vullneti për ta njohur atë dhe për t'ua bërë të njohur atyre që janë ma shurdha se ne.

7. Mjeshtrat për kryemjeshtrin

Duhet të kemi parasysh një fakt të rëndësishëm: shkrimtarët e sipërpërmendur si interpretues të veprës letrare të Dante Alighierit janë edhe studiues të thekur në njohjen e letërsisë, por mbi të gjitha shkrimtarë të rëndësishëm të letërsisë bashkëkohore evropiane apo latino-amerikane, disa prej tyre edhe fitues të çmimit "Nobel" në letërsi, të tjerë fitues të çmimeve të rëndësishme letrare ndërkombëtare. Pra, mjeshtrat që vlerësojnë kryemjeshtrin e tyre, profetin e letërsisë evropiane. Këtyre analizave mund t'u shtohen edhe analizat e shkrimtarëve e studiuesve dhe shkrimtarëve të tjerë, si Jorgo Seferis, Seamus Haney, Ismail Kadare etj. Bie në sy në këto interpretime mahnitja nga gjenia e Dantes, mahnitja nga bukuria estetike e veprës së tij, por edhe nga kompleksiteti i domethënieve kuptimore të saj, çka është e natyrshme për t'u pasur zili nga shkrimtarët e të gjitha kohërave. Në fakt në këto ese, ligjërata, mjeshtrat e letërsisë pranojnë me modesti supremacinë e kryemjeshtrit të madh të letërsisë botërore. Secili prej tyre priret të gjejë në veprën e tij atë çka e karakterizon në fakt veprën, përvojën letrare dhe konceptet estetike të tyre, pra secili priret të gjejë Danten e tij i cili edhe ngjason edhe dallon me Dantet e të tjerëve. Në tërësi kryevepra e Dantes *Komedia Hyjnore* vlerësohet *si vepër artistike që paraqet njeriun dhe botën njerëzore me gjendjet e saj; si vepër artistike që komunikon me të gjitha kohët; si vepër artistike që është krijesë dhe krijuese e gjuhës italiane; si vepër artistike në të cilën realizohet udhëtimi i intelektit të Dantes; si vepër artistike që paraqet "gjendje" të shpirtit njerëzor dhe vetë ëndrrat e Dantes; si vepër artistike në të cilën filozofia bashkudhëton me poezinë; si vepër artistike në të cilën ka unitet mes dritës, tingullit dhe materies; si vepër poetike e cila ngjan me një strofë të vetme ose me një prizëm perfekt njëmijë faqesh; si vepër artistike në të cilën Këngët janë instrumente për të kapur të ardhmen; si vepër artistike që mund të shijohet edhe pjesë-pjesë por mund të kuptohet mbas leximit të plotë; si mrekullia e fundit e poezisë botërore; si panel i një biblioteke që prek skajet e universit;*

si kryevepra për të rikthyer Beatricën; si një vepër poetike që mund të merret ende model për t'u ndjekur. Dante konsiderohet këtu si poet para së gjithash evropian; si poeti më universal i gjuhëve moderne, si poet i bashkëkohësisë së pafundme; Dante është njëkohësisht çdo njeri. Ndërsa dija e sotme bëhet më e pafuqishme përballë veprës së tij është i këshillueshëm leximi kompleks i saj duke shqyrtuar jo vetëm tekstin poetik dhe bukurinë estetike, por edhe duke lexuar jetën, kulturën formimin dhe epokën në të cilën lindi dhe u krijua vepra, madje edhe duke hedhur hipoteza të reja për interpretimin e saj. Sugjerohet ndërkohë se studimi i kësaj vepre ka nevojë edhe për një antikomentar që hedh poshtë interpretimet e gabuara apo shkollareske që i janë veshur asaj në shekuj.

Pjetër MESHKALLA¹

KRITIKË NDERTUESE?

E egër shpërthej nder këto muejt e fundit në shtypin e përkohshëm shqiptar një polemikë letrare, e cila si duket, ende s'ka me. Dihet se polemika, ma teper se me këthiellue idenat, ban me vëlue gjakun. Porse, këjo polemika e jonë sado e zhvillueme pergjithsisht me egersim, ndonji fryt të mirë e ka qitun. Ma së pari, vëlëra poetike e Dom Ndrë Mjedës, deri dje jo aq e njoftun sa ndoshta e meritonte, sot ka zgjue interesim të gjanë në mbarë Shqipnin, e çeshtja e Mjedës. Poet asht bā një herë e pergjithmonë çeshtje publike. E këta nuk asht pak. Së dyti (shka asht edhe ma me rands), kemi nisë me dermue pengimin ma të madhin e kritikës letrare: respektin e tepruem ndaj personëstë shkrimtarit. Nder gjykime letrare nuk duhet shikjue në fëtyrë askush, as per auktoritet qi mund të gëzojë si personë, as per hater të krahinës, as të miqsis, as të partis letrare.

Por me kaq mos të kujtojme se ja kemi mbërrijun me fitue plotësisht lirin e fjalës e zotnimin e gjykimit të pa-aneshem: lypet kohë e mundim shum përpara se të zhbihen ato idé mbrapambetse e rrenimqare qi e mbajnë kritikën si t'ishte një e fyeme personale, e kritikun si anmik, perpara se të kuptohet se në lamën e letersis nuk pranohen diktatora por vetem vëlëra, se çeshtjet nuk zgjidhen me polemika e parimet nuk imponohen me *fjalë të medhaja* (prej kahdo qi keto të vinë) e aqë ma

¹ Tomorri i Vogël, Viti I, nr.11, Tiranë, Qershor 1942, f. 1; Viti I, nr.12, Tiranë, Qershor 1942, f. 4; Viti I, nr. 14, Tiranë, 15 Korrik 1942, f. 1

pak me fjalë sherbeze e të germushuna o edhe vjolente.

Publiku i madh i lexuesve shqiptarë nuk asht pjekun ende per me ndjekë një diskutim objektiv e pa-anshem, porsì një luftë ideale në kërkim të së vertetës e per dobi të përbashkët. "Me kritikue" asht nder në ende sot synim me fjalet "me sa, me fye". Me këtë lloj mentaliteti shumica e lexuesve e merr në dorë Tomorin, Hyllin e Dritës, Kumbonen... e shkrimtarët nuk kanë gjith herë aq fuqi e mbizotnin sa me i mbajtur nder duer të veta frenat e diskutimit, e mos me ja lëshue opinionit publik: teper i tërhjekë rryma, teper kompromise e akomodime bajnë me të mbetat e me andjet e lexuesve, ndersa perkundra misioni i tyne do t'ishte me drejtue e me edukue kah e verteta e kah e mira, tue sakrifikue, po kje e nevojshme, edhe popularitetin.

Sa ma teper qi nder lexuesat shqiptarë kemi tashma një numer të mirë asish qi dijnë hollë shka asht letersija dhe shka asht kritika, e, në mos kjoshin ata vetë letrarë o kritike, së paku letersis ja njofin vëleren e bukurin, e kritikes kufijtë. Shi këta, besoj une, tue ndjekun polemikat letrare të ditve të kalueme, me e pare do të kenë ndejë si në pritje, por në vazhdimin e tyne do ti këtë kapë merzitja e mbëlue deluzioni ma i madhi, deri në neveritje, tue vërejtë se kufijtë e kritikës së këthiellët po u shkapercejshin nder shum raste, dashtas o padashtas, me diletantizme të papergjegjëshme gazetarije të perciptë, me degjenerime fjalësh së mëdhaja, akrobacinash retorike, dredhimesh sofistike; me paraqitje teorinash së diskutueshme si t'ishin të sigurta, me "ignoracion elenchi", e, shka asht ma zì, me insinuancione e të fyeme të randa personale krejt jashta argumentit të rragatjes.

Lexuesi i pjekun e i urtë do ta këtë pëvetë vedin me pezmetim: "Po a këjo asht kritika ndërtuese, udhëheqse kah e verteta? Këjo asht vepra edukuese e Shtypit? Ky asht lavrimi i shijes esthetike e ... burmore?!"

"Shkrimtarët Shqiptarë" është emëri me të cilin janë pagëzuar dy vëllime të bëshme të cilët, po t'i vësh njerin mbi tjetrin, t'a mbushin me të vërtetë syrin dhe të lënë si të mahnitur. Përmbajnë që të dy së bashku afro një mijë faqe. Në terësinë e tyre kërkojnë të paraqesin në syrin e lexonjësit një pasqyrë të plotë të letërsisë shqipe që nga origjina e saj dhe gjer në ditët t'ona. Që të dy vëllimet janë punuar nënë kujdesinë e Ernest Koliqit i cili në lëmën e përkëthimevet dhe të noveles shqiptare ka dhënë prova të lavdërueshme. Vëllimi i parë është punuar nga Prof. Namik Ressuli, filollog i ri me zell e me vullnet në çështje gjuhësore, dhe i dyti nga Prof. Karl Gurakuqi, durimtar i shqipes. Inicjativa që

mori përsipër Koliqi, Ressuli dhe Gurakuqi për të përmbushur një nevojë të ngutshme dhe të pabiseduarshme për sa i përkiste tekstevet të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në shkollat t'ona të mesme meriton të gjitha lavdërimet dhe përgëzimet nga ana e shqiptarvet. Vetem ata që kanë kryer shkollat e mesme në Shqipëri e kanë parë se sa mundim hiqnin ata dhe profesori vetë në mësimin e gjuhë shqipe”.

Kështu ja nisë recensionit të botimit “Shkrimtarët Shqiptarë” auktori i *Quo vadis Letërsi Shqipe* (Tomori, 1 Mars), tue marrë pikënisjen prej artikullit t'Etëhem Haxhiademit, mbi “Shkrimtarët pa vepra” (Tomori i Vogël, nr. 2).

Dhe shton ma poshtë: “nuk e do nevoja sot që të kalohen orët e shqipes me të diktuar në klasë. Botimi i tekstevet të gjuhës dhe të letërsisë shqipe jo vetëm që kursen një humbje koheje të tillë por edhe i pasuron nxënësit e shkollavet të mesme me njohuni më të gjera letërsije”.

Por ka edhe të meta ky botim, thotë artikullshkruesi, pikërishtvolumi i dytë, qi përfshin 554 faqe, i cilli “është punuar, siç thame edhe më sipër, nënë kujdesinë e Ernest Koliqit nga Prof. Karl Gurakuqi”. “Kur e merr me dorë njeriu këtë libër, pa e hapur, i duket sikur ka të bëjë me një antologji të nonjë letërsie italjane, gjermane, apo inglize, apo frënge. Kaq voluminozë është! Kur fleton, papandehur, mbetet i trishtuar dhe nuk di në se duhet të qeshë apo të qajë...”

*Të metat, për fat të keq, janë të shumta e të mbëdha... aq të mbëdha, sa me thanë mendja se kritikuesi, tue naltue në e parë prënë e vet me lavde e përgëzime, don ma me furi me e perplasun per dhe e me e ba copë copë.

Aj të goditë shkrimtarë (perveç njij pakice), copa të zgjedhuna, metodëe përpilim, por ma keqas se të gjithë goditë pergjegjsin e vëllimit të dytë, prof. Karl Gurakuqin.

Se goditet e shkallmohet pa farë mëshire nji puntuer i vjetër e i palodhshëm i gjuhës dhe i arsimit shqiptar, nuk asht së mbrami nji nderë aq e madhe! Por me bā zhele nji Tekst shkollë shi ndër duer të Profesorit e të nxansit, e me shtye këta me bjerrë besimin në nji Vepër, e cilla, po s' kje e perkryeme, së paku, si provë e parë, asht për t'u çmue e mundet me u shfrytsue me shum dobi, këjo asht e tepërt!

Duketsitëdojshimveç me hanger shoqishojnë!

E këtu s'e kam vetëm me auktorin e *Quo vadis Letërsi Shqipe*, pse këjo smundje asht bā e përgjithshme e kronike nder në; as nuk kam arësyesna të mjaftueshme per me besue se u fut ndër polemika letrare me

plane "të pa rrëfyeshme". Shka e shtyni ate, dhe ndonji tjetër me himun ndër këto valle besoj se kje një zemrim deri diku i ligjshëm, kundra disa padrejtësive në lamen e letersis. Por mjerisht zemërimi e bani tepër të ngutshëm ndergjykime, e, ndersa fjalët i merr era, scriptamanent, shkrimet përkundrajesin.

Jo po, të metat e botimit "Shkrimtarët Shqiptarë" nuk duhen mohue, e jam i sigurtë se këto të meta kurr një tjetër si njëf ma mirë se Perpilusat e Veprës.

Kush nuk e din se nder "Shkrimtarët" qi permban, per shembull, vëllimi i dytë: një shumicë e madhe janë shkrimtarë pa vepra letrare të përkryemë; shumë tjerë janë porsa në fillim; shumë tjerë kishin, po me meritue një vend të shquem në historin e perpjekjeve kulturore, didaktike, shkencore, kombetare, por jo në veshtrim të ngushtë.

E dijmë edhe se një numer i bukur shkrimtarësh tjerë qi në këtë vepër nuk gjinden, kishin me meritue një vend aty mbrendë, së paku me aq të drejtë sa shumë tjerë qi aty u pranue.

E dij mirë se copat e zgjedhuna as nuk janë në perpjestim me vlera reale.

Porse, të më lejohet ndonje vërejtje e përgjithshme:

1) Antologjia, mbas veshtrimit të fjalës, asht një Tubë lule copash së zgjedhuna prej auktorësh, me një qëllim te caktuem. Kur këjo permban edhe rreshtimin kronologjik e zhvillimim historik te letersis, merr ngjyren e histories letrare. Si njena si tjetra ka per të kenë ma e gjanë o ma e ngushtë, simbas qëllimit per të cillin perpilohet. Numri i faqeve i vëllimeve nuk asht mbasa e pasunise letrare. Edhe nder letersi të hueja të perparume kemi botime kësilloji gjith nduer dimensionesh.

Per ne ishte e nevojshme me vue gurin e parë. Lypej një tekst shkolluer, mjaft i gjanë por jo i randë, me ngjyrë antologjije e njiherihistorije letrare; një repertor (natyrisht i gjymtë) i letërsis shqipe, mbasi as Profesori as nxansi nuk kanë lehtas perdoresh botime e studime të veçanta shkrimtarësh shqiptarë.

Kritikuesi shkandullohet pse vëllimi i dytë njehka 554 faqe. Po t'ishin shtue edhe vërejtjet e shpjegimet per çdo copë të zgjedhun, sikur haptas e kerkon aj vetë, vëllimin do të kishte dalë sa një mal.

2) Parandej as Profesorias nxansi nuk kishin kurrnjë ndimë; tashti; kanë dishka; e qe se me një çast pretendojmë të kemi gjithçka!

Te e mbramja punen e ka gati krejt në dorë Profesori, i cili po pati pregatitje të gjanë kulture, zell e entuzjazem, zotsi e ekuilibër, ka me

dijtë ma së miri me trajtue menden e shpirtin e nxansit, si me tekste të gjymta, si me tekstet ma të përkthyeret e botës. Librat vijnë për ndihmë e lehtësim, o pak gjà ma teper.

Jet per t'u thanë një fjalë per "*Shkrimtarët pa vepra*", por këtë herë po i apim fund bisedimit tue riprodhue Parathanien e kaptinës II, të vëllimit II të *Shkrimtarve Shqiptarë* prej së cilës del në shesh se sa pjekuni e mbatuni zotnojnë perpiluesat aq të neperkambun të kësaj Vepre, sa me pasë mësim prej tyne edhe kritikuesat:

"Kaptina e parë e këtij vëllimi përmbloodhi shkrimtarët e periudhës së quejtun e *Rilindjes*, të cilët, në shumicën e vet, me pushkë në dorë e me libër nën sjetull përhapshin pak vjetë ma parë iden e njëj Shqipnije së lirë. Shum prej sish u janë kushtuem letravet ma fort me një qellim të jashtëm: paten para syshë ma tepër apostullimin kombtar - si e lypte n'atë kohë nevoja e atdheut - se sa hartin, prandej vlefte e tyne letrare, përgjithsisht tue folun, asht relative dhe e lidhun përherë me historin e zgjimit shqiptar.

"Ndonse, pra, vetëm disa prej sish prekën hartin e vërtetë, u radhiten pa përjashtim me jetëshkrime sa ma të plotsueme, me rreshtimin e prodhimit dhe, deri ku ka qenë e mundun, me kritikën e vepravet. Kjo gjà u ba pse - sot qi jemi nder të parët hapa të zhvillimit - këta janë përfaqsesit kryesorë të letravet shqipe; këta edhe, mbassi, a janë shuem ase janë shtym në moshë, përgjithësisht e kanë kryem veprën e vet letrare; këta pastaj meritojnë qi rinija e jonë t'i ketë si shembull veprimi dhe të shofë si të Parët e saj të njëj kohe punuen pa pushim simbas zotsis, ku ma të madhe ku ma të vogël, për t'i vum themele të shëndoshta idës kombtare, gjuhës e letërsis qi janë vula pamvarsije.

"Në këtë kaptinën puna ndryshon. Kemi të bajmë me shkrimtarë të rij, të cilët janë ende gjallë jo vetëm, por edhe shumica e tyne asht në kohën ma të miren e zhvillimit të vet prandej arësyeja këshillon qi të kufizohemi, sa të jetë e mundun, si ndër jetëshkrime, si në kritikën e vepravet. Nder disa nga këta shkrimtarë ndeshim një përparim të madh në qortimin e gjuhës e nga një herë zotsi të dallueme harti, për ma teper edhe puntorë shum të mirë per lavrimin e gjuhës së përbashkët letrare. Koha duhet të randojë mbi ta dhe këjo të pjekë ngadalë gjykimin e drejtë të vepravet të tyne gjithnji në zhvillim". (*Shkrimtarët Shqiptarë*, vëll II, faqe 361-362).

Prej parathanjes së kaptines së dytë të II të veprës "*Shkrimtarët Shqiptarë*" qi riprodhuem integralisht në numrin e kaluem, nuk asht

vështirë me kuptue se ata qi e punuene nuk e kanë humbun kriterin e gjykimit të drejtë mbi shkrime e shkrimtarë, e se kurrkund nuk e kanë pasë mendën me e paraqitun si të përsosun e definitive.

Del prandej i paspjegueshem zemrimi qi këjo vepër zgjoj ndër disa qarqe. I paspjegueshem nen peshen e arsytimeve objektive, për të cillat të gjith sa per arsytina tjera, qi mund kemi të drejtë t'interesohejmë; se t'ekzistojnë, as nuk i dijmë as nuk duem t'i dijmë.

"E shumta janë shkrimtarë pa vepra", qe fjala e bujshme qi kaloj gojë mbë gojë!

Shkrimtarë pa vepra? Po shka kuptojnë me këtë fjalë ata qi e fabrikuejnë? Po deshtem me gjykue prej artikujve të tyre, kishim me pergjegjë: gjithshka, e, së fundi, kurrqja!

Me thane se "vepra" në mendën e disave asht synonym me "vëllime të shumta e të mëdhaja" drue se bahem qesharak, tue e çëmue teper ultë nivelin menduer të tyre. Pse gjithkushë din se ka shkrimtarë me fame botnore, të cillët na kanë lanë pak e t'imita. Në sa perkundra ka shkrimtarë pa kurrnji vëlerë, të cilët kanë shkruar aqë shumë vëllime sa me mbushë një bibliotekë!...

A por ndoshta "shkrimtar me vepra" - "quhet ay njeri që ka një kulturë të gjërë dhe që di t'i shprehë ndjenjat apo mendime te tij në një formë të përsosur"? Atëherë prej çëdo letersije duhet të dëbojmë së paku gjysen e shkrimtarëve, sidomos ata të zanafillës së letërsive të ndryshme, qi natyrisht janë të papersosun. E mandej mbetet për t'u caktue: cilla asht, pikrisht, këjo formë e persosun? kush ka të drejtë me e folun fjalën e fundit?... Sa shkrimtarë janë pa tue u naltue deri në qiellë prej ndonjenit, e mandej tue u qitun në baltë prej ndonji tjetrit, megjithse në 'ta një fare vëlere letrare ishte e pamohueshme.

Veprat letrare mund të studjohen prej shumë anësh: prej hartimit, prej rreshtimit, prej thjeshtsis, prej fuqis, prej njomsis, prej pasunis, etj. etj., e jo gjith herë shquhen me të njajten mbasë në të gjitha këto cillsi.

A por ndoshta kerkohen vepra "origjinale"? Ah, origjinal mue më duket fjalë shumë ma enigmatike se i *persosun*! Mandej, edhe po kje përkthim i thjeshtë nuk asht e pamundun qi të jetë një kryeveper stili e gjuhe, e të fitojë një vend të lartë ndër fletët e letërsis.

Cilli asht pra temeli i levisjes kundra "Shkrimtarve pa vepra"? A thue asht mënjia e shenjtë kundra anmiqve të Naimit (në kohën e tij), "disa agjenta të huej"... "dhaskajt truëndryshkun dhe fletorarët batakçij"... ose kundra disa tjerve të kohës s'onë: "dhaskajt shterba...

(qi me hajdutët shkojnë mirë, me bataçij prehen zbavitën)... qi pa qenë të zotët t'i shtojnë gja pasunis s'onë letrare, vërsulen me një anmiqsi të tërbueme kundrejt atyneve qi gjith jeten e tyne ja kanë kushtue lulzimit të gjuhës shqipe pa pasë shpesh herë edhe bukën në gojë...?" (Shif E. Haxhiademi, *Tomorri I Vogël*, n. 2.)

E shkrimtarët e sotshëm të nëpërkambun kush janë? Haku, Spasse, Kokona? Bukur! Këta kenkan shkrimtarë me Vepra. Bukur! Bukur! E po ti kalonte neper tru ndonji tjetrit me shtue disa emna tjerë, a e kishte per të na i pranue Z. Haxhidemi e Z. Lumi si shkrimtarë me Vepra? Ndoshta asht halli i faqeve, qi shtohen teper!

Jo, Zotni, per këtë udhë nuk dalim kurr në breg! Të metat qi kemi pranue edhe na, munden me u qortue e me u plotsue; të rijve duhet t'u japim zemer, - por jo për këtë udhë.

Si per me rimbëkambë si per rrëzue lypet temperament kritiku e si temperament kritiku nuk kanë dhanë provë të kënaqshme asnjëni nder dy Zotnijt e naltpermendun, sidomos i mbrami me disa *qui pro quo* teper, teper të randa.

T'i lamë rrëshqitjet e shpeshta jashtë argument të rragatjes; çansimin jo eksakt të *Kumbonessë Dielles* si Revistë fetare, ndersa në ball ka të shkrueme: fetare-kulturore; moskuptimin e fjalës *Retorikë* si klasë e kursit klasik të dikurshëm, etj.; por ku aj i bjen murit me krye shum keqas asht kur shkruen: e se "ay e ka marë përsipër që t'a kryej atë barrë të rëndë, ndonse i ndihmuar nga shumë të tjerë. Edhe faji doemos i bje më teper atij".

"Nuk mund të ngrihet tashti Z. Gurakuqi e të pretendojë në librin e punuam nga ai vetë se është "nji perkthyes i mirë" kurse Noli është vetëm "një përkëthyes".

Pak vërejtje mjaftojnë per me provue:

- 1) Deri tash na e dijshim se pergjegjsin ma të madhen e artikujve nder punikësilloji e ka artikull shkruesi e jo drejtuesi. E njimend, kur tash disa vjetë u duk n'*Enciklopedia Treccani* artikull mbi letersin shqipe, qi zgjoj aq shum protesta në Shqipni, kritikati i kjene drejtue kryesisht auktorit t'artikullit e jo Presidentit e Drejtorve t'Enciklopedis.
- 2) Nuk kam muejtë me hetue se ku çansohet K. Gurakuqi "përkëthyes i mirë". Sido qi të jetë, tue lexue jetëshkrimin e veprimin e tij letrar, kurrkujë nuk i shkon mendja se "auktori është nji Naim, Fishtë, apo një Fan Nol". Qi nji shkrimtar të botojë o të drejtojë nji Antologji prej shkrimtarve të kohës së tij, asht kombinacion i rallë, por kur

vertetohet kombinacjoni, nuk asht një çudi që edhe ai të figurojë në mes të shkrimtarve tjerë, përkundra di t'ishte çudi e faj i pafalshëm kur mos të figuronte.

- 3) Ftoj cilindo fëmijë, që të ketë krye të tretën klasë fillore, të lexojë shka shkruen Andon Frashëri (jo Gurakuqi) mbi Fan Nolin, e jam i sigurtë se kanë për t'a impresionue lavdet që, me plot të drejtë idhurohen këtij "përkëthyesi ("përkëthimet për bukuri..." "përkëthimet ma të goditura..." " kryeveper përkëthimi..." "përkëthyer me zotsi mjeshtri...").
- 4) As mos të trembet kush se "Shkrimtarët Shqiptarë" mund të na turpnojnë përpara "botës së qytetruar" pse tue pa këtë Veper, bota e qytetnueme e ka shprehë gjykimin e vet e ka thanë: "Pra Shqiptarët paskan një të kalueme, paskan një letersi...pra paskan të drejtë për një t'ardhme!"

▪ Albanologji. Qytetërim ▪

Ernest MARKU

**FISHTA: HISTORIA E TË PARËVE DHE PEMA
GJENEALOGJIKE**


Para se të flas për jetën e Poetit Kombëtar, Atë Gjergj Fishta, më duhet të gjurmoj pak në origjinën e të parëve të tij¹. Gjakova ka shërbyer gjithnjë si një vend tranzit për katolikët shqiptarë; sa herë që situata ishte e mirë, ata i afroheshin këtij qyteti; për t'u larguar më pas, sapo nisnin problemet apo pëndjekjet. Parardhësit e Fishtës, thonë se ishin nga fisi i Thaçit, që ishin vendosur diku pranë Gjakovës. Kujtesa popullore nuk shkon më larg se emri i Bib Pacit, i cili, së bashku me dy vëllezërit e tij, u nis nga Gjakova me rreth 200 dhí e keca, për të veruar në një stan në bjeshkët e Munellës. Se çfarë të drejte kishin ata mbi këto kullota, paguanin qera apo jo, për këto çështje, kujtesa popullore hesht. Aty duhet të kenë ndodhur disa ngjarje, që i futën tre vëllezërit në konflikt me vendasit. Biba kërkoi kohë për të biseduar me të vëllezërit, kurse në mendje kishte planin për të ikur fshehurazi. Sa ra nata, të tre vëllezërit vunë dhitë përpara dhe tentuan të iknin pa rënë në sy, por vendasit nuk flinin; ata e prisnin diçka të tillë, ndaj u kishin zënë pritë. Në pushkët e para u plagos Çupi, vëllai i dytë; kurse dy vëllezërit e tjerë arritën të arratiseshin, duke lënë pas më shumë se gjysmën e dhive. Vëllai i vogël, të cilit nuk ia kujton kush as emrin, u kthye tek i ati në Gjakovë, së bashku me pjesën më të madhe të dhive të mbetura. Për të

1 Marku, Ernest. Libri i Fishtës. Lezhë 2020.

thuhet se emigroi në Stamboll, e prej aty, disa pasardhës të tij arritën deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Po le të kthehemi tek Biba. Me ato pak dhi që mbajti, i bindur për t'u shkëputuar nga e shkuara, u vendos në një livadh pranë fshatit Fishtë të Zadrimës. Aty, shumë shpejt, hyri në konflikt me një bari nga Kelmendi, që përfundoi me ikjen e këtij të fundit. Meqë kelmendasi ishte i ardhur dhe banorët e zonës nuk shquheshin për konflikte, Biba arriti të hidhte rrënjë në atë vend. Banorët e rrëzës së Munellës, ia gjetën adresën dhe i çuan fjalë që të shkonte e të negocionte me ta, se përndryshe da t'ia vrisnin të vëllanë. Biba nuk u ktheu përgjigje fare; zuri miqësi me një familje vendase me ndikim dhe e shumfishoi tufën e dhive, gjersa arriti të rekrutonte edhe roje me armë. Armiqtë e tij, si tentuan ta kapnin apo ta vrisnin nja dy herë, duke parë vështirësitë e kësaj pune, u kthyen të gjenin zgjidhje tek i vëllai që e mbanin peng, i cili tashmë, ishte shëruar nga plaga në këmbë. Kjo ngjarje solli shkëputjen përfundimtare të mardhënjeve në mes të vëllezëreve, fëmijëve të tyre, si dhe fëmijëve të fëmijëve; andaj, tani e tutje, do të merremi vetëm me pasardhësit e Bibës, që u vendos në Fishtë. Jemi në vitet e para të shekullit XVIII.

Themelet e kullës ku lindi Poeti Kombëtar, e cila nuk ekziston më, duhet të jenë hedhur rreth viteve 1750 – 1760; pasi, kur u nda familja e madhe, rreth vitit 1890, flitej për një ndërtesë 130-140 vjeçare. Bibës, i lindi një djalë dhe për katër breza, linja mashkullore u mbajt vetëm me një trashëgimtar, ku ermrat Mark e Shtjefën, alternoheshin me njëri-tjetrin. Marku i dytë, pati tre djem dhe që këtu, degët e pemës gjenealogjike, shpërthejnë në lulëzim të pafre. Nga Ndoci, djalë i këtij Markut që përmenda më lart, del Ndoka i Simon Ndocit, që është i ati i Zef Ndokës, i cili më vonë do të quhej Gjergj Fishta. Perna gjenealogjike e fisit të Fishtës, vetëm për linjën mashkullore të trashëguar, që nga viti 1710 e deri në ditët e sotme, mbështetur në punën studimore të Gjergj Franit e Engjëll Zefit; jepet si më poshtë:



Aty ku ishin themelet kësaj kulle, lartësohet sot një memorial i thjeshtë, i ngritur me kontributin e një misionari italian, dom Antonio Sciarra; poshtë një kryqi, mbi fletët e një libri të gurtë, tregohet se aty lindi Poeti Kombëtar, At Gjergj Fishta.

RINIA, BOSNJA

*Më 23 të vjeshtës së dytë, në tetor të vitit 1871, - thotë At Daniel Gjeçaj², - votra e Ndokë Simon Ndoci³ shtohet me një djalë. Ky djalë do të bëhet aq i famshëm, sa do t'i jepte famë edhe Fishtës që e lindi. Po të njëjtën datë jep edhe At Pashk Bardhi³, duke na kujtuar se i ati quhej Ndoka i Simon Ndoci³, kurse e ëma ishte Prenda e Lazër Kaçit nga Kotri. Ata paten tre djem e një vajzë, ku frati dhe poeti i ardhshëm, do të ishte fëmija më i vogël. Regjistrat e lindjes⁴ të vitit 1871, të mbajtura nga meshtari i famullisë së Troshanit, frat Leonardi (*Leonardo de Martino*), na japin 22 tetorin si datë lindjeje për të pagëzuarin Zef, të birin e "Nok Simonit" dhe "Prena Lazerit", lindur në Fishtë. Pagëzimi*

² Po aty, faqe 19

³ Dema, Benedikt: "At Gjergj Fishta, 1871-1940", faqe 21

⁴ AQSHSH: Fondi 615 – Dioqeza e Sapës, Dosja 447-Regj. i pagëzimeve, Famullia Troshan, viti 1881


është bërë me datë 24 të këtij muaji, nga i njëjti famullitar, me dëshmitarë Gjin Frrokun dhe Mara Kolian (*nuni e nuna*). Më poshtë po paraqesim faksimilen e këtij regjistri:



Ndoshta data 23, si datë e lindjes, mund të jetë inspiruar prej vetë Poetit Kombëtar, ka shumë mundësi që ai të ketë dashur të përdorë një datë simbolike, që do të përfaqësonte si lindjen fizike me 22, ashtu edhe lindjen shpirtërore, ditën e pagëzimit me 24. Një gjë e tillë mendohet, pasi data 23 nuk jepet vetëm nga Gjeçaj, por edhe nga At Pashk Bardhi, që ishte një nga miqtë më të afërt të Fishtës. Ai që thoshte: *"Un jam Pater Gjergj Fishta, qi shkaj dynjasë tue i njitë bishta"*; me shumë mundësi, i lejonte vetes të bënte dhe një autoironi të tillë, deri edhe me vetë datën e ardhjes së tij në këtë botë.

Gjithashtu edhe një dokument⁵ tjetër, i vitit 1886, i regjistruar në Guca Gora, aty ku u ndal për herë të parë Fishta, gjatë studimeve në Bosnje; na jep sërish datën 22 tetor, si datëlindjen e tij. Faksimilja e këtij dokumenti jepet më poshtë:

⁵ AFPBS (Archiv Franjevčke Provincije Bosne Srebene) – Guca Gora.



Faksimile e dokumentit të Guca Gorës, ku regjistrohet ditëlindja e Fishtës.

Mbi një shkrep, sipër Troshanit, gjenden edhe sot rrënojat e një ndërtese të moçme, ku rrinin dikur françeskanët, larg fshatit dhe larg zhurmës së njerëzve; por edhe sidomos, larg syrit të anadollakëve turq, që më se një herë e dogjën dhe e rrënuan deri në themel. Aty rrinte edhe At Leonardo de Martino (1865 – 1905), i cili e pagëzoi me emrin *Zef. Nuk ndodhi gand e pa hiri* – thotë Daniel Gjeçaj⁶, - që një poet

⁶ Gjeçaj, Daniel: "Gjergj Fishta, jeta dhe vepra", faqe 20

italo-shqiptar, të lindte rishtas me ujët e pagëzimit, Poetin Kombëtar të shqiptarëve. Ishte shenji i asaj Provanie hyjnore, në duer të së cilës janë shartet e njeriut edhe fatet e botës."

Në kujtesën e pasardhësve ka ngelur edhe emri Zekë, me të cilin e thërrisnin, dy vëllezërit më të mëdhenj, Simoni (*Çupi*) dhe Leka, motra Lena, prindërit, si dhe bashkmoshatarët e tij në Fishtë. Asokohe, ndërsa Zeka i vogël po ruante delet, në ato kodra kalon At Mariani nga Palmanova (*Padre Mariano Pizzochini*), misionar françeskan venedikas, i mirënjohur sidomos prej shqiptarëve të Kosovës, tek të cilët derdhi për shumë vjet djersët e veta apostolike, nën emrin "*Marian Pasha*"; emër të cilin ja kishin ngjitur ndoshta pse ishte një frat i shëndetshëm e faqekuq. Bashkë me At Marianin ishte edhe At Gianpiero nga Bergamo, prefekt i misionit të Kastratit; të cilët, kishin filluar të mendonin për themelimin e një kolegji françeskan në Shqipëri. Ata, një ditë, ndërsa po shëtisnin në kodrat e Troshanit e të Fishtës; shohin një bari të vogël, duke vendosur disa krande të thyera mbi njëra-tjetrën dhe e pyesin:

- Shka po ban?
- Jam tue ndertue nji shpi, – i përgjigjet Zeka (*Zefi*) i vogël.
- Shpi apo kishë?
- Shpi, se ... kisha asht shpija e Zotit e nuk ndertohet me krande.

Kjo përgjigje e djalit të vogël i la pa mend dy fretërit, saqë shkuan tek prindërit e tij dhe ua kërkuan këtë fëmijë, për ta shkolluar e për ta drejtuar në rrugën e meshtarisë. Respekti për françeskanët ishte shumë i madh, ndaj prindërit, ndonëse kjo punë u ra si e papritur dhe fillimisht nguruan, nuk ia bënë fjalën dysh Patër Marianit. Një gjë tillë dëshmohet jo vetëm nga Gjeçaj e nga Bardhi, por edhe nga At Marin Sirdani⁷. Zefi i vogël dërgohet në Shkodër, ku merr mësimet e para mes fretëve të qytetit. Aty dallon ndër të gjithë moshatarët e vet, bie në sy për talentin, aftësinë dhe sjelljen shembullore. Françeskanët e kishin hapur shkollën e parë popullore në Shqipëri, qysh në vitin 1861. Kjo shkollë në Shkodër ishte shkolla e të varfërve, e të harruarve, e fshatarëve; nxënësit e kësaj shkolle do të bëheshin disa nga ithtarët më të shquar të shqiptarizms. Në mjediset e saj u shfaq për herë të parë melodrama në shqip e Leonardo de Martinos: "*Nata e Këshëndellave*". Atë Leonardit, italo-shqiptar nga provinca françeskane e Puljes, - shprehet Marin Sirdani⁸, - ishte i pari që dëshmoi se gjuha shqipe ishte e denjë për çdo ritëm të poezisë klasike.

Në vitin 1880, në Kuvendin Fretnor të Troshanit, hapet për të parën herë Kolegji Françeskan Shqiptar, nën drejtimin e At Marianit nga

⁷ Dema, Benedikti: "At Gjergj Fishta, 1871-1940", faqe 21 dhe 30

⁸ Po aty, faqe 31

Palmanova dhe të At Giampieros nga Bergamo. Zefi i Ndokës së Simon Ndocit, alias Gjergj Fishta, është ndër të parë nxënës që regjistrohet në këtë shkollë, në degën e destinuar për ata që do të ndjekin rrugën fetare të Shën Françeskut. Ndoshta që këtë vit, ai ndjeu për herë të parë problemet shëndetësore në zemër. Në moshën 10-11 vjeçare, Zefi do të udhëtonte drejt Raguzës (*Dubrovnikut*) për t'u kuruar. Gjatë periudhës së qëndrimit aty, ai do të mburrej më vonë se kishte kënduar solo në kishën françeskane të qytetit, pa dyshim në kuvendin e mirënjohur të Male Braces, aty ku mjeshtri i madh shqiptar, Miho Tivarasi, projektoi e ndërtoi në vitin 1360, një nga veprat më të njohura të artit mesjetar.

U kthye nga Ragusa në Troshan, për të përfunduar mësimet e para, që për hir të së vërtetës, ishin të varfra e të kufizuara, në aspektin shkencor. Zefi i vogël, 11-vjeçar, - thotë At Marin Sirdani⁹, - është i pari nxënës që regjistrohet në këtë kolegji për fëmijë. Fishta do të ankohej gjithnjë, para studentëve të mëvonshëm : *"Ah medet! T'kisha patun fatin tuej e të ndiqja shkollat qi ndiqni ju.* Nën kujdesin e kryetarit të Urdhërit Françeskan, At Benardinit nga Portogruaro, në vitin 1886, studentët e Kolegjit të Troshanit caktohen të vazhdojnë studimet e larta të filozofisë e teologjisë në Provincën Minorite të Bosnjes. Zefi, së bashku me gjashtë të tjerë, ndër të cilët Ejell Paliq, Severin Lushaj, Pjetër Gjadri (Vrusha), Loro Mitroviç (Mazreku), Bonë Gjeçaj e Pashk Bardhi dërgohen në Manastirin e Guca Gora-s, afër Travnikut, ku kryejnë vitin e provës. Këta emra jepen nga At Daniel Gjeçaj¹⁰, ndonëse At Pashk Bardhi thotë se Fishta niset vetë i gjashti; po ashtu At Donat Kurti¹¹, në veprën e tij *"Provinca Françeskane Shqiptare"*, përmend gjashtë student të përzgjedhur, në mes të të cilëve: Zef fishta, Martin Lushaj, Mëhill Mesi, Pashk Mitroviçi (Mazreku), Sebastjan Paliq e Simon Vrusha (Gjadri). Mospërputhja e emrave, besoj, ka të bëjë me faktin se njëri përmend emrat e pagëzimit, kurse tjetri emrat e zgjedhur prej tyre, kur vendosën t'i kushtohen meshtarisë. Gjithashtu Gjeçaj ose Kurti, mund të përfshijnë padashje, edhe ndonjë student te viteve të mëvonshme. Kështu, sipas zakoneve françeskane të asaj kohe, edhe Zefi parazgjedh të thirret Gjergj; emër të cilin nuk e ndryshoi më e me të cilin do të bëhej i njohur në mbarë shqiptarinë e më gjerë.

Mësimet e filozofisë i ndoqi në kuvendin Sutjeska, kurse ato të teologjisë, në Livno. Kudo e në të gjitha lëndët u dallua për zgjuarsi dhe intiligjencë krijuese, e, për rrjedhojë, vlerësimet ishin maksimale, në çdo lëndë. Siç shprehet Daniel Gjeçaj¹², i cili i referohet At Pashk

⁹ Po aty, faqe 30

¹⁰ Gjeçaj, Daniel: "Gjergj Fishta, jeta dhe vepra", faqe 22

¹¹ Kurti Donat: "Provinca Françeskane Shqiptare", faqe 24

¹² Gjeçaj, Daniel: "Gjergj Fishta, jeta dhe vepra", fq. 23

Bardhit; frat Gjergji nuk shpenzonte shumë kohë për mësim, mjaftonte një e lexuar për t'i riprodhuar pastaj, pothuajse përmendësh, faqet e tekstit mësimor të dhënë. Ndërsa ne të tjerët thyenim kokën mbi librat shkollorë, – tregon At Pashku, - ai lexonte poezi kroate si: "Osvetnici" të Grga Martić (1822-1905), "Rasgovor Ugodni naroda Sloniskoga" të Andrije Katiç Mioshiç (1704-1760); mbi të gjitha, kryeveprën e Petroviç Njegosh Petar (1813-1851), "Gorski vijenac"; ndonëse autori me të cilin ishte dashuruar në ato kohë ishte Ivan Mazhuraniç (1805-1888), nga i cili dinte përmendësh, krejt poemën "Smrt Small Age Čengića". Këta autorë, përfaqësues të denjë të popullit të tyre, i cili kishte vuajtur për shekuj me radhë sundimin osman, duke e fituar lirinë shumë përpara nesh, më shumë me penë sesa me shpatë, lanë në mendjen e freskët të Gjergj Fishtës gjurmë të palshlyeshme, shenjat e të cilave duken në të gjithë krijimtarinë letrare të tij e veçanërisht në "Lahutën e Malcis".

Përveç këtyre, ai lexonte vazhdimisht edhe klasikët grekë e latinë e sidomos autorët italianë, si: Dante (1265-1321), Goldoni (1707-1793), Alfieri (1749-1803), Manzoni (1785-1873), Carducci (1835-1907), Paskoli (1855-1912); dhe këta janë vetëm disa prej tyre, aq sa kujton At Pashko Bardhi. Më 1906, Fishta do të botonte përkthimin e odeve të Manzoni, "Inni Sacri". Vetë Pashko Bardhi shprehet se Fishta që në Bosnje nisi të shkruante poezi, disa nga të cilat ai i ruante si relike. Në përkthimet e Fishtës, përveç këtyre që përmend Bardhi, si dhe disa dramave të Molierit dhe të dramaturgut tjetër francez, P. Rondina S.J., bie në sy edhe një përkthim i pjeshëm i "Iliadës", që flet për një njohje të hershme të tij me Homerin dhe letërsinë e grekëve të vjetër. Ndoshta energjia e tij, e përqëndruar tek puna me "Lahutën e Malcis", do ta pengonte në përfundimin e atij përkthimi. Anton Nikë Berisha¹³ shprehet se Fishta kishte lexuar edhe autorë të tjerë të famshëm: Hesiodin, Homerin, Virgjilin, Aligerin, Bokaçion, Petrarkën, Arioston, Miltonin, Molierin, Mankonin, Goldonin, Leopardin, Hajnen, Shilerin, Calderonin, pastaj shkrimtarët më të shquar kroatë e malazias e shumë të tjerë. Poeti ynë shkruan: "Calderon, sigure njani nder ma t'mdhajt dramaturgj t'botes, dramet e veta – e jan me qindra – i ka shkruar n'etrrroksha. Un kam ktu parasysh, vetun tre blej t'veprave t'tijna, me ll drama..."

Në këtë periudhë Fishta, zuri një miqësi të përzemërt me lirikun kroat, më të njohurin e kohës së vet, Silvije Strahimir Kranjčević (1865-1908). "Poeti kroat, aso kohe i shtymë në mot, hetoi në të riun shqiptar gjeninë e ardhshme: kleriku me zhgun mësoi nga mjeshtri i letrave e

¹³ Berisha, Anton Nikë; "Vepër e qenies dhe qenësisë sonë – vëzhgim mbi artin poetik të Fishtës", faqe 47

nga miku, dashurinë ndaj atdheut, ndaj përfaqësueve gjenuinë të racës, ndaj kombit e gjuhës popullore, gjana këto që edhe për Strahimirin ishin notat dalluese të madhësisë së tij në Parnasin e poetëve kroatë” - shprehet Daniel Gjeçaj¹⁴. Është me shumë interes poezia e Fishtës në gjuhën italiane, të cilën student i vitit 1892, ia kushtonte mikut të tij kroat, me titull: “*Al valente poeta, signior Silvio Kranjxheviçit*”; një nga më të hershmet poezi, botuar për herë të parë në shqip më 1933 ose 1934, sipas studiuesit Tonin Çobani¹⁵. Ndër të tjera, në variantin e Daniel Gjeçajt, poeti shprehet:

*“Po kshtu, Silv'im, m'asht fjala jote,
Qì zemren ma freskon, t'rime n'dnesë e vaj,
Per atdhe tim t'dashtun, qi vuen pa mshirë,
Tashsa qindvjeta, nen zgjedhë t'randë e rajë,
E turkut tiran, qi dekë as gjallë s'e don.
Uh! Evropë e shitun, per vedi veç mendon!”*

Origjinali në italisht, sjellë nga studiuesja Blerina Suta¹⁶, na jepet i tillë:

*“Tal scende, o mio Silvio! l tuo cocento
Al core mio fesso dal lungo lament
Dell'inclita Patria, che senza pieta
Da secoli giace nel duol, nell'affano
Vivendo la morte che il Trace tiranno
Le niega ... Vah! Europa che serva vitta!”*

E njëjta, na sjell një variant të sajën në shqip, të përkthyer nga italishtja:

*“E ktille asht ulë, o Silvio jem! e ambla kanga juej
N'zemer teme varrë prej t'ankuemit t'giate
T'perndritshmit Dheut t'Parvet, qi pa mshirë
Kavaljetesh tanë djergun m'dhimbtë, m'travajë,
Motet tue shkue me deken qi Traku tiran
Mohit ia qet ... Ah! Evropë shka m'sherbeve!”*

U ndalëm kaq shumë tek kjo poezi, pasi poeti kroat Silvije Strahimir **Kranjčević**, zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën e Fishtës; aqsa,

¹⁴ Gjeçaj, Daniel: “Gjergj Fishta, jeta dhe vepra”, faqe. 23-24

¹⁵ Çobani, Tonin: “Gjergj Fishta, fillimet letrare”, faqe 69-70

¹⁶ Suta, Blerina: “Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës”, faqe 45

studiesja e mirënjohur Blerina Suta¹⁷, në librin e saj "Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës"; aludon, se edhe poezia "Nji lule vjeshtet", e botuar në vitin 1909, në vëllimin e titulluar "Pika Voeset"; i kushtohet pikërisht atij. At Viktor Volaj, në shënimet shoqëruese të botimit të "Mrizit të Zanave", më 1941, dëshmon se dorëshkrimin origjinal të kësaj poezie në gjuhën shqipe, Fishta e kishte lënë në dhomën muze të Kranjçeviçit, në Sarajevë. Një argument tjetër, pro kësaj teze, është fakti se poeti përdor formën "silvija", për të treguar selvinë; edhe pse Fjalori i Bashkimit i një viti më parë, 1908, përdor trajtën "selvi-ja", gjë të cilën, ai s'kishte si të mos e dinte. Këtu mund të aludohet lehtësisht, se Fishta ka dashur të përmendë emrin e mikut të vet, Silvije Strahimir Kranjçeviç. Gjithashtu, tek poeti kroat, në një nga poezitë e tij, gjejmë vargjet: " ... Përse? Sepse unë nuk jam i kësaj bote ... Yjet janë vëllezërit e motrat e mia ... "; kurse Fishta në poezinë e vitit 1892, kushtuar atij, e quan atë si më të ndritshim yll, të kiblës poetike kroate; kurse te poezia "Nji lule vjeshtet", i drejtohet me vargjet: " ... s'kije toka, jo, per ty kje qiella". Për vargjet: " ... me shkrola t'njohtne veç e prej barijvet", studiuesja Suta¹⁸ i interpreton këto shkronja, si një mesazh të njohur vetëm prej krijuesve të këngës epike, apo bardëve të kësaj kënge, duke e konsideruar poetin kroat, si një anëtar të familjes poetike të Fishtës. Autori i këtij libri, në një ese të 2015-ës, të titulluar "Më shumë dritë"; e kërkonte atë, të cilit i dedikohet kjo poezi, në radhët e familjes biologjike të poetit, duke aluduar për të vëllain, Çupin, apo për të atin, gjë e cila, nën këtë dritë të re, duket më pak e mundshme. Unë ato vargje i kisha kuptuar, si një aludim për barinjte që e ruajtën gjuhën e pellazgëve e të trako-ilirëve, duke e sjellë të gjallë e të pazhvilluar, deri në shekullin XX.

Mbi njohjen dhe miqësinë e dy poetëve, si dhe për ndikimin reciprok të kësaj njohjeje, në jetët dhe poezitë e secilit, kanë folur vazhdimisht biografët dhe studiuesit e veprës së Kranjçeviç-it. Koha e qëndrimit të këtij të fundit në Livno, përkon me fazën më të njohur të krijimtarisë së tij poetike, si dhe takimi i dy poetëve do të ndikojë në konceptin e ngjashëm për poezinë lirike. Në fakt, Fishta e Kranjçeviç, të dy të dashuruar me konceptet estetike të traditës më të mirë latino-romake, kishin çfarë të ndanin në bisedat e tyre, në kushtet e mungesës së lirisë në Ballkan. Marakoviçi, i cili e ka njohur personalisht Kranjçeviç-in, mik i të atit, profesor i Institutit Tregtar, jep informacione të rëndësishme për Livnon e kohës, kur aty jetonte poeti kroat. Ndryshe nga Bijelina ku kishte qenë më parë, qyteti i hapur dhe miqësor, i banuar me popullsi serbe, por tolerante dhe mikpritëse, Livno, e ashtuquajtura "Sibiri

¹⁷ Po aty, faqe 71-72

¹⁸ Po aty, faqe 73 dhe 84

Bosnjake", banohej nga një popullsi krenare e etnisë kroate, e ashpër dhe njëkohësisht mjaft humane dhe e përgjegjshme. Këto përshkrime, - thotë studiuesja Blerina Suta¹⁹, - na ndihmojnë të krijojmë një përfitim më të qartë, për mjedisin kulturor ku jetoi e studio Fishta, në fazën e fundit të studimeve të tij në Bosnje; si dhe rolin që ka pasur ky vend në formimin kulturor dhe në fermentimin e idealeve patriotike, tek poeti kombëtar shqiptar. Të rralla janë vendet e Bosnjes, ku mund të takohet një etni me moral kaq të lartë, - shprehet Gjeçaj. Livno rrethohej nga një peisazh natyror me bukuri të rrallë dhe me një horizont shumë të hapur, por edhe me një terren mjaft të thyer njëkohësisht. E përshkuar nga erëra të forta dhe stuhi të frikshme dëbore, në ajrin e pastër të lartësive panoramike. Banorët e Livnos ishin të pajisur me cilësi morale të karakterizuara nga pastërtia, virtyti dhe gjenialiteti. Shoqëria antike patriarkale ishte ruajtur aty e paprekur, në natyrshmërinë e saj të kohëve të fillësës së jetës në tokë; ende në ditët tona, një vajzë nuk guxon të dalë e vetme nga shtëpia, pa arsye, ndërsa, pasi të errej, nuk dilte fare. Sesa ishte e rrënjësor ndërgjegjia kombëtare në mes të këtyre njerëzve, dëshmohej nga fakti se librat dhe gazetat kroate ishin të pranishme në Livno, qysh në vitet '40, ndërsa në vitin 1891, këtu u themelua një sallë leximi.

Në këtë sallë leximi u bëhej jehonë ideve të teorive të Hereder-it dhe Cantu-së, të cilat, nga një vështrim i shtypit të kohës, ishin zakonisht të përkthyer në gjuhën kroate, duke ushqyer kështu lëvizjen ilirike me idetë mbi gjuhën popullore dhe kombin. Kranjčevići, me origjinë nga fiset malësore kroate, uskotët, ndihej si në shtëpinë e tij, në Livno, vend i cili ka stimuluar në shumë këndvështrime, karakterin dhe krijimtarinë poetike, si dhe ka përfaqësuar për poetin një impuls të fortë për afirmimin e dashurisë për atdheun dhe zhvillimin e notave patriotike të veprës së tij, do të theksonte Marakoviç, duke vënë në dukje orientimin e tij të qartë politik prokroat, megjithëse njihte mirë e interesohej edhe për kulturën serbe. Këtë pohon edhe Slavko Ježić, më 1934, kur shprehet se Livno për Kranjčević-in, pati një rëndësi të madhe në formimin e tij njerëzor dhe artistic, pasi që cilësitë njerëzore dhe morale të malësorëve kroatë që banonin në këtë qendër, përputheshin plotësisht me prirjen dhe edukatën uskote, që ai kishte marrë nga familja e tij.

Marakoviç, sipas Sutës²⁰, pohon se Fishta, ishte miku "më i mirë" i Kranjčević-it në Livno; një miqësi që, me gjithë diferencën e moshës, që e menjëhershme dhe e shënjuar nga takime të shumta. Ai shkruan: "*Pranë kuvendit të Goricës, miku më i mirë i Kranjčević-it ishte Gjergj*

¹⁹ Po aty, faqe 29-31

²⁰ Po aty, faqe 31-33

Fishta, një frat i ri shqiptar, që për atëherë dhe për shumë vite të tjera, nuk guxonte të kthehej në atdhe për shkak të një gjakmarrjeje ... Më vonë Fishta kthehet në Shqipëri, ku bëhet shkrimtari më i madh i atij vendi". Tadiç, në artikullin e tij për dy shkrimtarët në Livno, shprehet: "Pjesën më të madhe të kohës së lirë Kranjčević e kalonte nën shoqërinë e Gjergjit, në dhomën e tij të vogël të manastirit, sigurisht me lejen e të rreptit, atit guardian. Kanë lexuar poezitë e njëri-tjetrit dhe kanë diskutuar për letërsinë, për ngjarjet në botën rreth tyre, si dhe në botën e madhe. Kranjčevići ishte 27 vjeç, kurse Fishta 21. Që të dy mjaft të rinj, entuziastë dhe plot me ideale, por të shtrënguar mjaft nga rregullat e ndryshme dhe nga detyrat, të cilave u nënshtroheshin në mënyrë të ashpër." Mlladen Brčić, në artikullin e tij: "Takimi i dy poetëve në manastirin françeskan të Goricës, pranë Livnos", 1982, shprehet se njohja në mes të dy të rinjve, ishte burim stimujsh të thellë nga këndvështrime të ndryshme: "Dihet që Silvije Strahimir Kranjčević, i ka dhënë Bosnjes pjesën më të çmuar të jetës së tij, periudhën me aktivitet profesional. Dihet gjithashtu, nga njohësit dhe ekspertët e letërsisë kroate se Kranjčevići, si mësues i Institutit Tregtar, ka qëndruar në Livno në dy raste, duke kaluar aty disa vite të jetës së tij. Por, janë të paktë ata që e dinë se ai, ishte shpesh i ftuar në manastirin françeskan të Goricës, pranë Livnos dhe se ishte mik i klerikëve që studionin teologji aty. ... Por, gjithsesi, duket se Kranjčevići ka qenë mik i përhershëm i këtij manastiri, sidomos edhe falë faktit se aty lindi e u zhvillua, miqësia e sinqertë në mes të dy të rinjve poetë të apasionuar, Kranjčevićit dhe fratit shqiptar, Gjergj Fishta".

Në 12 dhjetor të vitit 1892, Fishta shkruan një poezi në italisht, kushtuar Kranjčević-it. Brčić, po sipas Sutës²¹, nisur nga data e shkrimit të poezisë, thekson: "Duket se dy të rinjtë janë njohur menjëherë dhe që në takimin e parë lindi një miqësi, siç ndodh zakonisht në mes të të rinjve që ndajnë interesa të ngjashme; ata i afrohen njëri-tjetrit hapur dhe pa asnjë rezervë, apo përllogaritje. Kështu duhet të ketë ndodhur, besoj, edhe në mes tyre. Megjithëse kishin vizione të ndryshme për botën, kjo gjë nuk e pengoi aspak miqësinë e tyre. I bashkonte rinia, poezia dhe një dashuri e madhe për vendin e tyre të origjinës." Arsyetimi i Brčić-it, se dy të rinjtë janë njohur, vetëm dy muaj para se Fishta t'i dedikonte poezinë Kranjčević-it, e ka të vështirë të përballet me disa fakte të tjera, që flasin për mundësinë e njohjes, qysh herët, të poezisë së Kranjčević-it nga ana e Fishtës. Sipas dokumenteve të O.F.M., në vitin e tretë të teologjisë, 1891-1892; me një talent të veçantë në artet figurative, pikturë dhe arkitekturë, Fishta u parashikua nga Ministri i Përgjithshëm

²¹ Po aty, faqe 34-35

i Provincës, Fra Buzuku, që të dërgohej në Vjenë për shkollë grafike; siç dëshmon një letër e 10 tetorit 1891, dërguar gjeneralit të Urdhërit Françeskan në Romë. E dhëna interesante ka të bëjë me faktin se Fishta, merrte mësimë private vizatimi, që para tetorit të 1891-it, të cilat i kryente në shtëpinë e Marakoviçit, një mjedis familjar për Kranjçeviçin, qysh prej përvojës së parë boshnjake. Ja si shprehet ai: *"Kleriku shqiptar Gjergj Fishta, për të cilin Ju pata shkruar fort i nderuar Atë, që po studion këtu në Bosnje, në vitin e tretë të Teologjisë së Shenjtë, të cilin ja rekomandova Qeverisë sonë civile, për prirjen e tij ndaj artit të pikturës dhe që nga ana e tij ushtrohet me sukses, edhe privatisht në këtë art, prandaj, duket e nevojshme që fort e nderuara Qeveri, të jetë e gatshme ta marrë nën kujdesin e saj dhe t'i gjejë një vend në Austri, në shkollën grafike, në mënyrë që ai, të ketë mundësi të përsoset në këtë art. Nëse edhe Qeveria e sipërcituar do të ketë nga ana e saj të njëjtin opinion, unë, për të mirën dhe dinjitetin e fesë në atë rajon, do të kërkoj ta pregatis, nëse më jepet leje për ta bërë këtë gjë."* Për këtë arsye, mund të supozohet, së paku se Fishta, do të jetë njohur shumë herët me poezinë e Kranjçeviçit. Ndonëse Fishta nuk do të shkonte dot në atë shkollë arti, duke humbur mundësinë që të bëhej një piktor i madh, nuk besoj se ka shqiptar që mërzhitet sot për diçka të tillë, pasi ajo që do të bënte At Gjergji për Shqipërinë e shqiptarët, nuk mund të zëvendësohet me asgjë tjetër.

Ljubomir Marakoviçi, gjithnjë duke ndjekur hulumtimet e Sutës²², kur përshkruan vizitat e Fishtës në shtëpinë e tyre, tregon se, veç leksioneve të vizatimit që ai merrte tek i zoti i shtëpisë, dy poetët kalonin shumë kohë bashkë, duke ndarë edhe pasionin e përbashkët për fotografinë. Ai thotë: *"Fra Gjergji, studionte vizatimin me tim atë, ndërsa në shoqëri të Kranjçeviçit, kishte gjetur një aparat fotografik dhe së bashku provonin të shkrepnin fotografi amatore, pak a shumë të arrira, disa prej të cilave janë ruajtur në gjendje të mirë."* Ka edhe të dhëna të tjera, që flasin për mundësinë e njohjes më të hershme të Kranjçeviçit nga ana e Fishtës. Kranjçeviçi kishte përshtatur për nxënësit e shkollave, Faustin e Goethe-s dhe Marakoviçi flet për ndihmën që ai u jepte fretënve për organizimin e shfaqjeve, siç qe ajo e *"Mefisto-s"*, nxjerrë nga *"Fausti"* i Goethe-s. Pikërisht për këtë vepër Fishta do të shprehej në një artikull për 100-vjetorin e Goethe-s, se e ka njohur atë shumë herët, që kur ishte 19 vjeç, pikërisht koha e studimeve në Lívno, rreth vitit 1890. Ai shprehet kështu: *"Ishem 19-vjetsh, kur lexova sparit Faustin, kryevepren e Wolfrangut Goethe; edhe kaq shumë, ky poem i çuditshëm, pjesa e parë, mirret vesht; kaq shumë ma rrëmej me gjallni*

²² Po aty, faqe 36-37

poezije e vezullime dritet e bukurije, menden t'eme; saqi, per shum vjet e mbajta si typin estetik ma t'perkryemin nder ato literatyra moderne, qi un aso kohe kisha mujtë me njoftun; e pse shi rreth asajë kohe, kisha fillue me literatyre t'onën kombtare, kushtuqi, tash e ma vonë, u vejshe me kthye shqyp prej sish, copa qi ma fort thekshin fantazin t'eme; e sidomos, me natë e ditë, rrijshe tue lodhë menden, se si me e perfue edhe un vetë n'gjuhë shqype, nji veper aso dore; me nji Faust t'emin shqyptar, me nji Mafistofeles tjeter, me nji Margeritë shqyptare dhe me 'i mij t'tjerë djemen, shtriga e shtrigaj, gryka ferri e "net Valpurgë" e s'dij shka tjeter, por qi te tana u shprazshin, ta merr mendja, nper ajri."

Me siguri, pasioni për kulturën antike, për Romën, ka qenë një element i rëndësishëm, që i ka bashkuar të dy personalitetet. Marakoviçi flet për kulturën romake, si për një lloj filtri gati të brendshëm, që do të sendërtonte edhe poezitë patriotike të Kranjçeviç-it. Nëse analizohen hollësisht, poezitë e Fishtës ku përmendet Roma; lexojmë të njëjtim përjetim të lavdisë së dikurshme romake, si një vlerë përballë qytetërimit të sotëm, të njëjtin përjetim që lexojmë edhe në poezitë e Kranjçeviç-it, si për shembull "*Shëndeti i fundit i Hanibalit*". Sistemet e rrënojave të qytetërimeve antike (*aludohet për artin dekadent- shënim i EM*), si ai romak veçanërisht, janë simbol i karakterit ciklik të jetës, - shprehet studiuesja Blerina Suta,²³ - ku roli i shkrimtarit është më i privileguari për monumentin etiko-estetik që lë pas vdekjes, siç vihet re në poezinë

"Mbi vorr t'At Anton Zanonit, S.J.":
"... Do mure
T'shkatrrueme e t'hatata, sod mezi na flasin
Sesi 'i Çezar n'Romë zotnoi!
Gjithseshkafja mbi shekull
Des e kalon ...
... Sheklli gjithmonë ushquu burrnin e dijen...
Me njato kangë perligjë, qi mort nuk njofin:
E pra, stina mbi vorr t'tijna a shndrrue..."

Tradita letrare italiane e ka ushqyer konceptin poetik të dy shkrimtarëve me një vizion të ri poetik, që do të përfshinte, si poezinë patriotike, ashtu edhe atë sociale apo të mendimit filozofik. Përveç fakteve të larpërmendura, që hamendësojnë një njohje të hershme të Kranjçeviç-it, poezia që Fishta i kushton atij, është dëshmia më e qartë e një njohjeje në rrafsh të thellë e poetikës së autorit kroat, e cila do të kushtëzojë edhe përpunimin e poetikës vetjake të autorit shqiptar,

²³ Po aty, faqe 37-39

sidomos për sa i përket poezisë lirike.

I frymëzuar nga letërsia e Rilindjes kroate e veçanërisht nga pasuria e pashterrshme e poezisë popullore, nga e cila poetët e lartpërmendur thithën nektarin e poemave të veta, Fishta që atëbotë, nisi sprovat e para në poezi. "*Thuhet se vjershëtari len, gojëtar i bahet: e Fishta njëmend kishte lindë poet*" - shprehet At Daniel Gjeçaj²⁴ në monografinë e tij.

Siç na zbulon studiuesi Tonin Çobani²⁵, ndoshta është poezia më e hershme e shkruar nga Poeti Kombëtar, por sigurisht, poezia e parë e botuar e Tij, në nëntor të vitit 1899, disa muaj pas themelimit të shoqërisë "*Bashkimi*"; është poezia satirike "*Zoti Anselmo Lorecchio në Vlenë*", botuar në numrin e 11-të, viti 1899, të revistës "*Albania*", drejtuar nga Faik Konica. Kjo poezi është nënshkruar, me një nga pseudonimet që përdorte Fishta: "*e popullit*". Ndërsa po zhvillohej një kongres gjuhëtarësh, të cilët trajtojnë probleme të gjuhës shqipe dhe të Shqipërisë, Anselmo Lorecchio, ngrihet e propozon përfshirjen e Shqipërisë brenda Greqisë ose të një shteti më të gjerë, që do të mbante të njëjtin emër, duke ngacmuar mjaftueshëm sedrën kombëtare dhe ndjesitë artistike të Poetit Kombëtar, saqë përftohet poezia satirike e lartpërmendur.

Në vitin 1941, nga shkrimi i Lasgush Poradecit tek "*Shkëndija*", mësojmë se Fishta, jo vetëm e njohu personalisht Martiç-in, në kulmin e famës së tij letrare, por i kushton atij poezinë e parë në kroatisht, para vitit 1890, në kuvendin françeskan të Banja Lukas, Bosnje. Citojmë: "*Dhe s' do të ishte mbase pa vend, të shënoj këtu për të parën herë, se vjersha e parë që bëri Fishta, siç më thotë Atë Pal Dodaj, ishte një vjershë lirike dhe pikërisht në gjuhë sllave, kushtuar më të madhit poet boshnjak, Gregor Martiç, i cili duke e lëçitur dhe shqyrtuar, i shqiptoi autorit djalosh fjalët profetike, se ka për t'u bërë një poet i math në Shqipëri.*"

Zefi i vogël (që do të bëhej Fishta i Madh), qysh në moshë të njomë, siç dëshmon At Daniel Gjeçaj²⁶, në raste gëzimesh familjare, apo argëtimesh shoqërore, paraqitej para bashkëmoshatarëve të tij me vjersha gazmore, si ato kur imitonte mësuesin e tij të parë, At Leonardo de Martino-n. Hartimet fillestare të poetit të ardhshëm, tanimë me një horizont më të zgjeruar kulturor, ndonëse jo shumë të zhvilluara për nga forma dhe gjuha, janë shenja të qarta të atij zjarri si vullkan që ndrynte në zemrën e tij dhe që e ushqente përditë me mendje.

Prireja drejt poezisë, veç të tjerave, ishte edhe trashëgimi familjare. Në trungun familjar që buron nga Bib Paci, bie në sy edhe emri i Lazër

²⁴ Gjeçaj, Daniel: "Gjergj Fishta, jeta dhe vepra", faqe 24

²⁵ Çobani, Tonin: "Gjergj Fishta, fillimet letrare", faqe 28-31

²⁶ Gjeçaj, Daniel: "Gjergj Fishta, jeta dhe vepra", faqe 24-25

Gjonit, vëlla i Ndrec Gjonit e kushëri i parë i Simon Ndocit, gjyshit të poetit; i cili ishte një "poet-bejtexhi", i mirënjohur në Zadrinë e më gjerë. Po ashtu, vëllau i madh i poetit, i cili do të kishte një fund tragjik; sa herë që fliste, me dashje ose pa dashje, do të shprehej me vargje të rimuara. Gjithashtu edhe vëllau tjetër dhe motra, të cilat biografi i tij, At Daniel Gjeçaj, i njihte personalisht. Për vëllanë e madh, fjala që bie, thuhet se ishte aq satirik në "*këngë shpotie*", të cilat përdorëshin nëpër dasma, zakonisht pas lojës me kapuçë, sa që nuk mund t'ia kalonte askush. "*Ndër arsye tjera, ndoshta, edhe ky sarkazëm që një shkak ma tepër, për të cilin tërhoq mëninë e ndonjanit dhe shpejtoi vrasjen e tij në vitin 1899*" - shprehet Gjeçaj²⁷. Në fakt, vrasja e Çupit, ka ndodhur për një arsye akoma më banale. Disa dasmorë, po ktheheshin nga shtëpia e Markapalëve në Troshan, ku sapo ishin dendur me raki e me verë, për në fshatin e tyre në Kodhel. Duke kaluar pranë shtëpisë së familjes së Gjergj Fishtës, ata qëllonin me gur qenin, që po i besdiste me lehtë e tij. Lëngimi i qenit të plagosur, u dëgjua deri lart në kullë, ku njëri nga burrat e shtëpisë, Gjekë Zef Ndoci, i inatosur me veprimin e dasmorëve, qëllon drejt tyre, duke plagosur njërin syresh. Markapalajt, u ndjenë të fyer nga ky akt dhe u dërguan fjalë familjarëve të Fishtës, se u kishin gjakun borxh, pasi u kishin qëlluar mikun që kishte ngrënë bukë në shtëpinë e tyre. Këta, siç duket, nuk e morën seriozisht këtë kërcënim, deri sa u vra Çupi prej Palokë Gjinit, i cili u largua nga Zadrina dhe u vendos në Ulqin. Ndoshta, arsyeja pse zgjodhën të vrisnin pikërisht atë, ishte rastësore, apo ndoshta sepse ishte më i miri dhe në më të mirën moshë, siç ishte edhe tradita kur kërkohet të kryhej një vrasje për të vënë në vend krenarinë e cënuar, apo ndoshta, vërtet, Çupi i kishte cënuar me sarkazmën e tij dhe ata shfrytëzuan rastin të hakmerreshin. Në këtë rast, Gjeçaj do të kishte të drejtë, ndonëse në mënyrë të tërthortë.

Fishtës i bëri përshtypje të jashtëzakonshme vrasja e të vëllait, i hapi atij një plagë të thellë në zemër, nga e cila buroi lirika e përmendur "*Gjaksorvet*", e cila u botua për herë të parë te "Albania" e Faik Konicës, më 1901. Poeti, duke folur për vëllezërit e vet, thoshte: "*Ah, medet! Po të kishin pasë fatin tim, do të kishin dalë poetë ma të mirë se unë, do të ma kishin kaluar njëqind here.*" At Pashk Bardhi, edhe ky një ndër figurat më karakteristike të fretënve të Rilindjes; sa që gjallë, i ruajti me kujdes të madh dorëshkrimet e kolegut të vet, të cilat ruanin në vetvete, si fruti në bërthamë, atë lëndë poetike, që me kohë do të rritej e zhvillohej, aqsa degët e saj filaditëse do të përtërinin e gjallëronin mbarë Shqipërinë.

"Ndeja në Bosnje edhe edukimi fetaro-kulturor nga françeskanët

²⁷ Po aty, faqe 25

boshnjakë, që në dukë e në vepra personifikojshin idealin e Shën Françeskut, ndjenjat e aspiratat e popullit të tyre, - shprehet At Daniel Gjeçaj²⁸, - qenë një fat i madh për Fishtë. " Gjendja e popullit kreshnik të Bosnjes e Hercegovinës, nën sundimin e osmanëve; luftërat e pandara, kryengritjet e vazhdueshme dhe heroizmi tyre, deri në kurorëzimin e lirisë më 1878, ishin të ngjashme me ato të viseve tona, që prej shekujsh ishin në robëri. Historia e madhërueshme e françeskanëve në Ballkan e veçanërisht aty ku Fishta po studionte në atë kohë, në Sutiska e Livno të Bosnjes, popullariteti i fituar dhe dashuria e merituar, ndaj bijve të denjë të shenjtit nga Azisi, mbujtën në mendjen dhe zemrën e djaloshtit të ri prototipin e fratit shqiptar, që me aq madhtështi hyri në historinë e popullit e të kulturës shqiptare. Gjatë periudhës së studimeve në Bosnje, në shpirtin e Fishtës u ndez ajo shkëndijë, e cila do të shpërthente më vonë, në një zjarr të madh dashurie e veprimi, për liri e përparim të atdheut, për lumturim të fesë e lartësim të kombit.

Shembujt për këtë rrugë nuk i munguan, nga axhat (*ujaci*) zhgunë-murmë, siç i quante populli boshnjak fretërit e vet. "*Vini re - shprehet Gjeçaj²⁹, - se para popullit tonë, dashurinë për të cilin nuk e humbëm asnjëherë tash shtatë shekuj, por, me të hymë në burgje të errëta të historisë, me të mbajtëm pranga të ndryshkuna, me të gëzuem fitore, me të jetuam e vdiqëm, aqsa, për të meritue këtë epitete dashunie; ju, pinjollët e parë të Provincës Françeskane Shqiptare, do të fitoni mbiemrin, "tatat" e kombit tuaj fisnik. " Kështu do të dëshmojnë Bardhi, Mitroviçi, Gjeçovi, Mesi, Fishta etj; për atë që u thonin, edukatorët e profesorët boshnjakë studentëve shqiptarë. E vërtetë, - vazhdojnë këta themelues të Provincës Françeskane Shqiptare³⁰, - gjatë viteve që qëndruam në Bosnje, profesorët dhe drejtuesit tanë, na kishin caktue orë të detyrueshme për të folur shqip njani me tjetrin, si dhe shpesh na porosisnin: Mësojini po, gjuhët e hueja edhe gjuhen tonë, por kujdes se mos harroni gjuhën tuej; pse me ate e jo me një gjuhë tjetër, do t'i fitni popullit tuaj, me atë do të mësoni analfabetët, me atë do të predikoni të vërtetat e Ungjillit, me atë do të ngallni dashurinë ndaj atdheut, për atë gjuhë do të punoni, me atë do të shkrueni dhe me atë do të ndezni në zemrat e bashkëatdhetarëve tuej, dëshirën për liri e pamvarsi të vendit. Po ashtu na shtërngonin të paraqitshim punime filozofike edhe letrare në gjuhën amtare, apo fundja në latinisht. E në këto ese, Fishta ishte gjithmonë e gjithkund, jo vetëm i pari, por edhe më i shkëlqyeri.*

At Andria Buzuk, Provincial i Françeskanëve të Bosnjes, në kohën që po përshkruajmë, e lavdëronte shumë Fishtë, duke e konsideruar si

²⁸ Po aty, faqe 26

²⁹ Po aty, faqe 27

³⁰ Po aty, faqe 27

talent të jashtëzakonshëm. Në një punim, të mbajtur nga Gjergj Fishta në latinisht, mbi një argument teologjik me natyrë skolastike, bie në sy jo vetëm zgjuarsia e studentit të ri, por edhe zotërimi i lëndës, njohja e përsosur e latinishtes, italishtes dhe kroatishtes. Ky punim gjendet në Arkivin e Urdhrit Françeskan, pranë Santa Maria Mediatrice, Romë, shprehet At Daniel Gjeçaj³¹, kurse studiuesja Blerina Suta na sjell në vëmendje se një gjë e tillë përmendet edhe në "*Glasnik-un*" e provincës françeskane të Bosnjës, "*Viestni*" - i Andrija Buzuk, numri 10, nën emrin "*Juraj Enej Fišta*". Nuk duhet harruar se, periudha e studimeve në Bosnje, për At Fishtën dhe bashkëstudentët e tij shqiptarë, nuk ka qenë gjithnjë idilike. Ata gjendeshin në një vend të huaj dhe siç thonë të moçmit: "*Në vendin tënd s' të ha ujku, kurse në vend të huaj, të ha edhe miza.*" Dhe me të vërtetë, megjithë mikpritjen dhe mirëkuptimin e boshnjakëve, nuk u munguan studentëve tanë, as keqkuptimet e as përcmimet, deri edhe te përbuzja e xhelozia. Edhe më tepër shfaqeshin këto mosmarrëveshje ndërmjet grupeve të ndryshme etnike; atëbotë, kur studentët shqiptarë, të nxitur e të udhëhequr prej Fishtës, ndërmerrnin nisma të veçanta, si grup etnik më vete. Diçka e tillë shihet qartë, në një letër-ankesë, që studentët shqiptarë i drejtonin autoriteve kishtarë në kuvend.

Në këtë shkresë, të përpiluar dhe të shkruar nga Gjergj Fishta, me një kaligrafi të kujdesshme; përveç ankimit për vështirësitë e poshtërimit, fyerjet e sharjet, të cilat herë-herë manifestoheshin nga ana e studentëve sllavë, studentët shqiptarë, kërkonin të drejtën për të ngritur një shoqëri të vogël letrare. Në këtë shoqëri, - thoshin ata, - do të ushtroheshin në fusha të ndryshme të dijës e të artit, në degët letërsisë e në muzikë. Të përfshirë nga entuzjazmi i tyre rinor, mendonin se kjo shoqëri, kur të ktheheshin në Shqipëri, do të mund të bënte për kombin shqiptar, atë që kishte bërë "*Matica Hrvatska*, për Kroacinë e asaj kohe. Qëllimi kryesor i shoqërisë dhe i organit të shtypit, që mendonin të botonin; do të ishte lartësimi i letërsisë shqipe dhe përparimi i saj, duke ruajtur pastërtinë e gjuhës dhe moralitetin e dokeve zakonore.

Kjo letër që mban datën 20 shtator 1892, nënshkruhet nga dhjetë vetë, ku i pari është Fishta, renditur si më poshtë: Enea-Silvio-Giorgio Fishta, Lorenc Mitroviç, Bonaventura Gjeçaj, Severin Lushaj, Pashk Bardhi, Ejëll Paliç, Zef Mesi etj. Padyshim, emrat Enea e Silvio të Fishtës, ishin emra që ai i kishte zgjedhur për vehte, pa ndonjë akt anagrafik e prandaj si të tillë, zhduken dalëngadalë, duke ngelur vetëm emri: Gjergj.

³¹ Po aty, faqe 28

Studiuesja Blerina Suta³² na sjell një informacion edhe më të detajuar në lidhje me këtë temë; ajo ka zbuluar se përpara kësaj letre, janë edhe disa të tjera të ngjashme, njëra prej të cilave mban datën 3 prill 1891; e cila firmosej nga 14 nxënës (*Fishta firmoste nën emrin: Enea Silvje Georg Fishta*), të cilët deklarorin se nuk e njihnin At Agustino Čengiç, si mësues guide në sjellje. Në këtë letër thuhet: "*... Pasi jemi aq larg, saqë deri tani po vuajmë nga sjellja e tij e padrejtë dhe e paarsyeshme; nuk mund as që të vuajmë më. Dhe përtej Definitorio-s, siç shihet, lejoni që të merret një vendim: ai nuk mund të jetë më mësuesi ynë dhe ne nuk jemi dishepujt e atij. Në drejtimin e tij, vuajmë si fizikisht, ashtu edhe moralisht.*" Përgjigjia e At Čengiç për Atin Definitor, që mban datën 4 maj 1891, e përshkruan gjendjen me pamjen e një manastiri ku duhet vënë rregull, sidomos ndër shqiptarë e malësorë boshnjakë (plehanezë). Është interesante, se në mes të grupit të studentëve rebelë, At Čengiç, mbulon me përgjegjësi pikërisht Fishtë, si drejtues dhe frymëzues i gjendjes. Ai shprehet: "*Disa prej tyre, parapëlqenin ta kalonin ditën duke pirë duhan, në vend që të sistemonin tonsurën (korone). Mes të të gjithëve, spikasin shqiptarët, të cilët, ashtu si edhe të tjerët, komandohen nga fra Juraj (Gjergj) Fishta, djall me pamje njeriu, natyra e të cilit ishte të tallej e të përqshte, si dhe të nëpërkëmbte çdo rregull e ligj; ... për këtë arsye nuk ndenja duarkryq, po m'u desh të qortoj e të lutem, ndonëse pa sukses, se mungesa e bindjes ende vazhdonte, sidomos falë Fishtës.*"

Episodi që i ndërlikoi më tepër gjërat, - shprehet Suta³³, - është emblematik. Fishta dhe shokët e tij, kishin varur portretin e Skënderbeut, në murin përballë hyrjes së muzeut, gjest ky, jo fort i mirëpritur nga një pjesë e nxënësve boshnjakë, që përfundon me fshehje të portretit, siç vihet re në letërën e Čengiç-it, i cili thotë: "*Besomëni At, që në 10 vjet mësimdhënie dhe edukim, nuk kam pasur kurrë degjenerime të gjithanshme, si këto të këtyre arnautëve dhe të disa rishtarëve. Sapo mbërritën, filluan të sulmojnë Krajinoviç-in, për shkak të karakterit të tij të butë dhe, nëse ai nxehej dhe përpiqej t'ju përgjigjej njëfarësoj, ata e sulmonin edhe më shumë. Gjithashtu arnautët, kishin vënë në kornizë një portret të Kastriotit dhe, duke dashur ta varin në murin përballë muzeut, në vend të fra ...; dhe nëse spostohej prej nxënësve tanë në një vend tjetër, ata e kthenin prap aty ku donin. Gjithsesi, meqë Fishta tallej dhe çfarë nuk thoshte për çdo gjë, si me tekstet liturgjike, ashtu edhe me rregullat etj.; një nga nxënësit tanë, e fshehu atë portret. Atëherë ata shpërthyen dhe ktijuan një rrëmujë të paparë në mes të nxënësve.*"

³² Suta, Blerina: "Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës", faqe 19-20

³³ Po aty, faqe 20-22

Meqë unë nuk dija asgjë për këtë ngjarje, kur ma treguan, i kërcënova të gjithë, që të tregonin kush e kishte fshehur portretin dhe atëherë, njëri prej tyre më tregoi se ku gjendej, por, meqë nuk mund ta tradhëtoja nxënësin, portreti ngeli edhe sot, aty në të njëjtin vend, kurse Fishta bashkë me një grup shokësh, vazhdonte të provokonte, siç bën edhe sot e kësaj dite. ... Nga ana tjetër, Fishta është një nxitës i keq shpirtërash, i padërgjuashëm e kokëshkëmb, që ndiqet nga shumë arnautë dhe biles, edhe nga ndonjë prej tanëve. Sillet në formën më të keqe të mundshme, saqë nuk arrij t'i rri dot mrapa, sidomos në Seminar, pasi, nëse provoj t'i them diçka, ai do të përgjigjet 50 herë më keq dhe do të mundohet të nxisë konflikt, gjithmonë nën frymën e kundërshtimit; nuk ka as besim as fe, me një fjalë, nuk vlen aspak."

Konflikti vazhdon edhe përgjatë vitit shkollor 1891-1892, siç dëshmojnë letrat e të dyja palëve, dërguar Urdhërit në shkallë lokale e më lart. Këtu, studiuesja Blerina Suta³⁴, përmend letrën e 20 shtatorit 1891, me të dhëna interesante që konfirmohen edhe nga studiuesi tjetër, Tonin Çobani³⁵, ku thotë se Fishta dhe shokët e tij deklarojnë se do të pranenin më mirë të kalonin në laicitet, sesa të njihnin si mësues lektorin A. Çengiç; i cili sipas tyre, thëllon hendekun midis grupit shqiptar dhe atij boshnjak: *"I nderuar At. Më 19 të këtij muaji, filluam mësimin dhe pamë se Çengiç, ishte sërish Magistro morum (mësues i sjelljes). Mirëpo, ai dhe Guardiani, na trajtojnë si të mos ishim anëtarë të kësaj familjeje religjioze. Prej tri javësh, Çengiç nuk flet me ne asnjë fjalë. Në mensë, ulen para nesh, që jemi të vitit të tretë të teologjisë, edhe ata që sapo kanë filluar teologjinë. Sapo nisi shkolla, thirri të gjithë boshnjakët për të parë muzeun, kurse për ne të tjerët tha: Ç'më duhen ata?! Tani, na ka përgojuar në të gjithë Bosnjën, aqsa një boshnjak kishte thënë se provinca nuk ishte e kënaqur pse mori shqiptarët. Për këto gënjeshtër e shpifje, ne Ju themi sinqerisht se, nëse Çengiç do të vazhdojë të jetë Magister morum, ne të gjithë jemi të gatshëm të kalojmë më mirë në laicitet, sesa të njohim atë për mësuesin tonë. Gjithashtu, jemi gati ta bëjmë këtë gjë, nëse provinciali do të lejojë ndarjen që Çengiç ka bërë, në mes nesh e boshnjakëve. Por, para se të arrijmë në këtë pikë, ne do të bëjmë gjithçka është e mundur, pranë Gjeneralit e Qeverisë, për ta rregulluar çështjen. Këtë do ta bëjmë edhe atëherë, nëse Ju do të hiqni dorë nga çdo përkujdesje atërore ndaj nesh (Zoti na ruajtë!). Në gjuhë, Ju lutemi të mos na braktisni në nevojën tonë. Nuk e shihni që na kanë braktisur të gjithë?! Provinciali ka përzënë nga ky kuvend, të gjithë boshnjakët që nuk kanë shkuar mirë me Çengiç-in. Nëse Ju na*

³⁴ Po aty, faqe 22-24

³⁵ Çobani, Tonin: "Gjergj Fishta, fillimet letrare", faqe 80-81

braktisni, nuk do të kemi tjetër mik në botë, përveç Zotit. Na lajmëroni menjëherë për mendimin Tuaj. Duke Ju përshëndetur sërish dhe duke Ju puthur dorën, Ju lutemi të tregoni durim me ne dhe të mos humbisni dashurinë Tuaj ndaj nesh, teksa po Ju themi të vërtetën. Livno-Gorica, 20 shtator 1891. Bijtë Tuaj në Krisht: Fr. Gjergj Fishta, Anton Lushaj, Pjeter Gjadri, Lorenc Mitroviç, Engjël Paliç, Bona(ventura) Gjeçaj." A nuk shihen këtu, përveç kulturës së gjerë, edhe shenja të konsoliduara të etikës dhe diplomacisë ?!

Vlen të theksohet për lexuesin e sotëm, se shprehja "*të kalojmë në laicitet*", nënkupton të kaluarit në një degë tjetër në atë kuvend, ku nuk përgatiteshin fetërit e ardhshëm, por thjesht diplomoheshin në fusha të ndryshme të shkencës e kulturës. Nëse do të kalonin atje, nuk do ta kishin më lëndën mësimore "*moribus*"/(sjellje), pasi atë e bënë vetë klerikët e ardhshëm. Gjithashtu, duket sikur ka një mospërputhje të emrave që jep Gjeçaj, me ato që na jep Suta, për firmosësit e letrës; por unë besoj se është vetëm çështje e formave të ndryshme të shkrimeve të njëjtimit emër, apo emrave të ndryshëm që ata kanë përdorur.

Episodi i fundit i përplasjes ashpërsohet si në tone, ashtu edhe në përmbajtje, siç e tregon letra³⁶ e 4 majit 1892, ku të rinjtë shqiptarë me forcë drejtësie, mbi shpifjen që u është bërë, duke i quajtur "*epikurianë*" dhe "*platonikë*"; si dhe përgjigjia e Patër Çengiç, e datës 10 maj 1892, i cili vazhdon ta konsiderojë Fishtën si nxitësin kryesor të opinionit negativ mbi punën e tij. Pas shkëmbimit të letrave në nivele të ndryshme, deri edhe te qendra në Romë, Urdhri e zgjidhi çështjen me zëvendësimin e Çengiç, me një mësues të ri, Kataviç, i cili, me një letër të 23 majit 1892, të cituar nga historiani Vrgoc; e interpreton shkakun e vërtetë të konfliktit, në mes të shqiptarëve dhe Çengiç-it, si: "*një intolerancë reciproke, që u transformua në urrejtje e ushqyer nga pasioni*".

Ky incident është shumë domethënës, për të treguar ndjeshmërinë e Fishtës, ndaj një modeli kulturor, që do të përshfaqet më vonë në veprën e tij. Skënderbeu do të ngelet një figurë kyçe dhe qëndrueshme, e idealit të lirisë për Fishtën. Nuk është e rastësishme që emri i pagëzimit "*Josephus*" (Zef), i 24 tetorit 1871, do t'ia lërë vendin emrit "*Joannes*" (Gjon), siç dëshmon një akt i 08 dhjetorit 1890; si dhe më pas, do të marrë solemnisht dhe përfundimisht emrin e shugurimit: "*Georgius, Silvius, Aeneas*"; Gjergj, për nder të Gjergj Kastriotit dhe Enea-Silvio, në nderim të Enea-Silvio Piccolominit, Papa Pio II, i cili ndihmoi Skënderbeun në fushatat e tij anti-osmane. Viti shkollor 1891-1892, kur emri i Fishtës përfshihet në konfliktet brenda manastirit, përkon me

³⁶ Suta, Blerina: "Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës", faqe 25-26

njohjen dhe miqësinë e tij të thelluar, me Silvinje Strahimir Kranjčević.

Ndryshe nga sa thotë At Daniel Gjeçaj, për rezultatet e dëftësive shkollore të Fishtës, studiuesja Blerina Suta³⁷, në veprën e saj "*Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës*", mbështetur në të dhënat e nxjerra nga Arikivi i Provincës Boshnjake të Sarajevës, na sjell të dhëna të reja mjaft interesante, një pjesë e të cilave janë përmendur edhe nga historian françeskan Mirko Vrgoç, në punimin e tij për historikun e kolegjit të Livno-s, 1858-1905. Rezultatet e dëftësive për periudhën 8-vjeçare të studimit në Bosnje, përkatësisht; të shkollës përgatitore të Guca Gorës, të shkollës për filozofi në Krajleva Sutjeska dhe të fakultetit teologjik në Livno, shpalosin jo vetëm profilin e formimit bazë të Fishtës, por edhe anë të personalitetit të tij të hershëm, që do të përshfaqet në veprat e tij poetike, në të ardhmen.

Në një dokument të datës 07 mars 1892, në Sarajevë, me firmë të ministrit të provincës boshnjake, Andrea Buzuk, që gjendet pranë Arkivit Historik të Urdhrit Françeskan, në Romë; jepen lëndët që kryheshin në të tri nivelet e studimit të shkollave në manastiret e provincës boshnjake, për nxënësit që përgatiteshin për t'u shuguruar si meshtarë. Prania dhe niveli i studimeve të rishtarëve shqiptar, në mes të tyre edhe Fishtës, pasqyrohet në dokumentet e manastireve të Guca Gora-s, Krajleva Sutjeska-s dhe Livnos.

Më 1886, Fishta gjendet në manastirin e Guca Gora-s dhe një nga dokumentet e para ku përmendet emri i tij, mban datën 15 tetor 1886, në të cilin saktësohen dhe detajohen të dhënat e një dokumenti paraprak të 6 tetorit për gjashtë nxënësit e ardhur nga Shqipëria³⁸. Sillen gjeneralitetet e Gjergj (*Juro*) Fishtës, data e lindjes dhe emri i pagëzimit *Zef (Josip)*. Pesëmujori i parë i vitit shkollor 1886-1887, nga relacioni i datës 11 shkurt 1887, ka një klasifikim të progresit në kulturë dhe në karakter, të rishtarëve dhe klerikëve. Fr. Joannes (*Gjon*) Fišta, rezulton i shkëlqyer (*eminens primus*), vlerësim që e ka në lëndët: Doktrina e Fesë/ *Doctrina Religions*, Sintaksë Latine/ *Syntaxis Latina*, Gramatikë/ *Gramatika*, Aritmetikë/ *Arithmetika*, dhe Analizë/ *Analysis*. Po ashtu, në këtë relacion dallohen edhe vlerësimet: shkëlqyeshëm/ *eminens primus* në Impenjim/ *Occupationes*, mirë/ *bona* në Aftësitë/ *Capacitas* dhe në Zell/ *Diligentia*, si dhe "asgjë për t'u qortuar"/ *irreprehensibilis* në Sjellje/ *Mores*. Relacioni i fundit të vitit shkollor 1886-1887, për rezultate në letra e në sjellje, i datës 8 korrik 1887, konfirmon ecurinë e shkëlqyer të semestrit të parë, për Fr. Joannes Fišta. (*Nuk është gjetur një motiv i arsyeshëm, pse Fishte në atë kohë, kishte zgjedhur të mbante*

³⁷ Po aty, faqe 12-14

³⁸ Po aty, faqe 14-19

emrin Gjon - shënim i EM).

Viti akademik 1888-1889 e gjen Fishtën duke studiuar për Filozofi, në Krajleva Sutjeska dhe dëftesa e semestrit të parë, që mban datën 28 shkurt 1889; pasqyron rezultatin shkëlqyeshëm/ *eminens primus*, të Fr. Joannes Fishta; në lëndët Metafizikë/ *Metaphysica*, Shkenca/ *Mathesis*, Histori Universale/ *Historia Unives(alis)*, Fizikë/ *Physika*. Kolona e gjuhës gjermane, e plotësuar për disa nga nxënësit që kishin bërë gjermanisht, rezultoi të jetë bosh pranë emrit të Fishtës. Pra ai nuk e kishte gjermanishten gjuhë studimi, megjithëse, ndoshta, ai dinte të komunikonte në gjermanisht, e konfirmuar kjo prej At Zef Pllumit, në parathënien e ribotimit të "*Lahutës së Malcis*", më 2006; pasi Bosnja e kohës së studimeve të Fishtës, qeverisej nga Austro-Hungaria. Bashkëkohësit e Fishtës, si studentë në Bosnje, konfirmojnë shpesh se ata konsultoheshin me të, për detyrat e lëndës së gjermanishtes. Për semestrin e dytë, dëftesa e datës 26 qershor 1889, shënon rezultatin shkëlqyeshëm/ *eminens primus*, për Fr. Joannes Fishta në lëndët; Metafizika Speciale/ *Metaphysica Spec(ialis)*, Histori Universale/ *Historia Universalis*, Fizikë/ *Physica*, Matematikë/ *Mathematica*, Prozodi Latine/ *Prosodia Latina*.

Dokumentet arkivore të viteve 1890-1893 flasin për një grup shqiptarësh, të cilët u pranuan në tetor të vitit 1890, në kuvendin e Shën Pjetrit e Shën Palit, në Gorica të Livno-s, të studionin për teologji: Joahannes Fishta, Antonium Neucsiati, Josephium Bliniscti et Angelum Paliç. Rezultatet e vlerësimeve, në të gjitha këto vite, flasin për formimin e shkëlqyer të fratit shqiptar, Georg Silvius Fishta; të dyja dëftesat e vitit të parë, 10 shkurt 1890 dhe 27 qershor 1890, e klasifikojnë Fishtën të shkëlqyer/ *eminens primus*, në të gjitha lëndët; Histori Kishtare/ *Historica Ecclesiastica*, Hyrje në Dhjatën e Re/ *Introductio in N(uovum) T(estamentum)*, Hermeneutikë Biblike/ *Hermeneutica Biblica*, Ekzgjegjëzë Biblike/ *Exegesi Biblica*; dëftesat e vitit të dytë, të datave 4 shkurt 1891 dhe 27 qershor 1891, e shohin gjithashtu në mes të të shkëlqyerve (*eminens primus*), në klasifikimet e të gjitha lëndëve: Teologji Dogmatike/ *Theologia Dogmatica*, Hyrje në Dhjatën e Re/ *Introductio in N(uovum) T(estamentum)*, Ekzgjegjëzë/ *Exegesi*, Gjuhë Hebraike/ *Lingua Hebraica*; klasifikimi i vitit të tretë, që mban datën 21 qershor 1892, e sheh sërish klerikun Georgius Fishta, me vlerësimin shkëlqyeshëm/ *em(inient) prim(us)*, në të dy lëndët, Dogmatikë e veçantë/ *Dogmatica Spec(ialis)* dhe Teologji Pastoriale/ *Theologia Pastoralis*; i njëjti vlerësim përsëritet edhe në vitin e fundit, në dëftesat e datave 6 shkurt 1893 dhe 21 qershor 1893, për dy lëndët, Teologji Morale/ *Teologia Moralis* dhe E Drejtë Kanonike/ *Jure Canonike*.

Mirëpo ndërkohë fillojnë të evidentohen edhe vlerësime të tjera. Dëshmia e fundit e periudhës së studimeve në Livno me 6 shkurt 1893, sjell dy vlerësime shkëlqyeshëm/ *izvrstno*, në Filozofi Morale/ *Filosofia Moralka* dhe në E Drejtë Ekleziastike/ *Crkveno Pravo*; si dhe vetëm mjaftueshëm/ *dosta dobro*, për lëndën Sjellje/ *Çudorje*. Ndryshe nga vlerësimet e shkëlqyera, për lëndët e formimit bazë, vlerësime mesatare apo të dobëta, për zellin në lutje dhe për sjelljen e Fishtës, gjenden qysh në një raport paraprak të periudhës së Krajleva Sutjeska-s; ku flitet për gjendjen morale dhe intelektuale, si dhe progresin e studentëve të Institutit Filozofik të Sutjeska-s, për vitin 1889, apo në klasifikimin e vitit të parë në Livno, më 27 qershor 1891; ku, përveç vlersimit shkëlqyeshëm në lëndët teologjike, ka edhe një vlerësim kalueshëm/ *suficiens*, në Sjellje/*Moribus*. Këto vlerësime bëhen plotësisht negative, gjatë qëndrimit në Livno, ku mësues i lëndës Sjellje/ *Moribus*, magister morum, ishte Fra August Čengiç; mardhëniet me të cilin i shtjelluam pak më sipër.

Në një Relacion/*Relatio*, mbi jetën dhe mënyrën e të vepruarit të nxënësve dhe fretërve të teologjisë, i datës 25 mars 1891, i firmosur nga August Čengiç; jepen këto vlerësime për Georgius Silv(io) Fishta: Të qenit i dëgjueshëm/ *Ob(o)edienta*, vlerësimi "me hope"/ *non sine tergiversatione*; Devocion/ *Devotio*, vlerësimi "kalon me të shtyrë"/ *vix absolvibilis*; Recitim i Uficeve Hyjnore/ *Recitatio Divini Officii*, vlerësimi "neglizhent"/ *negligiens*; Zelli në studim/ *Diligentia in studio*, vlerësimi "i pakët"/ *mediocre(is)*; Zelli në praktikim feje/ *Diligentia in devotione*, vlerësimi "zero"/ *nulla*; Rregulla/ *Regula*, vlerësimi "i pakujdesshëm"/ *neglecta*; Mënyra e të jetuarit/ *Conversatio*, vlerësimi "qortueshëm"/ *reprehensibilis*; Sjellje/ *Mores*, vlerësimi "në kufinj të të pranueshmes"/ *utcumque boni*. Vlerësimi aspak i shkëlqyer i Fishtës në Sjellje ndriçon një anë kontrastuese të karakterit të tij, të pakompromis, e cila do të theksohet edhe më shumë në vitet në vazhdim. Por nga ana tjetër, vetëm një mendje e ngarkuar me paragjykime nacionaliste dhe pedantizëm skolastik, si ajo e magister morum, Fra August Čengiç, mund të vlerësonte Fishtën, me zell të pakët në mësim. Pak a shumë, ky konflikt, ishte në mes të një pedanti dritëshkurtër dhe gjenit të ardhshëm, të cilit i rrinte ngusht zhguni i fratit dhe jo më ndonjë "kostum" tjetër.

Edukimi fillestar i marrë nga Leonardo de Martino, përputhej plotësisht, me linjat e përgjithshme të edukimit në Bosnje, kështuqë Fishta dhe shokët e tij u rritën e u brumosën plot entuziazëm, me ato parime fetaro-kombëtare, të cilat, që nga ajo kohë e më pas, do t'i kishin ideal të jetës e të veprave të tyre. Me këto ideale dhe me këtë formim

kulturor, Gjergj Fishta kthehet në Shqipëri, së bashku me të gjashtë shokët e tij, me të cilët kishte nisur këtë udhëtim në fushën e edukimit, dijës dhe të formimit kulturoro-teologjik.

At Daniel Gjeçaj³⁹ na sjell në monografinë tij, një letër, të cilën, drejtori i Kolegjit të Troshanit, At Lorenc Mihaçeviq, ia drejton sivëllaut të vet, At Marçelino da Civezza, në atë kohë superior i Misionit të Françeskanëve në Shqipëri, (*Provinca nuk ishte krijuar ende* – shënim i EM). Në këtë letër, që mban datën 22 shkurt 1893; Mihaçeviq, ndër të tjera thotë:

Shqipëria pati një fat të madh këtë vit, pasi pikërisht sivjet, mbaruan studimet filozofike e teologjike, gjashtë djelmoshat tanë françeskanë shqiptarë; lulet e para dhe frytet e pjekura të Kolegjit Serafinik të Troshanit, hapur për herë të parë më 1881. E pamundur që ta imagjinosh, shumë i dashuri Atë; se me sa dëshirë e shpresë, i priste populli shqiptar këta bijtë e vet, këta bij që do të ndezin ndër bashkatdhetarë të tyre, flakën e dashurisë hyjnore, s'bashkut me dritë e Ungjillit. Kanë për të qenë, shpresojmë, apostuj të qytetarisë kristiane; veçnisht nëse kanë për të hedhur shtat në fe, dije, specialitete dhe në art. Pikërisht për këtë qëllim, e jo për tjetër, këta djelmosha lane vendin e tyre e shkuan në Bosnje; ku Urdhëri ynë Françeskan, u kujdes për t'ua plotësuar nevojat. Ndërkaq, këta të rinj, kanë për të qenë nderi e lumturia, jo vetëm e Shqipërisë, por e mbarë Urdhërit Serafinik në botë. Edukimi që kanë marrë, nga sivëllezërit boshnjakë, bashkëstudentë apo mësues; nuk kishte si të bëhej më i mirë, edukimi fetar ishte njëkohësisht edhe atdhetar, ashtu siç e praktikojnë kudo françeskanët. Dhe me të vertetë, sa t'i shohësh, të lënë të kuptosh, se atë edukatë e kanë bërë normë të jetës së tyre; dhe unë besoj se këta, kanë për të shkëlqyer porsì drita e agimit, në dobi të vendit të tyre dhe me anën e apostullimit të shenjtë, do të shndërisin porsì yje në amëshim të pasosur.

Ashtu si Heroi Kombëtar i Shqipërisë, e mbrojti truallin e të Parëve, me shtatë dorë kundër barbarëve otomanë; ashtu edhe këta, me anën e dijeve dhe forces së virtyteve, me fuqinë e fjalëve të shembullit personal, kanë për të qenë vazhdues të atij misioni kombëtar dhe ka për ardhur koka kur, edhe për ta do të thuhet se, me gjeneratën e tyre atdheu kaloi një periudhë të lavdishme dhe një zenit kulturor. E verteta është se kanë lënë Bosnje, tek profesorët dhe bashkëstudentët që jetuan aty, përshtypjet më të mira dhe kanë manifestuar një sjellje shembullore; aqsa, ditën që do të largoheshin prej aty, e gjithë familja rregulltare e Livnos, doli t'i përcillte, me lot në faqe.

Të të gjashtë flasin perfekt në katë gjuhë: shqip, latinisht, italisht

³⁹ Gjeçaj Daniel: "Gjergj Fishta, jeta dhe vepra", faqe 30-32.

e kroatisht; si dhe disa prej tyre flasin edhe frëngjisht e gjermanisht, njohin mire muzikën gregoriane dhe artet figurative, ashtu siç dinë edhe të këndojnë, gjë kjo shumë e dobishme për raste festash e kremtimesh fetare.

Siç shihet, letra është një dëshmi e qartë për dijet, njohuritë dhe edukimin që kishte marrë Fishta dhe bashkëmoshatarët e tij gjatë periudhës së studimeve në Bosnje, ashtu siç është edhe një profeci, të cilën këta pinjollë të trungut ilir, të ushqyer me "limfë" bjeshkësh boshnjake, do ta përmbushnin pikë për pikë në të ardhmen. Mihaçević, njeri me një talent të rrallë e shumë largpamës, ai që i dërgoi si studentë në Bosnje, pa tek këta djalosha shqiptarë, gurët e themelit dhe shtyllat e asaj ndërtese, që do të lartësohej nga duart e tyre e që, me kalimin e kohës, do të ripërtërinte lavdinë e dikurshme të françeskanizmit në Shqipëri, duke bërë që aty e mbrapa, ku ishte frati, ishte edhe flaka e Ungjillit, vatra e kulturës dhe pishtari i atdhedashurisë.

Këta ishin brezi i parë i priftërinjëve dhe i françeskanëve shqiptarë, të shkolluar e të diplomuar edhe në fusha të tjera civile; ndonëse do të dilnin edhe plot të tjerë, askush nuk do të ndriçonte si këta, ndoshta pse me ta ishte Gjergj Fishta apo, ndoshta, pse asnjë rreze drite nuk krahasohet me rrezen e parë të agimit pranveror.

Engjëll ÇEKA

HISTORIA E FAMILJES ÇEKA (SUMMA)

Epiteti “sumë” ekziston si fjalë e rrallë dialektore në folklor dhe ka kuptimin “majë kodre”, ndoshta edhe nga burimi latinisht “majë e lartë” (summa), apo me një kuptim tjetër, kësaj radhe ushtarak, autoriteti komandë e lartë (summa autoritas).

Bajraku i Sumës në zonën e Postribës mund të jetë krijuar para shekullit XVI dhe mbështetet në fillim mbi bazën e lidhjeve të gjakut, duke përfshirë njerëz të një fisi. Udhëheqja e tij i përkiste krerëve të fiseve, ndërsa udhëheqja e forcave ushtarake njërit prej djemve (zakonisht të tretit) të krerëve të fiseve, i cili, si mbajtës i flamurit në ekspedita luftarake, quhej bajraktar (flamur = bajraktar).

Suma ka pasur lagjet e saja si: Gurë-Dajçe, Bukmina, Pergjon, Dedgjon, Vatnikaj, Bojej, Likaj.

Në listën e anzhuinëve, sado që moshatar me fise të tjera, duke u nisur nga emërtimi latin, fisi i Sumajve u mbajt si i huaj edhe pse në këto shekuj këtij fisi nuk mund t’i mohohej as përkatësia shqiptare dhe as rëndësia historike.

Disa nga fiset e vjetra në Shkodër që gjallërojnë në jetën tonë a në dokumente, janë Logorecët dhe Mazrekët (1304), Sumejt (1322), Muzhanët (1274), Duodaj (1700), Miletaj (1471), Shirokajt etj.

Sumejt kontribuan për ta mbajtur gjallë e zgjuar të fortë idenë e

Shqipërisë, madje të një Shqipërie të vetësunduar me forcën e pjekurisë së tyre, me virtytet e racës dhe shëmbëlltyrën perëndimore të një Shqipërie të mëkëmbur, të zhvilluar dhe plot dinjitet.

Shuflaj mbështetet në dokumentet e mesjetës, duke e nxjerrë familjen Suma si familje patriote nga qyteti i Drishtit (Drivastor-Antica) me kryevend Sumën. Duke filluar nga shekulli i XIV deri më sot, herë direkt, herë indirekt, fisi i Sumajve del me origjinë shqiptare e fisnike nga Drishti.

Në punimet e Prof. Shuteriqit, Dom Nikoll Summa përmendet si ambasador i Gjon Kastriotit në Raguzë.

Me datën 30.12.1378 në Raguzë na del përsëri "Patrus Summa Arbanensis". Ajo që i vë vulën shqiptarisë së fisit Suma për këtë periudhë është Papa Nikolla V, i cili në 20.09.1451 emëronte Nunc Apostolik françeskanin shqiptar Eugjen Summa.

Pra, në këtë trevë historike bën pjesë dhe aktiviteti i familjes ÇEKA (SUMMA).

Sipas studiuesit shkodran Emil Shiroka, i cili është në fisin e Shirokajve (ku bën pjesë dhe Tina Mikel Çeka, gjyshja jonë), është nxjerrë një material i plotë për historinë e familjes ÇEKA.

Kur turku e pushtoi Shkodrën me kala (jo ku është Shkodra sot, por afër lumit Buna dhe afër liqenit të Shkodrës), shkodranët, burra dhe gra, fëmijë dhe pleq ikën në Itali, ndonjë edhe në malësi, përveç një pasaniku të madh, të cilit Venediku ia kishte ngjitur emrin ÇEKA, që do të thotë "qarë". Për të mos e humbur gjithë atë pasuri të madhe që kishte, ai e ndërroi besim dhe u bë mysliman. Mbas 5 viteve Veziri i Shkodrës (turk) e detyroi që të shkonte në Qabe tek varri i Muhamedit për t'u bërë haxhi. Pasi shkoi, ky u bë haxhi dhe erdhi në Shkodër me emrin Haxhi Çeka.

Në këtë kohë ishin dy vëllezër në fshatin Sumë. I madhi quhej Sokol (Kol) dhe tjetri Pjetër. Veziri kishte të dhëna se këta dy vëllezër ishin prej një familjeje të mirë dhe bajraktarë. Dërgoi t'i thërrisnin që të vinin në Shkodër. Pjetri nuk erdhi, ndërsa Sokoli erdhi dhe Veziri i premtoi shumë pasuri dhe tokë, por ai duhej të kthehej në mysliman. Sokoli e pranoi dhe Veziri e mbajti afër vetes së tij. Mbas do kohësh Veziri i tha që të shkonte në fshatin Sumë për t'ia mbushur mendjen Pjetrit dhe gjithë fshatit që ta mohonin besimin me të mirë ose me detyrim.

Pra, sipas fakteve, rezulton se nga dy vëllezërit, Pjetri dhe Sokoli, Sokoli e ndërroi besimin dhe u kthye në fenë myslimane. Kjo shihet tek pema gjenealogjike e familjes Summa (Çeka), prej së cilës u nda një degë e saj që quhet Sokolej e fesë myslimane. Dy degë me dy fe kanë një trung të përbashkët, ndaj ne dy familjet ende sot e quajmë njëri-tjetrin

kushëri. Në një bisedë me të moshuarin Xhelal Sokoli, ai e kujton nga të parët e tij se Filip Summa (Çeka) e quante e Isuf Sokolin me epitelin "apë"-axhë. Ata të dy ishin nga një trung familjar dhe bashkëluftëtarë në kauzën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në fund luftuan së bashku për mbrojtjen e Ulqinit. Edhe ne, si pasardhësit e familjes Suma dhe Sokoli e konsiderojmë veten kushërinj dhe në takimet apo bisedat e ndryshme që kemi midis nesh, thirrëmi me emrin kushëri.

Kur e kuptoi se vëllai i tij Sokoli e kërkonte për ta detyruar që të mohonte besimin me të mirë ose me të keq, Pjetri u arratis nga fshati i tij dhe për 10 vjet qëndroi i fshehur ndër miq të tij në malësi. Pas 10 viteve ai u mërzi me jetën e keqe që bënte nëpër male i fshehur, me shumë shpenzime e me rrezik vdekjeje dhe vendosi që të shkonte në Shkodër, drejt e në shtëpinë e Haxhi Çekës, duke e ditur se ky ka qenë katolik dhe është kthyer në mysliman. Ai i tha se kishte shkuar për t'i rënë në qafë dhe në qoftë se kishte besë ta shpëtonte nga vëllai i tij, Sokoli, i cili donte ta detyronte që ta mohonte fenë, ose përndryshe do ta vriste. Haxhi Çeka i tha që të rrinte tek shtëpia e tij se as kush nuk do ta vriste dhe as besim nuk do të ndërronte.

Pjetër Summa ndenji tek shtëpia e Haxhi Çekës për 3 vjet dhe mbas kësaj Haxhi Çeka i dha para për të bërë një shtëpi (ose më mirë një jerevi). Pjetri e ndërtoi shtëpinë por kur turqit e morën vesh se Pjetër Summa kishte ndërtuar shtëpi, shkuan që t'ia prishnin. Sa e kuptoi këtë gjë, pa vonesë Pjetri lajmëroi Haxhi Çekën. Ai shkoi direkt tek shtëpia e Pjetrit dhe i ndaloi turqit që t'ia prishnin shtëpinë duke u thënë se ajo ishte shtëpia e tij (Haxhi Çekës), ndaj turqit u zbrapsën pa bërë ndonjë veprim.

Duke e përmendur gjithmonë "shtëpia e Çekës", ky mbiemër ose llagap i mbeti Pjetër Summës dhe qysh në ato kohë në Shkodër ka mbetur mbiemri Çeka, ndërsa jashtë Shkodrës si dhe jashtë shtetit përdorej mbiemri Summa.

Pjetri u martua dhe i lindën 5 djem: Preçi, Hila, Ejlli, Kola dhe Simoni. Kur u rritën, Preçit dhe Hilës, Pjetri i dha profesionin e rrobaqepësit. Djalin e tretë, Ejllin, e dërgoi në Romë për prift, i cili, pasi mbaroi studimet, erdhi në Shkodër dhe shërbeu në Shirq, ku vdiq dhe u varros në kishën e Shna Premtes.

Vëllezërit e tjerë punonin si rrobaqepës e fitonin ushqimin, por vëllai i dytë nuk ishte i kënaqur me profesionin që kishin. Ai u thoshte se me penj e gjilpëra nuk do bëheshin kurrë të pasur, prandaj filluan të blinin lëkura të llojeve të ndryshme, bletë dhe dyllë blete, të cilat i shiste dhe fitonte, por edhe qepte me vëllezërit e tij. Duke e vazhduar këtë tregti për disa vite, Hila bëri shumë miq tregtarë lëkurash.

Ndër lëkurat që shiste, ato të lepujve nuk kishin asnjë vlerë, ndaj tregtarëve iu mbetën pa iu shitur për 5 vjet, duke i mbushur magazinat plot me lëkura lepujsh. Këta tregtarë nuk ishin vetëm shkodranë, por edhe prej qyteteve të tjera. Hila u propozoi tregtarëve që t'ia shisnin me kredi dhe çmim të lirë për një vit. Tregtarët e lëkurave mbetën të kënaqur nga kjo marrëveshje me Hil Sumën (Çeka).

Vëllai i madh, Preçi, ishte në kundërshtim me këtë marrëveshje dhe thoshte se brenda vitit tregtarët do t'i kërkonin paratë dhe nuk do të kishin mundësi të paguanin. Ata do t'ia merrnin shtëpinë, e cila nuk kushtonte më shumë se 6 qese dhe prapë se prapë do t'i mbeteshin borxh tregtarëve, mbasi lëkurat nuk kishin se ku të shiteshin. Atëherë Hila mori një barkë me qira, e mbushi plot me lëkura dhe u nis për Venedik. Mbas 3 muajve ai u shkroi vëllezërve se lëkurat nuk po i shiteshin sepse nuk kishin asnjë vlerë, por po vazhdonte të rrinte atje, se ndoshta gjente ndonjë tregtar dhe i shiste. Mbas disa muajve Hila u tregoi vëllezërve se u kishte dhënë tregtarëve nga 1 grosh e gjysmë për copë, por shton se nuk po ngutej që t'i shiste se ndoshta mund t'i jepte me një çmim më të lartë. Tre vëllezërit vazhdonin punën si rrobaqepës, por ishin në merak për Hilën dhe për paratë që u duheshin dhënë tregtarëve të lëkurave.

Në Shqipëri Hila i bleu lëkurat me 4 pare copën dhe tregtarët e Venedikut ia dhanë me 60 pare copën, prandaj vëllezërit u çuditën pse Hila nuk po i shiste. Në ato kohë nuk kishte as port, as vapor, veç kur vinte ndonjë barkë për disa muaj. Kur u mbushën tetë muaj Hila ishte në Venedik dhe i lajmëroi vëllezërit që lëkurat e lepujve i kishte shitur për 120 pare copën dhe duhej ta mbanin sekret si dhe të blinin tetë dyqane në rrugën e hekurit që ta shiste mallin që kishte sjellë me barkë.

U blenë 6 dyqane dhe 2 u morën me qira. Mbasi u mbush viti, Hila erdhi nga Venediku me barkat plot e përplot me mallra si, manifakturë koloniale, lëkura etj., dhe bashkë me vëllezërit i rregulloi të gjitha nëpër dyqane. Nuk kaloi shumë kohë dhe erdhën tregtarët me lëkura, dyllë etj. Hila ua bleu të gjitha lëkurat, dyllin dhe llogaritën edhe lëkurat e lepujve që i kishin dhënë në besim një vit më parë. Hila u propozoi tregtarëve që të blinin mall, të cilat i jepte edhe me kredi, duke u thënë se atyre që e kanë besuar për 10 qese, ai do t'i besonte për 100 qese. Kështu tregtarët u nisën të kënaqur si për shitje ashtu dhe për blerje.

Mbasi puna erdhi duke u shtuar, Hila u detyrua që të hapte agjenci në Prizren, Gjakovë, Tetovë etj. Ata dërgonin shegertë nga Shkodra tek ato agjenci, të cilat njiheshin të firmës Summa (Çeka).

Simoni ishte më i vogli ndër vëllezër dhe dinte shkrim e këndim dhe në llogari ishte mjaft i zoti. Këtij ia lanë të gjitha llogaritë si dhe korrespondencën e shitjes së mallit dhe kontrollin e të gjitha agjencive

që kishin. Ai shkante të ngarkonte nga 20-30 kuaj me pare dhe i sillte në Shkodër. Hila udhëtonte në Venedik, dërgonte lëkura të ndryshme të regjura, dyllë e bletë, i shiste atje dhe kthehej me mall të ndryshëm për Shkodër.

Preçi dhe Kola ndenjën gjithmonë në Shkodër, blenë toka, vreshta, dyqane dhe u martuan sipas radhës. Hila ndërtoi një shtëpi të madhe me 6 dhoma, e cila sot thirret Arra e Madhe. Kur e panë atë shtëpi, populli tha se Hil Çeka kishte ndërtuar një kala.

Preçi pati 2 djem: Pjetrin dhe Zefin. Pjetri pati 3 djem: Ndocin, Filipin dhe Mikelin. Ndoci pati 2 djem: Pjetrin dhe Lecin. Ky i fundit pati 2 djem: Tonin dhe Pjetrin. Zefi pati Ejllin, i cili la 9 fëmijë: një djalë, Gasprin dhe 8 vajza. Gaspri pati 3 djem: Ejllin, Zefin dhe Luigjin. Këta nuk u martuan, ndaj kjo degë u shua.

Tetë vajzat e Ejllit ishin: Çilja, Agia, Kusha, Drandja, Cina, Tonja, Lezja dhe Gjystja. Çilja dhe Agia u martuan me bijtë e Pjetër Shirokës, Shanin (1837) dhe Gasprin (1834). Kusha dhe Drandja u martuan me bijtë e Kol Shirokës, Ndreken (1834) dhe Zefin (1837). Cina u martua me Pashko Muzhanin, Lezja me Loro Saraçin, Tonja me Filip Çurçinë dhe Gjystja u bë murgeshë.

Kola la një djalë, Filipin, i cili pati vetëm vajza dhe kjo degë u shua. Simoni, më i vogli, ka 5 djem: Matinë, Lazrin, Ndocin, Franon dhe Gasprin. Matia vdiq, Lazri shkoi në Francë dhe Franoja shkoi në Spanjë. Por për ta nuk kemi asnjë informacion. Ndoci pati vajza e kjo degë u shua gjithashtu, ndërsa Gaspri pati Kolën, i cili la Zefin me dy djem, Nikolinin dhe Gasprin.

Materiali për familjen Çeka është edhe në Arkivin Qendror të Shtetit Tiranë, dorëshkrim.

2

PERSONALITETE TË NJOHURA TË FAMILJES

Lidhjet e familjes SUMMA kanë qenë të shumëllojshme dhe këtu mund të përmendim një dokument të Propaganda Fide të vitit 1854, në të cilin jepet një dëshmi për Pjetër Summën, i cili prej shumë vitesh ka ushtruar në Venedik detyrën e agjentit të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide, shërbim që është ushtruar mbi 13 pesëvjeçarë, pra rreth 65 vjet nga njerëz të familjes. Dokumenti është firmosur nga Kardinal Frasoni në Romë, më datë 6 tetor 1854:

"Dëshmojmë, e vërtetojmë kujt do që ti përkasë se z. Pjetër Summa ka disa vjet që ushtron në Venedik, plot zell besimin e pa interes të Agjentit të Kongregacionit të Shenjtë të Propagandës Fides, shërbim tue që në tashma 13 pesëvjeçarë që ushtrohet me të njëjtën lavd prej njerëzve të së njëjtës familje. Gjë për të cilën tue e pasë lypë i sipërthanuni z. Summa që ti jepet një vërtetim, me mjaft kënaqësi po ia përmbushim kërkesat e tij të drejta."

Romë, prej Propagandës, më 6 tetor, 1854.

E. T. Kardinal Frasoni - Prefekt

Ab. Barnoba Seg.

Aktiviteti i familjes u shtri edhe në fushën arsimore. Meqenëse nxënësit e shkollës Gjergj Benusi u shtuan shumë në vitin 1856, pasanikët e Shkodrës bënë një mbledhje në dyqanin e Ejëll Çekës për të biseduar mbi themelimin e një shkolle popullore duke vendosur që të thërrisnin mësues nga Trieste apo Venediku.

Pasqyrimi i aktivitetit të familjes Summa vërtetohet edhe nga vulat e saj, të cilat kanë shërbyer për dokumentet zyrtare të autorëve të kësaj familjeje, të miratuara nga shteti otoman.

Lidhjet e dy vëllezërve Mikel dhe Filip Çeka (Summa) me konsullatat e huaja kanë shërbyer për një kohë të gjatë dhe kanë krijuar premiset për vlerësim personal të tyre.

Kështu, në vitin 1854 u lëshua një dokument, patentë mbrojtjeje për shtetasin otoman Filip Summa, e lëshuar nga konsullata franceze e asaj kohe në Shkodër, firmosur nga Hecquardi:

"Në Konsullatën Franceze në Shkodër vërtetojmë se zotëri Filippo Summa, shtetas otoman, lindur dhe banues në Shkodër është i

rregjistruar në numrin 2 në rregjistrin e veçantë për të huaj, mbajtur nga kjo konsullatë në bazë të dispozitave të marrëveshjes të përmbytur në traktatet ndërmjet Francës dhe Portës së lartë Otomane. Me besën e dhënë dhe fjalën në i japim atij këtë dhuratë për ti shërbyer aty ku të jep të drejtë."

Shkodër, 08 shkurt, 1854

Ndërsa dokumenti tjetër i jepet Mikel Summa nga Ministria e Jashtme Franceze në vitin 1895, firmosur nga presidenti francez i asaj kohe Felix Fauer:

"Presidenti i Francës me propozim të Ministrisë së Jashtme të Republikës Franceze dekreton një medalje prej ari, lëshuar z. Mikel Summa përkthyes dhe ndihmës i Konsullit të Francës në Shkodër, Albania për shërbimet e bëra për interesa franceze nga viti 1856 deri më 1895."

Firmosur më 23 prill, 1895

Familja Çeka i forcoi pozitat politike, ekonomike dhe sociale me një dokument, i cili ndodhet në AQSh, pasqyruar në librin e Ardian Popojanit "Firmat tregtare Çoba-Bianku" (1795-1912), libër i përgatitur nga shtëpia botuese Pegi në vitin 1998, ku thuhet se misionarët françeskanë, kur ndaleshin në Shkodër për nevojat e veta, deri në vitin 1861, vinin në shtëpitë e më të parëve, pasanikëve shkodranë, ku disa familje me leje mbanin altar në dhomat e vogla të shtëpive. Në shekullin XVII ishin shtëpitë e Çobës, Çekës, Llupit etj., ku kryheshin ritet fetare pa u shqetësuar nga administrata turke e asaj kohe.

Gjithashtu emri i familjes Çeka përmendet edhe në librin e pagëzimit të vitit 1737, shkruar nga famullitari i Tophanës Dom Pal Karnsi në datën 18 qershor, 1736 krahas familjeve të tjera katolike shkodrane.

Familja Çeka (Summa) pati lidhje të ngushta me personalitetet e konsullatës franceze. Kështu, sipas një dokumenti të shkruar me shkrim do të jepen disa referenca.

Në pagëzimin e Filip Çekës, nunë kanë qenë Gjorgjo De Grand dhe Maria Berte De Grand (konsulli dhe gruaja e tij) ndërsa për Gjystinë Çeka, nun ka qenë punonjësi i kësaj konsullate Albert Loffon si dhe Dava Bib Doda (motra e Preng Pashës). Në këtë dokument jepen dhe të dhëna për meshtarët, të cilët kanë pagëzuar gjithë pjesëtarët e familjes Mikel Çeka (Summa).

Pjesëtarë të familjes Çeka janë dalluar edhe në fushën e muzikës. Kështu, babë dhe djalë, Gaspri dhe Engjëlli kanë marrë pjesë në grupet e asaj kohe me shokë të tjerë ahengxhinj. Është mjaft kuptimplotë një foto e vitit 1900 me një grup ahengxhinjsh nga muzeu Marubi Shkodër, si dhe një violinë, e cila është përdorur nga Engjëlli, prodhim i Stradivarit. Kënga shkodrane "Sa ma shpejt ma vune kamën" është kompozuar nga Engjëll Çeka.

Falë gjendjes shumë të mirë financiare, familja Çeka ndërtoi një shtëpi të madhe me një sipërfaqe ndërtese rreth 290m² me dy kate, me oborr përpara dhe mbrapa. Sipas burimeve gojore, shtëpia është ndërtuar afro 250 vjet më parë nga dy ushtarë dibranë, usta Jashar Lleshi dhe usta Jashar Xhani. Krahas shtëpisë tonë, vlen të thuhet se edhe disa familje të fisit Summa janë vendosur në këtë zonë me shtëpi dhe oborr.

Afër shtëpisë është edhe një sipërfaqe toke (bahçe) rreth 12 dynym, në të cilën kohët e fundit, rreth vitit 2005 kemi ndërtuar një shkollë private 9-vjeçare "Miqësia", e cila nga ana mësimore administrohet nga Flora Çeka (bashkëshortja ime) dhe Ervin Çeka (djali i dytë i familjes sonë).

Me vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror Tiranë, nr. 6, datë 15.01.1963 shtëpia e Filip Çeka, krahas me disa shtëpi të tjera në Shkodër është shpallur monument kulture i kategorisë I. Gjatë periudhave të ndryshme janë kryer restaurime të ndryshme, por duke ruajtur fizionominë e saj të vjetër.

Këto fakte tregojnë mbi aktivitetin patriotik, historik, arsimor, fetar të pjesëtarëve të familjes Çeka (Summa).

Në nderim të familjes Çeka, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, ka përfshirë edhe një pjesëtar të familjes (Filip Çeka) në një rubrikë të veçantë, ndërsa në fjalorin enciklopedik të hapësirës shkodrane, hartuar nga Zenepe Dibra, ka një rubrikë prej dy faqesh për familjen Çeka.

3

VEPRIMTARIA PATRIOTIKE E FAMILJES

Udhëheqësit e jetës patriotike shqiptare i vazhduan me javë të tëra përpjekjet për të bindur Portën e Lartë, që të lejonte formimin e Lidhjes Shqiptare, si një organizatë kombëtare, e cila do të luftonte për të mbrojtur tërësinë territoriale të Shqipërisë. Por Porta e Lartë nuk u bind. Ajo lejonte vetëm formimin e Lidhjes Islamike, si një organizatë të myslimanëve të Ballkanit, e cila veç kësaj do të ishte nën kontrollin e Portës së Lartë. Por, gjatë dhjetëditëshit të tretë të muajit maj 1878, kancelari Bismark mbledhi fuqitë e mëdha në Berlin. Më 13 qershor, 1878, u vendos të mbledhej Kuvendi i Përgjithshëm i Shqipërisë, i cili themeloi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Për sa i përket karakterit politik që do të kishte organizata, vëzhguesit e huaj vinin në dukje se delegatët që kishin ardhur në Prizren, qenë ndarë në dy grupe kryesore, sipas prirjes që kishin për t'u formuar, ose një Lidhje Shqiptare ose një Lidhje Islamike.

Sipas konsullit Pons, banorët myslimanë ishin për besnikëri ndaj Portës së Lartë, ndërsa bashkatdhetarët katolikë kërkonin një Shqipëri autonome.

Me një shënim të botuar nga At Zef Pllumi në parathënien e Lahutës së Malësisë (botim XVII) shkruhet se ... Abedin Pasha tue shfrytëzue politikën europjane të kohës që mbështetej mbi vetvendosjen e popujve apo mbi parimet europiane i tha Abdyl Bej Frashërit që të thirret Lidhja Shqiptare e Prizrenit që shqiptarët të kërkonin të drejtat e vetëvendosjes. Mjerisht në seancën e parë ajo u emërua "Lidhja e myslimanëve të vërtetë". Kështu thonë proces verbalët, se duam të shkruajmë historinë e vërtetë. Atë kushtim në emër të islamizmit nuk e dëgjoji kërkues në botë, ndërsa në një seancë tjetër, në të cilën morën pjesë delegacioni i Shkodrës, z. Filip Çeka (Summa) në shtëpinë e të cilit banonte konsulli francez në Shkodër, parashtrroi kërkesën që ajo të quhej Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

Kuvendi i përgjithshëm i zhvilloi punimet e veta në një nga sallat e medresesë, ndërtuar në shekullin XVII nga Mehmet Pasha, e cila ndodhet pranë xhamisë. Punimet u zhvilluan me dyer të mbyllura për publikun.

Si rrjedhim, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, edhe pse me 10 qershor, 1878 nuk u shpall zyrtarisht si një organizatë shqiptare, pati që ditën e parë të saj një karakter politik. Karakteri patriotik dukej gjithashtu në detyrën që mori përsipër Lidhja Shqiptare e Prizrenit për të organizuar

rezistencën politike dhe ushtarake, duke mobilizuar vetëm shqiptarë, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare apo krahinore.

Shkodra i merrte vesh shumë shpejt ngjarjet e Prizrenit, zakonisht nëpërmjet qiraxhinjve që sillnin pothuajse çdo ditë lekë nga miqtë e shkodranëve, por nganjëherë brenda ditës nëpërmjet telegrafistëve, të cilët bisedonin fshehurazi me njëri-tjetrin me alfabet morsk. Nëpërmjet këtyre kanaleve lajmet arrinin deri te zyrat e konsujve të huaj, të cilët dalëngadalë filluan që ta kthenin fytyrën e tyre nga Prizreni.

Nga raporti i konsullit Lipich hartuar më 15 qershor 1878, kuptohet se Shkodra ishte në dijeni për platformën e Lidhjes, prandaj qytetarët shkodranë myslimanë dhe katolikë vendosën që në peticionin e tyre, i cili, sikurse u tha, u pajis me 380 nënshkrime, të mos shprehej besnikëria ndaj Portës së Lartë, por të theksohej vetëm interesi i Kombit Shqiptar.

Në peticionin e datës 15 qershor 1878, i cili kryesohet nga Daut Efendi Boriçi, ndër të parët nga pjesa katolike është edhe Filip Summa (Çeka).

Gjithashtu edhe Pashko Vasa ka theksuar se ... në Shkodër është krijuar një bërthamë e fortë me patriotë të shquar më në krye Filip Çeka, Daut Boriçi, Selim Çoba. Nëpërmjet Isuf Sokolit ata u lidhën me të parët e Hoti, Grudës, Kelmendit, Dukagjinit, Shkrelit, Shalës dhe Shoshit (në librin e Sulejman Krasniqit-Mic Sokoli).

Janë të njohura ngjarjet e viteve 1877-1878. Vendimet e Traktatit të Shën Stefanit cenuan rëndë interesat tona kombëtare, sepse vise të tëra shqiptare si Ulqini, Kraja, Anamali, Gruda, Kelmendi, Vermoshi, Plava, Gucia, Rugova etj., duhet të kalonin në Mal të Zi.

Një valë e madhe tubimesh dhe protestash u zhvilluan në qytetet kryesore. Veçanërisht në Shkodër vërehej tensioni më i madh, ku pasojat e veprimtarive ambicioniste ndiheshin drejtpërdrejtë. Një muaj para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, shkodranët i patën dërguar ambasadorit francez në Stamboll një patentë ku thuhej: Ne katolikët dhe myslimanët, vëllezën prej shekujsh dhe që jetojmë në bashkësi interesash e zakonesh pëlqejmë më mirë të asgjësohemi se sa të vdesim të poshtëruar dhe të skllavëruar... Në këto akte është mendja e familjes Çeka (Filipi dhe Mikeli).

Pa u krijuar mirë Lidhja e Prizrenit, shkodranët shprehën menjëherë solidaritetin e vet, duke njoftuar edhe qendrën që më 10 qershor 1878. Me një politikë të acaruar, mbledhjet dhe protestat e memorandumit ishin në rend të ditës. Ishin patriotët dhe elita intelektuale që i udhëhoqën këto veprimtari. Krahas guximit të patriotëve duhej edhe kultura intelektuale në përzierjen e këtyre protestave, memorandumëve dhe miqësia e lidhjet e ndryshme që kishin krijuar ata me qarqet diplomatike.

Ishte në praktikën e familjeve tregtare katolike që fëmijët të ndiqnin shkolla private dhe më vonë ato të urdhrave fetarë (Jezuit ose Françeskanë), mbasi shkollimi dhe veç të tjerave përvetësimi i gjuhës së huaj u imponohej.

Pra, në këto kushte ishte dhe Filip Çeka. Paria e Shkodrës mblidhej rregullisht herë në xhami e herë në bibliotekën e Pazarit për të diskutuar situatën. Mbas një pune me kujdes, (paria) më tepër katolikët në bashkëpunim me koloninë shkodrane të Triestes, shqiptarët hartuan një memorandum për të drejtuar Bconconsfield.

Ky memorandum në italisht, në formë broshure u botua në Trieste më 13 qershor 1878. Duke u nisur nga data e botimit, kuptohej pa vështirësi se për të arritur te botimi janë nevojitur më shumë se 30 ditë, pra ky është hartuar para hapjes së Kongresit të Berlinit. Kjo i drejtohej përfaqësuesit anglez, sepse politika e tyre ishte me dashamirësi ato vite dhe se kërkesat e shqiptarëve ishin shumë të avancuara për kohën, përderisa bëhej fjalë për tërësinë taksore dhe pavarësinë kombëtare. Një qëndrim i tillë i bën nder historisë, mendimit politik në Shkodër dhe elitës që përvijoi këto ide.

Më 15 qershor, dy ditë mbas hapjes së Kongresit të Berlinit, u zhvillua një manifestim i fuqishëm në Pazar të vjetër, në oborrin e bibliotekës pranë Medresesë dhe në mes një entuziazmi mbarë popullor u lexua peticioni dërguar Kongresit të Berlinit në shenjë proteste. Në firmëtorët e këtyre dy protestave gjejmë edhe emrin e Filip Summës. Sipas dokumenteve angleze, rezultoi administrator i konsullatës angleze në Shkodër Filip Summa. Pra, krahas familjes së vjetër Çeka (Summa) është edhe një familje tjetër e vjetër po nga i njëjti vend (Sumë) familja e njohur e Andrea dhe Anton Summa e cila nxori Jak Summën dhe Nikolla Summën (Kol Heqimi) konsuj të Venedikut e mandej të Anglisë në Shkodër prej vitit 1782-1832. Pra kushëriri i tyre Filip Çeka sugjeroi që telegrami t'i drejtohej Lordit Salisburg me disa anëtarë tjerë.

Më 23 qershor do të ishin të pranishëm të gjithë delegatët e qyteteve shqiptare në Prizren. Më 30 qershor u paraqitën edhe delegatët e Shkodrës me Isuf Sokolin dhe një tjetër delegat të Podgoricës, 14 veta nga Gruda, Hoti, Kastrati, Kelmendi, Shkreli, Rrjollli, Shllaku, Temali, Suma, Shoshi dhe Shala. Këta shkuan më vonë, sepse ishin zënë me marrjen e masave në krahinat e tyre në kufi me Malin e Zi.

Sipas korrespondencës Çoba-Bianku, shkruar më 5 korrik 1878, thuhet se ... zotërinjtë që patën shkue në Prizren u kthyen dhe ishin Selim Begu, Jusuf Aga, një podgoriçan dhe 7 krerë prej malsije.

Nga korespondenca e mësipërme kuptohet formimi i degës Shkodër dhe se në Komisionin e Degës së Lidhjes së Prizrenit morën pjesë

katër vetë nga katolikët: Filip Çeka, N. Shiroka, Simon Simoni, Gjon Muzhani, të cilët ishin thirrur të këshilloheshin me ta. Myslimanët iu paskan thënë... Ju kemi thirrë me u këshillu mbasi gjithmonë keni bashkëpunue.

Filip Suma (Çeka), i cili bisedoi me delegatët që morën pjesë në takimin e Prizrenit, i vunë kryesisht theksin vendimit që u mor për mbajtjen e trojeve shqiptare nga lakmitë e huaja. Në raportin që ia drejtoi ambasadorit britanik në Stamboll A. Lojer, më 15 korrik 1878, i shkruan tekstualisht kështu... Në rast se Kongresi i Berlinit do t'i japë Serbisë dhe Malit të Zi zmadhime në Shqipëri, banorët në masë do të marrin armët për t'iu përgjigjur thirrjes së parë të krerëve të tyre, pastaj do t'u bëhet një lajmërim këtyre dy principatave që të boshatisin pozicionet e pushtuara dhe në rast se ata nuk do të pranojnë, do t'i detyrojnë të tërhiqen me luftë. Kështu Lidhja Shqiptare e Prizrenit kishte marrë atributet qeveritare në fushën e rendit administrativ, gjyqtar dhe fiskal.

Sipas konsullit Lipih, mbledhjet për formimin e Komiteteve Ndërkrahinore Politike, të cilin e quan Komitet Krahinor i Mbrojtjes së Vendit, filluan më 7 korrik 1878 dhe përfunduan më 12 korrik 1878, së bashku me Komisionin Ndërkombëtar Ushtarak. Si në njërin, ashtu dhe në tjetrin u zgjodhën përfaqësues shkodranë të tre besimeve.

Komisioni i Degës Shkodër përfaqësohej prej këtyre personave: Kryetar: Daut Efendi Boriçi, Selim Efendi Çoba, Shaban Begu, Haxhi Agë Lohja, Selim Agë Gjyrezi, Ethem Agë Kazazi, Ibrahim Efendi Dragusha, Filip Çeka, Ndreke Shiroka, Gjon Muzhani e Simon Simoni.

Në mbledhjen e datës 20.07.1878 ky komision kërkoi nga myslimanët dhe katolikët së bashku 500.000 groshë dhe dy pjesë do t'i paguanin myslimanët dhe një pjesë katolikët. Katundeve u vunë 1000 barrë grurë dhe 1000 qese për transport.

Në një nga vendimet që mori Komiteti i Shkodrës më 11 korrik, thuhej... Çdo njeri që dëshiron të kapërcejë vijat ushtarake turko-malazeze, duhet të jetë i pajisur me një lloj leje të lëshuar në emër të popullit shqiptar, e cila do të mbajë vulën e Komitetit të Shkodrës, asnjë leje tjetër nuk do të jetë e vlefshme. Ndërsa në 1878, detyra kryesore e Komitetit Shkodër ishte organizimi dhe marrja në dorë e disa funksioneve kryesore të pushtetit. Në etapën e dytë në 1879, në plan të parë doli çështja e dorëzimit të Podgoricës dhe e kthimit të Ulqinit, si dhe përgatitja për të ndihmuar Plavën e Gucinë që kërcënoheshin. Kur u hap fjala se Mali i Zi ka vendosur të pushtojë Gucinë me forcën e armëve, u ndezën gjakrat, kudo u bënë mbledhje dhe u vendos që të ndihmohej Gucia. Me gjithë përpjekjet e Ali Hajdar Pasha për të penguar vullnetarët shkodranë më 27 dhe 28 tetor, ata u nisën nën komandën e

Isuf Sokolit dhe Filip Çekës, kurse kelmendasit i udhëhiqte Nik Leka. Në bazë të vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm, Shtabi Ushtarak, nën kryesinë e Ali Pashë Gucisë, shpalli gjendje lufte në zonën Plavë-Guci.

Selinë e vet Shtabi shqiptar e vendosi në Guci 5 km larg kufirit. Përveç kryetarit të Shtabit Ali Pashë Gucia, morën pjesë si anëtarë të tij krerët e krahinave shqiptare që kishin dërguar në front vullnetarët e tyre si Jakup Ferri, Haxhi Zeka, Kel Shabani, Sulejman Vokshi, Riza Kryeziu, Bajram Curri, si dhe Isuf Sokoli dhe Filip Çeka nga Shkodra. Në shtab morën pjesë edhe disa oficerë shqiptarë të karrierës.

Luftimet më të ashpra u bënë në luginën e Nikshiqit, ku u angazhuan forca të shumta malazeze. Përlëshja vazhdoi disa orë me radhë. Forcat vullnetare të Lidhjes ndalën sulmin e ushtrisë malazeze dhe i shkaktuan asaj disfatë në Nikshiq, duke e detyruar të tërhiqet brenda kufijve të Malit të Zi.

Në Betejën tjetër të Pepajve dhe Velikës, shqiptarët korrën fitore kundër ushtrive malazeze më 8 janar 1880, e cila la një përshtypje të thellë në opinionin ndërkombëtar. Vetë kryekonsulli austro-hungarez në Shkodër i raportonte qeverisë se vetë malazezët pohojnë se me luftën e Velikaj e Pepaj, shqiptarët luftuan burrërisht dhe fituan mbi ta. Me fitoren që u arrit në Nikshiq, Pepaj, e Velikaj, shqiptarët i dhanë të kuptonte Diplomacisë evropiane se Perandoria Osmane, sado që e mbante Shqipërinë prej 5 shekujsh nën zgjedhje, nuk ishte zonjë e trojeve të saj dhe se zotër të këtyre trojeve ishin banorët shqiptarë. Fitoret e shqiptarëve kundër ushtrive malazeze dhe jehona e tyre në arenën ndërkombëtare patën pasoja të thella në Shqipëri. Ato e përforcuan më tej bindjen e shqiptarëve, se tashmë ishin në gjendje të mbronin trojet e tyre jo vetëm pa ndihmën e ushtrive osmane, por edhe kundër vullnetit të Portës së Lartë. Pa kaluar 24 orë nga dorëzimi i telegrameve filluan të mbërrinin edhe përgjigjet. Mesazhi i parë erdhi nga "Mexhlisi shqiptar i Prizrenit dhe i Dibrës" dërguar nga Hoxhë Koronica, Ymer Efendiu, Sulejman Agë Vokshi, Iljaz Pashë Dibra etj. Prej Shkodre mbështesnin Hodo Begu, Hasan Hoti e Filip Çeka dhe disa krerë e bajraktarë të Malësisë së Madhe.

Përgjithësisht tekstet e telegrameve kishin përmbajtje të ngjashme "Për fir ju kjoft kjo luftë. I lumtë memleqetit të Gucisë, Gajret, Rrnoft Shqipnija, Jemi me ju".

Pas disfatës në Velik dhe Pepaj, Knjaz Nikolla iu drejtua përsëri Fuqive të Mëdha dhe këto nga ana e tyre i bënë presion Perandorisë Osmane për të çuar deri në fund dorëzimin e Plavës dhe Gucisë. Porta e Lartë u përgjigj se ishte e gatshme të kënaqte Malin e Zi, por jo në Plavë e Guci. Nëpërmjet ambasadorit të saj në Stamboll Italia me kontin Corti

sugjeroi që t'i jepeshin Malit të Zi viset e Hotit dhe Grudës së bashku me një pjesë të Kelmendit, të cilat banoheshin gjithashtu nga popullsi shqiptare. Kështu, më 18 prill 1880, ambasadorët e Fuqive të Mëdha miratuan propozimin italian që njihet me emrin "Vija Korti" për t'i dhënë Malit të Zi në vend të Plavës e Gucisë, viset e Hotit dhe Grudës. Dorëzimi i këtyre viseve u vendos të bëhej më 22 prill 1880.

Meqenëse Hoti, Gruda, Kelmendi dhe Kastrati bënë pjesë në vilajetin e Shkodrës, baza e organizimit të luftës mbrojtëse i takonte Komitetit Ndërkombëtar të këtij vilajeti. Qysh nga 25 marsi 1880, Komiteti Ndërkombëtar i Shkodrës ishte në mbledhje të vazhdueshme dhe filloi të merrte masat e nevojshme për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Më 3 prill 1880 u zhvillua në Shkodër një kuvend krahinor, ku morën pjesë përfaqësues të qytetit e malësisë. Kuvendi vendosi të kundërshtojë me çdo kusht lëshimin e Hotit e të Grudës dhe u dërgoi një peticion fuqive të mëdha në të cilën thuhej: Kemi vendosur që të derdhim pikën e fundit të gjakut para se të hyjmë nën zgjedhën e një qeverie të huaj. Më 11 prill 1880, Komiteti Ndërkombëtar i Shkodrës formoi Shtabin Ushtarak të vilajetit me detyrë që të merrte masat e duhura për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Në krye të shtabit Ushtarak u vunë Hodo Sokoli, një kolonel i karrierës. Midis anëtarëve të tij bënë pjesë jo vetëm përfaqësues nga qyteti si Selim Çoba, Filip Çeka, Shaban Bushati, Zef Simoni, Selim Gjyzezi etj., por edhe mjaft krerë malësorë të regjur në luftim. Komiteti Ndërkombëtar i Shkodrës i bëri thirrje Preng Pashë Bib Doda duke e emëruar, nëse do të ishte i gatshëm, nënkryetar të Shtabit Ushtarak.

Më 19 prill 1880, u zhvillua në Shkodër një miting i madh popullor, një nga manifestimet më masive që kishte parë qyteti deri atëherë. Në miting, para mijëra qytetarësh shkodranë, mbajti një fjalim Hodo Sokoli. Ai dhe 1500 vetë që ndodheshin në miting, hoqën publikisht spaletat ushtarake dhe dekoratat e sulltanit dhe deklaruan se nuk do të njihnin as atë dhe as Stambollin.

Në mbrëmjen e 21 prillit u nisën nga Shkodra, duke lundruar në liqen, disa dhjetëra anije me vullnetarë shkodranë, rreth 3 mijë vetë, dhe së bashku me Shtabin Ushtarak u vendosën në Tuz. Kështu, tek ura e Razhamicës filloi më 22 prill përleshja e armatosur ndërmjet forcave shqiptare dhe malazeze. Më në fund ushtritë malazeze u thyen dhe u tërhoqën në Podgoricë, duke lënë disa të vrarë e të plagosur.

Fitorja e Razhanicës dhe Shelmit ngjalli entuziazëm në mbarë Shqipërinë. Pas luftës së Razhanicës, viset e Hotit dhe Grudës, të liruar nga ushtritë osmane, por të papushtuara nga ato malazeze mbetën de facto nën sovranitetin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për 8 muaj, nga 22 prill 1880 deri më 28 dhjetor 1880. Pothuajse të gjitha gazetët kryesore

të Evropës Perëndimore dërguan ato javë korrespondencat e tyre në Shkodër, shumica e të cilëve u detyruan të vinin në objekt atdhetarizmin e lartë që frymëzonte qëndresën shqiptare.

Fuqitë e Mëdha u bindën përfundimisht se as Protokollit i Stambollit nuk mund të zbatohet me anën e presionit diplomatik. Anglia dhe Rusia propozuan një ndërhyrje ushtarake të përbashkët të Fuqive të Mëdha kundër shqiptarëve të përqendruar në kufi, por Austro-Hungaria dhe Gjermania e kundërshtuan. Më në fund fitoi qëndresa shqiptare. Pasi pranuan në parim të hiqnin dorë edhe nga protokollit i Stambollit, Fuqitë e Mëdha miratuan më 15 qershor 1880, propozimin e Anglisë dhe të Austro-Hungarisë për t'i dhënë Malit të Zi në vend të Hotit dhe Grudës qytetin bregdetar të Ulqinit së bashku me rrethinat e tij.

Dega e Shkodrës diti fare mirë që ta organizonte mbrojtjen e Hotit dhe Grudës, bile në këtë kohë qendra në Prizren e humbi rëndësinë dhe iu nënshtrova veprimeve të Shkodrës. Dega e Shkodrës përbëhej nga 25 delegatë shkodranë e bajraktarë dhe kishin caktuar një komision ekzekutiv me fuqi të plotë. Kryetari i Shkodrës dhe i komisionit ekzekutiv ishte Daut Efendi Boriçi dhe anëtarët e komisionit ishin: Selim Çoba, Filip Çeka, Gjon Muzhani, Zef Simoni, Ibrahim Dragusha, Haxhi Age Drishti, Shaban Bushati e Selim Gjyrezi. Por vendimi i Fuqive të Mëdha për t'i lëshuar Malit të Zi Ulqinin me rrethinat e tij, shtroi përsëri detyrën e ngutshme të mbrojtjes si tërësi të atdheut, të cilit po i shkëputej një pjesë e rëndësishme jetike. Kështu u hartua memorandumit i datës 19 qershor 1880 kundër copëtimit të tokave shqiptare.

Në qershor të vitit 1880, në kabinetet e Fuqive të Mëdha po rrihej problemi për t'i dhënë Malit të Zi toka në perëndim të liqenit të Shkodrës, kalanë e Ulqinit bashkë me qytetin. Kjo ndodhi mbasi Kongresi i Berlinit kishte vendosur në fillim t'i jepte Malit të Zi tokat shqiptare të Plavës dhe Gucisë, por siç duket forcat ushtarake malazeze u thyen nga forcat vullnetare shqiptare që luftuan nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pastaj erdhi "kompromisi". Korti që zëvendësonte Plavën e Gucinë me tokat shqiptare të Hotit dhe Grudës. Të njëjtin përfundim pati edhe lufta për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Shqiptarët luftuan me heroizëm për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut.

Lajmi për dorëzimin e Ulqinit u bë i ditur në Shkodër edhe pse qeveria turke nuk e kishte marrë ende notën zyrtare për këtë. Rreziku që kërcënonte Ulqinin ishte biseda e ditës në Shkodër. Komiteti i Lidhjes për Shkodrën, së bashku me përfaqësuesit e degës së Ulqinit që erdhën për të kërkuar ndihma, hartuan planin e përqendrimit të ngutshëm të forcave vullnetare në Ulqin. Qeveria turke ngarkoi Hysen Pashën, i cili ishte Vali në Shkodër, që të ndërmjetësonte pranë parisë Shkodër,

të cilët i njihte personalisht që t'ua mbushte mendjen popullit që të mos kundërshtojë dorëzimin e Ulqinit. Qysh më 27 gusht, ai i drejtoi Lidhjes në Shkodër këtë telegram: "Për së shpejti do të vijnë luftanijet e Pushteteve të mëdha për me i dorëzuar Ulqinin Malit të Zi, prandaj ju këshilloj për të mirën tuaj që pa humbur kohë të mbushni mendjen popullit me e dorëzuar shpejt Ulqinin. Nesër pres përgjigje, keni kohë e keni për detyrë të domosdoshme me u këshilluar."

Përgjigja e popullit ishte kjo: Përmbajtja e urdhrit telegrafik që erdhi dje ju komunikue fjali për fjali popullit të për bam prej mysliman e të krishterë por sikurse në protestat e kërkesat e paraqitura deri më sot Portës Lartë dhe këtë herë populli na përgjigjet se kërkush nuk e pranon që Ulqini t'i jepet Malit të Zi... me 28 gusht 1880 nga e gjithë parësia Shkodrës.

Hysen Pasha pa se në këtë mënyrë nuk mundi t'ia mbërrinte qëllimit dhe mendoj që të merrej vesh drejtpërdrejt me ta me anë të aparatit telegrafik. Më 27 gusht, Ministri i luftës thirri parësinë e Shkodrës që të mbledhë në zyrën telegrafike ku u zhvillua bashkëfjalim telegrafik. Telegrafisti i Shkodrës i thotë atij të Stambollit: A doni t'ju paraqes emrat e zotnive të Shkodrës që gjenden para aparatit? Zotnit e ndershëm po presin.

Pasha i përgjigjet: Ai i Stambollit akoma ndodhet në audiencë tek Sulltani, tani sapo erdhi Ministri, cilët prej parisë gjenden pranë jush? Zotnitë që gjenden pranë aparatit janë: Daut Boriçi, Selim Efendiu, Shaban Beu, Haxhi Lohja, Selim Gjyrezi, Ethem Kazazi, Ibrahim Efendi Hoxha, Ibrahim Efendi Dragusha, Osman Bekteshi, Filip Çeka, Kolec Shiroka, Gjon Muzhani e Zef Simoni.

Biseda u zhvillua ndërmjet palëve të cilat kishin pretendimet e tyre, por ministri turk i luftës me dinakëri u thotë: Nxitoni të dorëzoni Ulqinin, nesër pres përgjigje, e keni për detyrë të domosdoshme me këshillu ata njerëz nga populli që nuk e mendojnë se brigjet e detit të Shqipërisë e të Turqisë në Evropë do të rrifen me topa prej luftanijeve që janë mbledhë në Raguzë e Zoti na ruajt ka me u marrë nëpër këmbë nderi i myslimanizmit dhe i krishterimit.

Më 9 shtator 1880, mbas dreke, me anën e një shkrese të nënshkruar dhe vulosur, Lidhja refuzoi kërkesën e Ministrit të luftës. Më 14 nëntor 1880, Dervish Pasha urdhëroi me anë të shpalljes ndalimin e largimit për në Ulqin. Gjendja e shtetdrethimit, e vendosur që më parë, zbatohet me rreptësi të madhe. Në Shkodër, nëpër pika strategjike që çonin në Ulqin, u shtuan patrullat e shumta.

Për mbrojtjen e Ulqinit filluan të vinin në Shkodër vullnetarë edhe nga krahina të tjera. Poeti patriotik 20-vjeçar Filip Shiroka, i cili në këtë

kohë ndihmoi çështjen kombëtare me shkrime si korrespondent i disa gazetave të Triestes, i frymëzuar nga qëndresa heroike e shqiptarëve në mbrojtje të Ulqinit shkroi poezinë patriotike "Në armë Shqipëri", ku ngre lart patriotizmin e popullit shqiptar dhe demaskon Kongresin e Berlinit që e quan turp të botës.

Presionet që Dervish Pasha bëri nga 7 deri më 16 nëntor 1880 ndaj Komitetit Ndërkombëtar të Lidhjes për Shkodrën, për të detyruar të dorëzonte Ulqinin, nuk dhanë rezultat. Për të shpejtuar dorëzimin e Ulqinit u angazhua konsulli anglez K. Grini dhe ai austro-hungarez F. Lipihi në Shkodër, të cilët, në marrëveshje me Dervish Pashën ushtronin trysni mbi Komitetin Ndërkombëtar të Shkodrës për ta bindur të hiqte dorë nga mbajtja e Ulqinit.

Përballë kësaj trysnie të Dervish Pashës dhe premtimeve të konsujve të huaj, më 17 nëntor 1880, shumë anëtarë të Komitetit Ndërkombëtar të Shkodrës deklaruan se hiqnin dorë nga qëndresa e armatosur në Ulqin. Ndërkohë edhe mjaft nga përfaqësuesit e krahut të moderuar kishin kapitulluar para Dervish Pashës dhe patën shkuar aq larg sa ditë më parë kishin lajmëruar telegrafisht Kuvendin e Dibrës se nuk kishin nevojë për ndihma, pasi kishin vendosur të dorëzonin qytetin. Kapitullimi i tyre shkaktoi revoltimin e atdhetarëve shkodranë, të cilët formuan një komitet të ri të Lidhjes Shqiptare për Shkodrën. Në komitetin e ri, i cili u ngrit më 19 nëntor 1880, hynë partizanët e vulosur të mbrojtjes me armë të Ulqinit si: Selim Çoba, Isuf Sokoli, Filip Çeka, Fetah Dragusha etj.

Por ngjarjet u zhvilluan me shpejtësi të madhe, përçarja në udhëheqjen e Lidhjes dobësoi forcat e saj ushtarake, sidomos me ardhjen e vullnetarëve të tjerë. Komiteti i Ri i Shkodrës nuk pati kohë të mobilizonte popullin dhe të organizonte qëndresën e armatosur kundër ushtrisë osmane. Tre ditë më vonë, më 22 nëntor 1880, ndërsa Shkodra nuk e kishte kapërcyer ende krizën e brendshme politike, Dervish Pasha i dha urdhër ushtrisë turke të fillonte marshim për në Ulqin. Atë ditë ushtritë turke u ndeshën me forcat shqiptare te Kodra e Kuqe afër fshatit Klezna. Në fillim, në Kleznë qenë përqendruar gati njëmijë luftëtarë shqiptarë, të përbërë nga vullnetarë shkodranë ulqinakë, hotjanë, prizrenas, tetovarë, kelmendas e të tjerë të udhëhequr nga vetë shtabi ushtarak ku merrnin pjesë: Isuf Sokoli, Mehmet Beu, Abdyl Hoti, Fetah Dragusha, Filip Çeka, Gjon Deda etj.

Në fillim vullnetarët shqiptarë i sprapsën ushtritë turke, por më vonë, pasi arritën reparte të tjera osmane të pajisura me artileri moderne, forcat shqiptare u thyen. Komandanti i tyre, Isuf Sokoli, u plagos rëndë dhe pak më vonë vdiq. Pasi ushtria shqiptare u thye, forcat turke vazhduan

marshimin dhe hynë në Ulqin më 23 nëntor 1880 dhe më 26 nëntor 1880 ia dorëzuan ushtrisë malazeze.

Së bashku me dorëzimin e Ulqinit mori fund dhe çështja e kufijve veriorë, e cila kishte shqetësuar për gati 30 muaj, jo vetëm perandorinë osmane, por edhe diplomacinë evropiane. Megjithatë, edhe pse çështja e kufirit turko-malazez u mbyll, lufta që zhvilluan shqiptarët kundër shantazhit brutal të Fuqive të Mëdha dhe ndërhyrjes ushtarake të Portës së Lartë la përshtypje të thella në opinion publik të Evropës. U ngritën zëra proteste kundër politikës së Fuqive të Mëdha, të cilat vendosën luftanijet për të shtypur të drejtat kombëtare të popullit shqiptar. Veç kësaj, sapo përfundoi dorëzimi i Ulqinit, Fuqitë e Mëdha filluan të largonin luftanijet njëra pas tjetrës, duke i dhënë kështu fund demonstratës navale. Pas thyerjes së rezistencës shqiptare, Fuqitë e Mëdha vendosën ta zgjidhnin çështjen e Ulqinit, duke caktuar sa më parë në terren piramidat e kufirit të ri turko-malazez. Mbas përfundimit të dorëzimit të Ulqinit, ku mbeti i plagosur dhe më pas vdiq luftëtari dhe patrioti Isuf Sokoli, kushëri i një trangu me Filip Çekën, ky i fundit jetoi në Shkodër dhe në vitin 1895 vdiq nga një goditje në zemër dhe u varros tek varrezat e Rrmajit në varrin familjar të vjetër të familjes. Ai ishte i martuar në vitin 1844 me vajzën e Gjergj Shirokës (shënim nga ditari i Mustafa Boriçit) por nuk pati fëmijë.

Me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit nga Presidenti i Kuvendit të Republikës Socialiste të Shqipërisë u dekorua me urdhrin "Për veprimtari Patriotike të klasit III".

Në shtator të vitit 1989, në kujtim të patriotit Filip Çeka është vendosur një pllakë përkujtimore me këtë motivacion: Në këtë shtëpi ka lindur dhe jetuar atdhetari Filip Pjetër Çeka, ndër autorët më aktivë të degës Lidhja Shqiptare për Shkodrën, 1878-1880.

4

AKTIVITETI PASARDHËS I FAMILJES

Familja Çeka e vazhdoi jetën e saj. Mikel Çeka u martua me një vajzë nga familja e nderuar e Shkodrës (Shiroka), Tina Palok Shiroka. Ata patën tre fëmijë: Filipin, Angjelinin dhe Gjystinën, të cilët lindën respektivisht në vitet 1898, 1900 dhe 1902.

Në një dokument dorëshkrimi në gjuhën italiane jepen disa të dhëna për familjen Mikel Çeka (Summa).

- Mikel Çeka, djali i Pjetër Summa dhe Roza Melgushi, mbajtur në pagëzim nga Pjetër Gurakuqi dhe Tereza Vladogoneja, lindur më 20 maj 1830, pagëzuar nga Dom Nikolla Valla.

- Agetina Çeka, vajza e Palok Shirokës dhe Tereza Antonia e Agostin Muzhanit, mbajtur në pagëzim nga Mikel Zef Muzhani dhe Agate Pjetër Shiroka, lindur më 9 tetor 1871, pagëzuar nga Dom Paskual Junki.

- Filip (Xhuvani, Antonio) djali i parë i Mikel Summa dhe Agetina Shiroka, mbajtur në pagëzim nga konsulli francez në Shkodër De Grand dhe Marija Berta De Grand, lindur më 20 gusht 1898, pagëzuar nga Dom Nikolla Radovani.

- Gjystina, vajza e Mikel Çekës dhe Agetina Çeka (Shiroka) mbajtur në pagëzim nga një punonjës i konsullatës franceze Albert Loffon dhe Dava Bib Doda (motra e Prenk Pashës), lindur më 19 qershor 1900 dhe pagëzuar nga Dom Gj. Serreqi. Ajo u dorëzua murgeshë shtëpie.

- Angjelini, djali tjetër i Mikel dhe Agetina Çeka, mbajtur në pagëzim nga Mikel Topalli dhe Marije Gurakuqi, lindur më 18 korrik 1902, pagëzuar nga Dom Pjetër Gucija.

- Djali tjetër i Pjetër Çekës, Filip Çeka (Summa) ka lindur në Shkodër në vitin 1825 dhe u martua në vitin 1844 me vajzën e Gjergj Shirokës por nuk patën fëmijë. Ai vdiq në vitin 1896 nga një goditje e menjëhershme gjatë kungimit në kishën S.M.

- Djali tjetër i Pjetër Çeka (Summa), Ndoc Çeka ka lindur në Shkodër rreth vitit 1828, pati dy djem, Pjetrin dhe Lecin (1844-1900) me dy djem Tonin (1886-1936) dhe dy vajza, Rozën, martuar tek Kakariqët dhe Ninën (1885-1958) martuar me Simon Shulin (1871-1955) të cilët patën djalin Zef Shuli dhe katër vajza (Liza, Gjyljana, Gjyzepina, Luçija).

Fillip Çeka (djali i Mikel Çekës) mbaroi shkollën teknike në Shkodër dhe filloi punën si financier nga viti 1916 në Shkodër, në vitin 1918 në Durrës, në vitin 1920 në Ministrinë e Financës Tiranë deri në vitin 1922.

Më vonë, në detyrën e drejtorit të Financave në Krujë mbas vitit

1922, në Lezhë në vitet 1925-1926, në Pukë në vitet 1926-1927. Më pas vazhdoi në Vlorë si Kryesekretar Prefekturë, në Delvinë 1933-1936 nënprefekt, në Kolonjë 1936-1938 dhe në Çamëri (Konispol) deri në vitin 1939.

Gjatë kohës që ishte në Shkodër, në vitin 1918 pas ikjes së austro-hungarezëve dhe me ardhjen e trupave serbe më 30 tetor 1918, së bashku me Kel Koçobashin, fshehën aktet zyrtare në shtëpi qytetare të qytetit, duke bërë të mundur që asnjë material të mos binte në duart e ushtrisë serbo-malazeze.

Gjatë luftës qëndroi më tepër afër familjes në Shkodër, përveç në periudha të shkurtra mujore kur shërben si Nënprefekt në Delvinë dhe Lushnjë, e në shtator të 1943, gjatë kohës së ardhjes së forcave gjermane në Shqipëri, bëri një akt patriotik, duke mos lejuar që qyteti i Lushnjes të digjej nga forcat gjermane.

Në vitin 1938 Filip Çeka u martua në Korçë me Marika Iljadhi, mbesa e atdhetarit Nikolla Lako, i cili ishte botanisti i parë në Shqipëri, figurë e njohur në Korçë për të cilin Bashkia e Korçës në vitin 2017 i dha titullin "Qytetar Nderi" i Korçës për aktivitetet e tij patriotike, shkencore dhe arsimore.

Nikolla Lako ka takuar personalisht presidentin amerikan Willson gjatë konferencës së parë në Paris në vitet 1919-1920, ku i ka parashkruar fakte të plota për autonominë e Shqipërisë. Ai ka hartuar edhe një hartë etnografike të Shqipërisë.

Marika Çeka (Iljadhi) e datëlindjes 1910-1968, vajza e Jorgji e Thomaidha Iljadhi, pas ardhjes në Shkodër në vitin 1957, punoi në një repart të vogël punë dore me disa gra të qytetit. Gjatë viteve të Mbretit Zog ajo u nderua me diplomë nga Enti Kombëtar "Djelmënija Shqiptare" në vitin 1931.

Ndërsa Filip Çeka në Korçë punoi si llogaritar në disa ndërmarrje të ndryshme dhe në manastirin e Kamenicës, por gjithmonë i mbikëqyrur nga sigurimi i shtetit. Për këtë fakt dëshmohet edhe në librin e Pjetër Pepës ... Tragjedia e klerit katolik... (arrestimi i Papa Josif Mihalit në vitin 1946).

Mbas vitit 1957 filloi punë në Shkodër përsëri në detyrë të thjeshtë si llogaritar në Fushë Arrëz dhe fermën e Bushatit, prej nga doli në pension me një pension tepër minimal (nuk i quajtnë vite pune nëpunësit e kohës së Mbretit Zog).

Jetoi deri në vitin 1975 vetëm me djalin e tij Engjël Çekën.

Nga martesja e Filipit me Marikën lindën dy djem Mikeli (1940) dhe Engjëlli (1944). Djali i madh, Mikeli, u martua me Terezina Toskën (Çeka) dhe kanë dy djem: Filipin dhe Eugjenin. Filipi është martuar

me Ani Pogu dhe kanë dy djem, Jim dhe Nikolas. Ndërsa Eugjeni është martuar me Liana Frashëri dhe kanë dy djem dhe një vajzë, Michael, Christian dhe Barbara. Të dy djemtë, Filipi dhe Eugjeni jetojnë dhe punojnë në Gjermani. Më parë, Mikeli ka punuar me detyrë Zooteknik i Lartë në Shkodër.

Engjëll Çeka, me profesion ekonomist, ka punuar në Lezhë e Shkodër dhe në vitet 1993-2006 ka qenë kryetar i degës doganore dhe doganier në Shkodër. Jeton në Shkodër dhe është i martuar me Florinda Tef Çeka, e cila ka kryer shkollën e lartë për mësuesi. Ajo ka punuar për rreth 15 vite si mësuese muzike dhe e ciklit të ulët në Shkodër. Sot, ajo drejton kopshtin dhe shkollën private 9-vjeçare "Miqësia", objekt i ndërtuar në pronat e familjes Çeka, në afërsi të banesës që jetojnë.

Nga martesë e Engjëllit dhe Florës lindën dy djem: Gjorgji, me profesion ekonomist dhe Ervini me profesion mësues. Gjorgji është martuar me Zoga Guri (ekonomiste) dhe kanë dy djem: Sebastjanin dhe Klausin. Ervini është martuar me Luida Ujka (ekonomiste) dhe po ashtu kanë dy djem: Engelin dhe Jonasin.

Shtëpia ku jeton familja Çeka është ndërtesë mjaft solide me një vjetërsi rreth 250-vjeçare, e shpallur monument kulture në vitin 1963, kategoria I. Ajo ka vlerë historike e arkitektonike dhe është mjaft e mirëmbajtur. Shtëpia vizitohet nga shumë vizitorë të huaj dhe vendas.

Falë paraardhësve të familjes, të cilët kanë lënë mjaft pasuri, kryesisht tokë, si në Shkodër, Vrakë, Zejmen etj., u krijua mundësia e ndërtimit të shkollës "Miqësia".

Në vitin 1966 i janë dhuruar Arkivit të Shtetit Shqiptar shumë dokumente, të cilat do të plotësojnë më tej historinë e familjes Çeka.

Historia e popullit shqiptar dhe veçanërisht e atij shkodran, është e mbushur me plot veprime, iniciativa dhe përkushtime ndaj çështjes kombëtare.

E në këtë histori ka luajtur rolin e saj edhe familja ÇEKA (SUMMA).

• Trashëgimi kulturor •**Gjush SHELDIA****DARMA NË DUKAGJIN****1. Shkuesija:**

Në malësinë e vogël si quhej deri vonë krahina e Dukagjinit, kur prindi bante mendim me i avitë përbri të birit shoqen e jetës, si merrte edhe mendimin e pëlqimin e pjesëtarëve të tjerë të shtëpisë, i a vente synin njasaj vashe, e cila i dukej se i kishte të gjitha vetitë dhe cillësitë për të kenë një shoqe jetet si duhet për të birin dhe njiherit për qéf të shtëpisë; atëherë, me anë të miqëve e të njoftunve, niste me ba hetimet e duhuna. Po qe se aj sigurohej moralisht se familja e vajzës kishte për t'a pranue me andje kërkesën e fejesës, o pse tui ba gjakun bashkë dy shtëpijat kishin leverdi ose këqyrëshin me sy të mire lidhjen e krushqisë ndërmjet tyne, i zotin i konakut shkonte vetë *me lypë vajzën*; kur nuk ishte tamam i sigurtë se kërkesa do të pëlqehet, atëherë çonte *shkuesin* tue i a lanë zotësisë dhe squetësisë së tij kryemjen e fejesës.

Po qe se shkuesit puna i shkonte mbarë kur kthehej kahë djali, pritej me nderim, gëzim e kënaqësi të madhe.

Mbasi kalojshin disa ditë, shkuesi shkonte përsëri në shtëpi të vajzës *me këputë punë*, domethanë me krye përfundimisht fejesën e cila merrte fund në shtëpi të sajë pa qenë pranë djali.

Në ditën e caktueme ana e vajzës përgatitëshin gostën ku merrshin pjesë shpijarët dhe ilakatë ma t'afërmit me gjak si dhe ndonjë mik i ngushtë i shpisë, nuni, kumbara, axha, daja, etj. Shkuesi, këso here, shoqënohej prej babës së djalit dhe kur ky mungonte, zavendësohej prej axhës, dajës apo dhandërrit të shpisë.

Si mbërrijshin në konak të vajzës, pritëshin me fjalë të mira, me përzemërsi; si piheshin kafet dhe shëndrroheshin *qeset e duhanit* ulej treveza (sofra) dhe *shtrohej pija*: raki, djathë, qepë, bukë. Gotën e parë e çonte i ati i djalit me këto fjalë: "Na kjoftë për hajr mikësija!" mandej të tjerët me radhë, sipas moshe, mashkujt e anës së vajzës, tui pri me të njajtin urim. Si kanë çue gotat e para nisej biseda rreth *merqirit* dhe kështu *këputej puna* domethanë caktohej shuma që do të paguente djali; në kohën e Turkisë *paret e nuses*, ishin 300 grosh, që derdheshin aty për aty. Ma vonë *paret e nuses* pësuene ndryshime sipas pares në qarkullim, por gjithmonë në bazë të vleftës fillestare. Derdhja e të hollave bahej edhe po t'ishte vajza foshnje; kusuri paguhej një vjetë para martese.

Ishte zakon, deri në vitin 1920, që të nesërmen, porsa lindëte dielli, me dhanë *kumtin e fejesës* me një batare pushkë, përcjellë me urimet e rastit.

Në të dalun, baba i djalit, ishte zakon, "me falë gratë e shtëpisë" tue i lëshue në grusht nga një sasi groshësh, simbas kamit, e, jo vetëm atyne por edhe motrave të vajzës, kur këto ishin të martueme.

Kur vinte koha e caktueme *me pague merqirin* i ati i djalit thirrëte shkuesin dhe babën e vajzës, që të shoqnuem prej ndonjë miku të ngushtë, pritëshin mire dhe u shtrohej gosta. Si çohej sofa, dorëzohej mërqiri, por kur ky përbahej nga armë ase bagëti, çmimi i tyne bahej të nesërmen dhe si përfundonte marrëveshtja, baba i vajzës siell e i falte ndonjë krye bagëtije t'imtë, si dash, sqjek, skjap etj, me vleftë rreth 50 groshave, për shpenzimet e darkës, mjesa baba i djalit ti falte, nanës së të fejuemes 100 grosh, që quheshin "paret e krushkës".

Kur afrohej koha në të cilën i ati i djalit ka pasë ba mendim me i prue nusen djalit, shkohej te konaku i vajzës "me da rrogun". Në këtë rast caktohej dita kur një shpijar i vajzës do të shkonte tek i fejuemi "me marrë fenë e unazës" që ishte një dhuratë e përbame prej katër okë djathë, katër okë raki e dy krenë dhen.

Pak ditë para darsme një shpijar i djalit dhe një i vajzës bijshin në qytet për të blé *sermajen* e vajzës.

2. Veshja:

Kjo përbahej nga: *disa shamija me ngyra, pasta e kresë, një palë vâthë, një pasqyrë, pesë gjylnere për të thurë çorape, ndonji kallëp sapun, jeleku, rrypi shollit me thumba kallajit, një palë opanga.* Të gjitha këto paguheshin nga ana e djalit mjesa për pjesën tjetër të pajës mendonte vetë shpija e vajzës e cila niste përgatitjen e saj me kohë dhe e ndihmueme prej shoqeve të vajzës si p.sh. qepja e të lintave, këmishave, etj., që do të veshte nusja si ditën e martesës si dhe gjatë vjetit.

Duhet shënue këtu se veshja e njenës krahinë ndyshonte shumë prej një krahine tjetër; ndryshim të madh kishin edhe kostumet ndërmjet Malësisë së Madhe e të Malësisë së vogël, ndërmjet këtyne dhe Mirëditës, Pukës etj.

Qe, tashti, prej çka përbahej veshja e nuses së Malësisë së vogël:

1. *Këmisha*, pëlhere të bardhë me krahë të gjanë.
2. *Tlintat*, pëlhere të bardhë, të gjana dhe të gjata deri në gju.
3. *Xhubleta*: ba me shajak, e hapun në gjoks, që mbërrinë deri nën gju. Xhubleta ishte dy sojesh: me mangë e pa to. Ajo pa mangë që thirrej "petka të bardha" ishte e punueme me shajak të bardhë, me vija të zeza rreth e rrotullë, që përdorej në Malsi të vogël edhe në Nikaj-Mertur; kjo -ka gjasë- se paraqet tipin ma të moçëm të xhubletës.
- Ajo me mangë, quejtë "petka të kuqe", ishte e zezë, qëndisë me lajle e zbukurime të kuqe e shpesh sermit të bardhë. Nuset që veshënin xhubletën e bardhë syri sajë veshënin:
4. *Zhgunit*, që ishte si një fund, i hapun aq sa ishte i gjatë, me krahë, zbukurue me lajle kuq -zi. Syri zhgunit veshej:
5. *Jeleku*, pakrahë, i hapun në gjoks, me dy rreshta sumbullash pričit, përpara-anash, e me tufa leshit të kuq-ufullë, në cepa të krahëve. Por nuset që veshënin xhubletën e kuqe, syri sajë kishin:
6. *Xhoken*, shajakut të zi, me qëndisje dhe vizatime më të kuq; n'ije ishte ma e mbledhun dhe zgjatej teposhte.
7. *Gryksa*, një soj mbulese gjoksi, zbukurue zakonisht me qëndisje në serm të praruem; këtë e veshënin të gjitha nuset pa përjashtim.
8. *Pështjellaku*, si dy përparëse që veheshin para dhe mbrapa, tui lanë haptë anët e poshtëme të trupit. Pështjellaku i pjesës përpara ishte ma i madh dhe i zbukuruem me lajle, shpesh sermit të praruem. Zakonisht mbizotnonte ngyra e zezë. Pështjellaku përmbropa ishte ma i vogël, ngyre të kuqe, me vizatime në të zi e bardh.

9. *Brezi*, leshit të kuq, me vija të zeza, që mbështillte belin.
10. *Rrypi*, lëkure të fortë, gjanë 8-15 cm me pulla kallaji në pjesën e jashtëme dhe me disa rrathë priçit, ku varehin: *brisku*, *çilci*, *gërshanët*, *masha* për të marrë gacen me i ndezë cingaren mashkujve.
11. *Çorapët*, çorapët punoheshin me lesh të nyjem kuq-zi, me lajle e ojna, me të vërtetë artistike. Çorapët ishin të gjatë deri në gju.
12. *Shputat*, çorapë që mbrijnë deri në nje të kambës, leshit, me njyra kuq-zi, vjollcë, zbukurue me bordura sermi të praruem. Mbathen përsipri çorapve.
13. *Opangat*, punue me lëkurë të trashë, pa taka, me gjalma mbi trinë, lidhë me rryp. Opangat, asokohe, punoheshin prej grave.
14. *Kapica*, *pafta*: Në krye vejshin *kapicën* që kishte sipri *paften* sermit të praruem në tars të diademës; shpesh për rreth sajë varehin pare e xhingla të ndryshme. Për kësulë kapeshin 1-2 shamija të bardha apo të zverdheme, me thakë, që lëshoheshin varun mbas shpine tui mbulue paksa shpatullat.
15. *Qosteku*: Mandej i varëshin qostekun mbushë me *pare*, *kryqa*, *medaja*, *hajmalija*.
16. *Vâthët*: Ndër veshë i varehin vâthët që ishin të punuem në serm, të lehtë e të vegjël, që lidheshin njeni me tjetrin me një sinxhir i cili mbështetej për qafë.

3. Darsma:

Për malësorët tonë-si dhe për të gjithë shqiptarët në përgjithësi – martesa ishte një ndër aktet ma solemne të jetës. Ajo ditë nuk ishte vetëm një kremte familjet por një festim botnuer, mbasi -zakonisht – në darsëm merrnin pjesë jo vetëm gjaku, farë e fisi por edhe kojshitë, kështu që gëzimi e hareja përgjithësohej.

Zakonisht darsma bahej n'e hane; me këtë rasë gjithë familja, ndihmue nga t'afërmit rregullonte shtëpinë dhe avitë me kohë çka nevojitet për të pritë sa ma mirë e ma nusen.

Natën e darsmës, nga ana e djalit, dërgoheshin darsmorët e darsmoreshat me marrë nusen; këtyne u printe *gjeveri* i cili duhej t' ishte një ilaka fort i afërm i dhandërrit.

Për nderë të *krushqëve* e të *krushkave*, shpija e vajzës përgatitej për sofër ku merrshin pjesë ilaka e miq.

Zakoni e lypte që krushqit të mbrireshin aty afër prendimit të diellit që pritëshin me një batare pushkësh dhe me përsëritjen: "Mbramja

e mirë!" Nusja, porsa ndiente krismën, do të ja niste me kja, fshâ e gjimue, me dënesë, për të dishmue kështu dhimbjen që ndiente për shkëputjen që po afrohej, nga votra e prindes.

Porsa xejshin vend n'odë, i vinte kafja, duhani e niste biseda që vinte gjithnjë tui u gjallnue dhe që zgjatej deri n'orët e vona të natës.

Shtrohej sofa dhe ulej rakia me meze e niste biseda me urime nga të dy palët; mandej ulej buka; në fillim bukë, djathë e qepë e mandej pshesha me lang mishit dhe *ferriku*.

Të nesërmen krushqit veheshin për rrugë, në mënyrë që kahë mbramja të mbrijshin në shpi të dhandrrit.

Nadje herët, gratë e shpisë, ndihmue prej mikneshave, përgatisin nusen: e lajnë, e krehin, i a lyejnë flokët me *makh*, i veshin teshat e nusië dhe e zbukurojnë me *sermaje*.

Një djalë, që mos të jetë jetim, i vën nuses *duvakun* - që ishte simbol i virgjinërisë - i cili do t'i hiqet të nesërmen e darsmës.

Porsa korteu merrte me dalë shpije, nusja, tui kja e dënesë, shkante e rrokte *vargonin e votrës* prej të cilit e shkëputëshin me zor e me mund gjindët e shpisë; mandej tui kja e lotue përqafonte prinden e i lypte *hallallin*. Të gjithë përmalloheshin por asnji burrë nuk shifej tui kja. Të gjitha këto çfaqje kishin një kuptim të madh moralitetit sepse dishmojshin shkëputjen e dhimbëshme të vajzës prej konakut të vet, prej kujtimeve të fëminisë dhe të vajzënisë, për të i u lëshue ndër krahë një të panjoftuni deri atëherë, me ba pjesë në një konak të ri, me fillue një jetë të re.

Kur nusja, mbajtë prej ilakave, delte prakun e shpisë, përcjellësi shprazte një batare pushkë e kur kjo delte n'oborr, e ama e përqafonte edhe një herë e mandej xente vend aty mjesa ilakatë tjerë e përciellshin ende pak. Nusja megjithëse e mbulueme, herë pas here, përshëndeste shpijarët me t'ulun kreje.

Kur mbrijshin aty ku do të ndaheshin, nusja përqafohej edhe një herë me të gjithë, një nga një, tui dënesë me të madhe; mandej e hypëshin në kalë ase në mushkë -prue enkas prej krushqëve; këtu kriste batarja shoqnie me urimet: "Për hajr e me nafakë!", "U kjoftë rruga e mbarë!".

Zakon ishte që shprazjen e fundit me i a lane anës së djalit, në përshëndetjet me shtimje pushkësh derisa nuk shifesh ma korteu darsmuer.

Gjatë rrugës, kur ndonjë shtegtar ndeshte në darsmorë, e kishte për detyrë me *qitë një herë* përcjellë me urimin: "Për hajr!". Këtij i

përgjegjëshin krushqit me një batare dhe i qitëshin me pi raki që e merrshin gjithmonë me vedi.

Ndërkaq shtëpija e dhandërrit vëlonte prej miqve darsmorë e darsmoresha, numri i të cilëve, shpesh kapej në 100-200 vetë, kur shpija e djalit ishte e kamun. Mund të merret me mend se sa shpenzimet duheshin përballue në raste të tilla!

Kur korteu i avitesh shtëpisë së dhandërrit i delshin para disa miq darsmorë dhe i përshëndetëshin me batare pushkësh mandej ma i moçmi me moshë ndalej dhe lëshonte zâ:

- Mbramja e mirë N-N!

Gjindët e shtëpisë dhe darsmorët i gjegjëshin me të madhe:

- Mirë se vjen!

Kur nusja hyente n' oborr të shpisë së dhandërrit, e merrte për dore *gjeveri* dhe e shtinte në shtëpi; porsa nusja e shkulte prakun e konakut, gjeveri shprazte alltijen, e të pranishmit i përgjegjëshin me të shtime pushkësh.

Për t'u vue në dukje këtu asht se si dhandërrit nuk shifej kund dhe ishte i veshun ma keq se tjera ditë, si në ditë pune e këta bahej me ia lanë nderen miqasisë me u dukë ma bukur.

Kur nusen e shtijshin n'odë dhe ulej në fron-karrigë me brryla dhe shpinzë, e dalueme për bukuri me lajle e ojna, ku spikaste zogu, punue nga mjeshtra gdhenës vendas – vendojshin në prehen të nuses një fëmi mashkull dy-tre vjeçarë, të cilit nusja i falte një palë shputa me një kokërr mollë mbrendë. Mandej, mjes dy grave, njena kahë gjaku i babës e tjetra kahë aj i nanës, e çojshin në skaj t'odës ku do të qëndronte në kambë, pa folë, mbulue me duvak; kështu do të qëndronte sa ngëjatëte sofrë, kanga e këcimi.

Kangët nuk ishin krejtësisht darsme por burrnije, trimnije, këndue *maje krahit* prej ma të mirëve kangatarë dhe rapsodë. Njehej dhe mbahej për ma i miri kangatar njaj i cili mbrrinte me e zgjatë sa ma shum intonacionin e fundit. Zakonisht këndojshin burrat por kishte edhe vasha; të shumtën e herës kangët përçielleshin me lahutë.

Vetëm ditën e darsmës këcehej; këcimi bahej kështu: një mashkull e një femën. Mashkulli me revolver në brez delte në log zbashkut me një nuse të ré e cila mbante në duer ka dy shamija thirrun *ruba*. Pa asnjë përcjellje muzike vetëm tui shkrepë kambët ritmikisht, herë njenën herë tjetrën, shoqnohej me të shtime pushke. Këcimi ishte i randë, i mundëshëm, e vetëm kur djersa rridhte çurg atëherë mashkulli i shprazte

revolen dhe mjes tymit përfaqonte valltaren.

Si tërhiqesh një çift nderhyente tjetri; në këcim merrnin pjesë vetëm nusët dhe virgjineshat.

Para se me shtruar sofrat, d.m.th. para se me nisë me hangër, sepse sofrat ishte e shtruar që kur kishte filluar pija, çoheshin dhe lajshin duert *simbas kanunit*, të cilin aj që ishte i ngarkuem duhej ta njipte e dinte mirë për mos me ra në gabim me vendue pa mend ndonji që nuk i përket sepse mund të kishte pasoja tragjike.

Vlen këtu të ceket kalimthi çka pat ndodhë në një darsëm në Shllak në vitin 1922, ku për një të lamë duersh u vranë 12 vetë e mbetën të shituem shumë të tjerë.

Këtu nuk asht nevoja të shenjoj se kush e kishte preçedencën sepse Kanuni e ka pasë përcaktue mirë.

Kur moti ishte i bukur, trevezat shtroheshin n'oborr të shtëpisë ase në livadhin përbri; mysafirt uleshin kambëkryq rreth sajë. Tërveza e rrumbullakët, punue me dru ahi, e sheshtë, e lëmuetë, me katër kambë 15 cm e naltë, rreth së cilës mund të mblidheshin 8-10 vetë. Vetëm lugë druni punue me bush, piru e thikë as nuk njifeshin.

Mishi merrej me gishta. Ndoshta ka mujtë, gjatë shekujve, me ndikue thanja e Muhametit i cili ka lanë fjalë se: "bekimi i Allahut asht n'atë gjellë që hahet me gishta". Të gjithë hajshin në një *çanak* të madh. Zakonisht ishin *bluda* zgavrrue në dru ahi ose bushi.

Gratë hajshin veças, me përjashtim të darsmoreshave që uleshin në sofër bashkë me burra.

Gjella ishte e thjeshtë: bukë, djathë, qepë, në fillim, mandej ulej mishi me oriz ase dimnit, me lakna; buka ishte misrit. Mbëkamsit e kishin për detyrë me pëvetë, kah mbarimi i sofrës:

- Kush asht për vënë, mos të pijnë kos!

Sofrat e shtruar ishin të shumta.

Vëna pihej pa masë por pa kalie kufinin sepse sejcilli ruhej fort mos me gabue ase me u shtye ndër fjalë.

Natën vonë bien me fjetë; t'afërmit me banim shkojshin ndër shtëpija të veta për të këthye të nesërmen prep.

Nusja kalonte natën, here me njanën, here me tjetrën ndër darsmoresha.

Në nesre e çojshin nusen, mblue me duvak, në vendin e maparshëm e porsa mblidheshin miqësija e grishun, gjeveri i avitej dhe i hiqte duvakun, mjesa nusja ndejtë ndrejhtë, mpimë në kambë, kuqej e ndezej,

me sy përdhe: të gjithë e urojshin: "Për hajr e me nafakë!" mjesa burrat qitëshin pushkë në shej gëzimi.

Nusja, me anën e gjeverit, i falte mashkujve të shtëpisë së burrit ka një palë shputa e çorapë, mjesa grave e darsmoreshave vetëm ka një palë çorape të gjatë.

Përveç kësaj, në rasë se në fisin e burrit gjendej ndonjë bashkëfshatare e martueme aty dhe kishte djalë, nusja i çonte një palë çorape fëmijshë.

Të gjithë ata që merrshin të *fatat e nuses* kishin për detyrë me e thirrë në gostë ku ajo shkonte e shoqnueme prej një ilakaje e të shojt.

Në këtë ditë ase të nesërmen, çifti i përcjellun prej dy kumbarëve, shkonte në kishë me *vue kunorë*. Ishte zakon që vajza mos me dhanë menjihërë pëlqimin e kërkuem me ngulm prej meshtarit por me ngurrue pak.

Sibert, në studimin e tij, në fq. 240 thotë se "ka ndollë që me u shtye vuemja e kunorës deri me lindjen e fëmijës së pare". Nuk due të vë në dyshim auktoritetin e auktorit – dhe ka gjasë e të ketë pasë raste sporadike- por për sa kam mujtë me hetue vetë për këtë mjaftojnë dëshmitë e plakut shalnjanë Marash Kola nga Pjesholli i Gimajt-Dukagjin, i cili tesh vonë ka dekë në moshën 110 vjeç dhe sipas rregjistrit të pagëzuemve të katundit Aba¹ Shalë delte ashtu me moshë-; ky më pat thane se aj nuk mbante mend të ketë ndollë gjatë jetës së tij një gja e tillë. Ka pasë raste kur kisha famullitare ishte larg, me e shtye ndonjë ditë vuemjen e kunorës.

Në Shkrel, në vitin 1909, pat ndollë që një vashë e pashme, shtathjedhtë, i pat gjegjë priftit me vendosmëni:

- Jo, nuk e due!

Tue qenë fyemje e randë për një burrë malsije, dhandërri, i cili ishte i mbrapshtë për të pamë e me trup sepse i shkjeptë, burri vuni dorën në armë, në brez, për me e vra aty për aty, por ndërhyemja e shpejtë e famullitarit bani që të mos derdhej gjak. Nusen e ndryni në një odë të qelës famullitare tui e vue në rojë të disa grave të katundit. Mbas do kohe, ndoshta tui drashtë se mos të bahej shkaktare e një vargu vrasjesh dhe gjakësish, nusja pranoi e dhandërri, mbas shum e shum lutjeve dhe përpjekjeve të miqve pëlqeu me lidhë kunorë me njetë që e kishte përbuzë botnisht.

Sado e mbrapshtë ase me gand me pasë qenë nusja, nuk ka ndollë që mashkulli me e braktisë e përbuzë; këtë sepse ishin të shtruem fatalitetit

¹ Në dorëshkrim nuk lexohet qartë emri i katundit.

tue ia ba qefin vedit me këto fjalë:

- Ka kenë kismet! Zoti ma ka çue!

Darsma zgjatej tri ditë; mandej, largue miqësija, xente fill jeta bashkëshortore.

Tui kenë se banesa ishte e përbashkët -zakonisht të gjithë flejshin në të njëjtën dhomë – dhandërr e nuse bijshin me fjetë në një qoshe t'odës ase mbas një arke dhe marrëdhanjet e tyre intime ishin të mbulueme me mister.

Si ditën e darsmës e deri në tri javë, ishte kori e madhe me pasë për të shkue gjindja e vajzës me pa nusen.

Përcjellë prej një ilakaje të burrit, nusja e veshun si ditën e darsmës, shkonte në *pasi*, ku rrinte në gjini disa javë simbas lejes që i kishte dhanë i zoti i shtëpisë. Mandej këthehej në konak e te prindët shkonte vetëm për *festë të bajrakut* dhe për *festë të bijave* që lutej me 26 korrik, që njëherit ishte e *kremtja e çobajve*.

• Histori •

Gëzim H. JUKA

**PËRFAQËSUESIT E PUSHTETIT QËNDROR NË NIVELIN
VENDOR NË SHKODËR**

Në sistemin e qeverisjes vendore, në momentin e shpalljes së Pavarësisë me 28 nëntor 1912, qyteti i Shkodrës si pjesë e Perandorisë Osmane, qeverisej nga valiu. Valiu emërohej nga pushteti qendror në këtë rast nga sulltani. Valiu, në përshtatje të emrit dhe detyrës që kryente, do ketë në vazhdimësi emërtimin “gubernator” e në disa raste edhe “qeveritari” e në fund “prefekti”. Si valiu ashtu edhe prefekti janë “syri dhe veshi” i qeverisë në pushtetin vendor. Kështu mund të ngjasojë edhe detyra e sekretarit të partisë së rrethit në vitet 1945 – 1990.

Në periudhën e shtetit shqiptar në vazhdimësi Shkodra ka qenë qendër prefekturë. Ka patur nën prefektura Malësinë e Madhe, Lezhën, Mirditën, Pukën dhe Dukagjinin siç dhe sot ka Malësinë e Madhe dhe Pukën. Kur prefekti mungonte ose transferohej deri në zevendësim detyrën e tij e ushtronte qarkomandanti i xhandarmërisë. Prefekti emërohej me propozim të ministrit të brendshëm dhe me miratim të qeverisë. Dekretohej nga kryetari i shtetit. Prefekti varej dhe kishte kontakt me qeverinë ndërmjet Ministrisë së Brendshme. Gjatë kohës që ushtronte detyrën pa ardhur dekreti, nënshkruante Zv/prefekt që do thotë: në zevendësim të prefektit.

Ky punim përshin prefektët nga 1912 – 2020 duke iu referuar shtypit në vite, fletore zyrtare në vite, dokumenteve në AQSH si dhe punimit tim :” Shteti Shqiptar dhe Shkodra 1912 – 2012”

PJESA E PARË – 1912 – 1944.

Hasan Riza Pasha

....28 nëntor 1912 – 31 janar 1913

Pavarësia e Shqipërisë e gjeti në krye të detyrës. Hasan Riza Pasha ishte emëruar nga sulltani: Vali i Shkodrës. Ai ishte drejtues i forcave ushtarake dhe në këtë moment të luftës ballkanike ishte drejtues civil dhe ushtarak. Në tetor të 1912 Shkodra ishte rrethuar nga malazezët me preteks se po luftonin kundër Perandorisë Osmane. Me forcat ushtarake turke, redifet e Esat Pashës dhe qytetarët shkodranë Hasan Riza Pasha qëndroi në mbrojtje të qytetit nga rrethimi i Malit të Zi. Hasan Riza Pasha u vra me 31 janar 1913 nga njerëz të panjohur, sëpaku zyrtarisht.

Esad Pashë Toptani

1 shkurt 1913 – 24 prill 1913.

Mbas vrasjes së Hasan Riza Pashës detyren e tij e mori Esad Pashë Toptani. Esad Pasha ishte zv/komandant dhe kish ardhur në Shkodër i shoqëruar nga një numër "redifësh" (vullnetarë) siç quheshin luftëtarët e tij. Esad Pasha vazhdoi të drejtojë rezistencen deri me 24 prill 1913. Me 22 mars 1913 Konferenca e Ambasadorve caktoi kufirin verior të Shqipërisë dhe Shkodra ngeli brenda shtetit shqiptar. Këtë fakt e shfrytëzoi Esad Pasha për të dorëzuar qytetin. Thuhet që Krajl i Malit të Zi i dërgoi lutësa me dhurata Esad Pashës që të dorëzonte formalisht qytetin.

Gjatë 7 muajve të luftës për Shkodrën numri i malazëzve të vrarë ishte i tillë sa që çdo shtëpi në Mal të Zi kishte sipër derës një cohë të zeze. Kjo e bënte Krajlintë ndihej keq përpara popullit të tij. Esad Pasha pas një muaji nga caktimi i Shkodrës brenda Shqipërisë e dorëzoi qytetin. Në marrëveshjen e nënshkrueme për dorëzim të Shkodrës, Esad Pasha nënshkruan:

Nëkamci i Valiut e Urdhëntari i Ushtrisë të Shkodrës, Xhenerali i Urdis, Esadi.

Petar Plamenac

28 prill 1913 – 14 maj 1913

Forcat e Malit të Zi hynë në Shkodër me mburrje e brohoritje për Krajlin Nikolla. Guvernator i Shkodrës u emërua Petar Plamenac.

Fuqitë e mëdha europiane e konsideruan pushtim të një territori, pjesë integrale e Shqipërisë, sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të zhvilluar në Londër. Forcat malazeze qëndruan vetëm 3 javë në Shkodër. Malazetët u larguan duke mallkuar Europen që ju çoi dëm gjakun e derdhur për Shkodren.

Sesil Brnej (Cecil Burney)

15 maj 1913 – 19 tetor 1913

Me largimin e forcave malazeze Shkodra për shkak të rendësisë u vendos që për një periudhë kohore të mbikqyret nga një Komision i Fuqive të Mëdha: Anglia, Franca, Italia, Rusia, Austro-Hungaria, Gjermania.

Guvernator u caktua Sesil Brnej i cili qëndroi gjer në tetor 1913 dhe u largua me sherbim tjetër.

Koloneli De Philips

19 tetor 1913 – korrik 1914

Detyrën e Guvernatorit të Shkodrës e mori Koloneli De Philips. Ai qëndroi gjer në korrik 1914 ku me fillimin e Luftës së Parë Botërore, Komisioni ndërkombëtar u largua dhe detyrën ia ngarkoi 12 zotërinjve shkodranë duke patur këshilltarë konsujt që gjindeshin në Shkodër.

Komisioni Kujdestarë me 12 zotërinjtë:

Preng Pasha, Shuk Serreqi, Shan Deda, Filip Kraja, Ndoc Coba, Sylço Beg Bushati, Muharrem Kazazi, Alush Lohja, Jusuf Efendi Golemi, Myrto Llazani, Haxhi Seferi.

korrik 1914 – 26 qershor 1915

Këto e moren detyrën në korrik 1914 me fillimin e Luftës Botërore duke patur këshilltarë konsujt e Fuqive të Mëdha që ishin atashuar historikisht në Shkodër. Në maj 1915 ndodhi një tërheqje nga anëtarët e krishterë të komisionit. Tërheqje e cila nuk kishte arsye të njohura publike.

Me 25 maj 1915 u mbledhen rreth 50 vetë të krishterë përfaqësues të mehallave dhe pasi morën vendim që edhe nëse del nga votimi, ndonjeri nga anëtarët që kanë qenë më përpara do jenë idetyruar të qëndrojnë në detyrë; u votua dhe dolën këto zotërinj: Luigj Gurakuqi, Filip Kraja, Shuk Serreqi, Luigj Deda, Patuk Saraçi, Gasper Daragjati të cilët gjer me 26 qershor sëbashku me 6 përfaqësuesit muslimanë ishin Drejtuesi

ose Prefekti i qytetit.

Bozho Petroviç

27 qershor 1915 – 22 janar 1916.

Mali i Zi në luftën e parë botërore ishte kundër Austro- Hungarisë dhe Gjermanisë. Nga data 21 qershor 1915 komandanti i trupave malazeze i kërkoi takim Kryetarit të Bashkisë Muharrem Beg Gjylbegu. Ai kërkoi që si rezultat i operacioneve luftarake duhej të hynin në Shkodër. Kështu pas bashkëbisedimit me Myftarët (kryetaret) e lagjeve, ushtria malazeze hyri në formë rrjeshtore në Shkodër. Guvernator u caktua Bozho Petroviç i cili qëndroi gjer sa erdhen forcat Austro – Hungareze.

Konsulli August Kral

mars 1916 – tetor 1918

Me 23 janar 1916 hynë nga ura e Bunës trupat ushtarake të Austro – Hungarisë me drejtues Injac Trollman. Me krijimin e zonës Austro – Hungareze të Shqipërisë u caktua Guvernator Konsulli August Kral i cili kishte qenë edhe më parë në Shkodër. Qëndroi deri në mbarim të luftës në tetor 1918.

Bardi De Fuortou

31 tetor 1918 – 12 mars 1920

Me mbarim të luftës botërore Shkodra përsëri u drejtua nga forcat ndërkombëtare. Mungonte Austro- Hungaria dhe Gjermania që kishin humbur luftën si dhe Rusia që si rezultat i ardhjes së komunistëve në pushtet ishte larguar nga roli i qasjes së çeshtjeve të europës. Antanta emëroi guvernator Bardi De Fourtou i cili qëndroi gjer në bashkimin e Shkodrës me qeverinë kombëtare me 13 mars 1920.

Fejzi Alizoti – 1914

Bajram Fevziu – 5 mars 1919

Ali Fehmi Kosturi - 1919 – 12 mars 1920.

Duhet të theksohet që caktimi i Shkodrës nën kujdestarinë ndërkombëtare nga ana territorit mbulonte qytetin dhe një rreze 10 km në fshatra. Malësia, Lezha, Puka, Mirdita qe ishin pjesë e Prefekturës Shkodër drejtoreshin nga qeveria e Turhan Pashës me qendër prefekturë Lezha. Kjo qeveri në periudhën e Princ Wiedit në 1914 kishte emëruar Fejzi Alizotin që nuk e kam vertetuar nëse arriti të vinte në Lezhë . Gjithashtu në mars 1919 u emërua Kryesekretar i Prefekturës me

funksione prefekti Bajram Fevziu. Po atë vit 1919 e gjer që Shkodra u bashkua me qeverinë kombëtare me 13 mars 1920 Prefekt i Prefekturës Shkodër ishte Ali Fehmi Kosturi.

Ahmet Zogu (Sulço Beg Bushati, Shuk Serreqi)

13 mars 1920 – gusht 1921

Me 12 mars 1920 Guvernatori Bardi De Fourtou i dorëzoi pushtetin Keshillit të Bashkisë Shkodër. Ministri i Drejtësisë Hoxha Kadria dhe Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu erdhën të marrin në dorëzim qytetin. Ata vendosën që detyrën e Prefektit të Shkodrës ta ushtrojë vetë Ministri Ahmet Zogu i cili duke qenë në Tiranë emroi dy ndihmes prefektë Sulço Beg Bushatin dhe Shuk Serreqin. Këto kaluan me sukses ate që quhet "Lufta e Koplikut" ku Sulço Begu ishte komandant i vullnetarve shkodranë. Siç konstatohet në shtypin e kohës këto dy zv/prefektë e mbajten detyren gjer në gusht 1921.

Xhafer Ypi

gusht 1921 – dhjetor 1921

Pas dy ndihmës prefektëve konsensualë siç do quheshin sot Xhafer Ypi është Prefekti i parë i emruar sipas ligjeve të shtetit shqiptar. Qëndroi gjer me 24 dhjetor 1921 pasi mori përsipër detyrën e kryeministrit. Prefekturën ia dorëzoi drejtuesit më të lartë të xhandarmërisë.

Ali Riza Kolonja

dhjetor 1921 – maj 1922

Ali Rizaja ishte zv/prefekt dhe komandant i xhandarmërisë. Në dokumente pasqyrohet veçanërisht një shkresë e marsit të 1922 kur detyrohet të marrë veprime të armatosura kundër kryengritjeve të Elez Isufit dhe Bajram Currit. Gjithashtu është perfaqësuesi shqiptar në Komisionin ndërkombëtar të vendosjes së kufirit verior të Shqipërisë.

Abedin Nepravishta

maj 1922 – nëntor 1922

Emërohet me 24 maj 1922 por u largua shpejt me detyrë në Durrës.

Rauf Fico

nëntor 1922 – korrik 1923

Rauf Fico u emërua zv/prefekt. Ai ishte Sekretar i Ministrisë Punëve

të Brendshme, detyrë që vazhdoi ta mbajë njëkohësisht.

Abedin Nepravishta

korrik 1923 – maj 1924

Rikthehet përsëri në Shkodër Abedin Nepravishta dhe në dokumente firmosë që në korrik 1923. Ishte në detyrë gjatë grushtit të shtetit të opozitës në qershor 1924. Në Shkodër opozita drejtohej nga Luigj Gurakuqi dhe Sulço Beg Bushati. Prefekti Nepravishta, Komandanti Xhandarmërisë Ferit Frashëri dhe Kryetari i Bashkisë Musa Juka i cili sëbashku me Shuk Serreqin drejtonin grupimin popullor në Shkodër me forcat qeveritare, i qëndruan kryengritësve në luftë me armë në ndertesën e Prefekturës. Me 31 maj në marrëveshje me rrethuesit u larguan nga Shkodra.

Sulejman Shkodra

31 maj 1924 – gusht 1924

Si ushtarak ishte zv/prefekt gjer në emrim të prefektit nga qeveria Noli.

Mustafa Kruja

gusht 1924 – 24 dhjetor 1924

Mustafa Kruja u emërua Prefekt nga qeveria Noli dhe u largua në momentin e rënjes së kësaj qeverije.

Musa Juka

25 dhjetor 1924 – tetor 1925

Musa Juka ishte zv/prefekt i emëruar pas rikthimit me 24 dhjetor. Qëndroi deri në tetor 1925, kur u emërua ministër.

Rasim Kalakula

4 mars 1926 – mars 1927

Rasim Kalakula rezultoi që ka firmosur më përpara por si zv/prefekt. Emërimi i vjen me 4 mars. Rasim Kalakula ka qenë në krye të detyrës gjatë kryengritjes së Dukagjinit. Në momentin që u largua për disa ditë, detyrën e prefektit e mori si zëvendës Izet Dibra.

Sirri Leskoviku

31 mars 1927 – janar 1928.

Me 9 mars largohet Prefekti i Shkodrës Rasim Kalakula dhe

zevendësohet nga Sirri Leskoviku. Ndërsa në janar 1928 jepet njoftimi që u transferua Prefekti i Shkodrës i cili ishte emëruar në prill 1927.

Kol Rodhe

korrik 1928 – korrik 1929

Megjithse me diferencë kohe, Kol Rodhe rezultoi i ardhur në korrik 1928. Megjithate një njoftim për emërimin e tij shprehet së zëvendëson Sirri Leskovikun.

Et'hem Toto

korrik 1929 – mars 1930

Detyrën si zv/ Prefekt e mori Et'hem Toto. U largua në mars 1930 dhe shkoi në një shkollë xhandarmërie në Itali. Detyrën zyrtarisht e mori përsëri si zv/prefekt Izet Dibra.

Rasim Kalakula

qershor 1930 – janar 1931

Në qershor 1930 rezultoi prefekt Rasim Kalakula. Me 16 janar 1931 njoftohet se Prefekti i Beratit Sirri Leskoviku emërohet Prefekt i Shkodrës në vend të Z. Kalakula. Gjithashtu edhe Zejnel Prodani Kryetar i Bashkisë Shkodër zëvendësohet nga Rustem Ymeri.

Sirri Leskoviku

shkurt 1931 – mars 1933

Rifilloi edhe një herë dhe qëndroi rreth 2 vite. Në dhjetor 1932 mungon një muaj dhe zëvendësohet nga drejtuesi i xhandarmërisë Et'hem Toto i cili ishte rikthyer nga Italia.

Et'hem Toto

prill 1933 – 15 nëntor 1933.

Përsëri Et'hem Toto zv/prefekt dhe qëndroi më gjatë se ishte parashikuar.

Qazim Bodinaku

nëntor 1933 – korrik 1935.

Qazim Bodinaku emërohet me 11 nëntor 1933 por e merr detyrën me 7 dhjetor 1933. Më 15 nëntor 1934 largohet me leje dhe zëvendësohet nga E. Tota. Në korrik 1935, Qazim Bodinaku transferohet në Berat dhe

detyrën, deri në nëntor 1935, e rimerr Et'hem Tota. Në nëntor 1935, E. Tota kalon Ministër i Brendshëm dhe detyrën si prefekt e kryen Kryetari i Bashkisë, Zejnel Prodani.

Abedin Nepravishta

dhjetor 1935 – shkurt 1936

Rikthehet si zv/prefekt për një kohë të shkurtër Abedin Nepravishta.

Javer Hurshiti

shkurt 1936 – maj 1939

Javer Hurshiti është prefekti i fundit i shtetit shqiptar të para Luftës së Dytë Botërore. Simbas shtypit gjatë mungesave në detyrë është zëvendësuar në dy raste nga drejtuesi i xhandarmërisë, Daut Çarçani. Pushtimi i 7 prillit 1939 e gjeti në detyrë, por ai vazhdoi në shërbim edhe më pas, me administratën e Italisë.

Lele Koçi

qershor 1939 – mars 1940.

Prefekti i parë, i emëruar nga qeveritë nën pushtim, është Lele Koçi, i cili në atë periudhë ishte n/prefekt i Lezhës. Në momente që mungonte, ka firmosur Daut Çarçani që ishte drejtuesi i xhandarmërisë, ku më pas kaloi Prefekt në Gjirokastrë. Më 19 mars 1940, njoftohet se prefekti Lele Koçi largohet po me atë detyrë në Vlorë dhe prefekti i Vlorës, Riza Drini, vjen në Shkodër.

Riza Drini

mars 1940 – nëntor 1941

Me 26 mars 1940, njoftohet se: Shkodra fashiste i paraqet mirëseardhjen prefektit të ri, Riza Drini. I premtojmë "ma të madhen disiplinë e bindje". Ky qëndroi gjer në nëntor 1941.

Daut Çarçani

nëntor 1941 – janar 1943

Daut Çarçani firmosi si zv/prefekt edhe më përpara nëntorit. Periudha e tij ishte tepër kritike me ngarkesë politike e luftarake.

Jup Kazazi

janar – mars 1943

Daut Çarçani u largua në janar 1943, kështu që gjer në mars zv/prefekt i Shkodrës u emërua Jup Kazazi që ishte nëpunës në dispozicion në Ministri të Brendshme.

Agathokli Xhitoni

Mars – maj 1943

Detyrën e filloi me 22 mars 1943 dhe qëndroi vetëm dy muaj. Siç duket ndikoi ndryshimi i shpejtë i qeverive. Me 12 qershor 1943 miratuar nga Mëkëmbësi, A. Pariani, jepet që Agathokli Xhitoni, regjent i Prefekturës Shkodër, shkarkohet nga detyra pasi do kthehet në detyrën e tij origjinale.

Riza Drini

maj – gusht 1943

Më 22 maj 1943 riemërohet në Shkodër Riza Drini. Qëndroi për një kohë të shkurtër.

Hasan Alizoti

gusht 1943

Gjatë muajit gusht 1943 rezulton Prefekt i Shkodrës, Hasan Alizoti.

Shaban Basha

shtator 1943 – dhjetor 1943.

Shaban Basha është prefekti i fundit i emëruar gjatë pushtimit italian. Shaban Basha gjer në korrik 1943 ishte Sekretar Federal i Partisë Fashiste Shqiptare për Shkodrën. Partia Fashiste u shpërnda nga mbreti Vitorio Emanueli me 25 korrik 1943. Shaban Basha kishte qenë pjesëtar i Brigadave Internacionaliste në luftën e Spanjës (1936-1939). Ai ishte përkrah Asim Vokshit, Petro Markos, Mehmet Shehut etj. Duke qenë nga Peja, bashkimin e Kosovës në një shtet me Shqipërinë, siç duket, e vlerësoi më shumë. Shaban Basha qëndroi Prefekt edhe pas kapitullimit të Italisë gjer më 3 dhjetor 1943, kur u shkarkua nga Regjenca.

Eqërem Telhaj

dhjetor 1943 – janar 1944

Më 12 dhjetor 1943, njoftohet se me Dekret të Këshillit të Naltë (Regjenca), Eqërem Telhaj emërohet Prefekt i klasit II në Shkodër, në vend të Shaban Bashës. Detyrën e kishte filluar ca ditë më parë.

Më 9 janar 1944 njoftohet se me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme e vendim të Këshillit të Ministrave, Eqërem Telhaj, deri atë kohë Prefekt i Klasit të dytë, Shkodër, vihet në dispozicion të Ministrisë Punëve të Brendshme.

Llesh Marashi

janar – mars 1944

Prefekti u zëvendësua që në janar, por detyrën e mori në mars, kështu që gjer atë ditë drejtuesi i Xhandarmërisë, Llesh Marashi, kreu detyrën e Zv/Prefektit.

Javer Hurshiti

mars – gusht 1944

Me vendim të Këshillit Ministrave, i propozuar nga Ministria e Brendshme, Javer Hurshiti, gjer tani inspektor i përgjithshëm pranë Kryeministrisë, ngarkohet me funksionet e prefektit në Shkodër. Me 15 gusht 1944, me shkresë drejtuar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, jep dorëheqjen i revoltuar dhe i prekur në sedrën e detyrës pasi pa procedura të rregullta u pushkatuan dy persona të dyshuar si pjesëmarrës në një atentat. Me 28 gusht 1944, njoftohet që Javer Hurshiti është larguar si prefekt i Shkodrës dhe ka filluar si zv/prefekt, me 18 gusht 1944, Mynir Tërshana.

Mynir Tërshana

gusht – tetor 1944

Ishte zv/prefekt në një periudhë të vështirë lufte. Largohet me 23 tetor.

Tahir Kolgjini

nëntor 1944

Megjithëse me 23 tetor ishte emëruar një komision qytetar për pushtetin lokal në Shkodër, rezulton që Tahir Kolgjini, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë, kryen detyrën e prefektit. Kjo, gjatë muajit nëntor 1944, kur po largoheshin nga Shqipëria një pjesë e administratës së lartë të shtetit.

PJESA E DYTË – 1945 – 1990

Organizimi i shtetit në periudhën 1945–1990 nuk ka postin e prefektit, megjithëse në fillim nuk u ndryshua termi “Prefektura Shkodër”, kjo gjer në vitin 1947. Detyrën e prefektit e mbulonte kryetari i Këshillit të Frontit Antifashist të prefekturës. Më pas, ishte “Sekretari i Partisë së Rrethit”, figura më e lartë në pushtetin lokal. Megjithatë për këtë periudhë kemi këtë pasqyrim:

Komiteti Ekzekutiv i Prefekturës, Shkodër

Riza Dani 1944 – 1945

Qamil Gavoci 1945 – 1946

Beqir Gjylbegu 1946 – 1947

Me qenë se detyra e *Sekretarit të Partisë*, gjer në vitin 1948, nuk ishte e publikuar, vazhdohet konkluzioni:

Rahman Perllaku – rezulton gjatë 1945, *Sekretar Politik të Komitetit të Qarkut Shkodër*.

Spiro Pano – rezulton me detyrën e *Sekretarit Politik të Komitetit të Qarkut Shkodër*, në shkurt 1946 – shkurt 1947.

Adil Çarçani – rezulton në prill 1947 me detyrën *Sekretar i Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës Shkodër*.

Abaz Loze – në gusht 1948, prezantohet me detyrën *Sekretari Politik i Organizatës Lokale të Partisë Shkodër*.

Sekretar i Parë i P. P. Sh për rrethin Shkodër:

Tonin Jakova - 1950 - 1951

Xhavit Qesja - 1952 - 1953

Adil Çarçani - 1953 - 1954

Sadik Bocaj - gusht 1954 - 1958

Sul Baholli - shtator 1958 - 1966

Pjetër Kosta - Tetor 1966 - 1968

Prokop Murra - 1969 - tetor 1976

Foto Cami - tetor 1976 - mars 1979

Muho Asllani - mars 1979 - nëntor 1979

Prokop Murra - nëntor 1979 - maj 1980

Sulejman Bushati - maj 1980 - maj 1983

Petro Dode - maj 1983 - 1985

Muho Asllani - 1986 - mars 1989

Xhemal Dymylja - mars 1989 - 1990

Në dhjetor 1990, u bënë ndryshime politike e administrative, kështu që *Sekretari i Partise Punës* nuk ishte më figura kryesore, pasi ishin krijuar edhe parti tjera politike. Gjer në krijimin e institucionit të Prefektit detyra u krye nga *Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit*.

PJESA TRETË – 1990 - 2020

Terezina Marubi - Kryetare e Komitetit Ekzekutiv Rrethit Shkodër, korrik 1990 - gusht 1991.

Ali Spahija - Kryetar i Komitetit Ekzekutiv Pluralist, gusht 1991 - mars 1992.

Fatos Gjyrezi - Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, prill 1992 - korrik 1992.

Ali Kazazi - Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, shtator 1992 – qershor 1994.

Prefekti:

Iliaz Vrioni - qershor 1994 – 1996.

Elham Sharra - 1996 – gusht 1997.

Gëzim Podgorica - gusht 1997 – janar 1998.

Ali Laçej - shkurt 1998 – janar 1999.

Jetmir Shpuza - janar 1999 –janar 2000.

Gjokë Jaku - viti 2000.

Gjergj Leqejza - dhjetor 2000 – janar 2004.

Kolë Malaj - Janar - shtator 2004.

Ramadan Hasani - tetor 2004 – maj 2005.

Oltion Luli - maj 2005 – shtator 2005.

Gjovalin Kolombi - shtator 2005 – shkurt 2007.

Maxhid Cungu - shkurt 2007 – shtator 2011.

Voltana Ademi - shtator 2011 – tetor 2013.

Paulin Radovani - 7 tetor 2013 – 1 nëntor 2017.

Çesk Midhja - 1 nëntor 2017 – 27 mars 2019.

Valdrin Pjetri - 27 mars 2019 – 11 maj 2019.

Çesk Midhja - 11 maj 2019 – 11 prill 2020.

Besfort Lamallari - 11 prill 2020 - (Është zv/ministër i brendshëm dhe komandohet me funksione Prefekti për arsye të situatës së pandemisë Covid-19)

Majlinda Angoni -1 shtator 2020 - në vazhdim

▪ **Letërsi** ▪

Stefan ÇAPALIKU

KOLË ASHTA LETRAR

Për shumë vetë që e kanë takuar emrin e profesor Kolë Ashtës, cilësori "Letrar" do ngjajë paksa i sajuar, sepse vazhdojnë ta lidhin figurën e tij ose me gjuhësinë ose thjesht me arsimin. Janë pak ata që dinë se profesor Kola ishte i thirrur për letërsi dhe e ushtroj këtë zeje hyjnore përgjatë gjithë rinisë së tij të hershme.

Kjo përmbledhje, besoj se shterruese, do i afrojë këtyre njerëzve një prespektivë të re nga mund ta shohin portretin intelektual të Kolë Ashtës.

Kolë Ashta, siç e kam njohur

Një dorë e madhe, më shumë e gjatë se e bëshme, me gishtërinj të hollë, thonj të prerë rumbullak dhe me një rreth ari në të katërtin, sheshonte sipërfaqen e rërës, duke zhdrukë me këtë rast edhe gjurmën e një germe, për të shkruar më pas germën e rradhës.

Është pesëmbëdhjetë ditëshi i dytë i gushtit të vitit 1973. Velipojë. Plazh. Ndën të njëjtën çadër gjenden dy zonja, që na kanë kthyer kurrizin, dhe një burrë që kërkon të më tërheqë vemendjen me një buzëqeshje të pambarimtë.

Ime më me zyshë Netën vazhdojnë e flasin me zë të ulët me vështrimin nga deti. Ime motër, adoleshente aso kohe, me siguri që lahet ose shetit bregut. Im atë vjen vetëm mbasditeve dhe ikën mjeseve për në punë.

Unë jam vetëm me Atë. Zotni Kolën apo profesor Kolën, siç e thërrasin prindërit e mi. Atë vit unë jam 8 vjeç, kurse ai sa ç'jam unë sot, 55.

Dhe meqë po i afronte moshën e pensionit, si shpërblim për punën e mirë, udhëheqësia e Shkodrës kishte vendosur t'i jepte një kabinë plazhi, jashtë sezoni.

Dita e parë e plazhit dhe në vend që të lodrojë nëpër breg... ka gjetë një orë kohë që të më japë mësimet e para në greqishten e vjetër. Kulmi! Po përpiqet të më mësojë alfabetin. Alfa, beta, gama, delta dhe ndonjë fjalë tjetër nëpër të. Dhe kështu më duket se më ikën e gjithë paraditja.

Pastaj vijnë shetitjet e mbasditeve vonë, bregut. Sërish zyshë Neta me t'ime më përpara. Profesor Kola me t'im atë, ish nxënësin e vet të gjimnazit, mbrapa. Unë disi si më i shmangur, por ama gjithë veshë te biseda e tyre.

Më vonë, kur nis të mendohem gjatë për atë burrë, kujtohem se ai vinte për vizitë të paktën njëherë në vit, në dhjetor, me 17, për ditën e emrit të t'im eti. Ishte vizita e fundit. Mbas tij zor se vinte kush. Qëllonte shpesh të mos gjente njeri tjetër kur vinte dhe kjo padyshim që për të ishte lumturi. Ai pastaj fliste. Por rastiste edhe që ta gjente dhomën plot. Dhe ai pastaj heshte. Heshtja e tij zgjaste derisa dikush merrte guximin ta pyeste për dicka, për dicka që kishte lidhje me gjuhësinë natyrisht. Për mbiemrin e vet përshëmbull.

Ndonjëherë këtë rol "pasuesi" e merrte im atë. Ai s'përtonte ta përsëriste pyetjen rreth mbiemrit "Ashta". E atëhere profesori ia niste shpjegimin. Kishte një tik, një si mbyllje buzësh e një si shpërthim të vogël ajri që i dilte prej hundësh, para se të fillonte bisedën. Dukej se ai cast i vetëm i mjaftonte për t'i përmbledhë në mënyrë metodike të gjitha që do thoshte. Ah, "Ashta"?! Ashta vjen nga ahishte, vend me ahe. Ndoshta vijnë, dikur, heret, edhe prej këtij katundi në të hyrë të Shkodrës, Ashtës.

Mandej në kujtesë më vijnë vizitat në shtëpinë e tij. Sa më shumë rritesha dhe përdellohesha në punët e letërsisë, aq më të shpeshta bëheshin vizitat në shtëpinë e tij. Derën e oborrit të vogël e hapte gjithmonë zysh Neta, mbasi që ia merrte përgjigjen pyetjes së bërë që në krye të shkallëve: "Kush a?" Mandej zysh Neta e lajmëronte profesorin

që nga oborri se kush po vinte, dhe ai varësisht nga konfidencat me personin që po hynte, zhdukte nga tavolina e punës librat dhe letrat që s'ishite e mira t'i shihte vizitori.

Përshkoje një oborr minimal, dy këmbë shkallë dhe fill djabatas te dhoma e ndenjës. Dhoma e ndenjës, e bukës si dhe studioja e profesorit që tragjikisht e vogël. Shtëpia gjithashtu me gjasë kishte vetëm dy dhoma simetrike dhe një korridor. Sa hyje në dhomë të ndenjës, përballë ishte një tavolinë e madhe, e vjetër e mbuluar me mushama, mbi të cilën një xham i trashë. Mbi tavolinë shumë lapsa të mprehura picigjati, me stil. Një lupë. Mbas tavolinës, rrasë për mur, nga toka deri në tavan një sergjen me libra i mbuluar me një perde basme. Midis tavolinës dhe sergjenit një njeri i papepur, hero i dijes, kalorës i heshtjes, profesor Kolë Ashta.

- Si je profesor?

- *"Si qoftë hajri e bafte Zoti /Orën çuet po e ka Hoti"*. Këto dy vargje të "Lahutës së Malcis" ishin edhe përgjigjia e tij e zakonshme.

Aso kohe, diku në gjysmën e parë të viteve '90, profesor Kola kishte ngut. Ai donte me çdo kusht t'i jepte fund projektit të tij madhor "Fjalori historik i gjuhës shqipe". Kishte arritur në finale. Mbeteshin edhe pak metra deri në finish, ndaj dhe vetëm për këtë çështje mund të flitej me të.

Mirëpo ai që i vëmendshëm edhe ndaj debateve të tjera që nisën të rilindnin mbas rrëzimit të komunizmit. Kur guxova atëherë ta pyesja për temën e nxehtë të atyre viteve: Gjuha letrare: Gëgnishtja apo Toskërishtja? Ai më tha: *"Fatkeqësisht nuk kam ma kohë, por do ulesha më kënaqësi me shkruar një punim, për me vertetue se gëgnishtja me toskërishten ato janë kaq afër, saqë nuk janë dialekte. Ata janë thjeshtë të folme."*

E kështu, vite më vonë, me gjetjen e mjeteve për botimin e vëllimit të parë të veprës së tij madhore "Fjalori historik i gjuhës shqipe" pata fatin të merresha vetë. Ishte fillimi viti 1998 dhe zyra e Fondacionit "Soros" në Tiranë ofroi një shumë të mjaftueshme për botimin e vëllimit të parë. Vepra e plotë përbëhej nga shtatë vëllime.

Mbaj mend se ky vëllim u përgatit për botim nga ish kolekegët apo dhe ish studentët e tij të dashur, profesorët Simon Pepa, Tomor Osmani dhe Tef Topalli. Libri u shtyp ndën siglën e Universitetit të Shkodrës, në shtypshkronjën "Volaj", që gjendej kund njëqind metra përtej shtëpisë së profesorit.

Kur mora ekzemplarën e parë vrapova për nga shtëpia e tij, hyra me kaq gëzim dhe entuziazëm të dhoma e tij, sa c'mbeta edhe i shtangur kur nuk e gjeta në vendin e vet. Ai rrinte te tavolina e bukës përbri skrivanisë dhe buzë stufës me dru. Ishte thujse tërësisht i verbuar. Zysh Neta u afrua gjithashtu te libri dhe të dy përnjëherë ia prekën me dorë kapakët.

Edhe gëzimi që i përmbajtur, tamam si jeta e tyre e përujntë...

Kolë Ashta "bachelor"

Kolë Ashta u lind në Shkodër më 1918. Ai ishte fëmijë i vetëm dhe shumë shpejt edhe jetim, për shkak të vdekjes së të atit, Balto Ashtës. E ëma bashkë me të motrën, beqare, ia dalin ta rrisin me thonjt e duarve, duke bërë gjithfarë punësh të ndershme dhe të përujnta.

Mësimet e para Kola i merr në qytetin e lindjes dhe tregohet një nxënës i shkëlqyer. Aq i shkëlqyer sa e ëma pranon t'i vazhdojë sakrificat dhe të mos e fusë në punë para kohe. Ajo e kupton se rruga e birit të saj është shkolla. Oso kohe në Shkodër ekzistonin tre gjimnaze: ai i fretënve, i jezuitve dhe i shtetit. Mirëpo koha e mbarimit të shkollës bazike dhe e regjistrimit në të mesmen për Kolën koïncidon me mbylljen e shkollave private në vitet 1933-1936. Për këtë arsye Kola regjistrohet te gjithmnazi i shtetit. Aty u bë shok jete me Pashk Gjeçin⁽¹⁾, me të cilin kishin lindur në një vit, mbaruan gjimnazin bashkë si dhe ndoqën studimet universitare.

Më 1938, në moshën 20 vjeçare, me anë të një burse shtetërore fillon studimet për filologji në Universitetin "La sapienza" të Romës, ku edhe laurohet më 1942, në Fakultetin "Filosofie e lettere".

Nga viti 1942 deri më 1944 nis punën si sekretar shkencor në Institutin e Studimeve Shqiptare në Tiranë, ku qenë bërë bashkë personalitete të tilla si: Vangjel Koça, Aleksander Xhuvani, Anton Paluca, Át Anton Harapi, Xhevat Korça, Mustafa Merlika Kruja, Ernest Koliqi, Dhimiter Berati, Át Giuseppe Valentini, Karl Gurakuqi, Ekrem Vlora, Nicola Lo Russo Attoma, Dom Lazer Shantoja, etj.

Nga viti 1945 deri më 1949 shërben si mësues i gjuhës dhe i letërsisë në Berat në shkollën "24 Maji", që ishte shtatëvjeçare, por edhe gjimnaz..

Në vitin 1950 kthehet në Shkodër dhe martohet me një arsimtare shkodrane të quajtur Karmina Gurakuqi⁽²⁾. Të gjitha vitet e martesës nga 1950 deri më 1955 i shpenzoi si mësues në Normalen e Elbasanit. Në fund të vitit 1955 Karmina sëmuret nga tuberkulozi dhe vdes krejt

e re, pa lënë fëmijë.

Më 1956 deri më 1965 dha mësimin e letërsisë në Gjimnazin "29 Nëntori" në Shkodër, nga ku ish nxënësit e tij trashëgojnë kujtime të mrekullueshme. Ata e kujtojnë si njeri fantazist, të mbushur me pasion, person që mizanskenonte dhe mbushte me imazhe vepruese fragmente të ndryshme të letërsisë shqipe dhe të huaj. Të gjithë ndajnë të njëjtin opinion se profesor Ashta shkëlqente në interpretimin e letërsisë arbëreshe.^[1]

Pas vdekjes së gruas së parë të dashur, Kolë Ashta më 1957 martohet me një tjetër arsimtare, ish sportiste, me zyshë Aneta Baba, me të cilën ngrys jetën, duke e pasë jo vetëm bashkëshorte, por edhe një bashkëpunore të ngushtë.

Në vitin 1965 profesor Kolën e marrin në katedrën e Gjuhës Shqipe të Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës për të dhënë lëndën e Leksikologjisë dhe Gramatikës Historike të gjuhës shqipe. Ai punoi aty deri sa u pensionua më 1976.

Nga viti 1976 dhe deri në fund të jetës ai i jepet me mish e me shpirt përfundimit të punës për hartimin e Fjalorit Historik të gjuhës shqipe. Ai e kishte të qartë arkitekturën e kësaj ngrehine monumentale. Në mendjen e tij ky projekt i kishte "vetëtuar"^[2] në krye që kur bëri divorcin me letërsinë, ndaj i dinte përmendësh rrugët sesi i dileshe në fund. Duheshin vetëm shëndet, kohë dhe vullnet, cka të cilat Zoti ia falë. Kështu që në vitin 1997, një vit para se të ndahej prej nesh ai i kishte përfunduar të shtatë vëllimet e kësaj veprë jete.

Vdes më 1998 në qetësi dhe përlutësi të plotë.

Kolë Ashta në letërsi

Hyri në letërsi pa emër. Si shumë të tjerë edhe ai përdori një pseudonim. Zgjodhi t'i bëjë hapat e para me pseudonimin "Shkaba". Ngandonjëherë, në të rradhë përdori edhe: "a" apo "o". Mbas mbarimit të universitetit nisi të shfaqej me emrin e tij të vertetë. Dhe pikërisht atëhere, sapo vetëtoi në qiellin letrar shqiptar, në moshën 26 vjeçare, e braktisi letërsinë, kritikën dhe studimet letrare, duke na lënë mbrapa një trashëgimi të pabesueshme në këto fusha.

Kolë Ashta fill mbas çlirimit e ndërpret krejtësisht raportin me letërsinë. Kohë më vonë i rikthehet krejt përkohësisht asaj, duke u vënë në kërkim të aspekteve letrare dhe estetike të autorëve të vjetër dhe rishfaqet në shtypin shkencor me një tufëz studimesh si: "Tue u ndalë

ndër shkrimtarë të veriut nga shek. i XVI në shek. XVIII, "Në kërkim të anës letrare të Matrangës.", "Pjetër Budi, prozator e vjershëtar", "Frang Bardhi shkroi të parën apologji për Skënderbeun më 1636.", punime të cilat janë më së shumti filologjike sesa letrare, në kuptimin estetik të kësaj fjale.

Siç e thamë më sipër, një pjesë e madhe e krijimtarisë dhe kontributit tjetër letrar gjendet e nënshkruar me pseudonimin Shkaba. "Shkaba" kishte me qenë një anagramë e emrit të vet, emrit të babës dhe mbiemrit. Pra nga Kolë kemi "k", nga Balto kemi "ba" dhe nga Ashta kemi "ash".

Mirëpo mbas ardhjes në fuqi të komunizmit, Kolë Ashta heq përfundimisht dorë nga letërsia. Ai heq dorë fillimisht nga krijimtaria letrare, studimet dhe kritika dhe më pas heq dorë edhe nga mësimdhënia e letërsisë. E pra vazhdonte epoka kur mësuesi i letërsisë ishte qenia më e dashur për nxënësit. Kur ndodhi një gjë e tillë Kolë Ashta ishte novic në veprimtarinë e vet letrare. Kishte vetëm tetë vjet. Ai sapo kishte filluar të skuqej si molla në degë, kur nisë me u pjekë. Dhe tamam në këtë kohë struket në gjuhësi, në gjuhësinë historike, te autorët e vjetër të shqipes, ku edhe shndritë me aftësitë e veta interdisiplinore filologjike. Sepse fundja një njeri si ai dinte të bënte mirë gjithcka që i çasej.

Po pse hoqi dorë nga letërsia? Ai hoqi dorë nga letërsia për të mos tradhëtuar veten, formimin e tij, arealin kultural prej nga kishte ardhur dhe kujt i përkiste. Kolë Ashta nuk do që t'ia fali kujt muzën e vet dhe aq më pak një ideologjie antihumane, që promovonte ide refraktare për krijimin e një përbindëshi, që do quhej Njeriu i Ri, me të cilin Kola nuk u lidh asnjëherë, deri në vdekje.

Letërsia e rrezikonte, sic kishte rrezikuar shokët e tij të burgosur Arshi Pipën, Pashko Gjecin, Nikollë Dakën etj, etj

Fillimet letrare

Ka qenë hiç më shumë se 18 vjec kur revista më seroze dhe skrupuloze e kohës, "LEKA" e themeluar nga etërit jezuitë ia hapë dyert. Madje me këtë rast revista themelon edhe një rubrikë për shkrimtarët dhe përkthyesit e rinj të titulluar "Për një edukim ma methodik në lamë letrare", duke kërkuar publikisht falje se: "Kemi pasë gjithmonë dishir t'napim të rijvet një lamë punimi ndër fletë të rivistës s'onë. Por ndopak serjoziteti i fysonomis se sajë, ndopak rrebitsija e zyres s'onë censures e kanë frigue deri sot mase një nder ta.", duke përfunduar kështu shënimin redaksional me fjalët: "Në kaq botojmë një perkthim poetik të vogël, ne

te cillin perkthyesi i ri ka diftue gjith at vullndet të mirë qi jep shpresë perparimi të vertetë."^[3]

Përkthen tekste nga autorë si John Ruskin^[6]. Po kështu përkthen nga Renato Fucini^[7]. Sjell në shqip poezi nga poetë shumë të rëndësishëm të modernes italiane si p.sh Giovanni Pascoli^[8] apo nga Giosuè Carducci^[9]. Nga ana tjetër profesor Kola i kushtohet edhe neoklasikes italiane, duke cmuar kësisoj edhe vështirësitë e përkthimit. Përkthen nga ajo letërsi Giuseppe Giusti^[10] dhe Vincenzo Monti^[11].

Dy janë revistat ku shfaqet më rëndom emri i Kolë Ashtës. Revista "Cirka" që botohej në Shkodër dhe revista "Shkëndija" që botohej në Tiranë.

Revista "Cirka" nisi të botohej më 1936 dhe jetoi deri më 1938. Drejtor ishte Cuk Simoni, përkthyes dhe një ndër esperantistët e parë shqiptar. Revista publikohej dy herë në muaj. Trajesat ishin te karakterit kulturor, historik, social dhe folklorik kryesisht të lidhura me krahinën e Shkodrës. Vend te veçantë në revistë zinin rubrikat kulturore të Shkodrës. Në të shkruajtën firmat më të dëgjua shkodrane dhe më gjërë. Në këtë revistë mund të gjejmë fondin themelor të krijimtarisë së Kolë Ashtës, botuar me pseudonimin "Shkaba".

Në revistën e dytë "Shkëndija" kemi kontributet e tij kritike dhe estetike. Numri parë i "Shkëndijës" doli në korrik të vitit 1940, ndërsa numri i fundit, i njëmbëdhjeti, është i vitit 1943. Ky organ drejtohej nga shkrimtari Ernest Koliqi, kurse drejtor përgjegjës ishte Selahudin Toto. Por nga numri 1 i vitit 1942 drejtor përgjegjës dhe pronar u bë Ernest Koliqi. Shkëndija ishte periodiku kryesor letrar në Shqipëri gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Nis të botojë edhe jashtë Shkodrës së tij, si p.sh në "Rilindja" (1934-1936): revistë e përdyjavshme shoqërore, kulturore dhe letrare që u botua në Korçë. Pjesën më të rëndësishme të kësaj reviste e përbënin artikujt ku u përshkrua gjendja sociale e vendit, ndërsa në rubrikën letrare të saj u botuan shkrime nga autorët e rinj.

Me rëndësi gjithashtu është edhe bashkëpunimi i Kolë Ashtës me revistën "Koha" (Il Tempo) që dilte aso kohe në Itali. Kështu përshembull në hyrje të studimit të tij "Përmbajtja idilike e "Lahutës së Malcis", redaksia e "Kohës" ka shënuar: "Nji ndër përfaqësuesit ma mëdhej të letërsisë së re shqiptare asht sigurisht edhe Dr. Kolë Ashta i lauruem tash së fundi prej universitetit Mbretnuer të Romës. Për koncesjon dashamirë të tij sod mundemi të botojmë nji copë prej tezit

të laurës së tij qi rreh gjanë e gjatë aspektet e shumllojshëm të poemës s'onë kombëtare, Lahutës së Malcis⁽¹²⁾. Po kështu edhe në numurat e tjerë redaksia nuk ka pushuar së vlerësuari zotësinë dhe të ardhmen e sigurtë të djaloshit të ri: *"Po vijojmë të nxjerrim prej thesit të laurës së Doktorit Kolë B. Ashta, këte parafrazë të poemës s'onë kombëtare, siç asht studjue dhe ndamë prej tij në rragatjen e dijshe dhe të thellë qi ka bamë para profesorëve të Fakultetit të Letrave në Universitetin Mbretnuer të Romës."* Kurse te *"Përmbajtja epike e "Lahutës së Malcis" thuhet: "Po botojmë artikullin e fundit të nxjerrun prej analyses së holl të Doktorit Kolë B. Ashta mbi poetin t'onë kombëtar dhe kryeveprën e tij: "Lahuta e Malcis".*

Kolë Ashta shkrimtar

Fillimet e veta Kolë Ashta i ka si shkrimtar. Si shumica e njerëzve të dashuruar mbas letërsisë si lexim, por edhe si pasqyrë e shpirtit të trazuar, e fillon me poezi. Janë dhjetë poezi që kemi arritur të mbledhim nga rinia e tij. Ato janë të thjeshta dhe rrinë paqësisht në rrjedhat e poezisë së kohës, që po tentonte të shkëputej nga klasikja dhe romantikja e sheqerosur.

Në poezitë: "Maril", "Poezija e rinis", "Kështjelli i Shkodrës", "Natë dimni", "Natën", "Rapsodi i malit", "Vjollcës", "Kur të kalojë dimni", "Melodi e venitun", "Due", Kolë Ashta paraqitet si një djalosh me virtyte poetike, të mbështetura te shprehitë e lindura melodike, senset temporitmike dhe shqisa të tjera të mprehura për t'i hyrë lëmisë poetike.

Në prozë ai qartazi është në ndikimin e shkrimtarëve të rinj të kohës. Vecanërisht sa i takon lëvrimit të prozës së shkurtë, që ishte një frymëzim poetik i derdhur në forma më komunikuese, profesor Kola është në rrjedhat më të dlira të shkrimtarëve bashkëkohës si Koliqi, Migjeni, etj. Prozat e tij të shkurtëra si: "I pshtuem", "Nji jetë", "Pënda", "Malsorit", "Zemër e ndrydhun", "Kangatarja endacake", "Jeta e Andres", "Gjarpni", "Jetesa" etj.

Kolë Ashta ka dy burime estetike nga të cilat ushqehet. Njëra është letërsia shqipe e kultivuar vecmas në qytetin e tij dhe prej autorësh të rëndësishëm dhe burimi i dytë është ai i leximeve kryesisht nga italishtja dhe frëngjishtja.

Kolë Ashta kritik

Kolë Ashta përsa kohë që u mor me letërsi, shkelqeu në kritikë. Ai

ishte edhe i talentuar të merrej me këtë zeje, por ai ishte edhe i arsimuar më së miri në të njëjtën kohë. Kolë Ashta dëshmon se njeh më së miri të gjithë teknologjinë e hartimit të tekstit letrar si dhe të gjitha teknikat e zbërthimit të tij. Kolë Ashta dëshmoi me kritikën e veta se ishte i aftë ta nxirrte tekstin nga konteksti pa e dëmtuar atë; ta zbërthente tekstik letrar në detaje; t'i kundronte një e nga një detajet duke kuptuar kësisoj funksionin e tyre në të tërën; dhe pastaj ta vendoste tekstin edhe njëherë në kontekst. Tamam ashtu sic zbërthehet dhe mbërthehet një makinë. Por në pikpamje të shkollës kritike që ndoqi dhe së cilës i përket ai që pozitivist.

Ai dëshmoi se e vlerësonte historinë e letërsisë dhe të arteve shqiptare si një dëshmi specifike e karakteristikave kombëtare, si një mjet për të njohur psikologjinë e popullit tonë. Posacërisht historia e letërsisë nisi të shihej prej tij si studim i paanshëm, që do të mund të shpjegonte dukuritë historike dhe zhvillimin e tyre dhe, duke u bazuar në spjegime të tilla, do t'ia dilte të shpjegonte edhe veprat e veçanta artistike, si përmendore të ndryshimeve përgjatë zhvillimeve historike të shoqërisë njerëzore.

Në një kuptim më të ngushtë të termit, pozitivizmi i aplikuar si metodë filozofike në shkrimet e profesorit mund të konsiderohet si bindje për ta kuptuar veprën artistike në bazë të të dhënave të nxjerra nga jeta e autorit. Këtë metodologji leximi dhe interpretimi Kolë Ashta e dëshmon gjithandej në kritikën e veta, si në: "Rozafa e Dom Ndre Zadejës"; "Novelat e Mihal Gramenos"; "Mihal Gramenua "Vdekja e Piros"; "Mallkimi i gjuhës shqipe", komedi e Mihal Gramenos"; "Ndieshmenia e re lirike të Nexhat Hakiu" etj. Etj.

Kolë Ashta polemist dhe veprimtar

Entuziazmi i studentit të letërsisë Kolë Ashta si duket se shkakton turbullira në opinionet letroro-estetike të kohës. Që në castin kur ai boton artikullin e vet të "Shkëndija" të titulluar "Për një kritikë letrare"^[13] nxit reagime pro e kontra. Asgjë që shkruan Kolë Ashta nuk kaon në heshtje. Këtu është me interes të përmendim reagimin e Dr. Kolë Prela në revistën e famshme "Hylli i Dritës" me titull "Kundërime letrare"^[14], me të cilin artikull ai nuk bie dakort me mendimin e Kolë Ashtës se kritika duhet me i "shenjue udhën letratyrës".

Një tjetër polemikë në të cilën Kolë Ashta është aktiv është ajo e hapur nga At Gjon Karma S.J edhe ky jezuit pra, në mbrojtje të

gjenialitetit poetik të Dom Ndre Mjedës. Në këtë polemikë që mund të thirret me emra të ndryshëm të tipit "Fishta apo Mjeda?" apo "A asht poet Ndre Mjeda" etj, marrin pjesë shumë personalitete të kohës si At. Fulvio Cordignano S. J, Kolë Kamsi, Nikollë Dakaj, Filip Fishta, Nikë Barcolla^[15], Henrik Lacaj dhe në fund edhe Kolë Ashta, i cili qe shprehë qartë se: "... *Fishta lartohet porsì epiku dhe satiriku ma i madh i Kombit...Mjeda n'anë tjetër xen vendin e parë si poet lirik klasik. Cui honor, honor!*"^[16]

Ndërkaq, po atë vit, më 1943, me t'u botuar në gjuhën shqipe romani i famshëm i romanticizmit italian "Të fejuemt" e Aleksandër Manzoni, Kolë Ashta shkruan një recensë^[17], me të cilën me dashje apo jo, hapë një polemikë, në të cilën do implikohën dy grupe njerëzish, që po i thërrasin konservatorë dhe liberal, apo pro dhe kontra çështjes së gjuhës letrare.

Në artikullin "Pse gegnisht Manzoni...?"^[18], përkthyesi At Mark Harapi S.J, vëllai i filozofit dhe publicistit të famshëm At Anton Harapi o.f.m mbasi që merret me qëndrimet me artikuj shkruesve të gazetës "Balli i Rinis" dhe "Shkëndija, përkatësisht "Thumbi" dhe Skënder Pirro, shkruan: "Porse në marc (1943), një tjetër (e kësaj here jo toskë, por gegë, e madje shkodranë: Kolë Ashta), krejt shoqi i tij, kinse po din ma mirë, duel me diçka ma të gjatë."

Në mbështetje të tezës së Kolë Ashtës, se përkthimi duhej të qe bërë në një gjuhë "të mesme" dhe jo në shkodranisht del edhe një bashkëmoshatar i tij, Nikollë Daka me artikullin "Kështu i don mushka drut" (Dy fjalë me mustakoca)^[19]

Polemika pastaj vazhdon sërish me reagimin e përkthyesit At Mark Harapit S.J. e kësaj here në revistën e vet "Leka". Kësaj here ai përveçse me Nikollë Dakën merret sërish me Kolë Ashtën^[20].

Është me interes gjithashtu që të ceket në këtë hyrje se Kolë Ashta qe një ëndërrimtar dhe progresist i madh. Ai kishte në kokë modele emnicipuese kulturore europiane që donte t'i implementonte me çdo kusht edhe në Shqipëri. Në këtë kontekst është e tij iniciativa që: "Instituti Mbretëror i Studimevet Shqipëtare, Akademia Albanologjike e Shkodrës dhe Bibliotheka "Dine" e Korçës që po pajohen me nga një seri të plotë e të njëjtë prej 100 e kusur manuskriptesh shqipëtare kombëtare."^[21]

Në lidhje me krijimin e këtij fondi dorëshkrimesh dhe me të ardhmen e këtij projekti ndër institucional, reporter i "Tomorit" na njofton se:

"...në vargun e botimeve që do të duhet të shtypen ndënë mbititullin "Corpus Scriptorum Albanesium", një endërr shqiptare e vjetër këjo e të ndjerit Janon Vreto Postenani, edhe një endërr e re, e sotme, që e t'faq me shumë vlagë profesori i ri shkodranë Kolë Ashta."^[22]

Mbi këtë botim

Në përgatitjen e këtij botimi kemi ndjekur rendin tematik dhe kronologjik të hartimit apo botimet të teksteve. Është ndjekur kriteri tematik, për arëye se teksteve janë grupuar nga ana ime mbi bazën e përmbajtjes dhe problematikës së trajtuar, por nga ana tjetër brenda së njëjtës rubrikë është respektuar kronologjia e hartimit ose publikimit.

E kemi klasifikuar kontributin e tij letrar në disa rubrika të mëdha siç janë: I. Folkloristika; II. Mbi letërsinë e vjetër shqipe; III. De Radiana; IV. Mjedologji; V. Fishtologji; VI. Autorë dhe vepra të tjera; VII. Recensione, VIII. Eseistika; IX. Krijimtaria origjinale; IX. 1. Poezia, IX. 2. Proza; X. Përkthimet; X.1. Poezia e përkthyer; X. 2. Proza e përkthyer; XI. Bibliografia.

Për disa nga shkrimet e profesor Kolës kemi pasur edhe datat e hartimit edhe ato të botimit. Datat e krijimit të disa prej pjesëve letrare janë marrë nga arkivi personal i autorit, një pjesë e të cilit, për fat të mirë është ruajtur me fanatizëm.

Sa i takon studimeve dhe artikujve mbi kontributet letrare të profesor Kolë Ashtës, ato pothuajse nuk kanë ekzistuar. Kolë Ashta i ka interesuar opinionit shkencor vetëm si gjuhëtar. Megjithatë janë marrë gjithashtu në shqyrtim kontributet e profesorëve si Gjovalin Shkurti me artikullin "Mbi dijetarin Kolë Ashta"^[23], Enver Muhametaj^[24] me... si dhe së fundmi Gëzim Puka^[25] me...

Një ndihmesë për hartimin e bibliografisë së botimeve të profesor Ashtës kanë dhënë edhe profesorët e universitetit të Shkodrës^[26] Artan Haxhi, Mimoza Priku dhe Alfred Çapaliku.

Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Prof. Kolë Ashtës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", organizoi një konferencë shkencore me temë "Prof. dr. Kolë Ashta dhe studimet albanologjike ndër vite"^[27]. Mbi kontributet letrare të profesor Kolë Ashtës ligjëruan Prof. dr. Alfred Çapaliku "Ashta letrar (Përkthyesi, poeti, kritik)"; Prof. as. dr. Vjollca Osja "Kontributi i K. Ashtës në studimin e letërsisë së gjysmës së parë të shek. XX"; Dr. Gëzim Puka "Kolë Ashta si kritik

letrar”, Dr. Lisandri Kola “Mbi sprovat kritike letrare të Kolë Ashtës”, Dr. Ermira Alija “Shpirti shqiptar në studimet letrare të Kolë Ashtës, referuar revistës “Shkëndija” (1940-1943)”.

Një pjesë e fotove janë nga Nikolin Baba, djali i vëllait i bashkëshortes së profesor Kolës, Aneta Baba Ashta. Fotot e tjera janë marrë nga arkivi i Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, arkivi personal i professor Romeo Gurakuqit, si dhe nga arkivi im personal. Këtu gjej rastin të falenderoj edhe disa kolegë dhe ish nxënës të profesorit, të cilët më kanë frymëzuar me kujtimet e tyre pikante.

- [1] Pashk Gjeçi (Shkodër, 1918 - Tiranë, 2010) qe poet, dhe përkthyes i “Komedisë hyjnore” të Dantes dhe “Odisesë” së Homerit.
- [2] Shiko. Gurakuqi, Karl. “Qi të mos harrohen”, ditar. Vëll. 1, fq.174. Dorëshkrim.
- [3] Nga bisedat me xhaxhanë tim Çezar Çapaliku, ish nxënës i profesor Kolës.
- [4] “Më vetëtoi idea” shprehje tipike e profesor Kolës.
- [5] Shih: Revista “Leka”, februar, VIII/1936, nr. 2, f. 69.
- [6] Kritiku kryesor i artit anglez i epokës viktoriane, si dhe një mendimtar i shquar shoqëror dhe filantrop
- [7] Poet dhe shkrimtar moralist Italian, i njohur edhe me pseudonimin Neri Tanfucio
- [8] Poet, studiues klasik dhe një figurë emblematike e letërsisë italiane të fund shekullit XIX, që së bashku me Gabriele D’Annunzio, ishte poeti më i madh dekadent i Italisë.
- [9] Poet, shkrimtar, kritik letrar me shumë me ndikim dhe i vlerësuar si poeti zyrtar kombëtar i Italisë moderne
- [10] Poet satirist Italian.
- [11] Poet, dramaturg dhe përkthyes neoklasicist.
- [12] Shih: “Koha” nr. 30 Milano 25 shkurt 1943”
- [13] Shih: Revista “Shkëndija”, gusht-shtator 1941, fq.61
- [14] Shih: Revista “Hylli I Dritës” fq.453-456
- [15] Pseudonim i Dom Nikollë Mazrreku.
- [16] Shih: “I tretuni”. Revista “Shkëndija”, viti III, nr.3, janar, 1943
- [17] Shiko: “Manxoni- Të fejuemit- At Mark Harapi S.J” botuar në revistën “Shkëndija” vj.III, nr.5 Tiranë mars 1943
- [18] Harapi, Mark. “Pse gegnisht Manzoni e jo në gjuhë zyrtare?”. Revista “Leka”. Nr.6. Shkodër,1943
- [19] Shih: Revista “Shkëndija”, viti III, nr.10. Tiranë, gusht, 1943
- [20] Shih: “Shkoj shyta me marrë brienat e la edhe veshët”. Revista “Leka”, viti XV, Shkodër, 1943
- [21] Shih: Gazeta “Tomori”, 28 maj 1942.
- [22] Po aty
- [23] Shkurtaj, Gjovalin. Mbi dijetarin Kolë Ashta. Tiranë, 28 Nëntor

2014. https://shkoder.net/kole_ashta/
- [24] Muhametaj, Enver. (Mblodhi) Mendimi letrar shqiptar (1939-1944), Tiranë, 2008
- [25] Shih. Puka, Gëzim. "Kolë Ashta si kritik letrar". Tiranë. Gazeta Mapo 07/07/18
- [26] Haxhi, A; Prik, M; Capaliku, A. " Bibliografi kronologjike e publikimeve të prof. dr. Kolë Ashtës (1936 - 2017)" botuar në revistën "Buletini shkencor", Seria e shkencave shoqërore, Viti XLVIII i botimit Nr. 68. Shkodër, 2018.
- [27] Konferenca i zhvilloi punimet më 29 qershor 2018.

Klodiana MARTICAMAJ, Ermira ALIJA

ELEMENTE LETRARE NË PERIODIKUN E SHKODRËS, NË VITET 1910-1920

Letërsia bashkëjeton pjesërisht me strukturat e shtypit dhe me shtjetet e ndësisme politike e kombëtare, pavarësisht pavarësisë së saj.

Për ne ka qenë interesante të ndjekim këtë shpërfaqje të letërsisë në shtyp në vitet, kur shtjetet politike dhe kombëtare kanë qenë tejet të ndjeshme. Këtë gjë e kemi bërë për të kuptuar më mirë raportin e faktorëve historikë e politikë me letërsinë publicistike. Prandaj kemi marrë në shqyrtim shtypin kulturor në vitet 1910 – 1920, periudhë, kur ndodhën disa nga ngjarjet më të rëndësishme të Historisë shqiptare, si: *Reaksioni xhonturk kundër kulturës dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (1910)*; *Kongresi Dytë i Manastirit (2-3 prill 1910)*; *Kuvendi i Greçës (23 qershor 1911)*; *Kryengritja e Kosovës (mars-prill 1910)*; *Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës (1911)*; *Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912*; *Lufta e Parë Ballkanike (1912)*; *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 1912)*; *Dorëzimi i Shkodrës*; *Ardhja e Princ Vidit në Shqipëri*; *Konferenca e ambasadorëve (korrik 1913)*, *Kryengritja e Shqipërisë së Mesme (1914-1915)*; *Lufta I Botërore 1914*; *Traktati i Londrës i 26 prillit 1915*, *Konferenca e Paqes në Paris (18 janar 1919)*; *Kongresi Kombëtar i Lushnjës (21 janar 1920) etj..*

Këtë shpërfaqje të letërsisë, për lehtësi studimi, e kemi shqyrtuar në

Periodikun e Shkodrës, por për ta kuptuar më mirë, e kemi vendosur në kuadrin e periodikëve të tjerë të periudhës që morëm në shqyrtim. Të dhënat jemi përpjekur t'i sistemojmë në një tabelë, ku kemi bërë objekt edhe gjuhët e botimit duke e kuptuar këtë jo vetëm si politikë, por edhe si ndërkomunikim kulturor. Kemi bërë objekt të fokusimit edhe personalitete që janë marrë me këto çështje për të gjurmuar raportin e shkrintarëve me shtypin.

Kemi përjashtuar median që ka pasur vetëm natyrë politike dhe në tabela kemi përdorur shkurtime, me qëllim që shprehim të mos marrin shumë vend dhe pamja të jetë sa më e qartë, në funksion të sintetizimit. Kemi shmangur, përgjithësisht, vitet e gazetave dhe revistave që dalin jashtë kohës që kemi marrë në shqyrtim.

Tabela me një pamje të përgjithshme të revistave¹ me karakter kulturor që kanë qarkulluar në vitet 1910-1920 në Shqipëri e jashtë saj

Titulli e lloji i periodikut	Përgj. dhe vendi i botimit	Vitet e bot.	Titulli e lloji i periodikut	Përgj. dhe vendi i botimit	Vitet e bot.
AGIMI... revistë e përtremuajshme, letrare, shoqërore, politike, pedagogjike, satirike, Shkodër, Organ i shoq. "Vilazënija" në shqip.	Dr. Kristo Floqi, Karl Gurakuqi	1919 1920	ADRIATIKU Gazetë me program kritikë në gjuhën shqipe	Drejtuës Josif Pani Amerikë	1914
ALBANIA gazetë e përjavshme, kombëtare dhe politike, shoqërore e letrare në shqip, anglisht e frëngjisht, Organ i Partisë Kombëtare dhe Politike.	Dr. A.G. Nache, D. Baša, etj Worcester	1918 1919 1920	ALBANIA... revistë e përmuajshme e ilustruar letrare, kulturele, arkeologjike, ekonomike, historike, artistike etj., në italisht,	A.R. Caffa- Relli Reggio- Calabria 1919-1921	1920

¹ Për titujt dhe numrin e revistave i jemi referuar; Listes së Periodikut të Bibliotekës së Universitetit "L. Gurakuqi", përgatitur nga Vili Kamsi (1989), si dhe Katalogut të Periodikut të Albanologjisë, të bibliotekës "Marin Barleti".

ALBANIA (ES-TRATTO DA "LA NAZIONE ALBANESE") revistë e përdyjavshme, politike, kulturele, letrare, në ital. e pak shqip	Roma 1897-1924	1919 1920	ATDHEU Del dy here ne muaj. Gazetë politike, shoqerore, kulturere, letrare, folkloristike etj. Nga 1914 nr. 37 « Organ kombëtar » me qendër në Durrës	Drejtor Ioan N. Mihail-Lehova Konstancë (Rumani)	1912 1913 1914 Bukuresht
ANNUARIO (1917-1918) Vjetar kalendrar E përvjetshme, kulturere, gjuhësore, historike, ekonomike, ngjarje, lajme.	Botuar nga Instituti Oriental i Napolit, në italisht, 1918	1918	BASHKIMI I KOMBIT e përvjetshme Botohet prej shoqërisë Botonjese Literare Manastir	Drejtor, A. Fehim Zavalani; Gjuke Dukagjini (Salih Gjuka)	1910
BESA SHQYP-TARE Gazetë e përdyditshme politike, shoqerore, kulturele, letrare, ekonomike, lajme të kohës etj., në shqip, gjermanisht e italisht, 1913-1921 (Prej 1918 eshte dy here ne javë) Pas 1915 botohet si ZANI I SHKODERS. Pas '16 serish si BESA SHQIPTARE.	Dr.Ndoc Nikaj, Qasim Përdoda, Tomë Pistulli Shkodër	1913 14, 15 1916, 1918 19, 20	BIBLIOTEKA "ZËRI I SHQIPËRISË" Revistë e përmuajshme, politike, shoq, kulturele, letrare, lajme të kohës etj., në shqip, frëngjisht e anglisht	Dr.Th.Gërmenji Red. Kr. A.Dako Sofie	1915, 1916

BOLLETINO DELLA REALE SOCIETA GEOGRAFICA= BULETINI I SHOQËRISË MBRETËRORE TË GJEOGRAFISË Revistë e për-muajshme, inform-ative, ekonomike, gjeografike, sociale, kulturore,	Roma në italisht, 1867-1914...	1914	CORRIERE DELLE PUGLIE Redaktor i shqipes Sotir Gjika, gazetë Italisht e vetem nje faqe shqip	Bari	1914 15, 16
DIALËRIA revistë vjetore, letra-re, shoqërore, Kulturele etj., me ilustrime, organ i Shoqërisë së studentëve Shqiptar, në shqip, 1920-1929 e përjavshme (të shtunave), politike, shoqërore, letrare, kulturele, pedagogjike, ekonomike, lajme e kronika të kohës etj.,	Kr.red. Nush Bushati, Gj.Basha, M. Zallari, Gj. Pekmezi, H. Ceka, S. Luarasi, F.Wallisch	Wien 1920	DIELLI [Nr. 2302 (1921) e 2370(1922)kanë shën.Botim i Boston Detoit Mich.pos. për Evropën] organ i Federatës Panshqiptare t'Amërikës "Vatra", 1909-1939...-...1972	Dr. Fan Noli, Faik Konicë, Kristo Floqi, Kristo Dako, Bahri Omari, etj. në shqip e anglisht,	1910 1911 1912 1915 1919 1920
DILLI E përjavshme.	Mehmet Pardo Shkodër	1910 1911	DIELLI E FLAM-URI... gazetë (shih te Dielli...), 1910-1911	Boston	1910 1911
DITURIA Revistë e për-muajshme me ilu-strime kulturele, letrare, shkencore, në shqip (bot. i 1909 me alf. e Stambol-lit), 1909, 1916, 1926-1929, Selanik, (1916) Bucurest, Tiranë	Dr.Lumo Skendo, Carshi Bashi, Myshir Sokak, Rafail Anastas	1910 11,12 13,14 15,16 17,18 19, 20	DRITA... gazetë dy herë në javë, politike, shoqërore, kombëtare, literare, në shqip, 1911-1912	Dr.Mustafa Hilmi Leskoviku, Ali Panariti E.N. Elbasanasi Manastir	1911 1912

E DREJTA gazetë E përjavshme, politike e sociale.	Dr. Leonidha Naçi Korfuz	1911 1912	DRITA Gazetë kombëtare, në shqip,	Dr. Veli Hashorva Gjirokastër	1920- 1924
*ELÇIJA E ZEMRËS S'JEZU KRISHTIT... , revistë 1891-1913 Nga 1914, 1915 dhe 1916 është " PËRPARIMI ", Pastaj del me emrin: " LAJMTARI I ZEMERS T'JEZU KRISHTIT " e përmuajshme fetare e klerit katolik, letr, kult, prej Kolegjit t'Jezuëve, ... në shqip me alf. e autorëve të veriut, alf. italian e alf. latin E perkohshme. Mujore e klerit Katolik. Drejtimi në shtypshkroje të Zojës së Paperlyer- Shkoder 1891	Shkodër Dr.P.J. Jungg, P.D. Pasi, P.Fr.Gjenoviçi, P. E. Serreçi, P. Sh. Zadrëma, P. A. Busetti, P. A. Xanoni Botohet prej kolegjit të jezuitëve në Shkodër.	1910 1911 1912 1913 1914 1915 1916 1917 1918 1919 1920	FIALA E T'IN ZOTI revistë e përjavshme fetare e rritit grek nga Hora e t' Arbëreshevet Dr.Ndon Masi, Bot. Paolo Schiro	në shqip, 1912-1915 Palermo	1913 1914 1915
FLAMUR'I SHQIPËRISË Gazetë pol. e shoq. në shqip e rumanisht Tri herë në muaj	Alexandru çerava	Rumani Constana 1915 1916	GAZETA E KORÇES Gazetë kombetare politike e ek, kulturele, letrare, sportive. Tre herë në javë.	Arhimidhi Vangjeli Korçë	1916 17, 18 19, 20
GRUAJA SHQIPTARE Revistë e përmuajshme pedag. Shoq etj., organ i Komitetit "Gruaja shqiptare"	Dr.Marka Pllana	në shqip 1920-1921 Shkodër	GREETHI Fletore satirike	Shkodër	1914

<p>HYLLI I DRITËS... Revistë e përmu- jshme fetare, filozo- fike, juridike, letrare, kulturale, shoqërore, gjuhësore, folklorike, lajme të kohës etj., në shqip e pak italisht, frëngjisht, gjerman- isht, lat.</p>	<p>Dr. Gj. Fishta, or- gan i Kuvendit t'Fretenve, në shqip,</p>	<p>Shkodër 1913- 1914, 1921- 1924, 1930-1944</p>	<p>HANA</p>	<p>Mudir e Muhair (drejtor e redaktor) Mehmet Hidajet (Pardo)- Scodra</p>	<p>Shkodër 1911 1912</p>
<p>ILLYRIA revistë E përkohshme politi- ke e literare Dy herë në muaj. Anglisht frëngjisht dhe shqip</p>	<p>Botonjes dhe drejtor Kost.Chekrezi USA</p>	<p>1916</p>	<p>KORÇA Gazetë e përjavshme politike, literare dhe tregëtare Shtypur në shtypsh- kronjen e Korçës</p>	<p>Drejtonjes; Sami Bej Pojani Kryesh- kronjes; Lyfti be Za- valani Korçë</p>	<p>1910</p>
<p>KALENDAR I PJESSHËM me ditime e msime gjithfarësh, në shqip, 1910</p>	<p>Shkodër Shtyp."Nikaj"</p>	<p>1910</p>	<p>KALENDARI e Vreemet mbi funk- cione qi bahen n' kishe t' Shoqnis Jezu per vieten 1911. Kalendar liturgjik kishtar, që flet për festat fetare.()</p>	<p>Arqipeshvia Shkodër Shtypshk- roja e Zojës Paperlyeme</p>	<p>1910 1911</p>
<p>KALENDARI I SHOQËRISË "DIJA" ... e përvjetshme, kal- endar fetar të tri besimeve, lëndë kulturore, Letrare, shoqërore, kronika etj., në shqip</p>	<p>Ëien Sofie Manastir Kalendar 55</p>	<p>1910 1906- 1908, 1910</p>	<p>KALENDARI I VA- TRËS I MOTIT Amerike Boston</p>	<p>Federata pan shqiptar- e "Vatra" e Amerikes</p>	<p>1918</p>

<p>KALENDARI KOMBIAR E përvjetshme, kalendar fetar, lëndë kulturore, letrare, enciklopedike, shoqërore, kronika etj., në shqip (deri më 1916 me alf. e Stambolit), 1897-1916, 1926, 1928 Diterreferenjësi Shtypur prej shoq "Dëshirë", në shtypshkronje Mbrothesia" Për vitet 1909-1910 drejtimi: Bulevard Dondukof; Carshi Bashi Myshir Sokak- Selanik/ Nga viti 1911-1916 Sofje. Nga 1901 titullohet "Kalendari Kombiar."</p>	<p>Sofie Selanik Sofie Tiranë</p>	<p>1910 11, 12 13, 14 15 1926 1928</p>	<p>KALENDARI "KORÇA" e përvjetshme, kalendar fetar të besimit ortodoks, lëndë kulturore, letrare, shoqërore, kronika etj., Manastir 1911 Korçë, 1912 Konstancë në shqip (me alf. E Stambolit), 1909-1933</p>	<p>Dr.M.S. Xoxe, Jami Kremo, Dhori Koti</p>	<p>1910 11, 12 13, 14 15, 16 17, 18 19, 20</p>
<p>KALENDARI I VJETËS (VEPRA PIJORE) E përvjetshme, kalendar fetar, lëndë kulturore, letrare, kuriozitet, historike, kronika etj.,</p>	<p>Botim i klerit katolik të Shkodrës, në shqip, Shtypshkronja e Zojes se Papertyer</p>	<p>1912 13, 14 15, 16 17, 18 19, 20 Shkodër</p>	<p>KALENDARI "SHQYPJA" E përvjetshme, kalendar fetar, lëndë kulturore, letrare, historike, kronika etj., në shqip, 1915</p>	<p>Shkodër Shtypshk. "Nikaj"</p>	<p>1915</p>
<p>KALENDARI PORADECI I përvjetshëm. Kalendar i festave fetare ortodokse.</p>	<p>Mihal V. Belkameni</p>	<p>1919 1920</p>	<p>KALENDARI I SOKNISË □ "DIJA" Nga 1908 shtypur në "Mbrothesia" e Kristo Luarasit, Sofia Bullgari Me 1910 në Manastir</p>	<p>Nga nr. 2 është e radhuar prej Sakolit (pseud. i Hilë Mosit)</p>	<p>Wien 1910</p>

<p>KOHA Gazetë e përjavshme politike, kulturele, shoqërore, letrare, ekonomike, kronika e lajme, etj., në shqip, frëngjisht e anglisht, 1911-1926</p>	<p>Dr. Mihal e Koço Grameno</p>	<p>Korçë 1911 12, 13 14, 15 16, 17 18, 19 1920</p>	<p>KOHA Gazetë e përjavshme. Kujdeson punët Komtare e t' Diturisë BASHKIMI (në vazhdim)... e përjavshme, pol, shoq, kult, letr, ek, lajme të kohës</p>	<p>D. Ndoc Nikaj Shkodër</p>	<p>në shqip e turqisht, 1910-1911</p>
<p>KOHA E RE Gazete e përditshme, politike, shoqërore, në shqip e frëngjisht 1919, 1925</p>	<p>Dr. Nikoll Ivanaj 1919</p>	<p>Shkodër</p>	<p>KOMBI Gazetë pro Patriis Laribus, politike, kulturele, shoqërore, në shqip</p>	<p>Dr. Sali Nivica</p>	<p>1919 Shkodër</p>
<p>KOPËSHI LETRAR Revistë e përjavshme kulturele, gjuhësore, folkloristike, letrare, pedagogjike, në shqip, 1918-1919</p>	<p>Dr. A. Xhuvani</p>	<p>Elbasan 1918 1919</p>	<p>KUVENDI... Gazetë vazhdim i Corriere delle Puglie... e përjavshme, politike, shoqërore, letrare, kulturele, gjuhësore etj.</p>	<p>Dr. Sotir Gjika, Ernesto Fratoni Shqip e italisht</p>	<p>Roma 1918 1919 1920</p>
<p>LAJMETARI Gazetë Politike shoqërore, letrare, kulturele.</p>	<p>Kristo Luarasi</p>	<p>Sofje, Bullgari 1911 1912</p>	<p>LAJMET E KOMISIS LETRARE SHQIPE gazetë e përkohshme gjuhësore, botim i "Komisjs Letrare Shqipe"</p>	<p>Shkodër</p>	<p>1918 në shqip</p>
<p>LIDHJA ORTHODOKS Gazetë e përditshme politike, fetare, letrare</p>	<p>Dr. Mihal Grameno Korçë</p>	<p>në shqip e greqisht, 1909-1910</p>	<p>Lirija gazetë e përjavshme, pol, shoq, kult, letrare, kronika etj., në shqip, 1908-1910</p>	<p>Dr. Lumo Skendo - Mithat Frashëri Doktor Shaban</p>	<p>Selanik</p>

LIBERI I PER-VJETSTEM SHQIPTARI Për festat fetare, lende kult, shkenc, letr. e shoq	Shkronjesi; Hil Mosi	Vjetar shqip e turqisht Stamboll 1911	MBROJTJA SHQIPETARE E përjavshme, politike, shoq, ekonomike e letrare, në gjuhën shqipe dhe pjesërisht anglisht.	Botohet prej Shoqëria Mprotja Shqipetare	USA 1916
LAHUT E MALSIS Një herë në muaj	Hristo D. Qirias	1910 Manastir	Liri e Shqipërisë Gazetë e përdhjetëditshme politike, shoqërore, kulturele, letrare, kronika etj., në shqip,	Dr.Kristo Luarasi	Sofia 1911-1915
LUFTETARI I DREJTËSISE Revistë politike e shoq.	H.Lumi	Boston 1917	OPINGA revistë e përkohshme politike e letrare, në shqip e frëngjisht, 1919-1920	Dr.Nikolla Lako, M. Guillot	Bologna 1919 1920
RASSEGNA ITALO-ALBANESE (Rrjeshtime Italo-Shqiptare) politike, kulturele, historike, gjuhësore, lajme. E përkohshme mujore Italisht e pjesërisht shqip e frëngjisht	Rosolino Petrota 1919 1920	periodik Palermo	MBROJTJA KOMBËTARE... gazetë e përjavshme, politike, shoqërore, letrare, lajme të kohës etj.,	Dr.Dom Mark Vasa, Qazim Kokoshi	Vlorë shqip 1920-1923
NAZIONE(LA) ALBANESE = KOMBI SHQIPTAR Revistë e përdyjavshme, pol, kult, letr. Në italisht e pak shqip.	Dr.Anselmo Lorecchio, Eugenio Calio	Catanza-ro 1897-1924	LA RIVISTA DEI BALCANI Revistë e përdyjavshme me politike historik, gjeografi tregtare, finance, bujqësi, art, doke e zakone.	Drejtor Terenc Toçi Kryredaktor ; Françesk Argondica	Romë 1912 1913 italisht e pjesërisht shqip.

<p>ÖSTER-REICHISCHE RUNDSCHAU PËRSHFAQJE AUSTRIAKE... e revistë e përkohshme, pol, letr, etnografike, kult, shkenc, shoq.</p>	<p>Pron. Alfred Freikern v. Berger; Bot.L.F.v.Chlmecky, K.Glossy, F.F.v. Oppenheimer</p>	<p>gjermanisht, 1913 Wien 1913</p>	<p>PAPAGALLO(IL)... gazetë e përkohshme me ngjyra, pol., humoristike, satirike</p>	<p>Dr. Augusto Grossi në italisht e frengjisht,</p>	<p>Bologna 1913</p>
<p>PËRLINDJA E SHQIPËNIËS gazetë e përdyditshme politike, shoqërore, lajme të kohës etj., në shqip</p>	<p>Dr. D. Berati</p>	<p>Vlorë 1913 1914</p>	<p>PERLINDJA Nje here/javë. Gazetë pol e shoq</p>	<p>USA Iraklin N. Trajan</p>	<p>1917 në gjuhë shqipe</p>
<p>PËRPARIMI... revistë e përmujshme e ilustruar politike, shoqërore, letrare, kulturele etj.,</p>	<p>Dr. Vangjel D.Nasse, Zenel H.Dizdari</p>	<p>Neë York në shqip 1916 17, 18 19, 20</p>	<p>RASSEGNA ITALO-ALBANESE = SHQYRTIME ITALO-SHQIPTARE Revistë e përmujshme politike, gjuhësore, historike, kulturele, lajme etj.,</p>	<p>Dr.Përgj. Rosalino Petrotta Palermo 1919 1920 1921</p>	<p>në italisht pjesërisht në shqip e frengjisht</p>
<p>POPULLI Gazetë e përjavshme politike, shoqërore, kulturele, ekonomike, lajme të kohës etj., në shqip e frëngjisht,</p>	<p>Dr. Mustafa Qulli, Kryered. Seit Qemal</p>	<p>Vlorë-Shkodër 1914 1915</p>	<p>POPULLI Gazetë politike e shoqërore në shqip dhe frëngjisht. pesë herë në muaj.</p>	<p>Salih Niviteza gerant Malik Bey Bushati Bedri Pejan</p>	<p>Shkodër 1919 1920</p>
<p>PERLINDJA E SHQIPËNIËS Gazetë politike e shoqërore. Në gjuhën shqipe 2 herë në javë</p>	<p>D. Beratti</p>	<p>Vlorë 1913 1914</p>	<p>POSTA E SHQIPËNIËS Gazetë e përdyditshme politike, kulturele shoqërore, lajme të kohës etj.,</p>	<p>Dr. Gjergj Fishta shqip e gjermanisht,</p>	<p>Shkodër 1916 1917 1918</p>

RIVISTA DEI BALCANI (LA) ... revistë politike e shoqërore, historike, kulturele, letrare, gjeografike, art, doke e zakone, ekonomike, financiare, E përdyjavshme me ilustrime në italisht e pjesërisht në shqip,.	Dr. e Përgj. Terenc Toçi, Red.F. Argondizza	Roma 1912-1913	SHQIPËTARI...LIBERI I PËRVJET-SHEM kalendar fetar pol, shoq, kult, letr, kuriozitetet etj., botuar prej zyrës së fletës "Shqipëtarit",	E përvitshme, në shqip me alf. e Stambollit e turqisht, 1909-1911	Kostandi-nopoje Stamboll 1910 1911
ROMA E L'ORIENTE= ROMA DHE LINDJA... fetare katolike, politike, historike, në italisht. 1910-1921...	Menagjer Përgj. Arbaçe Giovannino	Roma 1913, 1914 1918 1919, 1920 1921	SHQIPËRI E RE = ALBANIA NUOVA Gazetë e përvitshme, politike, letrare, satirike, kult, shoq, ek, sportive, lajme etj., Shqip e frëngjisht e rumanisht, 1919-1935...	Red.I. Qafëzezi, Dr.Pron. Mihal Xoxe Red.Dr. Gjergj Bubani (Mandi Kar-do)	Bucuresht-Constan-ta 1920
SHQYPNIA E RE Gazetë politike, letare, shoqërore, kulturele, lajme te kohes etj.	Drejtor H Mosi Kryshkrojes R. Siliqi Arketar: Karlo Suma	Shkodër 1913 1914 2 / javë ne shqip	(ALBANSKI OREL) SHQIPONJA E SHQIPENIS= ... gazetë e përdyjavshme, politike, shoq, kult, letrare,	Dr.Josif Jovan Bageri shqip e pjesërisht në bullgarisht	Sofia 1910 1911
SHKUMBI E përvitshme	Kasim Frasheri Hiqmet Salih	Stamboll 1911 1912	SHQIPËTARI ... gazetë e përvitshme, pol, shoq, kult, lajme etj., Në shqip me alf. e Stambollit, frëngjisht e turqisht	Dr. Dervish Hima Kryered. Hil Mosi	Kostandi-nopoje Stamboll 1909-1911

SHKEPTIMA gazetë E përjavshme	E. Toptani Aleksander Xhuvani	Kajro 1910 1911	SHKUPI Gazetë e përjavshme. Pruen intereset e kombit. Nuk tregohet se çfarë lloj gazete është.	Drejtimi i gazetës mbanet prej një tufe shqiptare.	Ushkup (Shkup) 1911 1912
SHKODRA Një herë në javë Gazetë politike e shoqërore.	Drejtor Riza Dani	Shkodër 1915	SHQIPERIA (ALBANIA) Revistë në shqip	Shoqëria fetare muhamedane shqiptare	USA 1918
TARABOSHI Gazetë inform, pol, kultur, shoq, letr, ekon, lajme të kohës etj., në shqip e italisht, e përditshme dhe e përmuajshme	Dr. Terenc Toçi	Shkodër 1913 1914	TOMORRI... gazetë e përkohshme politike, letrare, në shqip me dy alf. e Manastirit, 1910	Dr. e pron. Lef Nosi	Elbasan 1910
TRUMBETA E KRUIJËS = THE TRUMPET OF CROYA gazetë politike, letrare, shoqërore, e përditshme në shqip e anglisht	Dr. e pron. Faik Konica	1911 Saint-Louis	TRUMBETA E KRUIJËS Gazetë politike	Faik Konica Leonidha Naçi Durrës	1913 1914
THE ALBANIA ERA Revistë politike, shoqërore, historike letrare. Shqip dhe anglisht	John Adams Anastas Pandelev	USA 1915 1916	ZANA Revistë; Dy herë/muaj E përkohshme vetem letr, shqip. Me ilustrime kult, shoq.	Drejtor Lulo Malësori (Milo Duçi) Durrës	1914
THE ADRIATIC REVUE Revistë e përmuajshme kulturalo, shoqërore, politike e letrare	Fan Noli Anglisht e pjeser në shqip	Boston 1918 1919			
USHTIMA I KRUIJËS = L'ECHO DE CROYA... gazetë e përjavshme politike, letrare, shoqërore. në shqip e frëngjisht	Përgj. Asllan Kruja, Leonidha Naçi, Dr. Josif Bageri	1913 1914 Bari Durrës	VËLLAZËNIJA... gazetë me ilustrime politike, kulturalo, shoqërore, 1916-1918 E përjavshme organ i shoq. "Dija", në shqip	Red. Leo Freundlich	Wien 1916 1917 1918

VERTETA(E) = THE THRUTH Gazetë e përjavshme, politike, letrare, shoqërore, lajme e kronika të kohës etj., në shqip, 1920-1923	Dr. Vangjel Lasku	1920 Saint- Louis	E VERTETA gazetë Politike fetare e letrare. E përjavshme shqip- greq.	Drejtor Leon M. Frasheri	Stamboll 1911
VULLNETARI Gazetë popullore, politike dhe satirike Organ kombëtar. Del dy herë në muaj.	Washington Kole P. Rodhe	1916 1917	VIOSA gazetë komb, popullore, Literare, satirike Dy herë në muaj. Në gjuhën shqipe.	Red. V. Hashorva.	New York 1916
Xgjimi... revistë e përmujshme me ilustrime politike, shoqërore,	Dr. Dhori Kotti Shkronjës Mihal S. Xoxe	Korçë në shqip, 1913-1914	ZGJIM'I SHQIPERISE Del një herë në javë Frengj e shqip E përmujshme Per te mbrojtur te drejtat e kombit dhe arsimit	Drejtor Nikolla Naçi Hamza Tetazati Fehmi Tepelena	Janinë 1910 1911
YLL'IMËNGJESIT = THE MORNING STAR Revistë e përdyjavshme me ilustrime politike, letrare, shoqërore, pedagogjike, historike, gjuhësore, letrare etj.	Publ. Paraskevi D. Kyrias në shqip e anglisht	Boston 1917 1918 1919 1920	ZANI I RI Gazetë e përjavshme politike, shoqërore, lajme të kohës etj., në shqip, 1920	Dr. Osman Myderrizi	Tiranë 1920
ZANI I SHKODRËS Gazetë e përdyditshme politike, shoqërore, lajme të kohës etj., shqip e pjesër serb e italisht.	Shkodër Dr. Ndoc Nikaj	1915 1916	ZËR'I POPULLIT Gazetë e përjavshme, komb, politike letrare shqip dhe pjesërisht dhe anglisht	Drejtor; Kris- to Floqi Neç York	1912 1913
ZANI I SHNA NDOU... Revistë fetare e kulture, letrare e historike, organ Kuvendit t'Fretenve, në shqip, 1913-1944 Shkodër	Dr. Zef Gici Marjan Prela A. Harapi, V Prenmushi, J. Rrota, Antonin Fishta, Jak Marlekaj, Pron. Pashk Bardhi, Dr. Gj. Fishta, Dr. Agustin Ashiku	1913 14, 15 16, 17 18, 19 1920	ZOJA E SHKODERS. DRITA E SHQYPSNIËS Revistë e përmujshme fetare e klerit katolik: pol, letr, kult, shoq, lajme të kohës etj., Shkodër në shqip	Zyra famullitare	1917 1918 1919

Vihet re se janë botuar 103 gazeta e revista, nga të cilat 42 (40.8%) janë botuar brenda vendit dhe 61 (59.2%) jashtë Shqipërisë. Pra, botohen më shumë jashtë Shqipërisë, sesa brenda. Shtetet ku u botuan më shumë janë përkatësisht: Amerika me 19 gazeta e revista (18.4%), Italia 14 (13.5%), Maqedonia² (Manastir e Shkup) 5, Bullgaria 5 (4.8%), Greqia (Selanik, Korfuz, Janinë) 4 (3.8%), Stambolli 4(3.8%).

Vihet re se një pjesë e gazetave e revistave në këtë periudhë u botuan edhe në gjuhë të huaja, si: në shqip-italisht e në shqip-frëngjisht nga 6 periodikë (5.8%), italisht 6 periodikë(5.8%); shqip-anglisht 5 periodikë (4.8%); shqip-rumanisht e shqip-turqisht nga 1 periodik etj.Revistat e gazetat e botuara në gjuhë të huaj, përbëjnë 27.1% të gjithë periodikut, gjë që tregon misionin e medias shqiptare për të komunikuar me opinionin e shëndoshë europian.

Ndër qytetet shqiptare ku u botua më shumë, e para renditet Shkodra, me 27 gazeta e revista (26.2%). Më pas është Korça, 5 (4.8 %), Durrësi e Vlora me nga 3 periodikë (2.9%).

Nga periodikët, 12 janë me përmbajtje fetare (11.6%): 7 nga periodiku katolik (6.7%), 1 nga periodiku mysliman (0.9%) dhe 4 nga ai ortodoks (3.8%). Ndërsa 1 është i bashkuar nga të tri besimet: "Kalendari i shoqërisë "Dija", gjë që tregon një politikë përbashkuese mes tri besimeve.

Vendi i elementeve letrare në revistat shqip me karakter kulturor që kanë qarkulluar në vitet 1910-1920, në Shkodër.


Pasi kemi përmbledhur në mënyrë sintetike dhe kemi dhënë në mënyrë panoramike shtypin në gjithë Shqipërinë e viteve 1910-'20, jemi ndalur në mënyrë më të detajuar tek periodiku i Shkodrës i së njëjtës periudhë. Për ne ka qenë interesante të ndjekim shpërfaqjen e letërsisë së shtyp, dimensionin e saj në këto vite, para dhe pas shpalljes së pavarësisë.

Siç u pa, media ishte shumë aktive dhe u përpoq të ndikonte kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht nëpërmjet shumë personaliteteve kulturore e letrare. Shkodra që shquhej për bibliotekat (si të Mehmet Pashë Plakut dhe më vonë të françeskanëve) pati një lëvizje dinamike dhe operative të shtypit politik e kulturor. Tabela³ më poshtë përpiqet

² Në të vërtetë, Manastiri dhe Shkupi ishin qytete me pjesë dërrmuese populësisë shqiptare.

³ Nuk kemi paraqitur në grafik të gjithë periodikun e Shkodrës të viteve 1910- 1920, për arsye estetike, duke qenë se kanë qenë shumë gazeta dhe revista në këtë periudhë. Nuk kemi paraqitur, ato që kanë qenë më shumë politike e shoqërore, apo ato që kanë pasur më pak numra. Kështu te grafiku mungojnë : « Drita e Popullit », « Greqthi », « Hana », « Kombi », « Laimet e Komixis Letare Shqipe », « Populli », « Shkodra »,

të japë një pasqyrë të përgjithshme të periodikut të këtij qyteti, prej ku mund të shihet më mirë nga pikëpamja grafike, jetëgjatësia dhe frekuenca e Periodikëve.



Përveç frekuencës dhe jetëgjatësisë, na interesonte prania e elementeve letrare në periodikun e Shkodrës, në një kohë aspak të zakonshme, për të kuptuar rolin dhe mëvetësinë e letërsisë publicistike në këtë periudhë. Për këtë kemi ndërtuar një tabelë ku kemi bërë objekt vëzhgimi krijimtarinë letrare (pa anashkaluar edhe atë kritike e studimore) në këto periodikë.

PERIODIKU	RUBRIKA TË PRANISHME	AUTORË BASHKËPUNË- TORË
"AGIMI" (revistë) 1919 Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 <i>Rubrikat janë të përsëritura.</i> 1920 Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 <i>(Revistat kanë edhe shumë lajme me tematikë politike)</i>	Poezi me motive dashurie, sociale, atdhetare, fetare, meditative, filozofike etj. Drame , Tregime, Ese Studime (letrare, arkeologjike ...) Kritikë (teatri, ...) Përkthime (historikë, artistikë) Folklor (Gojëdhënë, Thënie të urta) Mitologji Gazmore, Argetuese Jetëshkrim Histori e mendimit albanologjik	Zani i Tomorrit (Bedri Pejani) Eurodensis, Omega (Lazër Shantoja) Kristo Floqi, S. Maleshova Karl Gurakuqi , Hil Mosi, Grethi (Llazar Siliqi, Xhavit Jukniu) M.L. (Mati Logoreci) P., H. Gjylbegaj; Omer Ruzhdi, Zef Harapi , A.J. (Luigi Naraçi) Kolë Gurakuqi (Critikas) M.K. (Mehmet Konica) ; Kadri Borshi K. J. (Kristo Luarasi) R Siliqi; Fishta D.A.K. ; D.N.K N.K (Dom Ndoc Kovaçi) Policia e ree ; Jak Kovaçi ; Gjeloshi S.Ç. (Spiro Çamora)
"BESA SHQIPTARE" (gazetë) 1913 1918	... Karakteri letrar konsiston në llojet e shkrimeve publicistikë-letrare si ese..... përshkuese, ironizuese, propogandistike. <i>Poezi të karakterit patriotik.</i>	R Siliqi; Fishta D.A.K. ; D.N.K N.K (Dom Ndoc Kovaçi) Policia e ree ; Jak Kovaçi ; Gjeloshi S.Ç. (Spiro Çamora)
"DILLI "	Nuk gjendet në bibliotekën M. Barleti.	
"DRITA E POPULLIT"	Nuk gjendet në bibliotekën M. Barleti.	
"ELÇIJA E ZEMRËS S'JEZU KRISHTIT" (revistë), 1891-1913 1910, 1911 1912	Ese Poezi dhe prozë (fetare, moralizuese) Tragjedi (me frymëzim fetar) Përkthim (La Fonteni, Heine) Fabula moralizuese	P.G.F (P.Gjergji Fishta O.F.M.) P.G. P.B.M. Z.B. Nd. Z. (Ndre Zadeja) Lazër Shantoja Athanas Ziler Qiro K.Kuluga
"GRUAJA SHQIPTARE" (revistë)	Poezi moralizuese.	Athanas Ziler Qiro K.Kuluga
"GRËETHI" Fletore satirike 1914	Poezi Pjesëza satirike	Kr. Floqi
"HANA"	Nuk gjendet në bibliotekën M. Barleti.	

<p>"HYLLI I DRITËS" (revistë) 1913 Nr. 1, 2, 3 1914 Nr.4, 5, 6, 7, 8, 9, 10</p>	<p>Poezi, Prozë (p.sh: kushtuar P. Luigj Paliq martirizuar prej malazezve). Kritikë (për librin "Visari Kombaar", për rolin e shkrimit dhe të letërsisë "Kangë popullore Gegnishte" P.Vinçenc Prendushi; Pjesë satirike</p>	<p>P. Vinçens Prendushi P.SH.K. Gjeçovi OFM P. Gjergj Fishta O.F.M. Vjersha të Don Pjeter Zarishit, Abatit t' Mirditës Critikus ; Zef Sqiroi</p>
<p>"KALENDAAR I PJESSHËM" 1910</p>	<p>Anekdota</p>	
<p>KALENDARI e Vreemet mbi funksione qi bahen n' kishet t' Shoqnis Jezu per vieten 1911.</p>		<p>Kalendar liturgjik kishtar, që flet për festat fetare.(1911)</p>
<p>"POPULLI" VI/SHK 1915</p>	<p>Poezi Përkthime Hapet një rubrikë: "<i>Shtylla literare</i>"</p>	<p>E.K.F. H. Gjylbegu; Ismail Mihрко Grup autorësh: Kel Naraqi / Jonus Tafili/ Kol Krajni/ Tajip Hilmiu</p>
<p>"KALENDARI SHQYQJA" shtypshkronja "Nikaj" 1915</p>	<p>Poezi, Tregim Rubrika: Pjesë satirike</p>	<p>Përkthim H.M. (Hysni Myzyri) Siliqi; S. Butka Popullore; K. Floqi; SH.D.</p>
<p>"KALENDARI I VJETËS" (Vepra pjore) 1913, 1914 1915, 1916 1917, 1918 1919, 1920</p>	<p>Tregime moralizuese dhe fetare Rubrikagjuhësore që sqarojnë fjalët me humor, mbi dialektin e Kosoves ...etj Poezi sociale ; Fabula të vjersherume Përkthime Rubrikë me reklama tëbotimeve e fundit , si : <i>Libra fejet, libra teatrit, romanza e kallxime t' kundshme.</i></p>	<p>N.V.=Niko Vrapit (Nustret Vrioni) Atë Ndoc M. Xanoni U.G. / P.L.O.F.M./ D.Z.R. Z.H. (Zef Mark Harapi) Filip Shiroka; Lumo Skendo D.L.SH. (Dom Lazër shantoja) D. Ndue Bityqi; Popullore (Xh.) Ag Sh, Kolë Thaqi Mati Logoreci; Asdreni</p>
<p>"KOMBI..." pro Patriis(gazetë)1919</p>		<p>Nje numer</p>

"LAIMET E KOMISIS LETRARE SHQIPE" (gazetë)1918	"Juda Makabeu", drame, pjesa I Vijon nr. e ardhshem te po atij viti	P. Gjergj Fishta O.F.M.
"ZANIT SHNA NDOUT" 1914, 1915 1916, 1917, 1918, 1919, 1920	Poezi, poema dhe tregime të shkurtra, kryesisht me karakter fetar. Tregimet janë me temë fetare, me nje moral te caktuar dhe zakonisht anonim.	Vallja popullore (Vinçenc Prennushi) P. Gjergj Fishta O.F.M F. Shiroka anonim Llesh Palojsi Vjersha te pabotueme të D.Pjeter Zarishit D. Lazer Shantoja A. Marin Sirdani o.f.m. P.Justin Rrota O.F.M. DR. Kr. Floqi Lec Kurti
"KOHA" që ndërron emrin në "BASHKIMI" 1910 1911	Poezi, Bejta, Anekdotë, Skeç e prozë artistike e fetare Editoriale: <i>"Leteratyra e gjuhës shqipe"</i> , <i>"Gjuha"</i> , <i>"Shkollat shqipe"</i> <i>"Shkrimtarët e huaj e gjuha shqipe"</i> . Përkthime, si p.sh.: nga <i>"Zemra"</i> , de Arnica, Rubrike që prezanton botimet e reja «Nje liber i ri» -	K. P. I. M. (Ilia Mitrushi) Përkthyer nga «Jetimi» H. Vjollca (Zef Mark Harapi) P.G.F. –O.F.M. (Gj. Fishta) I.Baiziani
« KOHA E RE » 1919	Ese, si : "A kena një farë vlefte ? » "A jena t' gjallë?" Dr. Kristo Floqi « Të mbledhim mentë », Mihail Lehova, avokat	N. Ivanaj Kristo Floqi
« POPULLI » (gazetë)1915, 1919	1920 (populli, Salih Niviza) Ka shume politikë dhe histori	Feuilleton Vallja popullore
"POSTA E SHQIPËNIES" (gazetë) 1916, 1917	Ese argumentuese	P. Vinçenc Prennushi O.F.M. P. Justin Rrota o.f.m.
"SHQYPNIA E RE" (gazetë) Konstancë	1920 Poezi	I.Q. (Ilo Mitkë Qafëzezi) Jorgji Bubani
SHKODRA	1915 Ese patriotike	XX A.B. (Antonio Busetti)
TARABOSHI	1913 Përralla të shkurtra	Mushkaja

ZANI I SHKODRËS (gazetë) 1915, 1916	Ky vit nuk përmban asnjë element letrar, vetëm lajme nga zhvillimi i luftimeve; luftërat ballkanike etj.	
ZOJA E SHKODRES, DRITA E SHQYPTARËS (revistë) 1917	Poezi fetare- atdhetare (p.sh.: për Rozafën si simbol) Prozë fetaro-artisike Poezi fetare-moralizuese	Anonim; Mark Suma D... / Z. Një bië e Zojës; D. L. Sh; D, Z P. Vinçens Prennushi o.f.m. D. Nd. Z. / X.

Të dhënat e paraqitura në tabela na ndihmojnë të kemi një pamje sintetike të elementeve letrare në periodikun e Shkodrës, ku kemi vënë re se:

- Në shtypin e viteve 1910-1920 ka pak revista vetëm të karakterit kulturor e aq më pak vetëm letrar; ndër to revista "Agimi", është revista që ka më shumë larmi rubrikash letrare.
- Ka tendencë për të futur çështje kulturore në shumicën dërrmuese të shtypit.
- Vihet re një tendencë e zhvendosjes së shtypit brenda territorit shqiptar: gazeta e revista që fillojnë të botohen jashtë, në numra të rinj, zhvendosen brenda Shqipërisë si dhe pjesëmarrje e personaliteteve edhe nga zona të tjera shqiptare në shtypin e Shkodrës.
- Ka personalitete që kanë bashkëpunuar më shumë se me një revistë apo gazetë, si: **Dom Lazër Shantoja** ("Agimi", "Elçija e Zembrës s'Jezu Krishtit", "Zani i Shna Ndout", "Kalendari i Vjetës", "Zoja e Shkodres. Drita e Shqypniës"); **Kristo Floqi** ("Agimi", "Grethi", "Kalendari Shqypja", "Zani i Shna Ndout", "Koha e Re"); **Gjergj Fishta** ("Besa Shqyptare", "Elçija e Zembrës s'Jezu Krishtit", "Laimet e Komisis letrare Shqype", "Bashkimi"; **Ndre Zadeja** ("Elçija e Zembrës s'Jezu Krishtit", "Zoja e Shkodres, Drita e Shqypniës"); **P. Vinçenc Prennushi** ("Hylli i Dritës", "Zani i Shna Ndout", "Populli", "Posta e Shqypënie", "Zoja e Shkodres. Drita e Shqypniës"); **Zef Mark Harapi** ("Bashkimi", "Kalendari i Vjetës") etj.
- Ka *studime letrare* interesante që shtrojnë shpesh çështje themelore teorike, si p.sh.: "Shënime të shkurtra mbi letratyren shqipe"; "A kemi ne Mythologji", "Studim letrar, mbi vepren e Bogdanit", etj.
- ka tendencë për të publikuar përkthime të veprave të mira dhe variante në shqipërimë. Një prej shembujve është fabula: "**Bretkoca e kau**", e La Fontenit, e përkthyer në një variant geg;
- ka tendencë për ta përdorur letërsinë në funksion ideologjik e për të

dhënë përmes saj mesazhin e krenarisë kombëtare, të rëndësisë së imazhit kombëtar, të unitetit pavarësisht feve të ndryshme, ashtu si ka më pak edhe tejkalime të kësaj tendence;

- ka tejkalime të simbolikës së ngushtë, edhe kur tema është fetare, në sajë të talenteve të fuqishme të cilët bëjnë që shkrimet e tyre, me dashje apo pa dashje, të kenë karakter metafizik
- në këto revista janë përdorur disa pseudonime, që nuk janë të Fjalori i P.Dakes. Disa prej këtyre janë: EURODENSIS - shkruan tek "Agimi"; P. - shkruan tek "Agimi"; D.A.K. - shkruan te "Besa Shqiptare"; POLICIA E REE - shkruan te "Besa Shqiptare", 1913; P.B.M. - shkruan tek "Elçija e Zemres s' Jezu Krishtit"; Z.B. - shkruan tek "Elçija e Zemres s' Jezu Krishtit", 1910; E.K.F. - shkruan te "Populli", 1915; SH.D. - shkruan te « Kalendari Shqypja », 1915 ; U.G. - shkruan te « Kalendari i Vjetës » ; P.L.O.F.M. - shkruan te « Kalendari i Vjetës », 1914 ; D.Z.R. - shkruan te « Kalendari i Vjetës », 1915; XH. - shkruan te « Kalendari i Vjetës », 1917 ; K.P. - shkruan te « Koha », që ndërron emrin në "Bashkimi", 1910 ; JETIMI dhe H. - shkruajnë te « Koha », që ndërron emrin në "Bashkimi", 1910 ; X.X. - shkruan te « Shkodra », 1915 ; MUSHKAJA - shkruan te « Taraboshi », 1913 ; Z. ; D.Z. dhe X. - shkruajnë te « Zoja e Shkoders. Drita e Shqypniës », 1917

Duke shfletuar faqet e këtyre periodikëve kemi parë se në to kanë spikatur figurat më të njohura letrare, të cilët janë bërë shprehje sa e problemeve të kohës, po aq edhe e individualitetit të tyre; ata e kanë konfirmuar veten si zëra të fortëshprehës të mediave përkatëse dhe kanë dhënë atyre tone dhe ngjyra. Ato kanë qenë majat shprehëse të një lëvizjeje të gjerë emancipuese, gjë që e tregon sasia e shtypit dhe shumësia e njerëzve që u morën me të. Njëpërmjet Publicistikës, Letërsia ka marrë dhe ka dhënë jetë; ka ecur me hapin e shqiptarit, ka frymëzuar me synimeve të larta duke ndriçuar mendjet dhe zbutur zemrat, duke forcuar shpresën e qëndrësensit metafizikë shqiptare.

BIBLIOGRAFI


- Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Palok Daka, "Bibliografi retrospektive e gjuhësisë dhe e onomastikës shqiptare 1879-1944, III (1941-1944)", Tiranë 1984
- Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, "Fjalor pseudonimesh (1743- 1944)" Palok Daka, "Shkenca", Tiranë, 1998
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë « Historia e Popullit Shqiptar II »

- Botimet Toena, Tiranë, 2002
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë « Historia e Popullit Shqiptar III » Botimet Toena, Tiranë, 2007
- Doktoratura : "Lëvizja arsimore - kulturore në Shkodër në vitet 1912-1920", Bendis Kraja, Tiranë 2013
- Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimimin dhe kulturën." Markus W. E. Peters, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Tiranë, 2016
- "Provinça Françeskane Shqiptare", Donat Kurti, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- "Shkrimtarë dhe periudha", R. Qosja, 2005
- Katalogu i periodikut të albanologjisë, biblioteka "Marin Barleti" Shkodër
- Lista e periodikut të bibliotekës së Universitetit "L.Gurakuqi", përgatitur nga Vili Kamsi (1989)

Salvator GJEÇI

HEM UDHË, HEM UDHËTAR

Cikël poetik



SALVATOR GJEÇI lindi në Lezhë ku edhe u shkollua, për t'i përmbyllur studimet e larta në Tiranë, në Institutin e Lartë të Arteve, në degën e Dramës.

Ka punuar drejtues në disa institucione kulturore në Lezhë, ndërsa aktualisht ushtron detyrën e regjisorit.

Është autor i këtyre librave:
 "Politikë Biberoni". Fabula.
 Botimet "Toena", 1997
 "Margaritari i një Çmendine".
 Roman. Botimet "Fishta", 2004

dhe 2019, ribotim.

Pjesët teatrale: "Toka Jonë" (variacion me dy personazhet e dramës së Kol Jakovës: Tuçi e Lokja) dhe "Epopeja e Kuvendorëve", komedi – fabul.

– Hem udhë, hem udhëtar (Lirika) – Botimet "Ombra GVG", 2020.
 Cikli poetik është shkëputur nga vëllimi me të njëjtin titull.

VJESHTAT

- triptik -

1.

Pranvera erdhi e iku pa e kuptuar,
pa folur me të shtruar;
rëmbyeshëm erdhi
e me turravrap shkoi.
Por s'jam i brengosur për ikjen e saj,
as në kërkim pranverash nuk do dal,
por vjeshtën...ah!...
vjeshtën gjatë dua ta ndal.

2.

E bukur,
e ëmbël, plot ngjyra
zhvishesh ngadalë në sfilatë -
në shtrat të pret vampiri plakushi
dimri i gjatë.

3.

A janë vjeshtat të pabesa
apo dimrat na i rëmbejnë
e nuk na i kthejnë?

SHTËPIA E POETIT

- Ndoc Gjetjes -

Ka kohë që rrin i mbyllur në shtëpi
me botën qelq i dritareve e ndan
pranë rrugës ku pihet kafja me raki
ku Drini kryelartë i shkon aq pranë.

Gulçima e një kolle të vjetër
e mbylli në manastirin e vetmisë
dënuar ta çojë jetën me laps e letër
të shkruajë për gjithë dertet e njerëzisë.

Atje ngujuar sikur fsheh ndonjë sekret
e bota thonë thur vargje për njerëzinë
një nga një përmend banorët në qytet
por ata për këtë aspak s' duan t'ia dinë.

Mbeti disi gjatë ngujuar në shtëpi
dhe vizitorë tashi shkojnë më rrallë
thonë se nëpër fletë ai fsheh shpirtin e tij
nga përtej dritares rri vështron me mall.

Shtëpizën e poetit që të gjithë e njohin
madje edhe fëmijët ta tregojnë me gisht
por dhimbjet s'patën si t'ia shohin,
dhe s'kanë si t'ia dinë, sigurisht.

I mbetur thellë në bisedë me veten
seç ka marrë një pamje prej profeti.
Por jo, askush s'e ditka të vërtetën
Për vjedhtas një pragmuzg ai iku nga qyteti.

Ah, këta poetët, krijesa që vijnë rrallë
nga fundi i jetës humbin,se ku mbesin
shkojnë si t'mos kishin qenë kurrë të gjallë
fshihen thonë,se nuk dinë të vdesin.

Kushedi,ku ndodhet shtëpia e poetit-
pyet ndonjë mik që vjen prej larg
kudo në të katër anët e qytetit
del dikush që di dhe e thotë një varg.

DIELLA

E mbetun vetëm në shpi,
 Diella tjerr pë prej shtrojës së djepit.
 Shkoi kërthini piate vjeshtë,
 pa ia ndie belbëzimin e 'thirrunit' "nanë".
 Tjerr ajo e pret orën me u pa në "skajp",
 me u puthë me të me dorë, prej larg.
 Thur ajo çorape për nipin,
 mos me vrapue kambë zbathun n'tokë
 të pashkelun.
 Kapërthehen vetëtimthi, si në një valle,
 shtizat, fija e penit, gishtat e rrudhun,
 përzie me pakëz aromë të mbetun fëmije...
 Dihate ofshanë ajo
 e bashkë me rritjen e çorapes së thurun
 rritet në përfytyrim të saj një humnerë;
 ajo valle epike në teh të çorapes,
 si në grykën e një pusi,
 sikur ka me e përpi.

Tjerr e thur e mbetun fillekat.
 E din fort mirë se punëdoret e saj
 s'ka me i veshë askush;
 asht tjetër modë atje, asht tjetër kohë.

VDEKJA E HARDHIVE

Atë gusht që shkoi përgjithmonë im atë,
 hardhitë në oborr i mbuloi një hije e zymtë
 e kokrrat prej idhnimit nuk morën ma ambëlti,
 as për musht e as për venë.
 Kazani i rakisë atë vjeshtë
 nuk i mbloodhi fqinjët në kuvende,
 atë dimën gërshanët e krasitjes
 s'iu bindën dorës së kërkujt.
 Shkurti na mbloodhi t'ia kujtonim babës lindjen,
 por sythat ndër degë lotuen,
 derisa i verboi dhimbja.
 Gushti tjetër e gjeti oborrin pa fladin e hijeve,
 pa buzëqeshjen e vileve të rrushit mbi krye.
 "Vreshti asht
 si fëmija, të don aty gjithë kohën," na i përsëriste
 shpesh këto fjalë i matë;
 ndoshta e ndiente fatin e hardhivë,
 pa praninë e tij të gjatë.
 Por prej kohësh, në fshehtësi,
 nëpërdo enë të drunjta, pak nga pak,
 ai kish sajuar një rreng tjetër:
 që nana të priste e të përcillte
 me raki të vjetër.

NJË COPË UDHË BASHKË

Veç një copë udhë
që e bëmë bashkë
mjaftoi të harroja
se për ku isha nisur...

Një copë udhë bashkë
dhe ti shkove
por unë të ndoqa
disa dhjetëra hapa
ecja dhe prisja
a do ta kthesh kryet mbrapa...

E bëmë një copë udhë bashkë
në udhën ku unë të gjeta
gjithë atë mbrëmje mbeta jashtë
gjithë atë natë nuk fjeta...

LODRAT E FËMIJËVE

Lodrat e fëmijëve të mi,
të vetmuara kanë mbetur,
heshtur edhe ngrysur,
si mbas një beteje hedhur,
qosheve e kthinave përmbysur.

Lodrat e fëmijëve të mi,
sirtareve e skutave ndryrë,
presin trishtuar të zot;
në lojëra të rritur i shkanë hyrë
e më nuk dalin dot.

SYRI

Planet sa planeti na qenkësh syri
me qiell e det paanë.
Edhe agu, edhe muzgu
te syri marrin kuptim.
Te syri ngryset e kthjellet qielli
te syri lind e perëndon dielli.
Syri i ndez e i shuan vetëtimat
te syri piklojnë e përthahen shirat,
vesat e brymat te syri bien e avullojnë
thellësitë e cektinat te syri marrin kuptim
te syri banojnë orekset e lakmitë,
te syri zënë pritë të gjitha pusitë,
te syri mashtrimi e gënjeshtër,
te syri e qara dhe e qeshura,
te syri fjala e përshëndetja,
te syri uria dhe etja,
te syri trokitja e pritja e parë,
te syri streha e bujtina,
te syri gjumi e zgjimi,
te syri përvidhet i ëmbël vështrimi,
te syri prehet si askund tjetër syri,
te syri sa planeti-
planet sa një pikë ujë syri i gjithkuj...

QYTETI HIPOTETIK

Nëse do ta donim të ribërë
hipotetikisht
qytetin tim të lashtë
nga e para,
me teknikat e fundit moderne,
me pamje tredimensionale,
rrethuar me mure të lartë,
me gurë të mëdhenj,
të skalitur,
me porta e kulla madhështore,
do mund të ringrinim gjithçka,
që nga Akropoli hijerëndë
atje lart mbi kodër,
gjer poshtë,
në portin e famshëm lumor,
do mund t'ia rikthenim shkëlqimin e dikurshëm atij,
me sallone mondane
e me oborr mbretëror,
do të ringrinim të gjithë tempujt
e të rishpallnim të gjithë zotat,
do mund të risillnim lëndinat,
krojet, hijet e gurrat-
porsa e vështirë,
t'i gjejmë e t'ia rikthejmë, si dikur,
Burrat.

AJO DITA ME SHI

Ditëve me shi kur mbetem i vetmuar,
më vjen ndër kujtime si atëhere:
të strukur aq pranë nën plepin e harkuar
ikur prej rrebeshit të asaj pranvere.

Më kujtohet breshëri që zbardhoi si brymë,
shiu që kërciste ëmbël nëpër gjethe,
piklat ndër qerpikë që i fshije me frymë,
balluket e mbushura plot me bulëzavese,

Rrëkezat mbi flokë që rridhnin ngadalë,
çastet aq pranë, të heshtur gjithë ndrojtje,
atë bisedën tonë, pa thënë asnjë fjalë,
veten që digjesha të të merrja në mbrojtje.

Shpeshherë e kujtoj atë ditën me shi
nën harkun e plepit mbetur të vetmuar,
as sot e kësaj dite ende nuk e di
sa zgjati ajo ëndërr, kush na pati zgjuar.

TEH MË TEH

N'teh të këmbëve,
tehut të udhës,
në teh t'greminës,
gjithë tehe.

Teh i fjalës,
n'teh të kohës,
si n'teh të thikës
me dy teha.

Gjithë jeta teh më teh,
teheve.

ART

Burrë e grua erdhën në jetë
për të mbetur
së bashku
si një kompleks
i bukur skulptural:
Gruaja - kryevepra
Burri-piedestal.

▪ **Filateli** ▪

Luigj SHABANI

HISTORIA PËRSËRITET

Revista Gegnia 9/2018, në faqet 97-99, ka botue materialin e z. Beqir Ndrukaj për librin: “Arkeologjia për pullat postare shqiptare 1913-2018” me autor z. Hysen Dizdari.

Puna studimore e tij lidhun me thesarin 106 vjeçar të pullave postare shqiptare ka rezultue e suksesshme.

Në ekspozitën ndërkombëtare të filatelisë “Italia 2018” (në Verona), z. Dizdari paraqiti: *Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, në pullat postare shqiptare* dhe u nderue me medaljen “VERMEL LARGE”. Flora dhe fauna në pullat shqiptare, me medaljen VERMEL. Ndërkohë promovimi i librit: “Arkeologjia në pullat shqiptare, 1913-2018” u bë në Shkodër. Z. Ndrukaj me këtë rast asht përpjekë të krijojë një “Urë lidhëse” në mes botimeve të z. Dizdari dhe historisë së themelimit të të Parit Klub Filatelik Shqiptar, në Shkodër, Prill 1947 dhe të 70 vjetëve të jetës së këtij Klubi historik.

Në rreshtat e këtij shkrimi do të japim disa pika që ngjasojnë me një “GUIDË FLUTURAKE”.

Trajtimi si dhe përmbajtja e tyre të ngacmojne me i marrë në konsideratë. Gjithsesi: kjo “urë lidhëse” asht e panevojshme dhe pa vend! Veprimtaria 71 vjecare e klubit Filatelik të Shkodrës asht kapitull

madhor i kësaj historie. Puna, kontributet e veprimtaritë, njëheri përkushtimi qytetar i armatës së filatelistëve shkodran, si n'asnjë qytet tjetër shqiptar, asht vetë historia e këtij klubi. Bilanci asht i pasun shumë i suksesshëm madje i pa përsëritshëm ma në Shqipëri! Njëheri, asht i pakrahasueshëm me veprimtaritë e zhvillueme të shoqatave të tjera si motra, ajo e Korçës dhe veçanërisht ajo e Tiranës. Duke iu referue GUIDËS në fjalë tërheq vëmendjen se i mungojnë argumentet, referencat e literaturës filatelike që autori i ka plotësue me fjalë të përgjithgjishme pa analizat e duhuna. Kjo histori e vlerës së jetës 71 vjeçare e këtij klubi nuk mund të përmbliidhet me 18 rreshta! Këtej rrjedhin gabimet dhe pasaktësitë. Ma keq, autori (z. Ndrukaj) arrin deri aty sa: me dije apo pa dije ka mohue nismëtarët kryesorë të themelimit të klubit filatelik të Shkodrës. Kjo asht nuk historia e vërtetë e këtij klubi!

Po sjell dokumenta, fakte argumenta si ma poshtë: Ideatori dhe nismëtari i këtij eventit historik ka qenë filatelisti veteran prof. Luigj Kromiqi. Ai ka shpalosë project- idenë e themelimit të klubit filatelik në Shkodër. Kërkesa e nismëtarëve asht drejtue dhe përcjellë organeve kompetente. *Rregullorja* apo *Statuti i Parë* asht shkruar e firmosë nga Idriz Fishta (Sekretar), Luigj Kromiqi (Kryetar). Dokumenti në fjalë daton: Shkoder 11- 04 - 1947.

Fotografia e parë që kemi asht ajo e një grupi të nismëtarëve të themelimit të këtij klubi dhe të Ekspozitës së Parë Filatelike Shqiptare që mban datën e mbylljes së saj, 04 -10 - 1947.

Rreshti i parë, (ndejun) nga e djathta në të majtë e fotos: 1) Gjok Shkreli, n/punës; 2)... ?

3) Pjeter Pema, infermier; 4) Prof. Luigj Kromiqi; 4) Qamil Quku, n/punës; 5) Ndreke Mazreku n/punës.

Rreshti i dytë në kambë.

1) Emil Prendushi, gjimnazist; 2) Gjush Darragjati, mesues; 3) Paulin Laca, n/punës; 4) Niko Pistulli, puntor artisan; 5) Kolë Gjinaj, mesues; 6) Idriz Fishta, mesues.

Bashkësia e filatelistëve nismëtar ka qenë e përbame prej të gjitha shtresave shoqnore, dashamirës të koleksionimit dhe të rruajtjes së pullave postare. Kuptohet se fjala "intelektual" e perdorun nga ju z. Ndrukaj nuk qindron, gjâ që e ban konkluzionin të pasaktë. Mosnjohja e realitetit të kohës ka ndikue në gabimet e shkrimit të kësaj GUIDE nga ana e juej. Ju kujtoj se Prof. Luigj Kromiqi, Kolë Gjinaj dhe Gjush Darragjati kanë qenë ndër nismëtarët kryesorë. Ata, ishin personalitete

të mirënjohun të filatelistë në Shkodër dhe më tej. Mohimi apo injorimi i tyre asht gabim i pa lejueshëm! Ata me Idriz Fishten, kanë kontribue si një trup i vetëm me realizue andrrën shumë vjeçare të themelimit të Klubit Filatelik në Shkodër. Synimi i nismëtarve ka qenë me i shërbye qëllimit të themelimit të Klubit Filatelik. Historia nuk pranon gabime!

Kështu në konkluzionin tuej për themelimin e Klubit Filatelik në Shkodër keni rreshtue si nismëtar edhe Zef Prendushin. Më ndjeni, por ju e keni ngjall së vdekuni Zef Prendushin! Sqaroj se: Zef Prendushi ka dekë në Shkodër më 25 .12. 1941.

Ju e keni ringjall atë (Zefin) me 1947, tue bâ edhe nismetar te Klubit Filatelik në Shkodër. Komenti asht i tepërt! Këtë gabim e ka bâ i pari edhe i ndjemi, Robert Ballauri (ish kryetari i parë i F. K. SH), njëheri dhe kryeredaktori i *KOLEKSIONISTI*-t, ku në numrin e parë, 1/1998, e ka botu këtë gabim (Zef Prendushi 1887—1945!). Zef Prendushin e ringjallin: Robert Ballauri dhe ju z. Beqir. Raste pa precedent! Komentet janë të tepërta! Gafa e më sipërme asht një dokument konkret i diteve tona i përsëritun mbas 20 vjetesh kur dy studiuesit e historisë së filatelistë shqiptare shkruajn dhe e dokumentojnë atë edhe në shtyp. Datat : 28-X-1947 / 4-X- 1947, tregojnë datën e hapjes dhe të mbylljes së Ekspozitës së Parë Filatelike në Shkodër të cilat janë të shkrueme në fotografinë e afishës së Ekspozitës në fjalë.

Ndër të tjera në rreshtat 29-30 fq. 98 lexojmë se rreth 4000 qytetar vizituen ekspozitën. Gazeta Bashkimi, nr. 968 datë 11.10. 1947 përcakton në 11 500 veta numrin e vizitorve të kësaj ekspozite. Dy të dhana të ndryshme për ekspozitën në fjalë.

Në rreshtat 33- 35, fq. 98, lexojmë "... *filatella në Shkodër mori zhvillim, sidomos në vitin 1957, kur Klubi drejtohej nga Idriz Fishta, Kolë Gjinaj, Gjush Darragjati, Prof. Shefik Osmani, Luigj Shabani etj. (?...)*". Me keq ardhje janë shkruet disa pasaktësi tue e përsëritë edhe gabime.

Sqarim: "Listen emnore" që e keni dokumentue asht e pasaktë, asht gabim! E pse ?..! E pasaktë, sepse kësaj liste i mungon emri i filatelistit Selim Karakaçi. Kjo kryesi nuk i takon vitit 1957, por 1963 e keni fiksue gabim! I ndjemi Shefik në vitin 1957 ka qenë student në Universitet dhe në këtë kohë ai, nuk ka qenë antar i këtij klubi. Ai ka deklarue se: në vitin 60 të shek. XX në bazë të koleksionit që paraqita në Klubin e filatelistëve të Shkodrës u pranova anëtar i atij klubi. (*Në gjurmët e Didaktit*, botim 2005, fq.174)

Fotografia që paraqet kryesisht e këtij Klubi, asht e vetme si dokument me antarët e kësaj kryesie. Në këtë foto në rreshtin e parë ndejun janë (nga e djathta në të majtë të fotos).

1) Shefik Osmani. 2) Idriz Fishta. 3) Kole Gjinaj.

Rreshti i dytë në kambë.

1) Gjush Darragjati. 2) Selim Karakaçi. 3) Luigj Shabani.

Me datën 26.09. 1958-6.10.1958, me nismën e Kolë Gjinajt dhe me mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Klubit kemi hapë ekspozitën filatelike me temë: *Muaji i miqësisë: "SHQIPERI-B:R.S. S."*

Ditën e hapjes, apo t'inagurimit të kësaj ekspozite në mes të pranishëmve ishin: Përfaqësues të Ambasadës Sovjetike në Tiranë, po ashtu nga Tirana ishin: Brahim Smajli dhe I. Erebara, filatelite të kohës. Në mos gaboj, ata ishin zyrtarë elitarë, përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të P. T. T. Tiranë. Të veçantat e ekspozitës, ndër të tjera ishin: a) *Zarfi i Parë F. D. C.* që sajue enkas, kushtue "*Muejit të miqësisë, Shqipëri-B. R. S. S.*". Zarfat i vulosëm me vulën e shoqërisë në fjalë, përdorëm varak të verdhë për vulosje. Në zarf aplikuem pullën 2,50 l. të serisë së 40 vjetorit të Revolucionit Socialist të Tetorit. Gjithshka e realizueme me forcat tona.

Kole Gjinaj, në shëj nderimi dhe vlersimi për filatelistin e madh moskovit, profesor i Universitetit të Moskës, Regolevički, i cili kontriboi shumë për filatelistat shqiptarë, hapi dhe pat krijue një "stende" të veçantë me fotografitë e tij dhe me një numër të konsiderueshëm të korispondencës së tij, në veçanti me Kolën. Suksesi i punës tonë ishte i madh. U vlersue maksimalisht prej të gjithëve. Ky sukses sherbeu për nxitje për punën tonë në t'ardhmen.

Në vitin 1959, Drejtorja e Përgjithshme e P. T. T. Tiranë botoi albumin "*Pulla poste shqiptare 1913-1957*": bashkautorë, B. Smajli dhe I. Erebara.

E veçanta me randësi historike dhe vleresim për filatelinë dhe filatelistët shkodranë ishte edhe përfshimja e tri fotografive të vetme në këtë album, dokument ky që tregon mirëfilli për kulturën filatelike në Shkodër. Ata janë një dishmi se kultura filatelike shqiptare ka qenë dhe asht në Shkodër. Ajo ishte bërë pjesë dhe bashkudhëtare e jetës kulturore ndër vite në familjet qytetare shkodrane. Fotografinë me Kolë Gjinaj, Luigj Kromiqi, Idriz Fishta e kam publikue në faqen e parë të ftesës kushtue Jubileut të 70 vjetorit të themelimit të Klubit Filatelik në Shkodër, njëheri në posterin e ekspozuëm në disa pika të qytetit tonë me

rasën e këtij Jubileu. Në faqet 3-4 kam publikue të gjithë veprimtaritë e këtij klubi. Pra, materialin e ke pasë të gatshëm, të arkivuem në Bashkinë Shkodër, të fotografuem dhe në atë të Arkivës së Muzeumit Historik Shkodër. Për një informacion të matejshëm për kontributin e madh të dhanë nga armata e filatelistëve në Shkodër asht unikale, gjithshka me forcat e të gjithë filatelistëve shkodranë janë arritë suksese të randësishme në historinë e filatelistëve tonë. Bëj me dije se: *Jeta e dhjetë zarfave F. D. C.* që sajuem me nismën tonë asht e shkurtë (27-IX-58 dhe mbyllet më 5/5/1960, në 80 vjetorin e themelimit të *Shoqërisë së Shkronjave Shqip.* E pse ? Dega e Drejtorisë së P. T. T. Shkodër i drejtohet *Shoqatës së Filatelistëve* në Shkodër (me shkresën nr.325/2 prot.) me urdhnin e Drejtorisë së Përgjithshme të P. T. T. Tiranë ku thuhet se ndalohet shtypja e zarfave dhe e kartolinave që kanë pamjen e subjektit të pullave...deri me penalizim. Ne, të gjithë zarfat i kemi botue me miratimin e Drejtorisë së Shtëpisë Shkodër.

2) I pa pranueshëm ishte vendimi i asaj Drejtorie (P. T. T. Tirane) e cila në vitin 1961 aplikoi dhe vuni në zbatim "tallonin" e blemjes e emisioneve postare me listë nga 1, 2, seri dhe për një grup shumë të vogël të filatelistëve u planifikue nga 3 seri, pra shteti me çdo kusht kufizoi zhvillimin e filatelistëve shqiptarë. Ajo ishte pronë e monopol shtetnor dhe n'asnji mundësi nuk lejoi me u zhvillue në masën e gjanë të popullit tone.

Pra, hovi, zhvillimi dhe sukseset e arrituna prej klubit të rrethit, shoqatës filatelite, asht meritë e veçantë e dashamirsisë dhe e përkushtimit qytetar të filatelistëve shkodranë, të dhanë për vite e vite të tanë.

Luigj Shabani, Torino, 20 Prill 2021

▪ **Bibliofili** ▪

Valbona **BËRDICA**

REFLEKSION PER REVISTËN E PARË NË SHKODËR (PJ.2)

(vijon nga numri 12-2020, ff. 179-185)




Viti 1897, “Zoja e Shkodrës”.

Me 26 prill 1897, kremtohet 430 – vjetori i largimit të afreskut së figurës së “Zojës së Shkodrës”.

“Zoja e Shkodrës” ndryshe e quajtur edhe “Zoja e Këshillit të Mirë”, është një afresk që u mor nga Kisha rrëzë kalasë së Shkodrës në vitin 1467, dhe shtegtoi në Genazzano të Italisë së bashku me besimtarët që emigruan për të mos iu nënshtruar pushtimit turk. Kjo figurë u bë e njohur në të gjithë botën katolike dhe jovetëm, kur u shpall si mrekullibërëse

nga Papa Pali i II (1464 – 1471). Afresku u rikthye në Shkodër dhe u vendos në katedralen e “Shën Shtjefnit” më 25 prill 2017.

**Viti 1899, Nekrologji, “Past Drit”, kushtuar P. Jak Junku (Trento, 1837 – Shkodër, 1899),
Drejtuesit të parë të Elcija-s.**



XSY

Ujku tui eue n'ghini, e tui ul kerat, e tui luit lëjtin
e veshet si multe, diftote se besen dote m'e amit
per t' sakt.

Zax Sc'Franceska: Uj morë xax, an dux ei si-
kurisë m'a kee xax kërcim t' anu jaxeta scobërit,
axeta t' m'a xaxpe muer sat t' gax popuëit, ei mor
me n' rëvëit si mos, e ei mos t' dal an rëvëitk para
popuëit. Athëe ujku tui eue përp kënce e dënat e
citi xaxim e vet n' dor t' Sc' Franceskut. Popuëit he
n glime e n cudit xax fëit me lëit t' maxe tui e lut
folim e tui ja fal muer ei ja këto eue gni Sc'it
se t' max si isete Sc' Franceska i xit isete lëit se-
bet me pectin at xax përp ghor t' anu ujku bëner.

Ujku rmoit eue dar vjet mrapa, e lëit e dëlte ne-
per sepeja pax i lëit kuf kee, e pax ken traxie përp
kerkut. Gënia i xitëin me hanghor e këur scote
rreghs eëit xax i xitëin gëia. Ne murrin mes dëit
vjetëe ujku xit përp pëvëit, e scobëritë ja xit
pax kë e scësin tui scote rreghs xaxut, n bëit
n' mom per t' xitëit e sepeërit e per scëitëit t' maxe
t' lëit Sc' Francesk.

Fotim A.S. Francesk

**Viti 1899, tregimi
"Mrekullia e
Sc'Francesk Asizit ci
sbuti gni uik".**

- Zbutja e Ujkut si
simbolikë e fjalës së
dhënë. "Ujku tui ra
nguj, e tui luit bishtin
e veshet si multe,
diftote se besen dote
me e mait per te sakte".

☾ Cereku i mram 2 — ☉ Hana e ree 11
☽ Cereku i par 18 — ☽ Hana e plot 25

Në botimin e vitit 1901 për të ndihmuar besimtarët, revista vendos fazat e formimit të hënës me pamjet përkatëse, të cilat janë një element ndihmës jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në atë informativ e kulturor, në këtë rast Astrologji.

☽ Hana e plot 4 — ☾ Cereku i mram 12
☽ Hana e ree 18 — ☽ Cereku i par 25

-Poezia "Rrena".**RRENA**

Fmija - "Rrena, moj Nan, si e ba ?

A shifet ?a perkitet ?

Prei gojet e thu qitet ?

Nana - "A din çka asht ? A kore

Asht një gja send i ndyt,

Nuk mund t'a shofin syt,

Nuk mund t'a preksh me dore.



Viti 1902, revista boton poezinë satirike "Ujku" [Ujku] apo përrallën "Delia e Kacuba", gjë që tregon se tashmë ndoshta kishte filluar të konsolidohej misioni i saj, jo vetëm fetar, por edhe kulturor, argëtues, përçues i mesazheve nëpërmjet simbolikave të tilla, tek besimtarët dhe tek të gjithë qytetarët që e lexonin atë. Drejtues ishte P. Frano Gjenoviçi, i cili e mbajti këtë drejtim së bashku me Pater Xanonin deri në Korrik 1905, të cilët filluan të kujdesen që shkrimet e botuara të pastroheshin nga turqizmat.

-Poezia "Ujku", në mënyrë simbolike nëpërmjet veprimeve të ujkut tregohet për lakminë dhe gënjeshtëri. "Ujku met.-

Cillon per dit, Ci dinaku kah kerkon, Merreit tiert, ai vet sharron, Uiku lkuren s'e nrron dot"

-**"Della e Kacuba"**, mesazhi: Mendohu mirë përpara se të kryesh veprimet.

Della e Kacuba

Ishte gmi dele leshatake,
Çe la fushën t'ân blerime,
Me vûu kamen kish dërrukë
Njer kacuba e njer ngatrimo;
Çka t'a desht atje me dal,
Me kallzu kerkuse s'ka fial.

Porsa hini, leshit t'gjat
I ngatrohët gjithkund driza,
Sa ma fort me dal dihat
Më përdëlohët njer murriza;
Blegbron delia, kamt po i shkrep
E kacuba fial po i çon.

Shllung njer ferra! Çka t'habiti
Damin vedit me i'a siell?
A s'e dishe se, ku t'qiti
Mënia e marr, ti kishte mend pshtjell?
Me ra n'ui e mos m'u ndy?
N'zierm me ra e mos mu shkrumbu?

Ik rrezikut, pra!a xat,
Se mo i pshtumun kur ke ra,
Vaji e mundi dalin kot.

Zamir

Della e Kacuba

Ishte një dele leshatake,
Çe la fushën t'an
blerime;

Me vu kamen
desheronte,
nder kaçuba e nder
ngatrimë;
Ça ju desht atje me dal,
Me kallzu kerkush s'ka
fial.

Porsa hini, leshit t'gjat,
I ngatrohët gjithkund
driza,

Sa ma fort me dal dihat,
Ma shume ngatrohët
neper murriza,
Blegbron delia, kamt po
i perplas,
E kaçubja fial po i çon

Shllung neper ferra! Çka t'habiti,
Damin vedit me i'a siell?
A s'e dishe se, ku t'qiti,
Mënia e marr, ti kishte mend pshtjell
Me ra n'ui e mos m'u ndy?
N'zierm me ra e mos mu shkrumbu?
Ik rrezikut, pra thot, se me i pshtumun kur ke ra,
Vaji e mundi dalin kot.
P. Anton Xanoni



Nga viti 1903, revista botohet me testur t' Arqipeshkvit.

-Poezia "Krapí",
 Ruje zoghun sa t'a
 keescn'dor, mesazhi:
 vlerëso mundësitë e
 momentit dhe mos
 rri kot vetëm duke
 pritur se diçka më
 e mirë do të vijë.
 "peshkataritha: ma
 mire një vezë sot se
 një pul mot.



Në vitin 1904 deri në vitin 1907: S h k o d ë r në "Shtypshkronje t' Zois Zhanunpa m k a t t' rriedhshem". Nga korriku i vitit 1905 deri në gjysmën e vitit 1909 drejtues është P. S h t j e f ë n Zadrira.

- "Kerkime Sctetistiket", jepet informacioni se në

vitin 1905 popullsia në mbarë globin ishte 1.500.000.000, ndërsagjatë

një viti vdekjet ishin 33.033.333. Numri i grave dhe i burrave ishte gati gjysmë për gjysmë. Moshë mesatare, tridhjet e tre vjeç, një e katërta e popullsisë nuk e arrinte moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Një person ndër 1000- vetë arrinte të kapte moshën 100-vjeç, dhe dy prej tyre moshën 80-vjeç. Ndër 100 vetë, gjashtë prej tyre arrinin moshën shtatëdhjetë vjeç.

Artikulli është përkthyer nga Kalendarit Italian i kohës "La Buona Strenna Sal. 1905".

1 "Strenna" në fjalorin Italian ka dy kuptime: 1. Dhuratë që është marrë ose dhuruar për Krishtlindje.

2. Botim antologjik i prozës apo i antologjive, të dala me rastin e vitit të ri.

Strenna editoriale lindi në fundin e shekullit XVIII dhe fillim shekullin XIX në Angli, ku viti i ri urohej me dy forma të veçanta botimesh: 1. Kalendarët hënorë, ose vjetare me informacion të gjerë për masat popullore, që përmbajnë parashikime meteorologjike, tregime të shkurtra, këshilla për ekonominë shtëpiake, fjalë të urta të destinuara për t'u ardhë në ndihmë fermerëve, artizanëve dhe tregtarëve të vegjël.

2. Fletë të veçanta të botuara për shtresën e lartë të shoqërisë së asaj kohe, ishin me informacione speciale mbidhurat, një dedikim dashurie etj.

lit.wikipedia.org > wiki > Strenna

"Strenna" e parë në Itali për vitin e ri apo për ditët onomastike u botua në Milano, vitet 1831- 1847. Në vazhdim të kësaj tradite siç duket u botuan kalendarët edhe në shtetëpinë botuese Zoja e Papërlyeme, ekzemplari i parë i të cilit u konfirmua që në vitin 1889: "Miku Bestaar" me autor Ndre Mjeda SJ (1866 -1937) ku pjesa e parë kalendarike (faqet 1-16) u shtyp në shtypshkronjën misionare papnore "Shën Jozefi" në Milano, kurse kopertina dhe faqet me përmbajtje të përgjithshme astronomike, lirike dhe të tjera (faqet 14- 47) që shtypur tek Jezuitët në Shkodër.


-"Termeku i Shkodrës".

Në këtë artikull jepet informacion për tërmetin e vitit 1905 që preku qytetin e Shkodrës. Lëkundjet e tërmetit filluan në orën 6.5 të mëngjesit dhe zgjatën rreth 12 minuta, epiqendra e tij ishte në Bahçallek, Ana e Malit, Bushat, Trush e zonat përreth. Ujërat e lumit Kir, Buna dhe Drini u frynë dhe dolën jashtë shtratit të tyre duke përmblytur fushat.

Gjatë gjithë ditës pati rreth 40 lëkundje, ku më të fortat ishin në orën 10.30 dhe 11.15 të mbrëmjes. Në qytet numri i të vdekurve ishte: 10 qytetarë të krishterë, 80 Myslimanë; në Bahçallek 40 të vdekur e 250 nën rrënoja, e në total në qytet dhe zonat përreth, numri i të vdekurve shkon deri në 300 persona e po aq edhe numri i atyre që janë nën rrënoja. Për rreth 1 muaj e gjysmë u ndjenë lëkundje të herëpashershme tërmeti me magnituta të ndryshme. Ky tërmet ishte një ndër tërmetet më të fuqishme që kanë rënë në qytetin e Shkodrës dhe në Shqipëri



²Markus W. E. Peters, “Tipografia e Zojës së Papërljeme” në Shkodër (1870 – 1945), Tiranë, 2016, f. 350.



-Në botimin e vitit 1906, në fund të tij, bie në sy vendosja e

një“Réclame”[Reklamë] me emrin “Hafis Hasan Kaduku,mjek zãmse”[3Mjek dhëmbësh, Hasan Kaduku ishte dentisti i parë shkodran i diplomuar dhe i specializuar jashtë vendit, që në periudhën e sundimit turk. Vlen të përmendet iniciativa e tij përparimtare për të hedhur bazat e shërbimit stomatologjik modern të Shkodrës, në një kohë kur dhëmbët

nuk kuroheshin, por hiqeshin me praktika primitive] në këtë mënyrë duket se revista përmbush edhe një mision tjetër, atë të "reklamës".

Në vitin 1907, Nr.2, botimi realizohet në Shtypshkroje t'Zois Paperlyeme - Shkodër, drejtues P.Shtjefën Zadrima.

-Poezia "Zani i Natyrës".

Zani i Natyrës



Çka flet tui shndrite prej s'nalit dëll?

Çka flet stolisun me hyi plot qilli?

-Se mi to zoti e ka shndrin

Nieri ta diin-

Çka flasin n'prill agimi e hana,

Lulet e bukra neper fusha t'gjana?

-Se një zot ma i bukur i ka krijue

Ban me i kujtue —

Çka flet kur rrebshem kris bubullima,

Bie shi e breshen, flakron vetima?

-Se rrfeja e zotit njerzit e kqi

Ka me i ba hii.-

Çka flet dallndyshja me krah t'lehta

Kur hik prei t'foftit nner venne t'zeta?

-Se një prei qiellit i kallzon shtekun

Zakun me prekun —

N'prenveer çka flasin zogit tu vallzu,

E tuba tuba ameltui knnue ?

-Se i gzim ma i amel pret n'tjeter jet

Nierin e dreit —

Çka flet ylberi kur shndrit nner re

E gazmon token se shiu kamet ?

Se mas vaitimit t'kti shekulli t'zi

Vien gaz i rii –
 Çka flet ullini ci dimen e veer
 Mlohet, o nieri, megaz t'bleer ?
 -Se do t'hijeshoim me vepra t'mira
 Neer gzime e t'vshtira –

Në vitin 1908, jepet një adresë e saktë e vendosjes së shtypshkronjës,
 Adresse: Imprimerie de l'Immaculée Conception –Scutari (Albanie).



Në fillim të muajit korrik, tek Pjesa I, lajmërohet për daljen e Fjalorit Shqip – Italisht, përgatitur nga Shoqëria “Bashkimi”. Në lajmërim thuhet: ky fjalor është me 538 faqe, dhe është shumë i vlershëm, pasi përmbledh shumë fjalë që skanë qenë të përfshira në fjalorë të tjerë. Është një ndihmë e madhe për ato që duan të dinë si i thonë “sendeve” në shqip, të cilat deri atëherë i dinin vetëm në gjuhë të huaj.

Shoqëria “Bashkimi” e themeluar nga Abati i Mirditës, Imzot Preng Doci, në vitin 1899 në Shkodër, me qëllime kulturore- letrare. “Fialuer i rii i shqypes përbaam prei Shoqniiet t’bashkimit”, fjalor dygjuhësh shqip-italisht, u botua në vitin 1908. Ky fjalor me rreth 14.000 fjalë, konsiderohet si një ndër më të mirët në leksikografinë shqiptare.

Poezia "Detari"

DETARI

Kurr-caper qytat — tri anal eta
 Laet laet pri breziot — na del me 'i herat;
 Jeto! nare qytat — kurr e' ni per t' met;
 Jan aleri i detit — jan is per det.

S'm' lakambet gajv — e' aerkei manime,
 Prei detit latin — e' qret e' t' rime;
 Sqese n' qytat vortit — e' qet e' i sekret
 Gi n' det sekun p'itit — e' i t' is per det.

Orret e' herat — herat kurr qytat
 E' detit is detit — e' na kurr detit,
 I herat detit — I herat qytat
 Jan aleri i detit — jan is per det.

Fi n' e' qytatit — herat is detit,
 E' herat qytat — detit qytatit
 Ta herat qytatit — detit is i per
 detit i detit — detit i detit.

Wi herat qytat — detit is detit qytat
 Detit is detit qytat — e' gal detit is
 Kurr e' detit — detit is i detit
 Jan aleri i detit — jan is per det.

E' detit is detit — e' detit qytat,
 Me per detit i detit — me per detit
 Me' e' detit qytat — detit is i detit
 Jan aleri i detit — jan is per det.

Kurr e' e' detit — detit is detit
 Me per detit i detit — detit is detit
 E' detit e' detit — detit is detit
 Jan aleri i detit — jan is per det.

Me per detit i detit — me per detit e' detit,
 E' detit is detit — e' detit is detit,
 Me per detit i detit — me per detit
 Jan aleri i detit — jan is per det.

-Poezia "Kater koht e nierit".

"oh koh vapet, Mas e ree, Shemellytyn n' veer e kee!"





Në botimin e vitit 1909 interesant është njoftimi i përgatitjes për botim të "Kalendarit", "i v i e f s h e m sidomosper tregtarë e shtepiakë, per vitetë 1910", duke dhënë sqarimet përkatëse të përdorimit të tij. Kykalendar në fletët e çdo muaji kishte të

dhënë edhe emrin e secilit Shejt që shënjote ditën përkatëse, si dhe fletët bosh ku mund të mbaheshin shënime

Që nga viti 1909 dhe në vazhdim kjo gazetë fillon të përdorë alfabetin e vendosur nga Kongresi i Manastirit, tashmë revista nuk shkruan më "Elcia" por "Elçija", pra shihet qartë përdorimi i shkronjës dalluese "ç" përdorimi i së cilës u miratua në këtë Kongres [në Kongres u mor vendimi që shqipja të shkruhej me germa latine, dhe të plotësohej me 9 shkronja të njëpasnjëshme, diagrame; DH, GJ, LL, NJ, RR, SH, TH, XH, ZH, dhe dy diakritike; ç, ë]. Kongresi i quajtur ndryshe edhe Kongresi i Alfabetit, u mbajt në qytetin e Manastirit në shtëpinë e Fehim Zavalanit (F.Zavalani ishte "Kryesonjësi"¹ i Shoqërisë "Bashkimi" të Manastirit), gazetar dhe aktivist i Rilindjes Kombëtare, ndërmjet datave 14-22 nëntor 1908, me iniciativën e shoqërisë "Bashkimi" dhe kishte si qëllim standardizimin e alfabetit të gjuhës shqipe, duke u nisur nga mendimi mbizotërues i kohës, që përdorimi i shkronjave jolatine nuk ishte në të mirë të një gjuhe unike kombëtare.

¹Revista "Leka", Vj. XII 1940, Shtyp.Zoja e Paperlyeme, Shkodër, f. 14.

-Revista në botimin e saj vendos edhe një njoftim "Abeçeja e ree vëmun me t'vietren", duke dhënë me shembuj përkatës mënyrën ezëvendësimi të shkronjave.

Fatmira LEKIQI (Shkodër)

GJURMË TË AT' GJERGJ FISHTËS NË BIBLIOTEKËN PUBLIKE "MARIN BARLETTI"

Dihet tashma se Biblioteka Publike "Marin Barleti" ka një pasuni të madhe me koleksione të randësishme (i antikuariatit, i dorëshkrimeve, i albano-ballkanologjisë e i hartave), ndër të tjera, edhe për studimet albanologjike. Prandaj kemi sistemu në fondin e Albano-Balkanologjisë, gjithë ato (libra, periodikë, harta etj.) që janë vlerësu nga intelektualë të ndryshëm ndër vite të përshtatshme për atë fond.

Krijimi i kësaj biblioteke ishte fryt i një tradite të vyme t'qytetit tonë, traditë e fillime që në mesjetë, e vijume më pas me bibliotekën Bogdani, dhe atë të Myftiut të Tabakëve. Biblioteka të randësishme të Shkodrës kanë kenë edhe ato të institucioneve fetare, siç ishte biblioteka e Medreses së Naltë pranë Kalasë, bibliotekat e çmueme të etërve Jezuitë (1858) dhe atyne Franceskanë (1875). Bibliotekat e shoqnive dhe private: bibliotekat e shoqnisë: "Bashkimi", "Agimi", "Gjuha shqipe", "Komisia Letrare" etj. Biblioteka e P.Vasës, Z. Jubanit, F. Shirokës, vllazënve Ivanaj, familjes Kamsi, H.Gjylbegu, H. Bushati, Ll. Karafili, K. Idromeno, K.Gurakuqi, M.Krujës, E. Koliqit, J. Kastrati etj. Bibliotekat publike: e para bibliotekë publike dhe ndër të parat biblioteka albanologjike, e njohun si biblioteka e "Komisisë letrare", u krijua në Shkodër në vitin 1916, me drejtues Hilë Mosi.

Biblioteka Franceskanenjohu lulzimin në vitin 1921 në saj t' përkushtimit të Gj. Fishtës, P.Dodajt, Sh. Gjeçovit, P.Bardhit e sa të tjerve. Në bibliotekë ruheshin dorshkrime me vler t'Zarishtës, Gjeçovit, Mariaskajt etj.

Në vitin 1945 me mbylljen e institucioneve fetare dhe organizimeve shoqërore, një pjesë e fondit të bibliotekave të tyre i kaluan në zotnim bibliotekës publike. Në fondet e saj ruhen libra të shekullit XV-XVI të shtypun në qendra të mëdha t' Europës, si: Gjermani, Zvicër, Paris, Itali etj., të cilat dallohen nga teknika e shtypjes dhe bukuria e tyre n' paraqitje.

Pra, në koleksionet me vlerë, ndër të tjera, kemi gjetun një numër të konsiderueshëm të librave që mbajnë firmën e At'Gjergj Fishtës, At' Sh. Gjeçovit, P.Bardhit e sa të tjere si dhe vulën e Bibliotekës Franciskane.

Këtu do të pasqyrojm një listë me libra të fondit të Albano-Balkanologjisë, që mbajnë firmën e At'Gjergj Fishtës, e cila është mjaft interesante nga pikpamja e zgjedhjes së titujve të librave. Ndër to të tërheqin vëmendjen vetkorrigjimet e pjesve të poemës "Lahuta a Malësisë" e shënime në shkrime të tjera të botume në revistën "Hylli i Dritës" të vitit 1934 (pron e tij).

Libra e revista që mbajnë firmën e At'Gjergj Fishtës

Revista

- 1.Hylli i Dritës, Vjeti III – 1922, nr.1-12, Shkodër, Shtypshkronja "Franciskane", 1922, F.596 , A1 / 18 / 5 D
- 2.Hylli i Dritës, Vjeti IV – 1923, nr.1-12, Shkodër, Shtypshkronja "Franciskane", 1923, F.568 , A1 / 18 / 7 D
- 3.Hylli i Dritës, Vjeti V– 1924, nr.1-12, Shkodër, Shtypshkronja "Franciskane", 1924, F.560, A1 / 18 / 9 D
- 4.Hylli i Dritës, Vjeti VI – 1934, nr.1-12, Shkodër, Shtypshkronja "Franciskane", 1934, F.606 , A1 / 18 / 10 D
- 5.Hylli i Dritës, Vjeti VII – 1935, nr.1-12, Shkodër, Shtypshkronja "Franciskane", 1935, F.620 , A1 / 18 / 12 D

Libra të Fondit Albanologjik në gjuhën shqipe

1. Aravantinos ,Panagiotis, Qafëzezi , Ilo Mitkë (adapt. e parath.),*Historië e Ali Pashë Tepelenës mbiemëruar "Luan' i Shqipërisë"*, Bukuresht , Shtypshkronja "D.C. Ionescu", 1917, F. 172 , 7 f. il., portr. , A1 / 10 / 19 B T

2. **Fishta, Gjergj**, *Epopeja e fisit shqiptar*, Shkodër ,Sht"Franciskane 1920, F.9, AI / 2 / 13 C
3. **Floqi, Kristo**, *E drejta themelore ...* Shkodër , Shtypshkronja Françeskane, 1920, F.209, AI / 1 / 96 E
4. **Korça, Xhevat**, *Tri pyetje nga jeta e Skënder Beut*, Tiranë, Shtypshkronja "Nikaj", 1923, F. 104, AI / 2 / 105B
5. **Kostandin Kristoforidhi**([përkth.]),*Psalteri : këthyem mbas evraistesë vietërë skip nde guhë gegëniste ..*Konstantinopojë, Shtypshkronja "A. H. Bojaxhiani" 1895, F.126, AI / 3 / 2 G
6. **Nikaj, Ndoc**, *Historia e Turkiis*, London, Sht "Perlindia e Shcyptareve", 1902, F.105, AI / 1 / 47 F
7. *Programi i së I-rës e i së dytës klasë fillore*. Shkodër , Shtypshroja e Arsimit, 1919, F. 60 , AI / 1 / 71 A
- 8.*Programa Synthetiko Analytike e shkollave fillore*. Elbasan, Shtypshroja "Elbasani", 1922, F.22, AI / 1 / 53 D
- 9.*Qëllimet dhe Organizimi i Lidhjes së kombeve*, Tiranë, Shtypshkronja "Mbrothesija", 1933, F. 98, shtojcë 42 f , AI / 2 / 135 B
- 10.**Vokshi , M.**, *Shqipnija e shqiptarvet afër njizet shekujsh luftnash e lëvizjesh komtare.Nji gjuhë nji atdhe*, Tiranë, Sht."Mbrothësia , 1930, F.28, AI / 1 / 55 E

Libra të Fondit Albanologjik në gjuhë të huaja

1. **Albania e Albanians**, Paris, Librairie Chapelot, s.a. , F.69, AI / 21 / 31D
2. **Dumont, Albert**, *Le Balkan et l'Adriatique*, Paris ,Librairie

- academique Didier et C-ie, 1874, F.411 , Al / 21 / 16 G
3. *Da Trieste a Valona*, Milano , Roma, Alfieri & Lacroix, 1918, F. 134 f. , Al / 22 / 62 E
 4. *Hyacinthe Hecquard , Histoire et description de la haute Albanie ou Guégarie*, Paris, Imprimerie de J.Clave, s.a., F. 265 , Al / 21 / 75 E
 5. [Frashëri, Sami](#) ; [Agostino Ribecco \(trad. dal\)](#), *Bësa o la fede Albanese*, Frascati, Tuscolano, s.a, F. 112 f , Al / 21/ 26 F
 6. *Kolovani, Demetre, La question de Koritza*, Paris,Imprimerie Henri Dieval, s.a.,F.95 , Al / 23 / 24 D
 7. *L'Albania*, Scutari,Tip. Dell Immacotata Concezione, 1911, F. 59, Al / 24 / 12 D
 8. *La situation de la minorite albanaise an Yugoslavie. Memorie*. S.l., s.a., F.43 , Al / 21 / 45 D
 9. *Louis-Jaray, Gabriel, L'Albanie inconnue*, Paris ,Librarie Hachette et C-ie, 1913, F.239 , Al / 21 / 64 G
 10. *Pascu, Dimitrie P, Câteva observatiuni asupra scrierii "Albanica"*, Bucuresti, 1937, F.40 , Al / 22 / 3E
 11. *Revendications de l'Albanie*. S.l., s.a., F.56 , Al / 21 / 21 A
 12. *Tomitche, L, Les Albanais au Vieille -Serbie et dans le Sandjak da Novi-Bazar*, Paris , Lib.Hachette & Com. , 1913, F. 81, Al / 21 / 36 F

Libra të Fondit Ballkanologjik në gjuhë të huaja

1. *Allmendinger, K., Die mazedonische Frage*. Nachdruck von "Wissen und Wehr", Sofia, Buchdruckerei Gebr. Boschinoff, 1927, F. 28, Bal / 32 / 46 B

2. **Broz, Ivan**(përg.),*Osman Ivana Gundulića s pjevanjima XIV i XV*, Zagrebu, Kr. Svenčilišna knjižara Fr. Župana, 1887, F.448, Bal / 32 / 37 C

- 3.**Broz, Ivan** (përg.),*Osman Ivana Gundulića s pjevanjima XIV i XV*, Zagrebu ,1887, F.448, Bal / 35 / 2 C

- 4.**Evtimoff, Siméon**, *Les serbes et la Macédoine*, Genève, Editions "La Macédoine", 1929, F. 24, Bal / 31 / 43 E

5. *I kaini dhiata, testamentum nuovum*, [Heildeberg],Excudebat Henr Stephanus, 1569, F. 709+99, Bal / 35 / 3 C

6. **Mihačević, Laurentius**, *Fr.laurentius Mihačević*, Sarajevo, Bosnische Post,1909, F. 39, Bal 31 / 11 G

- 7.*La question Macédonienne* et l'Union internationale des Associations pour la Société des Nations, Sofia, Imprimerie Spas et Nikolas Bojinoff , 1926, F. 64, Bal / 32 / 49 B T

- 8.*Le Comité Directeur du Bureau International de la Paix dan le Balkans*(13 au 30 octobre 1929), Dole-du-Jura, Imprimerie E. Goeury, 1929, F. 38, Bal / 31 / 40C

- 9.*I-ere Conference Balkanique*, Athènes, Pub. Carnegie, 1934, F.222, Bal / 31 / 37 C

10. *Popis publikacija Jugoslavenske Akademije Znanosti i Umjetnosti od god.1867 do I serije god. 1911*, Zagrebu, Tisak Dioničke Tiskare , 1911, F. 56, Bal / 34 / 4 D

- 11**Rivet, Charles**, *Chez le slaves libérés en Yougoslavie*, Paris , Perrin et Com., Editeurs, 1919, Vëll.XV, F.265, Bal 32 / 32 E

12. **Strupp, Karl**, *La Situation juridique des Macédoniens en Yougoslavie*, Paris, Les Presses Universitaires de France,[1929], F.140,Bal / 31 / 44 C

13. **Tocheff, A.**, *Le diferend serbo-bulgare*, Sofia, , Imprimerie De la Cour , 1932, F. 107, Bal / 31 / 13 F
14. **Traitchev, Guéorghj**, *Les qualities spirituelles des Bulgares de Macédoine*, Sofia, "La Bulgaria", 1930, F. 64, Bal / 31/ 6 G

Libra nga Fondi i Antikuarëve e Fondi i huaj

1. *L'Adone poema*, Amsterdam,1679, F. , An / 58 / 14 F
2. *Aristotelis opera omnia, graece et latine*, Paris,1604, F. , An / 149 / 5 C
3. *Aristotelis opera omnia, graece et latine*, Paris,1604, F. , An / 149 / 6 C
4. *Aristotelis opera omnia, graece et latine*, Paris,1604, F. , An / 149 / 7 C
5. *Commentarii in scripturam sacram*, Lugduni,1839, F. , H / 149 / 10E
6. *Commentarii in scripturam sacram...*, Lugduni,1839, F. , H / 149 / 11 E
7. *Commentarii in sacram scripturam*. Lugduni,1842, F. , H 149 / 9 E
8. *Commentarii in sacram scripturam*, Lugduni,1840, F. , H / 149 / 12 E
9. *Decii junii Juvenalis e auli Persil*, Rotomagi,1647, F. , An / 58 / 8 F
10. *Divi Caecillii cypriani episcopo*, Basilae,1540, F. , An / 145 / 18 A
11. *Il paradise perduto*, Milano, 1881, F. , H / 20 / 10-11 F
12. *Il paradise perduto*, Milano, 1881, F. , H / 20 / 10-11 F
13. **Moliere**, *Oeuvres completes*, Paris, Garnier Freres, [1861], F. 666, H / 55 / 4 B

14. *M.Annei Lukani pharsalia sive de Bello Civili*, Amsterdami,[1563], F. , An / 58 / 25 F
15. *Origenis Adamantii Operum Tomi Duo Priores...*, S.l.,[1512], F. , An / 57 / 7 D
16. *Revue generale de l'Architecture*, Paris, [1840], F. , H / 150 / 1 B
17. *S.Aurelii Augustini*.,Bassani,1774, F. , An / 63 / 3 G
18. *Sancti Athanasii Magni*, Paris, 1608, F. , An / 145 / 21 A
19. *Tertius et quartus Tomi Operum Origenis* ,S.l., s.a., F. , An / 145 / 14 F
20. *Tomus secundus operum divi Ioannis Chrysostomi*,Paris,1556,F. , An / 145 / 10 E
21. *Tomus secundus operum divi Ioannis Chrysostomi*, Paris, 1556, F. , An / 145 / 11 B

-Libra me nënshkrime e dedikime

1. **Ales=Zamputi Injac**, *Damjani himarjot : drame lyrike*, Shkodër, Sht."Z.Paperlyeme" 1937, F. 41, Al 2 / 75 C
(nënshkrim: Poetit tim / Atë Gjergj Fishtës / Ales)
2. **Beratti, Demetre**,*La question albanaise*, Paris, Impremerie Henri Dieval, s.a., F.109+16, Al / 22 / 57 C
(nënshkrim: At Gjergj Fishtës / per kujtim miqesije / e dashtnije / D.Betatti / Paris, më 26 Prill / 1920)
3. **Bettini, Sergio**, *Un collaboratore veneziano di Giusto da Padova*. Padova. . Estratto dal fascicolo nr. 4 Aprile 1932 della rivista "Padova" edita a cura del Comitato Provinciale Turistico, Padova , Soc. Coop. Tipogr., 1932, F. 12 , Al / 21 / 63 A
(nënshkrim: A Padre Giorgio Fishta / devote omaggio di / Sergio Bettini)

4. **Braille, S.**, *Fra un telegramma e l'altro. Versi giovanili (1891-1901)*, Corigliano-Calabro, Tipogr. "Popolano", 1925, F. 68, Al / 24 / 74 D
(nënshkrim: Al Rev.mo P. Giorgio Fishta O.F.M. / nel giorno del suo onomastico / con auguri cordialissimi / L'Autore)
5. **Chiafazezi, Ilie M.**, *Inscriptiile bisericilor din Moscopole-Cu un adaos de D.Berciu*. Extras din "Buletinul Comisiunii Monumetelor Istorice", fascicolo 97, Iulie-Septembrie 1928, Prahova, Tip. "Romaneasca", 1939, F. 11, Al / 21 / 31 A
[nënshkrim: (Botim i Akademia Rumanorus se Bukureshtit) / Sh Nderçmes revista / "Hylli i Dritës" / Shkoder / Ilo Mitkë-Qafëzeze / Korçë, 25 Korrik, 1940- XVIII / Prona e Prof. N. Iorga / Dhuratë e Bibliothekes së Ilo Mitkë-Qafëzeze)
6. **Irianni, O.**, *Il Panславismo russo e la civiltà europea*, Napoli, Stab. Tip. L. Pierro Figlio, 1913, F. 80, Al / 22 / 76 E
(nënshkrim: Al forte Poeta Giorgio Fishta / Gloria della Letteratura Albanese / Con ammirazione / L'Autore)
7. **Jokl, Norbert**, *Griechisch-albanische Studien (Sonderabdruck aus der Festschrift Kreschmer)*, Wien, [1926], F. 78-95, Al / 23 / 23 C
(nënshkrim: Poetit të "Lahutes së malsis" / njoftësit dhe krijuesit / të gjuhës shqype / A. Gjergj Fishta / me nderë / Vjenë, 18. Korrik V. Norber Jokl.)
8. **Kral, A.** *Le Pays de Kamal Atatürk. Formation et évolution de la nouvelle Turquie*, Leipzig, Edition Universitaires Vilhelm Braunmüller, 1938, F. 303, Bal / 32 / 26 C
(nënshkrim: / ... P. Georg Fishta / Provincial .. P.P. Francis- / kaner in Albanien / in alkr Ausfönglich... / ... / Wien, im Juni 1938 / Kral)
9. **Letër e hapun Z. Hilë Mosit Ministër Arsimit në Tiranë**, Shkodër, Sht. Françeskane, 1932, F. 22, Al / 2 / 51 B
[shënim: U çpallë me 10- XII - 1932. (e shkrovi P. Gjergj, ket) / Letra e ajo shka asht shkruar me germa të / vogla jashtë, janë fjalë të z. Hilë Mosi / shkruar në Gazeten Besa në muejn / e ndandorit 1932]
10. **Lutfi, Ymer**, *Nji pasuni e trashigueme*, Shkodër, Sht. "Ora e Shkodrës", 1932, F. 92, Al / 2 / 143 B

(nënshkrim: Zotit Pater Gjergj Fishta / Shkodër)

11. *Manuale di pittura italiana antica e moderna*, Milano, Ulrico Hoepli, [1901], F.429,
F / S.Rrota / 74. Në koleksionin e piktorit Simon Rrota.
(nënshkrim: Ket liber m'a ka falë Ndokë / Gjeloshi i Shalës në 1914 / P. Gj. Fishta)

12. **Rrota, Justin**, *Për historinë e alfabetit shqip*, Shkodër, Sht. Françeskane, 1936, F.92,
Al / 4 / 34 B
(nënshkrim: Provincjalit të vet / Auktori)

13. **Skendo, L.=Frashëri, Mid'hat**, *Hi ðe Çpuze*, Sofje, Sht. "Mbrothtësia" 1915, F.184,
Al / 1 / 98 G
(nënshkrim: Vjershëtorit G. Fishta / 7. III. 1913 / L. Skëndo)

14. *Vjershat e Murad Toptanit*, Tiranë, 1924, F. , Al / 3 / 8 E
(nënshkrim: Vjershëtorit të madh At Gjergj Fishtës / për kujtim dhe respekt i dhuroj librin e Atës / tim Murat / Toptanit / Said / Tiranë 4. VII. 1930)

15. **Xhuvani, A.**, *Libri i gjuhës shqipe pjesa e dytë për klasën e IV-ët të shkollës fillore*, Tiranë, Min. Arsimit, 1920, F.143, Al / 2 / 67 E
(nënshkrim: Të vlershëmit "Hyllit të Dritës" / ja dhuron auktori për Kujtim e nderim / A. Xhuvani)

16. **Zurani, Stefë**, *Ndodhjet e Shqypnis*, Shkodër, Sht. Françeskane, 1939, F.138,
Al / 1 / 66 E
(nënshkrim: Te Ndr. At G. Fishta / Autori)

Në koleksionin e dorëshkrimeve gjejmë:

1. *Historia e Shqypnis*, F. 13.
2. *Lahuta e Malcis*, F. 69.
3. *Proza. Artikuj*, F.191. (daklografim)
4. *Proza. Artikuj*, F.176. (daklografim)
5. *Proza. Artikuj*, F.196. (daklografim)

6. *Qafë-hardhija*, F. 35.

Vepra të At'Gjergj Fishtës që ndodhen në bibliotekën tonë:

1. **Anzat e Parnasit**, Shkodër, Botime françeskane, 2007, 204 f., Fh, Al / 6 / 33 B; S / 62 / 22 D
2. **Anzat e Parnasit**, Shkodër, 1907, 67 f., S / 122 / 47 F
3. **Anzat e Parnasit**, Tiranë, Eqrem Çabej, pa vt., 183 f., S 62 / 22 D
Codice di Lek Dukagjini ossia diritto consuetudinario delle montagne d'Albania **Gjergj Fishta (a cura di)**, Roma, Reale Accademia d'Italia, 1941, 320 f., Al / 23 / 60 B
4. **Demi për brinjësh. Polemikë me klerin**, Korçë, Sht. Dhori Koti, 1935, 28 f., S / 2 / 16 D; Al / 2 / 16 D; Al / 8 / 16 C
5. **Dramatika 1.Vitor Demaj (përg.)**, Shkodër, Botime françeskane, 2008, 296 f. Fh; Al / 6 / 7 C; Fh
6. **Dramatika 2.Vitor Demaj (përg.)**, Shkodër, Botime françeskane, 2008, 302 f. f. Fh; Al / 6 / 8 C
7. **Dramatika 3.Vitor Demaj (përg.)**, Shkodër, Botime françeskane, 2008, 248 f., Fh, Al / 6 / 9 C
8. **Epopeja e fisit shqiptar**, Shkodër, Sht. Françeskane, 1920, 16 f., S 133 / 7 D, S / 124 / 17 C; Al / 1 / 57 D; Al / 2 / 13 C
9. **Estetikë dhe kritikë**, Tiranë, Hylli i Dritës; Shtëpia e Librit, 1999, 223 f., S / 68 / 23 C
10. **Fjala e t'in' Zoti**, Palermo, 1912-1915, 4 f., Al ph.
11. **Fjalime nga Fishta, Harapi, Kollqi**, Tiranë, Uegen, 2009, 96 f., Fh
12. **Gogomelet. Polemikë me z. Kostaq Cipo profesor të gjuhës dhe të letërsisë shqiptare**, Korçë, Sht. Dhori Koti, 1935, 32 f., Al / 2 / 29 E; S 2 / 77 E
13. **Gomari i babatasit**, Tiranë, Hylli i Dritës, 1994, 185 f., Fh; S 55 / 1 E
14. **Gomari i Babatasit : poem melodramatik.-Bot 2**, Shkodër, Fishta, 1941, 104 f., Al / 1 / 118 F; Al / 1 / 138 G (pseud. Gegë Toska)
15. **I ligu per mend**, Shkodër, 1931, Al / 1 / 1660G; Al / 2 / 33 G
16. **Jashtevenije te menyres per te traituar fjalet e rea , Bukuresht," Arësimi i popullit rumun"**, 193, 134 f., S / 2 / 38 E
17. **Jerina ose Mbretnesha e luleve : poem melodramatik**, Shkodër, Fishta, 1941, 51 f., Al / 1 / 119 F; S / 121 / 104 A(pseud.

- Gegë Toska)
18. **Jerina ase Mbretnesha e luleve = Jerina regina dei fiori**, Shkodër, Botime françeskane, 2007, 180 f. Fh; Al / 6 / 13 C
19. **Juda Makabe. Botue se dytit**, Shkodër, Botime françeskane, 1923, 31 f., Al / 2 / 75 D; S / 124 / 17 C, 31 C, 51 F, 82 D, 89 D,
Kanuni i Lekë Dukagjinit Gjergj Fishta (parath.), Shkodër, Sht. françeskane, 1933, 140 f., Al / 2 / 65 A
Kanuni i Lekë Dukagjinit : [vepër postume] Gjergj Fishta (parath.) Shkodër : Botime françeskane, 2010, 144 f., Al / 10 / 15 A
Kombndriçuesit: poezi, Tiranë, Naim Frashëri, 2006, 224 f., Al / 3 / 89 D
- Komsija e Kleri Katolik : preje gni Meshtarit Shcypaar**, Shkodër, Sht. Françeskane, 1907, 29 f., Al / 3 / 6 D
- Lahuta e Malcis**, Shkodër, Botime françeskane, 2007, 650 f., Fh
- Lahuta e Malcis**, Tiranë, Alb-Ass, 2001, 150f., Fh
- Lahuta e Malcisë**, Shkodër, Botime françeskane, 2006, 182 f., Fh
- Lahuta e Malcis**, Tiranë, 1997, 528 f., S / 62 / 30 D
- Lahuta e Malcisë**, Tiranë, Uegen, 2010, 331 f., S / 71 / 54 F; S / 61 / 31 / F
- Lahuta e Malcis**, Shkodër, Sht. françeskane, 1932, 511 f., Al / 8 / 2 C; Al / 1 / 37G
- Lahuta e Malsis. Blee i Il. Vranina.-Botim i 4-t**, Zadar, Shtypshkr.e Ernesto Vitalianit, [1907], 52 f., Al / 8 / 5 C
- Lahuta e Malcis od il Liuto della Montagna. Canto V. La Morte**, Scutari, Tipografia "P.G.Fishta", 1941, 16 f., Al / 23 / 2 B
- Lahuta e Malsisë nga At Gjergj Fishta : ritreguar për fëmijë** [Odhise K. Grillo (ritregoi)], Tiranë, Dituria, 1992, 104 f., Fh
- Lahuta e Malësisë: variant i shkurtuar**, Tiranë, Alb-ass, 2001, 7, S / 30 / 21 C
- Lahuta e Malësisë, Bot. 3., Romë, Qendra e katolikëve shqiptarë jashtë atdheut**, 1991, 524 f., S 55 / 1 D
- Lahuta e Malësisë**, Tiranë, Uegen, 2003, 526 f., S 55 / 4 D
- Letër e hapur e Z. Hilë Mosit Ministër Arsimit Tiranë**, Shkodër, Shtypshkronja "Françeskane", 1932, 22 f., Al / 2 / 47 B
- Mil vorr t'At Anton M. Xanonit. S. J**, Shkodër, [1915], 7 f., Al / 1 / 116 F;
Al / 1 / 96 G
20. **Mrizi i zânave**, Shkodër, Botime françeskane, 2007, 150 f., Fh; S 158 / 26 C; Al / 6 / 41 B
21. **Mrizi i zânave**, Tiranë : Naim Frashëri, 1994, 247 f., S 158 / 24 C

22. **Mrizi i zânave**, bot IV, Shkodër , Sht.A. Gj.Fishta, 1941, 147 f., Al / 1 / 114 F
23. **Mrizi i zânave**, Tiranë , Naim Frasheri, 1999, 208 f., S / 158 / 26 C
24. **Nikolejda : satira**, Shkodër, Botime françeskane, 2007, ? f., Al / 8 / 11 G
25. **Nikolejda**, Shkodër, Botime françeskane, 2005, 77 f. Al / 13 / 60 E
26. **Odisea. Ifigjenia n'Aulli**, Shkodër , Sht.A. Gj.Fishta, 1931, 46 f., Al / 1 / 111F; Al / 3 / 18 D
27. **Pika voëset**, Zadar, Shtypshkr.e Ernesto Vitalianit, 1909, 82 f., Al / 8 / 2 D; Al / 2 / 113 E; Al / 1 / 98 F
- Poetët e mëdhej t'Italis** : Dante, Petrarka, Ariosto, T. Taso, **Gjergj Fishta (parath.)** Tiranë : Shtypshkronja "Nikaj", 1932, V. 1,2, 280 f., S 72 / 30 A, 31A
- Poezi të zgjedhura nga Mrizi i Zanavet, Vallja e Parrizit, Anzat e Parnasit, Tiranë, Sh.B.L.Sh. e Re, 2005, 108 f., S / 52 / 32 C**
28. **Porosit e Marash Uçit** : (nga "Lahuta e Malcis"), Shkodër, Sht. françeskane , 1932, 7 f., Al / 2 / 40 G
29. **Proza .Vëllimi 1: 1899-1922**, Shkodër, Botime françeskane, 2006, 480 f., Al / 6 / 42 B; Fh; Al / 6 / 10 C
30. **Proza. Vëllimi 2: 1923-1940**, Shkodër, Botime françeskane, 2006, 488 f., Fh; Al / 6 / 11 C
31. **Sotto l'impero romano prosperita del popolo skipetaro (Riv. d'Albania, fascic.II, 1940, Milano-Varese, A. Nicola & Co ,1940, 5 f., Al / 22 / 74 C**
32. **Sh. Luigji Gonzaga : melodram**, Shkodër : Shtypshkronja e Zojës s'Paperlyeme, 1927, 76 f., Al / /
33. **Shen Françeskui Azisit: melodrama**, Shkodër, Sht. Nikaj, 1912, 100 f., Al / 1 / 112 F
34. **Shna Ndou u Padues**, Shkodër, Sht. françeskane , 1927, 54 f., Al / 1 / 115 F; Al / 3 / 99 C
35. **Shqyptarët e të drejtat e tyne** : teksti shqyp i konferencës s'mbajtme frengisht prej të pershndritshmit e të prnderueshmit ëmzot Luigj Bumçit, ipeshkvit të Lezhjës në salë t'Universitetit Katolik në Paris, Shkodër, 1920, 29 f., Al / 3 / 14 C
36. **Taralloqja e Ballkanit: botim postum**, Shkodër, Sht. françeskane , 1944, 15 f., Al / 4 / 27 E
37. **The Highland Lute**, përkth.Robert Elsie, London I.B.TAURIS,

- 2005, 478 f., H
38. **Vallja e Parrizit**, Shkodër, Botime françeskane, 2007, 121 f., Fh; Al / 6 / 12 C
 39. **Vallja e Parrizit**, Shkodër, Sht. A. Gj. Fishta , 1941, 123 f., Al / 1 / 117 F
 40. **Vepra dramatike**, Tiranë, Naim Frashëri, 2007, 304 f., Fh; S / 25 / 28 A
 41. **Vepra letrare 1. Lirika: Mrizi i zanavet**, Lezhë, "Gjergj Fishta", 2001, 144 f., Fh ; S / 80 / 12 F; Al 14 / 23 E
 42. **Vepra letrare 2. Lirika: Vallja e Parrizit, Barinjte e Betlehemit**, Lezhë, "Gjergj Fishta", 2002, 176 f., Fh; S / 80 / 13 F : Al / 14 / 24 E
 43. **Vepra letrare 3. Lirika, përkthime**, Lezhë, "Gjergj Fishta" ,2002, 124 f., Fh; Al / 14 / 24 E; S / 80 / 15 F ; S 160 54 C
 44. **Vepra letrare 4. Lahuta e malcis dhe Mojs Golemi : epika**, Lezhë, "Gjergj Fishta" , 2002, 656 f., Fh; S / 160 / 53 C; S 80 / 21 F; Al / 14 / 26 E
 45. **Vepra letrare 5. Drama 1**, Lezhë, "Gjergj Fishta" , 2005, 291 f., Fh; Al / 14 / 27 E ; S 80 / 22 F
 46. **Vepra letrare 9. Publicistika 1**, Lezhë, "Gjergj Fishta" , 2004, 660 f., Fh; S / 160 / 54 C; Al / 9 / 14 D
 47. **Vepra letrare 10. Publicistika 2**, Lezhë, "Gjergj Fishta" , 2004, 527 f., Fh; Al / 9 / 13 D; S 80 / 23 F ; S 160 54 C

▪ **Kronikë kulturore** ▪

**DANTE ALIGHIERI: PROFET I SHPRESËS
DHE POET I DËSHIRËS NJERËZORE**



Në kuadër të aktiviteteve për nder të 700 -vjetorit të vdekjes (25 mars 1321-2021) së poetit Dante Alighieri, Konferenca Ipeshkvore Shqiptare në bashkëpunim me Departamentin e Letërsisë në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" organizoi, me datën 21.05.2021 në Auditorin A3 të Rektoratit, konferencën "Dante Alighieri: profet i shpresës dhe poet i dëshirës njerëzore".Konferenca u moderua nga Dr. Ermira Alia,

pedagoge e departamentit të Letërsisë.

Përveçse si vepër letrare me rëndësi për letërsinë botërore, vepra e shkrimtarit të madh Dante Aligieri u pa edhe si një vepër që nxit dialogun ndërkulturor në ditët sotme.

Duke përshëndetur konferencën, Imzot Angelo Masaffra O.F.M. Kryetar i KISH iu referua letrës apostolike *Candor Lucis Æternæ të Atit të Shenjtë Françesku*, në 700- vjetorin e vdekjes së Dante Aligierit, e sapo përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo letër përmbledh pikëpamjet e Papëve mbi veprën e poetit të madh që ka ushtruar një ndikim të madh kulturor edhe në botën shqiptare. Itinerari i Dantes, thotë Papa Françesku, është në vërtetë rruga e dëshirës së brendshme për ta ndryshuar jetën veti në mënyrë që të arrijë lumturinë e kështu t'ua tregojë rrugën atyre që e gjejnë veten si poeti, në një pyll të errët ku kanë humbur rrugën e drejtë. Në kuadrin e realitetit kulturor shqiptar, ku debati kulturor mbi përdorimin e shqipes ende nuk ka përfunduar, Imzot Masaffra theksoi nevojën e njohjes edhe të veprave të tjera të poetit si *De vulgari eloquentia* në të cilën shprehen pikëpamjet e poetit për përdorimin e gjuhës popullore si gjuhë e gjallë.

Prof.as.dr Paulina Hoti (Guli) Zv.Rektore e Universitetit të Shkodrës falenderoi Konferencën Ipeshkvore të Shqipërisë që bëri pjesë të iniciativës së saj për të nderuar poetin Dante Aligieri edhe Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" përmes bashkëpunimit me Departamentin e Letërsisë. Duke e parë këtë aktivitet si pjesë e dialogut ndërkulturor, ajo theksoi rolin dhe misionin e universiteteve në nxitjen e jetës kulturore, shkencore, por edhe të dialogut ndërkulturor. Institucionet tona kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin e së ardhmes së shoqërisë shqiptare ndaj duhet vijojë bashkëpunimi mes nesh dhe të interesuarve të tjerë. Prof.as. dr. Paulina Hoti falenderoi Departamentin e Letërsisë dhe studentët që u bënë pjesë e këtij organizimi.

Më pas përmes disa kumtesave u analizuan veçori të veprës *Komedia Hyjnore*, jehonës së saj në kohët moderne si dhe takimit të kulturës shqiptare me të përmes përkthimeve.

Në temën *Poezia- shtegu i përkryerjes së dashurisë*, Don Robert Kola (Instituti Teologjik i Shkodrës) theksoi faktin se nderimi i poetit Dante Aligieri është tashmë në traditën e Kishës Katolike që nga Papa Benedikti në shek XV përmes letrave apostolike ku shqyrtohen aspekte të ndryshme të kësaj vepre. E fundit prej këtyre letrave është *Candor Lucis Æternæ* e Atit të Shenjtë Françesku.

Ai u ndal në shqyrtimin e përshkrimeve poetike në *Komedinë Hyjnore të misterit të mishërimit* në krahnorin e Virgjërës Mari, veçanërisht në këngën e fundit të Parajsës si dhe *misterit të Trinisë e buzëqeshjes së amshueme*. Poezia këtu, bëhet shtegu i përkryerjes së dashurisë në mishin e njeriut. Më tej, don Robert Kola, vuri në dukje lidhjet e *Komedisë Hyjnore* me traditën biblike, ku njeriu i thuri poezinë e parë gruas duke brohoritur: "Kjo është ashti i eshtrave të mi, mishi i mishit tim!" (Libri i Zanafillës 2/23). Ndikimi i kësaj tradite është thelbësor në veprën e Dantes që përshkohet nga buzëqeshja e Beatrices, në fytyrën e së cilës shkëlqen Hyu. Poezia është shtegu i përkryerjes së dashurisë në mishin e njeriut. Poezia e Dantes shfaq përsosjen e dashurisë, gjykimi i fundit shfaqet si përforsim që përkryen dashurinë. Filozofia dhe teologjia vijnë pas poezisë, tha don Robert Kola, duke vlerësuar gjenialitetin dhe universalitetin e poezisë së Dantes.

Drejtori i Departamentit të Letërsisë, Prof.as.dr. Arben Prendi në kumtesën e tij *Dante përmes disa konsideratave të shkrimtarëve bashkëkohorë vuri në dukje se shkrimtarët e mëdhenj e kapërcejnë kohën në të cilën kanë krijuar e jetuar*. Homeri, Eskili, Sofokliu, Euripidi, Virgjili, Dante, Servantes, Gëte etj., bëjnë pjesë tashmë në traditën e letërsisë botërore dhe njëkohësisht janë bashkëkohorë. Jehona e veprës së Dante Aligierit vijon edhe përgjatë shekullit të XXI dhe XXII këtë e tregojnë edhe vlerësimet e disa prej shkrimtarëve të rëndësishëm bashkëkohorë evropianë si: Saint-John Perse, Ezra Paund, T.S. Eliot, Osip Mandelshtam, Jorge Luis Borges, Eugenio Montale, Jorgos Seferis, Seamus Heaney, Ismail Kadare etj. Të gjithë i referohen Dantes si mjeshtër, duke vënë në pah përmes shkrimeve të tyre, universalitetin e veprës, rolin e saj në konsolidimin e gjuhës italiane, cilësitë poetike, filozofike, fetare të veprës *Komedia Hyjnore*.

Andreas Dushi (Student i Masterit Shkencor në Universitetin e Tiranës, redaktor i revistës "Ex Libris") në kumtesën e tij *Historia dyshekullore e përkthimeve në gjuhën shqipe të Dante Alighierit* bëri një paraqitje të përkthimeve në gjuhën shqipe të *Komedisë Hyjnore* duke nisur nga përkthimi i parë, nga Luigi Lorecchio në vitin 1896; Sokol Baçi, *shqiptar erudit nga Mbishkodra* botuar në La Nazione Albanese (Viti IV - Numri VI - 31 mars 1900) të Anselmo Lorecchio-s; Padër Vinçens Prennushi boton më 1926 në të përkohshëm "Zani i Shna Ndout" Kanga XI e Parrizit. Ernest Koliqi botoi vëllimin e parë të librit "Poetët e Mëdhej t'Italis" (1932) edhe përkthime nga Dante.

Pashko Gjeçi do të botonte përkthimin e *Karonti*, në "Cirka", qershor 1937, për të vijuar mandej një vit më vonë ku sërish në "Cirka" edhe dy pjesë të tjera nga *Komedia Hyjnore: Farinata dhe Kont Ugolini* nga *Ferri*. Më 1938, Mark Ndoja, përktheu në shqip *Urata e mbrames* nga *Burgatueri*. Më 1943, kemi 37 vargje të *O Virgjin Nanë*, përkthyer nga Atë Mark Harapi S. J dhe botuar në vitin 1943. Më 1960, *Komedia* u botua e plotë nën përkthimin e Pashko Gjeçit. Edhe Çezar Kurti do të përkthente një pjesë të *Komedisë* e po ashtu, Hektor Shënpremtë, deri tek Meritan Spahia, nën përkthimin e të cilit deri më tani është botuar "Ferri".

Në mbyllje të konferencës, Dom Gjergj Meta, Ipeshkvi i Mirditës (Komisioni për Kulturën dhe mediat KISH) u shpreh se qëllimi i këtij aktiviteti ishte për të ndërtuar një kulturë të dialogut kulturor dhe ndërkulturor bashkë me universitetet. Koha po na thotë se asnjëri nga ne i vetëm nuk ka monopolin e kulturës, nuk ka monopolin e të vërtetës e të shkencës. I vetëm asnjëri nga ne nuk është i plotë, por vetëm bashkë ne mundemi të krijojmë një mozaik kulture. Bukur do të ishte që nesër pasnesër të mblihdhemi për një poet të kulturës islame. Pa këtë dialog kulturor ne nuk mund të ecim, por bashkë të gjithë. Dhe Dante mund të jetë pikënisja.

Ndërmjet kumtesave, në kujdesin e pedagogut të Departamentit të Letërsisë dr. Gëzim Puka, u interpretuan disa prej këngëve të "Komedisë Hyjnore" të Dante Aligierit nga studentët: Desara Kerjota dhe Kamila Fjerza, studente e Masterit Profesional në Mësuesi në Gjuhë-Letërsi dhe Lazarino Pjetri, student në Bachelor në Gazetari-Komunikim. Interpretimet e studentëve u pritën me interes dhe me duartrokitje nga të pranishmit në sallë. Aktiviteti u ndoq nga të pranishmit në sallë duke respektuar masat anticovid19 por edhe online përmes platformës zoom dhe u transmetua direkt nga televizionet lokale e kombëtare.

Departamenti i Letërsisë

▪ In memoriam ▪

Zenepe DIBRA

**ARTAN HAMID BORIÇI (1965-2021)
SHKENCËTARI I SHQUAR SHKODRAN**



Shkencëtarët, në krahasim me artistët, sportistët, shkrimtarët nuk njihen aq shumë në publikun e gjërë. Por ato janë si vullkani që kur shpërthen atëherë i njihet fuqia ngazëlluese e tyre. I tillë ishte pedagogu, studiuesi, kërkuesi shkencor, profesori i shquar shkodran, Anëtar i Akademisë së Shkencave,

Artan Hamid Boriçi, që këto ditë u nda nga jeta.

Në Shkodër shkencëtarët e këtij niveli janë të rrallë. E ka kaluar Shkodra një humbje të thellë dhe të madhe në vitin 1984, kur nga një vdekje e parakohshme humbi një nga shkencëtarët e shquar, në fushën e kimit kuantik, në frontet e para të saj, Besnik Syken, misionarin e parë të suksesshëm të integrimit evropian, me një devotshmëri atdhetare.

Dhe vdekja e parakohshme e prof Artan Boriçit, është humbje e

madhe jo vetëm për komunitetin shkencor shqiptar dhe ndërkombëtar por edhe për Shkodrën, qytetin ku kishte origjinën ai, prindërit dhe paraardhësit e tij. Kryebashkiakia e Shkodrës Ademi ka shkruar me plot të drejtë: *“Amaneti i tij ishte të prehej në Shkodrën e tij, që e desh dhe me të cilën krenohej në çdo hap të jetës, brenda dhe jashtë Shqipërisë.”*

Ai kishte lindur dhe ishte rritur në Tiranë por ambient familjar ku u rrit ishte krejtësisht shkodran me babën e nderuar Prof. Hamid Boriçin, me nënën e shquar nga familja Bushati, Prof. Myzejen Boriçi, të cilët e edukuan jo vetëm me traditat më të mira shqiptare por edhe me lavditë e Shkodrës në të gjitha fushat. Ai u rrit me historitë shkodrane por në mënyrë të veçantë me kontributet dhe meritat e fisit të tij. Prandaj ai donte të prehej në tokën ku lindi edhe **Daut Boriçi**-personalitet i shquar i historisë, cultures dhe i arsimit shqiptar, një nga rilindasit e shquar shqiptar, klerik përparimtar, Mësuesi Popullit, hartuesit të tekstesveshkollore, dijetarit në fushën e arsimit, të gjuhësisë shqipe, të cultures dhe të educates qytetare, organizatorit e drejtuesit politik në mbrojtje të kauzës kombëtare; **Ahmet Boriçi**- personalitet me contribute në fushën e financave dhe ekonomisë, nismëtar i ingritjes së doganave shqiptare, **Adem Ef. Boriçi** (gjyshi i babait Hamid), juristit të mirënjohur, njëheri një nga anëtarët e pare të Këshillit të Bashkisë së Shkodrës në themelim të saj në vitin 1913; si edhe shumë personalitete të tjerë të këtij fisi lavdiplotë, që kanë dhënë kaq shumë contribute në disa fusha të zhvillimit ekonomik, arsimor e shoqëror të Shkodrës.

Ne si shkodranë nuk e kishim njohur këtë anë të Prof. Artan Boriçit; nuk e kishim ditur se sa shumë ai e kishte dashur Shkodrën, sa veneracion, dashuri dhe vlerësim kishte për te por vetëm amaneti në momentet e fundit të jetës, do të zbulonte se çfarë kishte ndjerë për këtë qytet të të parëve të tij. Ne e njihnim dhe e dinim se babai i tij, Prof. Hamid Boriçi, ishte një nga gazetarët e njohur edhe tej Shkodrës e Tiranës, një nga themeluesit e të parës shkollë shqiptare, të gazetarisë që në vjeshtë të vitit 1964, pedagog i saj pa ndërprerje për më shumë se një gjysëm shekulli, projektuese dhe i Degës së Gazetarisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Hamid Boriçi, që nga viti 2005 është Anëtar Nderi i Unionit të Gazetarëve të Veriut. Po ashtu dihet se nëna e Artanit, Inxhinierë klimatologe, Prof. Dr. Myzejen (Bushati) Boriçi, dy herë laurate e Çmimit “Republika”, është nga dera e fisme e Bushatlinjve të mëdhej të Shkodrës.

Po kush ishte Akademiku Prof. Dr. Artan Boriçi që iu shtua panteonit

të shkenctarëve të shquar shqiptarë ?

Lindi në Tiranë më 1965 ku kreu shkollën 8-vjeçare "Emin Duraku", gjimnazin "Qemal Stafa" dhe u diplomua "Fizikan" në Universitetin e Tiranës. Gjatë viteve 1993-1996 kreu studimet pas-universitare në Politeknumin Federal të Zvicrës në Zyrih. Në vitet 1996-2003 mbajti pozicione, si kërkues shkencor në Institutin Kombëtar Zviceran "Paul Scherrer", në Politeknumin Federal të Zvicrës dhe në Universitetin e Edinburgut etj. Në vitin 2003 është kthyer në Shqipëri për të vijuar punën e pedagogut-kërkuesit shkencor, të nisur në dhjetor 1988 në Katedrën e Fizikës. Që prej vitit 2012 ai është në krye të Grupit të Fizikës Llogaritëse. Ndërkohë ka vazhduar pa reshtur të bashkëpunojë me institucione shkencore ndërkombëtare si CERN-i (Qendra Evropiane për Kërkime Bërthamore) dhe Qendrën Evropiane të Supërlllogaritjeve në Jylih të Gjermanisë.

Prof. Artani ishte projektuesi dhe organizatori i Konferencave Ndërkombëtare: "*Numerical Analysis and Lattice QCD*" në Edinburg dhe të konferencës "*The first International Workshop on recent LHC Physics results and related topics in Tirana*", në Tiranë,

Ai ka ligjruar e kumtuar referate në shumë konferenca ndërkombëtare: disa here në Amerikë, në Zvicër, në Austri, në Gjermani, në Australi, në Skoci, në Itali, në Rusi, në Angli, në Singapor, në Japoni, etj.

Prof. Artani ka të arshivuar 61 botime dhe 698 faqel eksione në gjuhën shqipe, ku për herë të parë përdori terminologjinë e re shkencore në shkrimin e leksioneve. Ai ka 624 citime. Ka dhënë leksione në disa shkolla ndërkombëtare si dhe konsulenca të vlefshme në disa institucione të vendit dhe ndërkombëtare. Ka botuar 2 programe kompjuterike, 3 monografi dhe 2 tekste shkollore. Ndër monografitë mund të përmendim: "*QCD and Numerical Analysis III*", 2005, autori parë, Shtëpia Botuese Springer 2005, ndërsa ka shkruar për herë të parë në gjuhën shqipe tekstet monografike "*Teoritë kalibruese të fizikës së grimcave elementare*", 2010 dhe "*Algebra lineare numerike*", 2011, Instituti i Karrierës Proteus, si dhe tekstin mësimor "*10 leksione mbi probabilitetin*", 2006, botuar nga Qendra e Analizës së Riskut në Tiranë. Ka shkruar më shumë se 50 artikuj, botuar në revistat shkencore kryesore më prestigjioze të fizikës, si "Physical Review", "Physics Letters", "Nuclear Physics", etj.

Ishte shumë i njohur në botën akademike për "*Formulimin e teorisë fermionike rrjetore, Algoritmet numerike për fermionet kirale dhe zhvillimin e teorisë duale Yang-Mills*".

Prof. Artani ishte pjesëtar i shoqatave shkencore dhe profesionale. Ka qenë i angazhuar edhe në organe drejtuese administrative, si: Drejtori Drejtorisë së Riskut në bankën "Credins" (2007-2008), zv. Dekani Fakultetit të Shkencave të Natyrës (mars-nëntor 2012), përgjegjës i Grupit Mësimor të fizikës llogaritëse (2012-2018), përgjegjës i Grupit Mësimor-Kërkimor të energjive të larta të astrofizikës, që prej dhjetorit 2018.

Një nga vlerësuesit e veprës dhe të personalitetit të professor Artan Boriçi, anëtari Jurisë për titullin "Profesor", Prof. Dr. Thomas Lippert, Drejtori Institutit të Simulimeve të Avancuara, Qendrës Kërkimore në Jylih dhe përgjegjës i Katedrës së Fizikës Teorike Llogaritëse në Universitetin e Vupertalit në Gjermani, ndër të tjera shkruan: *"Profesor Artani ka dhënë kontribute të rëndësishme në studimet e fizikës teorike, është gjithnjë një prej pionerëve të rëndësishëm që shtyn përpara metodologjitë e reja llogaritëse në LQCD; ishte prej të parëve që u orientua drejt paraqitjeve ekzakte të fermioneve kirale në rrjet dhe simulimin e tyre. Në funksionet e tij si kërkues i mirënjohur dhe fizikant Prof. Boriçi ka treguar qartë kompetencën më të lartë shkencore"*.

Kjoveprimtari e gjithanëshme e me kaq vlera, mori shumë energji nga trupi dhe mendja e tij e që ndoshta sëmundja e shpejtë e gjeti të papërgatitur për të përballuar furinë e saj.

Ai do mbetet një personalitet në panteonin e elitës intelektuale, shkencëtari përkushtuar, që me pasionin, vullnetin dhe inteligjencën e tij dha kontribut në arritjet ndërkombëtare të fushës së fizikës teorike.

Ai ishte shkodrani patriot që kurrë nuk e harroi origjinën e tij, kontributet e fisit të tij, por edhe lavdinë e Shkodrës. Toka nanë shkodrane e priti të prehet në gjirin e saj, aty ku prehen edhe personalitetet e familjes së madhe Boriçi të qytetit tonë.

Është fat që në rrugën e Artanit dhe të traditave kulturore e shkencore të Shkodrës ka hyrë e po ecën edhe djali i Artanit, **Dalini Boriçi**. Ai ka përfunduar studimet Bachelor në Orsejë (Paris), duke merituar dy diploma: e para për matematikë, e dyta për Fizikë dhe, i dërguar nga Universiteti Orsej është në vitin e parë të kualifikimit pas-universitar në Kolegjin Mbretor në Londër (Angli). Ecuria e deritashme e tij tregon se Dalini, që ka lindur në Zyrih të Zvicrës dhe rritur në Tiranë, do të zëvendësojë Artanin, në familjen shkodrane në Tiranë, që njihet edhe si një familje prej pesë anëtarësh, që, siç është quajtur nga mediat, përbënte një qelizë kulturore, pedagogjike e shkencore: **Hamidi** prof. dr.,

Myzejeni prof. dr., **Artani Akademik**, prof. dr., **Mirela** (bashkëshortja e Artanit), fizikane, Doktore e Shkencave dhe **Dalini** i cili po ecën I sigurtë drejt rrugës së bukur dhe të vështirë të shkencës

(në numrin e ardhshëm do botojmë bibliografinë e botimeve të Prof. H.Boriçit)

▪ In memoriam¹ ▪

Artan HAXHI; Tefë TOPALLI

**NDAHET NGA JETA, PROF. NJAZI KAZAZI
(1949 - 10 mars 2021)**



Njazi Kazazi ka lindur në qytetin e Shkodrës. Kreu shkollën e mesme Pedagogjike "Shejnaze Juka" dhe studimet e larta në ILP të Shkodrës, më 1975; më pas kualifikimin pasuniversitar e përfundoi me marrjen e gradës "Kandidat i shkencave". Ka punuar si

mësues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë në Pukë, Gruemirë (M.M.) për 26 vjet me radhë; pastaj metodist në Kabinetin Pedagogjik të rrethit Shkodër (1983-1990 e drejtor i këtij institucioni arsimor, si dhe përgjegjës i sektorit të kontroll-kualifikimit në Drejtorinë Arsimore të Shkodrës (1993), dhe nga ky vit e ishte pedagog –didakt i gjuhës shqipe,

¹ *Materiali u muar nga Tefë Topalli. Leksikon i Gjuhëtarëve dhe Albanologëve, ISA, USH "L. Gurakuqi", Shkodër: Fiorentia, 2012, f. 311-317.; Artikulli redaksional i revistës "Zani i Natës", 10 mars 2021.*

titullar për disiplinat "Didaktikë e gjuhës shqipe", "Metodikë e kërkimit shkencor", "Organizim dhe drejtim arsimit", Shkrimi akademik". Më 1994 fitoi titullin "Mësues i merituar". Më 1999 fiton titullin "Profesor i asocuar", kurse më 2004 "Profesor". Ka hartuar programe dhe cikle leksionesh për lëndë të veçanta nga gjuhësia e palikuar të ciklit të parë të studimeve universitare dhe ka dhënë mësim në shkollën pasuniversitare. Ka botuar me dhjetra artikuj e studime në revista shkencore periodike brenda dhe jashtë vendit; është paraqitur me kumtime në konferenca dhe veprimtari shkencore dhe ka kryer kualifikime të ndryshme sipas programeve, në Bolonjë, Bari, Sarajevë.

Karrierën e tij profesionale e mbylli në universitetin e Shkodrës. Ndonëse në pension, ai kalonte jo pak kohë në mjediset e universitetit, duke ofruar përvojën e tij për pedagogët dhe studentët.

Prof. Njazi Kazazi me lirinë e besimit pas viteve '90 do të angazhohej dhe do të jepte një kontribut të gjerë në publicistikë, duke botuar dhjetëra artikuj në shumë gazeta dhe revista islame, duke nxjerrë në pah shumë personalitete të shquara myslimane shqiptare. Prej rithemelimit të revistës "Zani i Naltë" në vitin 2012 ai ishte gjithashtu dhe anëtar i Bordit Editorial të saj, duke botuar shumë artikuj me karakter biografik dhe studimor për personalitete të shumta dhe historikun e medresesë së Shkodrës dhe arsimit islam në qytetin e tij të lindjes.

Prof. Nj. Kazazi ishte një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë dhe më të vlerë të revistës "Gegnia", pronë intelektuale e bibliotekës "Marin Barleti" (Bashkia Shkodër) për të cilën shkruajti mjaft artikuj të randësishëm sa i takon traditës, zhvillimit të arsimit dhe figurave të njohura të fushës në qytetin e Shkodrës.

Bibliografi e punimeve të prof. dr. Njazi Kazazit.

Prof. Kazazi, u dallua për punë shkencore në grup dhe një pjesë e mirë e botimeve kanë emrin e tij, ishte bashkëpunëtorë, si në monografi e tekstet mësimore universitare të mëposhtëme :

"Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike". MASH, Tiranë, 2003, 376 f. (bashkëpunëtor me prof.dr. Sh. Osmani)

"20 vjet-Fakulteti i CU në Shkodër" (Grup autorësh). Shkodër, 2002, f.156

"Universiteti i Shkodrës ndër vite, 1957-2002" /Historiku/, Shkodër, 2002, 330 faqe (Grup autorësh)

"Bibliografi e Botimeve të USH, 1957-2002", Shkodër, 2003, 190 f.
(Në b/punim me Gj. Çunin)

"Bibliografi e Buletinit Shkencor të USH "Luigj Gurakuqi" (Në b/punim me M.Hotin e Gj. Çunin), Shkodër, 2005, 232 faqe.

"Në gjurmët e një didaktit" (Nga veprimtaria dhe trashëgimia e didaktit Shefik Osmani), IKS, Tiranë, 2005, 444 faqe.

"Faik Luli- Jeta dhe veprimtaria" (Monografi). Shkodër, 2006, 220 faqe.

"USH në 50- vjetorin e tij, 1957-2007 ". Shkodër, 2007, 230 faqe (Grup autorësh)

Tekste universitare

"Udhëzues metodik për punën kërkimore-shkencore" Botim i USH. Dep. Gjuhësisë Shkodër, 2000, 150 faqe

"Organizimi dhe drejtimi i arsimit" .Tekst universitar dhe ndihmës për drejtuesit e shkollave (Në b/punim me N. Zhabjakun)

"Udhëzues për punën kërkimore- shkencore" (Tekst universitar për studentet e FSHSH të USH. Shkodër, 2003, 90 faqe (Në b/punim me R. Gurakuqin)

"Hyrje në metodikën e punës shkencore" (Tekst universitar) SHBLU. Tiranë, 2004, 160 faqe (Në b/punim me Gj. Shkurtaje Y. Çirakun)

"Didaktikë e gjuhës shqipe" SHBLU. Tiranë, 2005.303 faqe (Në b/punim me N.Garucin e N. Zhabjakun)

"Shkrimi akademik" USH "Luigj Gurakuqi" . Camaj-Pipa. Shkodër 2007. 144 faqe (Në b/punim me I.Hoti, M. Hysën)

"Metodikë e kërkimit shkencor" (Për studentët e USH "Luigj Gurakuqi". Camaj-Pipaj. Shkodër, 2007 164 faqe (Në b/punim me I. Hotin)

"Didaktikë e gjuhës shqipe" (për CU) SHBLU (Në b/punim me I.Hotin, autore e parë) 160 faqe. Tiranë, 2009

Redaksia e revistës "Gegnia", i shpreh familjes ngushëllimet më të sinqerta.

Zija Vuka

SKËNDER TEMALI, IN MEMORIAM
(30 korrik 1946 - 17 prill 2021)



Skënder Temali është një zë i përveçëm në historinë e letërsisë shqiptare; një autor që lëvroi shumë zhanre të artit të fjalës, si poezinë, tregimin novelën dhe romanin. Ishte gjithashtu publicist dhe mësues me një kontribut të gjatë e të vyer në arsim.

U lind në Shkodër, ku dhe kreu Universitetin "Luigj Gurakuqi". Për 15 vjet punoi redaktor në shtypin e Radion e Shkodrës, revistën "10 Korriku" dhe për një çerek shekulli mësues i letërsisë dhe drejtues në shkollat e mesme.

Përfshihet në enciklopedi e përmbledhje të ndryshme letrare.

Krijime të tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja. Në vitin 2018 doli vëllimi i tij me tregime në gjuhën malazeze "Këtë dimër nuk ra dëborë", botim i "Centar za očuvanje i razvoj kulture manjina Crne Gore".

Si publicist e shkrimtar nderohet me çmime lokale e kombëtare. Në vitin 2001, me tregimin "Këpucët e turpit" në gjuhën italiane, merr

çmimin special të jurisë në Konkursin e 7-të Ndërkombëtar të Shoqatës së Shkrimtarëve e Artistëve "Cristalide" të Italisë, mes 462 shkrimtarëve nga shumë shtete të botës. Në vitin 2015 me poemën "Unë, Ballkani dhe Europa", Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës në manifestimin mbarëkombëtar "Drini poetik" i akordoi çmimin "Adem Demaçi". Pen Klubi i Malit të Zi e ka nderuar me mirënjohjen e tij.

Në vitet 2013-2017 themeloi dhe kryesoi Shoqatën e Shkrimtarëve të Shkodrës, duke përmbledhur e redaktuar tri antologji voluminoze "Pena e Shkodrës" me krijime të anëtarëve. Udhëhoqi mjaft promovime librash dhe që bashkëpunues në veprimtari të përbashkëta me organizata homologe në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni.

Që nga viti 1971 botoi 20 vëllime më vete në poezi e prozë. Ka të përfunduar në dorëshkrim romanin "Hotel Univers", vëllimet me poezi "Vajza që nuk putha" dhe me tregime "Ngjarje në plazhin nudo", përmbledhjen me novela "Studentja nga Shkodra" si dhe monodramën "Vijmë në këtë botë për t'u gënjer".

Në krijimtarinë e tij në poezi autori Skënder Temali është afirmuar herët, që në vitin 1971 me vëllimin poetik "Këngë cigane". Poezia ka qenë një nga pasionet më të mëdha në krijimtarinë e tij letrare, që e ka shoqëruar gjithë jetën. Kjo i është bashkuar edhe kontributit të tij në fushën e letërsisë për fëmijë, konkretisht me poemën e vitit 2000 "Ishte një lajthishte", "Tre shokët" (2007), si dhe vëllime të tjera poetike "Lirika të hershme dhe të vona" 2010, "Të pathënat" (2016), "Kur vuaj shkruaj" (2012) "Curriculum vitae" 2013, "Vajza që nuk putha" (2019) "Unë Ballkani dhe Evropa" 2015 etj.

Krijimtaria në prozë nis me prozën e gjatë në vitin 1982, me romanin "Kjo ndodhi në Lis". Të tjera romane janë shkruar nga autori temali edhe përgjatë krijimtarisë së tij të mëvonshme. Kështu kemi romanin "Askushi" në vitin 2006, si dhe novelat "Nesër do të them mirëmengjes" (2002) "Studentja e Bolonjës" (2004), "Stina e divorceve" (2014). Ka shkruar gjithashtu edhe vëllimet me tregime "Ballo në mbrëmjen e maturës" 2001, "Këpucët e turpit" (2002), "Shtëpia pa pasqyra" (2006), "Këtë dimër nuk ra borë" (2016). Shkrimtari Skënder Temali ka shkruar edhe aforizma që përmbledhen në vëllimin "Një det pa dallgë s'është det" (2017) dhe është edhe autor tekstesh shkollore.

Veprimtaria krijuese e shkrimtarit Temali shtrihet në dy epoka; në epokën e letërsisë së traditës dhe në atë të pas viteve '90. Duhet thënë se në të dy epokat që shkroi dhe krijoi la gjurmë të pashlyera, duke

pasuruar me kontributin e tij krijues vlerat e letërsisë sonë kombëtare. I pajisur me vokacionin e artistit të fjalës dhe falë përvojave letrare dhe vëzhgimeve të mprehta, solli në të gjitha zhanret që trajtoi vepra me një vulë të spikatur originaliteti. Veprat e tij sidomos në poezi, u bënë të dashurura për lexuesit dhe u deklamuan nga breza të ndryshëm, veçanërisht nga nxënësit e studentët.

Me vdekjen e tij më 17 prill 2021, pas një beteje me covid 19, letërsia shkodrane dhe ajo kombëtare humbi një vlerë të vërtetë krijuese.

Pjerin MIRDITA

IN MEMORIAM EDUART GRISHAJ



Largimi i parakohshëm dhe tragjik nga jeta i kolegut dhe mikut tonë Eduard Grishaj, ishte një ngjarje e rëndë, e cila na shoqëroi ne të gjithëve si staf të rrjetit muzeal dhe jo vetëm, në fillim të këtij viti.

Eduardi ishte një koleg i mirë, mik dhe familjar shembullor. Ai u lind në qytetin e Shkodrës në vitin 1956, si bir i një prej familjeve me kontribute të veçanta për vendin dhe demokracinë. Formimin e tij intelektual, Eduardi, e vazhdoi në qytetin e lindjes edhe pse me vështirësi të shumta, pasi familja e tij ishte kundërshtarë e regjimit diktatorial komunist, duke bërë që kjo familje një pjesë të viteve t'i kalonte në internim.

Fillimi i viteve '90 do të ishte përcaktues për Eduardin dhe të vëllanë e tij, Alfonsin, sepse të dy do të kishin një kontribut të rëndësishëm në organizimin e lëvizjeve demokratike, që përfshinë vendin tonë dhe sidomos qytetin e Shkodrës. Eduardin e gjejmë në protestën e 14 janarit 1990, ngjarjet e 13 dhjetorit të po atij viti, apo në demonstratën e 2 prillit 1991. Në të gjitha këto ai ishte një ndër protagonistët dhe nismëtarët kryesorë, duke mos e kursyer kontributin e tij për liri dhe demokraci.

Eduardi u formua me dëshirën për historiografinë dhe shkencat shoqërore, duke shfaqur talent të padiskutueshëm në këto fusha dhe dashuri të madhe për librin. Që herët, në vitet e para të pluralizmit politik dhe shprehjes së lirë të mendimit, gjejmë në gazetatat lokale të Shkodrës disa artikuj të tij, të cilët kishin në qendër të tyre kulturën, traditën dhe trashëgiminë kulturore shkodrane. Ishte shumë i lidhur dhe krenar me origjinën e tij familjare, duke vazhduar aktivitetin e tij nën shpirtin frymëzues të të atit dhe gjyshit.

Aktiviteti i tij politik dhe kulturor do të vazhdonte edhe në vitet 2000, ku si fillim aktivizohet si këshilltar në Këshillin Bashkiak të qytetit e më pas, aktiviteti i tij vazhdon në Muzeun Historik të Shkodrës, si përgjegjës i koleksionit të arkeologjisë dhe fondit të bibliotekës personale të Arshi Pipës, dhuratë kjo kushtuar muzeut nga vetë familja Pipa. Gjatë viteve në muze, Eduardi bashkë me kolegët e tjerë, organizuan shumë aktivitete, ekspozita, takime, konferenca dhe biseda. Vlen të përmendet ndër to ekspozita kushtuar Luigj Gurakuqit, ku ai ishte kurator, duke realizuar një ndër ekspozitat më të bukura dhe profesionale në vite.

Nuk kursehej asnjëherë në ndihmën dhe takimet jo vetëm me studiues, autorë dhe profesionistë vendas e të huaj, por ndihmonte dhe orientonte shumë edhe studentët, në përzgjedhjen e bibliografisë apo edhe në punët e tyre shkencore. Të shumta janë figurat e përkujtuara në aktivitete të ndryshme apo konferenca shkencore nga Eduardi, ku në punimet e tij veçohen kurtesa mbi Migjenin, Luigj Gurakuqin, Arshi Pipën, Martin Camaj, Skënderbeun etj.

Si historian pranë muzeut "Vendi i Dëshmisë dhe i Kujtesës", po ashtu ai organizoi shumë aktivitete shkencore në përkujtim të figurave dhe ngjarjeve të rëndësishme për Shkodrën e Shqipërinë, ku vlen të veçohen aktiviteti në përkujtim të 20-vjetorit të ndarjes nga jeta të Arshi Pipës dhe aktiviteti "Që të mos harrojmë", kushtuar ngjarjeve të rëndësishme historike të Shkodrës, në vitet 1911-1914.

Mori pjesë në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, ku trajtoi

me kompetencë çështje historike e sociale, ku vlen të përmendet ajo e organizuar në Michigan, SHBA, nga Federata Pan-Shqiptare e Amerikës "Vatra", me titull "Gjergj Kastrioti -Skënderbeu në 550 vjetorin e vdekjes".

Eduardi në kujtesën tonë si kolegë, do të mbesë gjithmonë një profesionist shembullor, një mik i mirë dhe një pikë referimi dhe frymëzimi për të ardhmen. Nga ai kemi mësuar të gjithë shumë, sepse dijen e tij e vinte gjithmonë në shërbimin tonë dhe të institucioneve ku ka zhvilluar aktivitetin. Shkodra ishte qendra e tij e gravitetit dhe dashuria e madhe, edhe pse ndoshta mundësitë për emigrim dhe kushte shumë më të mira jetese në një vend të huaj nuk i kanë munguar. Prehu i qetë dhe në paqe Edi, mendimi dhe shpirti yt i lirë do të jenë gjithmonë i pranishëm mes nesh.

Nga kolegët e Bibliotekës "Marin Barleti", "Muzeut Historik Shkodër", "Vendi i Dëshmisë dhe i Kujtesës", dhe "Galeria e Arteve".

